monumentet

DO NOT COPY



2 / 1987

DO NOT COPY

KOPERTINA E PARË:

Eduard Lir: Berati, gravurë e shek. XIX

KOMITETI I KULTURËS DHE I ARTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

2/1987 (34)

KOLEGJIUMI I REDAKSISË

EMIN RIZA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZV/KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, GJERAK KARAISKAJ, GJERGJ FRASHËRI, HASAN NALLBANI,
NERITAN CEKA, PIRRO THOMO.

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Komitetit të Kulturës dhe Arteve

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Apollon BAÇE

Kullat, dhëmbëzimet dhe platformat për artileri të fortifikimeve në Iliri. 5

Aleksandër MEKSI

Të dhëna për teknikën e ndërtimit të kishave të shekujve VII-XV në Shqipëri 57

Prof. Dr. N.C. MUCOPULLOS

Rezultate të gërmimeve në bazilikën e Shën Akilit në Prespë 73

Koço ZHEKU

Glavinica dhe problemi i lokalizimit të saj 95

Gjergj FRASHERI

Kompleksi ndërtimor i hyrjes në kalanë e Krujës (gjurmime dhe konservime) 103

Maksim MITROJORGJI

Organizimi i hapësirës së jashtme në banesën me shtëpi zjarri-përgjatë dy kateve (Banesa e Tiranës) 139

Shuaip MANE

Kalaja e Goricës 147

Moikom ZEQO

Rezultate të kërkimeve arkeologjike në Karaburun e në Rrëzën e Kanalit. 153

Ferid HUDHRI

Monumente të Kulturës në vepra të autorëve të huaj 177

Valter SHTYLLA

Ndërtime të fortifikuara gjatë rrugëve mesjetare në Shqipëri (shek. XVIII-XIX) 189

Kristofor NASLAZI

Mësues Konstandini dhe disa nga ikonat e tij 195

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Page

ARTICLES

Apollon BAÇE

Les tours, les décrochements et les plates-formes d'artillerie des fortifications illyriennes 49

Aleksandër MEKSI

Données sur la technique de la construction des églises du XIIe sc au XVe sc 71

Prof. Dr. N.C. MOUTSOPOULOS (Grèce)

Résultats de fouilles à la basilique de Saint-Achilée à Prespa 85

Koço ZHEKU

Glavinica et le problème de sa localisation 101

Gjergj FRASHERI

Complexe de constructions à l'entrée de la forteresse de Kruja (Recherches et conservation) 136

Maksim MITROJORGJI

L'aménagement de l'espace extérieur de l'habitation dont la «maison du feu» va du rez-de-chaussée au premier étage 145

Shuaip MANE

La forteresse de Gorica 152

Moikom ZEQO

Résultats obtenus par les recherches effectuées dans la péninsule de Karaburun et dans Rrëza e Kanalit 174

Ferid HUDHRI

Les monuments culturels dans les oeuvres d'auteurs étrangers 188

Valter SHTYLLA

Constructions fortifiées le long des routes médiévaels en Albanie (XVIIIe-XIXe sc) 193

Kristofor NASLAZI

Maître Constantin et quelques-unes de ses icones 203

NR. 2 1987

monumentet

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

KULLAT, DHËMBËZIMET DHE PLATFORMA PËR ARTILERI TË FORTIFIKIMEVE NË ILIRI

Kullat, dhëmbëzimet dhe platformat për artileri të cilat mbizotërojnë brezin e mbrojtur dhe pikat e kërcënuara, duke siguruar në të njëjtën kohë mbulimin me zjarr anësor të mureve-perde (kurtinave): i janë nënshtruar një zhvillimi të vazhduar, në kundrapërgjigje të menjëhershme ndaj mënyrave dhe mjeteve të reja të luftimit. Këto elemente, krahas hyrjeve, janë treguesit më të qartë të nivelit të artit të fortifikimit dhe pika repere për datimin tipologjik të fortifikimeve[1]. Rrjedhimisht njohja e tyre lejon nxjerrjen në pah të parapëlqimeve e së veçantës, zbatimit krijues dhe zgjidhjeve specifike.

Zhvillimi dhe morfologjia e këtyre elementeve është trajtuar së fundi në një sërë botimesh për fortifikimet antike[2]. Por në këto studime ende nuk është gjetur emëruesi i përbashkët dhe një sërë problemesh kanë mbetur pa u prekur. Rrjedhimisht shtigjet për diskutim janë ende të hapura.

Trajtimin e grupuar të kullave, dhëmbëzimeve dhe platformave për artileri të fortifikimeve antike të vendit tonë e kemi ndërmarrë tetë vjet para, në kuadrin e një vështrimi sintezë për arkitekturën ushtarake ilire[3]. Por në këtë vështrim jemi mjaftuar me vënien në pah të dukurive, pa i spjeguar ato dhe pa marrë parasysh materialin ilir tej kufijve të sotëm politikë. Këto mangësi dhe rëndësia e këtyre elementeve, na shtynë për një ritrajtim, këtë herë në një artikull të veçantë. Përshkrimin e morfologjisë dhe ndjekjen e zhvillimit të tyre e kemi mbështetur në materialin faktik të truallit ilir, në radhë të parë të atij brenda territorit tonë, duke përvizuar njëkohësisht paralelet me ndërtimet bashkëkohore. Sasia dhe cilësia e fortifikimeve ilire, krahas homogjenizimit dhe barasecjes si pasojë e përfshirjes në të njëjtën sferë kontaktesh ekonomiko-shoqërorë dhe konfliktesh ushtarake me Greqinë dhe Maqedoninë, na lejon të marrim pjesë edhe në diskutimin për spjegimin e këtyre elementeve të arkitekturës ushtarake antike.

Artikulli synon ndaj kategorizimit të elementeve të mësipërme, spjegimit të disa prej dukurive dhe nxjerrjes së karakteristikave për periudhat e veçanta. Por jeta e pakëputur e shumicës së fortifikimeve, nga hekuri i parë në mos dhe më herët, e vështirëson lidhjen e fazave të fortifikimeve me shtresat përkatëse kulturale, duke e kufizuar kështu numrin e fortifikimeve me datim të sigurt. Si pasojë seritë e plota janë të mangëta, madje nganjëherë mungojnë dhe pikat repere. Në këtë drejtim artikulli paraqet një sprovë për shtresëzimin kohor të kullave dhe dhëmbëzimeve duke bashkërenduar me të dhënat e tjera dhe analizën tipologjike arkitekturore. Të mbështetur në këtë analizë disa prej qendrave të

---

1) Përcaktimi kohor i bazuar në tipologjinë stilistike të mureve duke i dhënë atij një përparësi absolute, siç është bërë nga mjaft autorë, ndër ta fillimisht edhe ne, në mënyrën e ndjekur deri më sot e ka treguar veten të pabazuar. Në të kundërt mjaft më e qëndrueshme është analiza e mbështetur në elementet arkitektonike të fortifikimit.

2) Kryesisht F. Winter, **Greek fortifications,** Toronto, 1971; A. Lawrence **The Greek** aims in fortification, (Towers and solid aquivalents-Towers, Revetted salients, Batteries, f. 376-398), Y. Garlan, **Recherches de poliercetique Grecque** Paris, 1974, J.P. Adam, **L'architecture militaire Grecque,** Paris, 1982 (Les tours f. 46 – 75).

3) A. Baçe, **Vështrim mbi arkitekturën e fortifikimeve antike në vendin tonë,** Monumentet, 17, 1979, f. 5 – 45.

fortifikuara i kemi përcaktuar ndryshe në kohë nga datimi tradicional, duke e argumentuar këtë për aq sa e lejojnë caqet e artikullit. Por nga ana tjetër theksojmë se artikulli paraqet një sprovë vetjake, pa synuar ndaj nxjerrjes së një ligjësie përfundimtare, e cila kërkon argumentin e saktë arkeologjik të bazuar në gërmime të gjera e të plota.

A. KULLAT

Kullat me gurë të papunuar

Kullat më të hershme që hasen në territorin ilir, ato me gurë të papunuar, kanë planimetri rrethore ose eliptike. Parimi i mbrojtjes së fortifikimeve të pajisura me kulla të tilla është i thjeshtë: mure të ulëta rrethuese me gurë të papunuar, më tepër në rolin e gjoksmbrojeve, të përforcuara në pikat e brishta (hyrjet dhe vendet e afrueshme) me platforma të gjera e relativisht të larta, prej nga mbizotërohej brezi mbrojtur[4]. Hezitimi tradicional për t'i pranuar këto ndërtime si kulla na duket i pavend[5].

Kullat me gurë të papunuar dëshmohen në një numër të madh në veri të Ilirisë, nga tokat e japodëve dhe istërve e deri në tokat e enkelejve dhe taulantëve[6]. Dendësimi i veçantë i tyre në territorin dalmat i ka shpënë një sërë studiuesish në përfundimin se ato janë një «veçori e rajonit dalmat»[7], ose «një fenomen i gjerë i territorit ilir ndoshta i shpeshtuar në rajonin dalmat»[8].

Krahas mbrojtjes, një pjesë të këtyre kullave u atribuohet një funksion thjesht kulti, për libacion e flijim, duke sjellë si shembull klasik Mandinën[9]. Por, pikërisht këtu, kulla ndodhet në pikën më të afrueshme dhe delikate të fortifikimit, duke ja lënë mbrojtjen e anëve të gjata rrëpirës (fig. 1), ndërsa atë të ballit të pjerrët perëndimor një muri të thjeshtë (fig. 2)[10]. Rrjedhimisht gjetja në të, dhe në një sërë kullash të tjera, e dëshmive të libacionit, enë-

4) Këtë dukuri e rihasim të qartë në fortifikimet e antikitetit të vonë: Në Bardhoc (rr. Kukësit), anët e gjata e të vështira për t'u ngjitur përforcohen me gjoksmbroje të ulëta të ndërtuara me mure të thata, me gurë të papunuar; kurse anëve të ngushta e të afrueshme ju kundërvihen balle të forta e të larta, me muraturë me llaç gëlqereje, në rolin e kullave (A. Baçe – L. Papajani, **Kështjella dhe monumente të tjera në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës,** Monumentet 1, 1983, f. 120).

5) N. Ceka **(Fortikimet parahistorike ilire** II Monumentet 1, 1986, f. 73) vë në dukje se emërtimi tuma kufizuese (limitni tumul) «shpreh ende pasigurinë për funksionin që kishin ato».

6) Në territorin Japod njohim 6 fortifikime të pajisura me kulla me gurë të papunuar (M. Guštin, **Gradišča železne dobe v sloveniji,** Arheološki vestnik Ljubljana, 1978, XXIX, fig. 5 – 5,8. R. Drechsler-Bizić; **Caracteristiques des agglomerations fortifies dans la region centrale de Japodes** Utvrdena ilirska naselja, Sarajevo, 1975, f. 78 – 79). Në territorin liburn 4 (S. Batović, **Prapovijesni ostaci na zadarskom otočju,** Diadora, 6, Zadar, 1973, f. 92 **Ostava iz Jagodinje Gornjem u Okviru zadnje faze** liburnske **kulture** Diadora, 7, 1974, f. 160 – 164, **Istrazivanje ilirskog naselja u Radovinu,** Diadora, 4, 1968, f. 53 – 69); në territorin Dalmat 30 (A. Benac **Utvrdžena ilirska naselja, I, Delmatske gradine na Duvanjskom polju, Buškom blatu, Livanjskom i Glamočkom polju,** Sarajevo, 1985, f. 13, 15, 16, 22, 26, 35, 39, 41, 42, 45, 50, 53, 55, 97, 99, 100, 114, 121, 129, 133, 134, S. Batoviç, **Prapovijesni ostaci** ... f. 92) në territorin Labeat 1 (P. Mijović, M. Kovačević, **Gradovi i utvrženija u Crnoj gori** Beograd, 1975, f. 9). Në territorin e Enkelejve 2 (Gj. Karaiskaj – P. Lera, **Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në rrethin e Korçës,** Kuvendi i I i Studimeve Iliro, Tiranë, 1974, I, f. 265. N. Ceka – A. Baçe, **Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit,** Monumentet, 3, 1972, f. 205) dhe në territorin taulant 1 (N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike ilire (I)** Monumentet 1, 1985, f. 32). Mungesa e dëshmive në territorin epirot, nuk na shpie në ndonjë përfundim të prerë mbasi pjesa në territorin e sotëm të Greqisë është plotësisht e pagjurmuar. Krahas kësaj shumica e qendrave nën Naronë (Neretvë) i janë nënshtruar një zhvillimi më intensiv, me pasojë zhdukjen e gjurmëve të hershme.

7) M. Zaninović, **Ilirsko pleme delmati,** Godišnjak centra za balkonološko ispitivanija, IV, 2, 1966, f. 144, S. Maxhar, **Najstarija arkitektura u Boki Kotorskoj,** Boka, 1, Herceg Novi, 1969, f. 28, J. Medini **Makarsko primorje u antici,** Makarski žbornik, Omish, I, 1971, f. 14 (Dy autorët e fundit cituar sipas S. Batoviçit **(Prapovijesni ostaci...** f. 92).

8) S. Batovic **Po aty.**

9) A. Benac, **(Quelques Caracteristiques...,** f. 87; **Utvrdena naselja...** f. 198) sjell si shembuj Mandinën, Libin, Kukun, Crvenicën, Shiljakun.

10) A. Benac, **Utvrdzena naselja...,** f. 16. Planimetria 2 dhe fotografija 8 e tregojnë fare qartë këtë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

ve dhe kockave të kafshëve, nuk e përjashton rolin kryesor mbrojtës. Madje, kthimi i tyre në objekte adhurimi, mendojmë se e përvizon rolin e veçantë të këtij elementi në sistemin e fortifikimit, deri në kthimin e tij në simbolikë të mbrojtjes.

Konstruksioni. Shumica e kullave të mësipërme sot ka trajtën e pirgjeve, grumbujve me gurë të thyer, me diametër 10-35 m, lartësi 2-6 m dhe profilin e stabilitetit natyror të çakëllit – gurit të thyer (rreth 20 – 30°). Një konstruksion i tillë pa dyshim që është i papërshtatshëm për luftim, jo më në shekujt e fundit të erës sonë, kur sipas burimeve antike fortifikimet dalmate të pajisura me kulla të tilla ju bënë një rezistencë serioze trupave pushtuese romake[11], por as edhe në nismën e tyre, në periudhën e bronxit të vonë[12]. Logjikisht kjo masë duhet të mbështillej në një strukturë me faqe vertikale ose pak të pjerrëta, me diametër më të vogël, rreth 10 – 15 m, dhe lartësi rreth 6 – 7 m.[13]. Kjo strukturë mund të arrihej nëpërmjet përdorimit të llaçit prej argjile[14], ose me një armaturë shtrënguese prej dërrasash dhe trarësh. Gjurmët «in situ» të një konstruksioni të tillë në muret e fortifikimeve bashkëkohëse japodë në Stiçna dhe Metul (Appian, illyr. 19, 21)[15], i japin mjaft vërtetësi kësaj hipoteze.

Struktura e këtyre pirgjeve njihet më mirë në Mallij Obljaj dhe Mandinë, ku janë kryer gërmime arkeologjike[16]. Në të parin pirgu ka një bazament eliptik prej dheu 2 – 2,5 m të lartë, mbi të cilin vijon mbistruktura prej guri, sot 0,5 metërshe. Në Mandinë bazamenti i poshtë, 3,8 m i lartë, përbëhet prej gurësh të përzier me dhe argjilor, ndërsa mbistruktura 1,2 metërshe prej gurësh. Konstrukt të tillë kanë dhe kullat në Peçane dhe Andxheliça Lipa[17]. Por në shumicën e qendrave të tjera e tërë struktura ka qenë e gurtë.

---

11) A. Benac, **Utvrdzena naselja...**, f. 194.

12) A. Benac, **Po aty.**

13) Duke marrë si shembull tipik kullën e Mandinës, sot kësulë sferike me diametër të poshtëm 30 m dhe lartësi 5 m. del se vëllimi i masës së gurtë, ka qenë 1400 m^3. Kjo do t'i përgjigjej një diametri rreth 15 m dhe lartësie rreth 6-7 m.

14) Kulla ovale, në formë të shkronjës «U» (4.5 x 4-5,5 m), rreth 8 m larg njëra-tjetrës, hasen në v. 2500 p.e.sonë në fortifikimin e Helandrianit në ishullin Syros (Zschietschman **s.v. Syros,** P.W.R.E., ser. II, vol. IV, col. 1789, v.). Muret e këtyre kullave janë prej gurësh të thyer të lidhur me baltë. Një shembull edhe më të hershëm, ndonëse më të largët, paraqet kulla e Jerikosë, sipas R. Braidwood e mijëvjeçarit të VII (R. Braidwood, **Jericho and its setting in new eastern,** History, Antiquity, XXXI, 1957, f. 73 – 81, tek J. Adam, **vep. cit** f. 8 foto 1). Klima pa rreshje e ka ruajtur mjaft mirë në lartësi kullën dhe llaçin prej argjile që lidhte gurët.

15) S. Gabrovec, **Überblick über eisenzeitliche Befestigungen in Slovenien,** UIN, f. 63-69. K. Pik. W. Schmied, **Fruhgeschichtliche Befestigungsanlagen in Bereiche der Isonzofront,** Jahreshefte des Österreichischen archaologischen Institutes, Wien, 1922, XXI-XXII, f. 280 – 295.

16) R. Drechsler – Bizić, **Vep. cit.** f. 78.

17) R. Drechsler – Bisić, **Vep. cit.** f. 79, A. Benac, **Utvrdena naselja...** f. 135.



Fig. 3

Kullat me gurë të papunuar hasen në mbrojtje të hyrjeve, përgjatë mureve dhe në qendër të fortifikimeve.

1) Kullat në mbrojtje të hyrjeve i përmbahen tri



Fig. 4



Fig. 5

skemave: në afërsi të hyrjes, me një kullë anësore dhe me dy kulla anësore.

Skemën e parë e hasim në fortifikimin e Privalit[18] (fig. 3), ku hyrja mbrohej prej një kulle të brendshme, në mes të murit – perde. Kulla ndodhet rreth 20 m larg hyrjes, brenda rrezes së hedhjes së ushtës. Këtë skemë e rihasim në Kerin[19] (fig. 4), ku kulla qëndron e lirë, e palidhur me muret, dhe në Lleshan[20] (fig. 5), ku kulla përfshihet në trasenë e jashtme të murit, duke kryer njëkohësisht kontrollin e kalimit nga juglindja. Së fundi në fortifikimin liburn të Zagroviçit[21], hyrja mbulohej prej një muri, i cili bigëzohej nga rrethimi kryesor duke krijuar një farë oborri të fortifikuar. Kulla e cila ndodhej në fundin e murit, e kontrollonte mirë kalimin për në hyrje dhe vetë hyrjen. Por kjo skemë sillte shkëputjen e kullës dhe mbrojtësave të saj nga rrethimi kryesor në çastin e marrjes së oborrit, ç'ka dëshmon për një stad

18) A. Benac, **Utvrdena naselja...**, f. 42 – 44.
19) M. Guštin, **Vep. cit,** fig. 5, Nr. 5.
20) N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike...** I, f. 32.
21) S. Batović, **Caracteristiques des agglomerations fortifiées dans la region des liburniens,** Godišnjak, Sarajevo, 1977, XV, fig. 2.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6

ende primitiv luftimi, kur sulmet ishin të shkurtra, kalimtare.

Skemën me kullë anësore e gjejmë në fortifikimin liburn në Radovinë (fig. 6)[22], ku hyrja e vetme mbrohej nga e majta prej një kulle të përshkruar mespërmes prej murit, në fortifikimin Japod të Çepnës[23] dhe në fortifikimin liburn të shek. V p.e.sonë në Jagodinjën e sipërme[24]. Në këtë të fundit kulla zhvillohej në brendi të murit, ngjitur me hyrjen.

Hyrjet e mbrojtura nga dy kulla anësore përfaqësohen qartë në fortifikimin – binjak japod të Obljajit[25] (fig. 7). Në Veliki Obljajin, hyrja e vetme e fortifikimit mbrohej nga dy kulla anësore. Fortifikimi tjetër, Mallij Obljaji përshkohej mespërmes nga dy hyrje, të mbrojtura anash po nga dy kulla. Skemën me dy kulla e hasim dhe në fortifikimin japod të Mekinjarit[26] dhe fortifikimin enkeleas, 15 hektarësh në Bllacë (rr. Pogradecit)[27]. Në këtë të fundit muri rrethues verior që zbret nga dy majat e kundërta drejt një lugu të ulët, përshkohet mespërmes nga hyrja e mbrojtur anash prej dy kullash.

Sipas nesh nga këto skema më e hershme është e para, më primitive dhe jo aq e arritur. Të dy skemat e tjera paraqesin koncepte të përparuara, racionale, të cilat rihasen rëndom në fortifikimet e shek. IV p.e.sonë e këtej. Ky shtresëzim përkon dhe me të dhënat arkeologjike.

2) Kullat përgjatë mureve, hasen në një sërë fortifikimesh. Në qendrat e hershme, si Privali (fig. 3), shpërndarja e tyre është disi e parregullt, por në fortifikimet e tjera ajo është e studiuar. Fortifikimet me sipërfaqe të vogël, mbizotëruese në numër, zakonisht përforcohen prej një kulle të vetme. Tipik ndër ta është fortifikimi dalmat i Gubinski Gradit (rreth 0,5 ha)[28], ku pllajëza rrethohet me mure të ulëta, duke ia lënë anën lindore mbrojtjes nga terreni i thikët (fig. 8). Por ana e afrueshme perëndimore



Fig. 7



Fig. 8

22) S. Batoviç, **(Istriživanie u Radovinu...,** f. 58), i bazuar në gërmimet arkeologjike, e daton themelimin e Radovinës në shek. e IV p.e.sonë. Sipas tij në muret dallohen dy faza, që ai nuk i përcakton në kohë, duke na dhënë kështu vetëm një «terminus post quem» për hyrjen dhe kullën.

23) M. Guštin, **vep. cit,** fig. 5, Nr. 8.

24) S. Batović, **Ostava iz Jagodinje...,** f. 160-164, fig. 1.

25) R. Drechsler – Bizić, **vep. cit,** f. 78.

26) R. Drechsler – Bizić, **vep. cit,** f. 79.

27) N. Ceka – A. Baçe, **vep. cit,** f. 215-216.

28) A. Benac, **Utvrdena naselja...** f. 126, plan 20.

përforcohet prej një kulle, e cila konturohet mirë duke u shkëputur qartë nga muret[29], Qendrat e tjera, më të mëdha, si Andzheliça Lipa, Gradina Privali dhe Lleshani (fig. 3,5) përforcoheshin nga disa kulla. Sistemin me disa kulla e hasim edhe në fortifikimet e vogla, por të vonë në kohë, si Mallij Obljaji (fig. 7), kur përveç 4 kullave në mbrojtje të hyrjeve, në mesin e murit jugor, shihet dhe një kullë e pestë[30].

3) Kullat në qendër të fortifikimeve janë tipike në fortifikimin labeat në Gradovë dhe atë të enkeleas në Ventrok[31]. Në Gradovë (fig. 9) muri mungon nga ana e rëpirrtë duke ja lënë mbrojtjen një kulle të vetmuar, ndoshta në rolin e kryekullës të fortifikimeve mesjetare, si pikë koordinuese veprimesh dhe mbrojtje e fundit e luftuesve.

Datimi. Sondazhet dhe gërmimet në fortifikimet e mbrojtura me kulla me gurë të papunuar, tregojnë se ato i përkasin 3 gjeneratave kryesore[32] I) 1000-800 p.e.sonë (Prival, Petroviç, Mandina) II) 800-600 p.e sonë (Radivinë Lib, Letki, Mish), III) 600-500 p.e.son (Selimoviç, Bastas, Andzheliça Gradina), me vazhdi mësi deri nga v. 400-300 p.e.sonë (Jagodinja, Oblja ji). Mbijetesa e tyre, të paktën deri nga mesi i shek II p.e.sonë, tregon për një tradicion të pandërprerë që shprehet në vazhdimin e konceptit të mbrojtjes m zjarr të përqendruar nga platforma të gjera, të larta të projektuara para linjës së mureve.



Fig. 9

Kullat me blloqe të përpunuara ashpër

Në sajë të futjes masive të veglave prej hekuri nga shekujt VIII-VII p.e.sonë, muret e një sërë fortifikimesh nisën të ndërtohen me blloqe të mëdhenj, të përpunuar ashpër. Kjo teknikë bashkësolli një strukturë më të qëndrueshme, vijat e drejta dhe kthesat me kënd të mureve.

Përcaktimi kohor i këtyre fortifikimeve në bazë të tipologjisë është i pamundur, pasi në zonat me zhvillim të zbehtë ata vazhduan të ndërtohen edhe pas lindjes së fortifikimeve me blloqe të latuar, deri nga shek. II-I p.e.sonë. Rrjedhimisht për qendrat ku nuk është kapur shtresa kulturore, koha e lindjes se fortifikimit, përkatësisht e kullave, mbetet ende e hapur. Por për një numër të kufizuar fortifikimesh, sondazhet dhe gërmimet e lejojnë në një farë mase përcaktimin kohor, të tyrin dhe të kullave. Në muret e fortifikimit dy hektarësh të Dorzit, faza e parë e të cilit i përket të paktën mesit të shek. VI p.e.sonë[33], kulla drejtkëndëshe, ndodhet nga fundi i fortifikimit, ku muret takojnë greminën (fig. 10). Ruajtja e mureve të kësaj faze vetëm për 120 metrat e fundit dhe pozicioni fundor i kullës të shtyn të mendosh për praninë e kullave të tjera. Krahas kësaj, gjurmë të tjera tregojnë gjasisht për praninë e një kulle të brendshme, në mbrojtje të hyrjes. Një kullë të tillë,

29) Këtë tip e gjejmë të qartë dhe në fortifikimet dalmate në Mandina (fig. 2), Lib, Mrkodol, Kovaçin, Stipaniç, Buhevo, Selimoviça, Mish, Prisoj, Vidosh (A. Benac, **Utvrdena naselja...**, plan. 2,3,5,6,8,10,11,14,15,16) në Libnën Japode etj.

30) Në të kundërt në Obljajin e madh ka vetëm 2 kulla çka tregon se nga këto dy fortifikime binjake Obljaji i vogël ishte më i mbrojtur, me sa duket në rolin e një kështjelle rifuxhio.

31) P. Mijoviç – M. Kovaçeviç, **vep. cit,** f. 8 – 9, Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet prehistorike në Shqipëri,** Monumentet 14, 1977, f. 24.

32) Këtë ndarje e kemi kryer duke u mbështetur në fortifikimet e datuara mirë nga gërmimet dhe sondazhet e A. Benacit **(Utvrdena naselja...,** f. 190 – 194) dhe S. Batoviçit **(Ostava iz Jagodinje...** f. 53 – 69; **Istrazivanije u Radovinu...** f. 58).

33) Shtresa kulturale e mesit të shek. VI p.e.sonë jep një «terminus ante quem» për fazën e I të fortifikimit (N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike** (II) f. 56). Po ky autor tregon dhe për kullën në mbrojtje të hyrjes. Por në planimetrinë përcjellëse (fig. 16) ai e vendos kullën perëndimore në mënyrë të gabuar në brendi të fortifikimit.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 10

po të brendshme dhe po në mbrojtje të hyrjes, e gjejmë të qartë në fortifikimin e mesit të shek. V p.e.sonë. në Belishovë[34]. Ky tip kulle përkon mirë në kohë me fortifikimet helene, ku kulla e brendshme lindi nga shek. VII-VI për t'u zhdukur nga mesi shek. V p.e.sonë[35]. Të periudhës së parë të hekurit duket se janë dhe kullat drejtkëndëshe në fortifikimin 1.50 hektarësh të Akrolisit[36] dhe fortifikimin 0,30 hektarësh të Kratulit (rr. Shkodrës)[37]. Në këtë të fundit kulla ndodhet në anën lindore të planimetrisë ovale të fortifikimit, prej nga sulmi ishte më i lehtë. Kjo kullë, drejtkëndëshe dhe e zhvilluar mirë (6.7 x 4.4 m), lidhet organikisht me murin duke ju përmbajtur së njëjtës teknikë punimi. Këtë strukturë e gjejmë dhe në fortifikimin Kaon 0.23 hektarësh të Pepelit (rr. Gjirokastrës), gjasisht të shek. VI-V p.e.sonë[38], me planimetri po ovale dhe një kullë të vetme, e cila pa marrë përsipër mbrojtjen anësore të mureve, mbulon pikën më të afrueshme (fig. 11). Më i hapur mbetet datimi i një sërë qendrash të tjera. (Vrgada

34) N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike** (II), f. 52.

35) A. Lawrence, **vep. cit,** f. 376 – 398.

36) Kulla me blloqe paralelopipedë të punuara ashpër lidhet nga P. Lera në sajë të gërmimeve që kryen në këtë pikë me fazën e parë të fortifikimit (P. Lera, **Rezultatet e gërmimeve në Akrolis,** Kumtesë në sesionin vjetor të v. 1984 të Q.K.A.).

37) Gj. Karaiskaj, i cili e vëren këtë lidhje organike, e daton kullën në shek. IV-III (**Kalaja e Kratulit,** Shtëpi muze, Tiranë, 1981, f. 109-111). F. Fistani (**Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit,** Iliria 1983, 1, f. 109-117) i bazuar në materialin arkeologjik e daton fortifikimin në periudhën e parë të hekurit, por heziton të shprehet nëse kulla është e njëkohshme me murin apo është shuar më vonë.

38) Duke u nisur nga teknika, trajtimi arkitektonik, dhe fakti se në luginën e Drinos fortifikimet që i përmbahen dy fazave, shek. IV-dhe I-III p.e.sonë janë punuar me blloqe të latuar, fortifikimin e Pepelit e kemi parë si të shek. IV-V p.e.sonë. (A. Baçe, **Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos,** Monumentet, 4, 1972, f. 106). N. Ceka, (**Fortifikimi antik i Butrintit,** Monumentet 12, 1976,) duke u nisur nga prania e kullës e daton atë në shek. IV p.e.sonë.



Fig. 11

në territorin Dalmat (fig. 12), Samobori (fig. 13), Renci, Ganjolla në territorin Labeat, të cilat deri më sot janë datuar në shek. IV-III p.e.sonë, pikërisht në sajë të pranisë së kullave[39].

Në vështrim të parë pajisja me kulla e fortifikimeve të vogla, kryesisht 0.15 – 0.50 hektarësh, me mure me blloqe të përpunuara ashpër, në një kohë kur kullat mungojnë në muret e qyteteve, të ndërtuara me blloqe të latuara, duket paradoksale. Por, ky inversion vihet re edhe në arkitekturën ushtarake helene, ku kulla me planimetri të zhvilluar, e cila deri nga shek. VI p.e.sonë mungon thuajse në tërë qytetet, haset në fortifikimet e vogla[40], deri dhe në rajonet e pazhvilluara, si në Danubin e Sipërm, në fortifikimin autokton të v. 520 p.e.sonë në Hojneburg (Baden – Würtenberg)[41]. Kjo dukuri mendojmë se spjegohet me faktin se muret e qyteteve të ndërtuara me blloqe të latuara, falë strukturës më të qëndrueshme, arrinin një lartësi të madhe, rreth 8 m, mbi cakun e sulmit me shkallë. Në të kundërt muret e fortifikimeve me blloqe të përpunuara ashpër luhaten rreth 4 m. (Mashkjezë rr. Fierit)[42], lartësi kjo e ngjitshme me shkallë. Në kushtet e gadishullit ballkanik, ku ndryshe nga lindja e afërt mjetet dhe mënyrat e sulmit ishin ende të prapambetura[43], ndërsa terrenet e thyera mund të siguronin një mbrojtje të fuqishme natyrore, muret e larta mbrojtëse të qyteteve të kësaj kohe mund ta merrnin përsipër mbrojtjen pa u përforcuar me kulla[44]. Ndryshe prej tyre në fortifikimet e vogla me mure të ulëta, ndihej nevoja e mbulimit të pikave të brishta nëpërmjet një zjarri të përqëndruar, i cili mund të sigurohej vetëm nga kullat. Në të vërtetë kullat e vetmuara të këtyre fortifikimeve të cilët nuk mund të arrinin kurrsesi mbulimin anësor të mureve-perde, flankimin,

39) Kullat e Vrgadës i njohim nga materiali fotografik i prurë prej S. Batoviçit (**Prapovijesni ostaci...** tab. LII-LV) i cili çuditërisht nuk i përmend ato në përshkrimin dhe skicën përkatëse. Samobori datohet tipologjikisht prej C. Prashnikerit – A. Shoberit **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien, 1920, f. 91-94) në shek. e IV p.e.sonë, ndërsa N. Ceka, (**Fortifikimet parahistorike** II, f. 58) e zbret këtë datë në shek. IV – III p.e.sonë. Renci sipas Gj. Karaiskajt **(Gjurmë fortifikimesh ilire në disa kështjella të rrethit të Shkodrës** Buletin arkeologjik, 4, Tiranë, 1974, f. 152) datohet, po tipologjikisht, në shek. e IV p.e.s. Kullën në fortifikimin e Ganjollës e kemi parë të ndërfutur në periudhën e II të hekurit në fortifikimin paraekzistues të bronxit të vonë-hekurit të hershëm (A. Baçe, **Vështrim...** f. 18). Datimet tipologjike të Prashnikerit dhe Shoberit janë pasojë e paragjykimit, në një farë mase të kuptueshme për kohën dhe informacionin në dispozicion, se ilirët mund të ndërtonin vetëm mure të tipit të Gajtanit ndërsa muret me blloqe të latuar i përkisnin mjeshtrave Grekë. Si pasojë ata kërkojnë bashkëkohësi dhe në qendra të diferencuara qartë në kohë, si Gajtani dhe Lisi. Datimet tipologjike të N. Cekës, Gj. Karaiskajt dhe të miat janë pasojë e shikimit të kullës si një element i huazuar vonë.

40) Ndër to mund të përmendim Larisën Eole 0.30 hektarëshe, të çerekut të fundit shek. VI, me kulla të mirëfillta të zbrazëta në katin e parë (A. Lawrence, **vep. cit,** f. 35, F. Winter, **vep. cit,** f. 152, 297), Sifnosin 0.90 hektarësh (A. Lawrence **vep. cit.** f. 32) si dhe shembuj të shumtë në Siçili, Azi të vogël, Provanse (A. Lawrence **vep. cit.** f. 35).

41) K. Bittel – A. Rieth, **Die Heuneburg an der oberen Donau,** Germania, 32, 1954, f. 22; 49, 1971, f. 63.

42) N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike** (II) f. 51, 55. Autori e daton Mashkjezën në sajë të gërmimeve në fund të shek. VII p.e.sonë.

43) Mënyrat e fortifikimit në lindjen e afërt dhe roli i tyre për zhvillimin e arkitekturës ushtarake mesdhetare përshkruhet mjaft qartë nga A. Lawrence (**vep. cit.** Part. I. **Relations of Greek to preceding military architecture** f. 3 – 39).

44) Për këtë problem F. Winter, **vep. cit,** f. 154-160.

DO NOT COPY

kryenin pikërisht kontrollin e pikave të afrimit të mundshëm. Këto parime, mbrojtja e hyrjeve dhe pikave të brishta, siç e pamë më lart, qenë dhe parime bazë në fortifikimet e mbrojtura me kulla me gurë të papunuar. Rrjedhimisht në këtë drejtim mund të përvizojmë lidhjen konceptuale ndërmjet këtyre dy tipeve të fortifikimeve dhe kullave[45]. Por nga ana tjetër duhet të vëmë në dukje se kullat me blloqe të përpunuara ashpër, megjithë zhvillimin e plotë planimetrik, për shkak të teknikës ende të dobët dhe përmasave të kufizuara, vështirë se e 'kalonin në lartësi murin-perde.[46]



Fig. 12

Kullat me blloqe të latuar

Fundi shek. VI – fillimi shek. V p.e.sonë shënoi në Iliri lindjen e qyteteve të fortifikuar me mure të ndërtuar me blloqe të latuar[47], sipas teknikës së re të huazuar mjaft herët nëpërmjet arkitekturës helene. Që nga kjo kohë arkitektura ushtarake ilire ingranohet plotësisht me arkitekturën ushtarake bashkëkohëse, duke ndjekur ritmet e kohës. Rrjedhimisht dhe zhvillimi i kullave i nënshtrohet rregullave të përgjithshme, ndonëse nuk mungojnë parapëlqimet dhe zbatimet krijuese.

Raporti i kullave ndaj traseës (shpeshtësia dhe vendosja). Shpeshtësia e kullave është në funksion të terrenit, kohës dhe përmasave. Me rritjen e pjerrësisë, numri i kullave pakësohet deri në zero, dukuri e vetkuptueshme, pasi në terrenet e pjerrët sulmi vështirësohej tepër dhe afrimi i makinave ishte i pamundur. Për më tepër në 38% të rasteve të njohur, në terrenet e thikta e të pangjitshme[48] mungojnë tërësisht jo më kullat, por vetë muret – perde. Prania dhe shpeshtësimi në kohë i kullave është në funksion



Fig. 13

45) N. Ceka (**Fortifikimet parahistorike II,** f. 73) shprehet në të kundërt se «rritja e funksionit mbrojtës të murit, si rrjedhim i zgjerimit të tij solli zhdukjen e këtij elementi (A.B. Kullës me gurë të papunuar) që logjikisht duhet të kishte evoluar drejt kullës».

46) Në këtë drejtim ato do përkonin më tepër me «bastjonet» e përmendur nga F. Winter (**vep. cit,** f. 153) në shekullin e IX-VIII, të cilat sipas A. Lawrence (**vep. cit,** f. 376) kalojnë në kulla të mirfillta nga fundi shek. VII p.e.sonë.

47) S. Islami, **Probleme të kronologjisë së qytetit ilir,** Iliria, 6, 1976, f. 101-112 e sheh lindjen e qytetit dhe fortifikimeve me blloqe të latuar nga fundi shek. V. Kësaj date i përmbahet dhe N. Ceka, **Lindja e jetës qytetare tek ilirët e jugut,** Iliria, 1983, 2, f. 135-192. F. Prendi, **Urbanizimi i Ilirisë së jugut në dritën e të dhënave arkeologjike,** Iliria, 4, 1976 f. 89-100 e shtyn këtë datë nga kapërcyelli shek. VI-V. Me këtë mendim jemi bashkuar dhe ne (A. Baçe, **Vështrim...**).

48) Këto të dhëna i kemi nxjerrë mbi një seri prej 103 fortifikimesh me trase të qartë mbrojtëse.

DO NOT COPY

të futjes së mjeteve dhe mënyrave të reja të luftimit. Kështu muret e hershme të qytetit koloni të Apollonisë, të fillimit shek. VI p.e.sonë, vijonin të papërforcuara me kulla. Trase të pastërta, të papërforcuara me kulla kanë dhe qytetet e fundit të shek. VI p.e. sonë. Karakteristik për këtë grup është qyteti 14 hektarësh në Paliaroforon[49]. Traseja e tij e shqetësuar, por pa kulla, përshkohet nga dy hyrje të thjeshta. Qeramika atike e viteve 525 – 500 p.e. sonë, dhe veçoritë e mësipërme përputhen mirë me njëra-tjetrën duke na shpënë në çerekun e fundit të shek. VI p.e.sonë. Këto veçori, hyrjet e thjeshta, fugatura jo krejt e përsosur, mungesa e vijave të peshimit dhe kullave, karakterizojnë dhe qytetin 39 hektarësh të Kasopesë[50]. Por traseja këtu vijon e qetë dhe muret-perde janë tepër të gjata. Mbroj tja e këtyre qyteteve me trase të pastër, pa kulla, besohej tërësisht mureve, të cilët në Velian arrinin deri në 8 m lartësi, mbi cakun praktik të ngjitjes me shkallë[51].

Ndryshe prej qendrave të mësipërme, fortifikimi i qytetit bylin 18 hektarësh të Nikaes, i kapërcyelli shek. VI-V p.e.sonë ka tipare më të evoluara (fig 14). Ndonëse fugatura mbetet po në atë nivel mungojnë vijat e peshimit dhe hyrja është një e vetme, në të vihet re pranija e tri kullave[52]. Prej tyre kulla e skajit jugperëndimor i shmanget skajit, duke

49) Kjo kuptohet nga sondazhet e C. Praschniker (**Muzakhia und Malakastra,** Wien 1920, f. 24, 28) dhe gërmimet e S. Anamalit (**Gërmimet në Apolloni**, Studime Historike, 1, 1964, f. 129 v.).

Qeramika atike e v. 525-500 p.e.sonë (N. Hammond, **Epirus,** Oxford, 1967, f. 52), traseja pa kulla, muratura lesbike me fuga të lakuara e të spërdredhura dhe mungesa e vijave të peshimit (S. Dakarie **Casopaia and the Elean Colonies, Ancient Greek Cities,** Athenes, 1971, 4, fig. 43,44,47), të cilat hasen rëndom në fortifikimet e shek. V p.e.sonë, përputhen mirë me njëra-tjetrën, duke e datuar fortifikimin e Paliaroforonit nga fundi shek. VI p.e.sonë.

50) Në Kasope gërmimet e S. Dakarisit kanë zbuluar një sërë elementesh arkitektonike të shek. V p.e.sonë. Krahas kësaj arkitektura e fortifikimit ka tipare arkaike: fugatura nuk është krejt e përsosur, mungojnë kullat dhe vijat e peshimit, hyrja është një e vetme, primitive, mbulimi i saj me hark rrethor dhe vija e peshimit në shpatullat, mendojmë se i përket një faze të dytë. Në të vërtetë muri i brendshëm i njëkohshëm ose dhe më i vonshëm është pajisur me hyrje me qemer të rremë dhe vijat e peshimit nuk hasen kund. Në të mirë të këtij datimi flet paraqitja e tij si qyteti i zhvilluar plotësisht në gjysmën e parë të shek. IV. Kështu në v. 360 – 355 ai përmendet në listën e theorodokëve të Epidaurit **(IG IV² 95),** ndërsa para v. 343/2 ai ka monedhë të tijën (P. Franke **Die antiken Münzen von Epirus,** 1961, f. 55, 69). Sistemi i rregullt urbanistik ortogonal nuk flet kundër këtij datimi, pasi në qytetet e «Magna Graecia-s» ai haset rëndom në shek. e VI. Për datimin e mësipërm nisemi dhe nga përfundimi logjik, se një qytet i fuqishëm i cili huazon teknikën e punimit duke shpenzuar fonde tepër të mëdha për fortfikimin, nuk do kish pse të mos huazonte dhe elementet arkitektonike, kullat, hyrjet e zhvilluara deri dhe vijat e peshimit. Për më tepër këto nuk janë elemente mode, por elemente thelbësore për t'iu kundërpërgjigjur mënyrave të reja të luftimit.

51) Muret rrethuese të qytetit 10 hektarësh në Velian, të papërforcuara me kulla dhe hyrje fare të thjeshta, ruhen deri në 5.70 m lartësi, (N. Hamond, **vep. cit,** f. 71-72). Duke i shtuar asaj gjoksmbrojen, lartësia e murit rezulton rreth 8 metrave. A. Lawrence **(vep cit,** f. 5), i mbështetur në burimet ushtarake, e quan lartësinë 8 m tej cakut të ngjitjes.

52) Përshkrimi i fortifikimit nga C. Praschniker **(Muzakhia und Malakastra,** Wien, 1922, f. 84-88), i saktësuar nga L. Papajani **(Qyteti ilir në Klos,** Kuvendi i I i Studimeve ilire, Tiranë, 1974, f. 516,) i cili e daton fortifikimin në shek. e V p.e.sonë. Nga mbarimi i shek. V p.e.sonë atë e daton N. Ceka. Por gërmimet arkeologjike tregojnë praninë e gjerë në pika të ndryshme të fortifikimit të qeramikës së lluksit, vendëse dhe të importuar, të fundit shek. VI p.e.sonë. (L. Papajani, **Gërmimet arkeologjike të v. 1973 në Klos të Mallakastrës, Iliria** 3, 1974, f. 456-7, **Gërmimet arkeologjike të v. 1974-75 (Klosi),** Iliria, 6, 1976, f. 347). Zënia e tërë sipërfaqes 18 hektarëshe të Nikaes nga ndërtesat dhe lindja prej saj e qytetit – bijë të Bylisit me sipërfaqe 32 hektarë në mesin e shek. IV (N. Ceka, **Bylisi,** Fieri, Almanak, 1976, Tiranë, 1978 f. 26, 31). do të kërkonte një interval kohor më të gjatë se 40-50 vjet. Por edhe në se do ta pranonim këtë interval do duhej të kishim një afëri në tiparet arkitektonike dhe ndërtimore. Kështu blloqet poligonale të mureve të Nikaes i kanë fugat jo dhe aq preçize, mungojnë vijat e peshimit, karakteristike për fortifikimet e shek. V p.e.sonë e këtej, hyrja është një e vetme dhe kullat mjaft të pakta e të pazhvilluara. Në të kundërt, Bylisi ka një muraturë të përsosur izodomike, kulla të zhvilluara mirë, vija peshimi në çdo skaj dhe të paktën. 5. hyrje. Nga ana tjetër në Nikae vërehet një rindërhyrje masive me këtë teknikë, e cila do justifikohej vetëm pas një kohe të gjatë.

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 14

e lënë të pambuluar anën jugore, dhe qëndron 100 m larg hyrjes pa marrë përsipër mbrojtjen e saj. Një shmangie e tillë vërehet dhe në kullën veriore. Së fundi balli i hyrjes tangenciale mbrohet prej një kulle të pazhvilluar mirë. Kullat e mësipërme tepër të rralla, ende të pasigurta dhe rudimentare, shërbenin për mbrojtjen e kalimeve të mundshëm dhe jo për mbulimin anësor të mureve – perde.

Qyteti 15 hektarësh i Amanties, i gjysmës së parë të shek. V p.e.sonë[53], ka trase më të përpunuara, hyrje e dhëmbëzime më të shumtë në numër dhe mure të pajisur me vija peshimi. Në anën jugore, të cënuar pak nga rindërtimi, ruhen 3 kulla të kësaj periudhe. Shpërndarja e tyre është më e studiuar, e kombinuar me lëvizjet e trasesë, por prej tyre ende nuk arrihej mbulimi anësor. Këto dy karakteristika, mbrojtjen e pikave të brishta dhe mungesën e mbulimit anësor, e hasim dhe në kështjellën kaone në Labovën e Kryqit, ku një kullë i kundërvihet afrimit të mundshëm nga lindja, ndërsa mbrojtja e hyrjes i besohej kullës tjetër[54].

Fortifikimet e mësipërme ndjekin ritmet e arkitekturës bashkëkohëse helene, e cila nga fundi i shek. VI i shkëputi lidhjet me të kaluarën dhe adoptoi një sistem më të avancuar fortifikimi[55]. Por deri në luftën e Peleponezit, (v. 431-404 p.e.sonë), akti i parë i së cilës u luajt në Epidamn, kullat mbeten ende të rralla, me qëllim kryesor sigurimin e pikave më të kërcënuara dhe jo flankimin[56]. Si të tillë muret e Epidamnit dhe fortifikimeve satelite ishin të parët që provuan mbi vetë inovacionet e mjeteve të sulmit. Rrjedhimisht këtu duhet të kenë ndodhur një sërë ndryshimesh të rëndësishme në sistemet mbrojtëse në përgjigje të këtyre inovacioneve. Si pasojë, e rritjes së presionit të armikut ndaj mureve, në vitet pas kësaj lufte, vihet re një shpeshtim i ndjeshëm i kullave.[57] Kjo dukuri ndiqet qartë në fortifikimet e shek. IV, ku traseve dikur të thjeshta ju bashkëngjitën kulla të shpeshta (fig. 15) (akropoli i Zgërdheshit) ose largësitë nga kulla në kullë reduktohen ndjeshëm (Matohasanaj (fig. 16), Rogos etj.). Këto largësi tregojnë qartë se sistemet e reja nuk synonin vetëm ndaj mbrojtjes së pikave të kërcënuara, por kryesisht ndaj pengimit të përqendrimit të armikut dhe mjeteve të sulmit rrëzë mureve-perde. Kështu në fortifikimet e gjysmës së parë të shek. IV largësia nga kulla në kullë luhatet rreth 50 – 60 metërshit (Lis 45 – 60 m (fig. 17), Shkambi i Shënlliut 48 – 62 m (fig. 18), akropoli i Gurzezës 50 m, faza e I e Kastrionit kryesisht 60 m etj.). Nga mesi i këtij shekulli ajo synon në më pak se 100 bryla (46,24 m) (Philo A 45)[58] një hedhje shtize larg, në mënyrë që kullat nga e majta dhe e djathta të mbulohen nga skorpionët (Vitruv De Arch. I. 5-4) (Goricë 35-40 m (fig. 19), Zgërdhesh 29.5 m (fig. 21), Medun 25-30 m). Por këto përfundime mbeten ende hipotetike për derisa pikat repere, të përcaktuara mirë në kohë, janë ende të pakëta.

Largësia mes kullave është edhe në funksion të madhësisë së kullës, përkatësisht fuqisë së instaluar të armëve: Në anën perëndimore të qytetit në Rogos kullat i përmbahen një hapi rreth 45 m, përjashtuar

53) Fortifikimi i Amanties tek S Anamali, **Amantia,** Iliria, 1972, 2, f. 61--133, i plotësuar dhe korrektuar nga N. Ceka, **Qendrat e Amantëve,** Monumenter, 10, 1975, f. 21-62, S. Anamali e daton në gjysmën e parë të shek. IV p.e.sonë. Për datimin e saj më të hershëm jemi nisur nga tiparet arkitektonikë, muratura lesbike e anës jugperëndimore e cila zhduket në shek. e IV, kullat e pazhvilluara, hyrjet e harkuara dhe ndërhyrja masive nga mesi i shek. IV me një muraturë të rregullt izodomike. Këtë datim e mbështet dhe qeramika e lluksit e fillimit shek. V p.e.sonë (N. Ceka **Qendrat e Amantëve...** f. 49).

54) Kështjellën e Labovës, duke u nisur nga teknika me rasa të palatuara në fugat, dhe tiparet arkitektonike e kemi parë si të kapërcyellit midis periudhës së I e të II të hekurit (A. Baçe, **Vështrim...** f. 106). Këtë datim e mbështesin dhe rezultatet e gërmimeve.

55) A. Lawrence **vep.cit.** f. 35. Vetkuptohet që fortifikimet ilire si zona skajore kanë një shkëputje kohore veçanërisht nga prototipet e zonave fqinje me lindjen e afërt, ku kullat e zhvilluara mirë e të dëndura, shfaqen herët, që në shek. e VI (Izmiri i vjetër, Mileti, Eleusa (v. 530) etj.) (A. Lawrence **vep.cit.** f. 29-35, 377).

56) F. Winter (**vep.cit,** f. 155-160) e sheh kullën në gjysmën e parë të shek. të V p.e.sonë si një element të zakonshëm, por të përdorur me kursim, në pikat e kërcënuara. Pas luftës Peleponezit, shkruan ai, kulla fiton tiparet e zakonshme, si në shpërndarje, ashtu dhe formë. Y. Garlain (**vep.cit.** f. 151) shton se kullat para kësaj lufte kishin një projektim mediokër nga muri.

57) Y. Garlain **Vep.cit.** f. 154-160.

58) Tekstet e Filonit i kemi marrë nga H. Diels – E. Schram, **Exzerpte aus Philons Mechanik B VII und VIII,** (Vulgo funftes Buch) Abhandlungen der Preusischen Akademie der Wissenschaften, Philologisch-Historische klasse Nr. 12, 1919.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16



Fig. 17



Fig. 18

DO NOT COPY

kullën e mesit që ndodhet 75 m larg kullës pasrendëse (fig. 22). Kjo mos përputhje spjegohet vetëm me përmasat mjaft më të mëdha të kullës së mesit. Po kështu në Zgërdhesh kullat e qytetit të poshtëm janë 29.5 m larg njëra-tjetrës, ndërsa në akropol, megjithë pjerrësinë më të madhe, kjo largësi ulet në 20 m (fig. 20). Spjegimin për këtë dukuri e jep po madhësia e kullave (9 – 10,6 x 7 m ndaj 6,5 – 7 x x 4,35 – 6,3 m).

Në fortifikimet e hershme vendosja e kullave ndaj trasesë është e çrregullt, e pastudiuar. Kështu kulla e skajit veriperëndimor të Nikaes projektohet asimetrikisht nga muri (1,75 dhe 3,8 m), duke qëndruar me kënd ndaj tij (fig. 14). Kjo tregon qartë se qëllimi i saj nuk ishte mbulimi anësor i mureve, por kontrolli i zonës para hyrjes. Një vendosje ende shabllone vërejmë edhe në fortifikimet e ndërtuara para mesit të shek. IV p.e.sonë. Në pikat ku traseja kthehet me kënd mbi 180°, njëra faqe e kullës pritet me kënd të drejtë me murin-perde, ndërsa faqja tjetër formon me të një kënd të gjerë, i cili e dobëson mbulimin anësor (faza e II e Paliaroforonit (fig. 23), Lelovo, Amotopos, etj.). Një sprovë për zgjidhjen e këtij problemi vemë re në Kastrion, ku muri – perde thyhet nga fundi për t'u bashkuar me kënd të drejtë me kullën (fig. 24). Si pasojë ajo fiton një formë asimetrike, me njërën brinjë më të gjatë se tjetra. Në disa nga fortifikimet e kësaj kohe ky problem është zgjidhur ndryshe, duke vendosur në kthesë një kullë rrethore (Matohasanaj etj.), (fig. 16). Këtë zgjidhje e vërejmë dhe në kthesat me kënd më të vogël se 180°. Në Lis kërkesa për mbulimin e mureve-perde të një gjiu të futur është zgjidhur me anë të vendosjes së një kulle rrethore (fig. 25), e vetmja me këtë formë nga 31 kullat e kësaj kohe, detyrë që nuk do ta kryente kurrsesi kulla drejtkëndëshe.

Veçori tjetër e fortifikimeve të ndërtuara para mesit të shekullit IV p.e.sonë është shmangia e kullave nga skajet e kthesave kënddrejta (Nikae, Kastrion (fig. 26), Oshanicë, etj). Në këtë rast kulla mbulon vetëm njërën anë, duke e lënë anën tjetër të zbuluar. Kjo vendosje haset edhe në fortifikimet e mëvonshme, por vetëm në rastet kur mbas kthesës vijonte rrëpira (Zgërdhesh (fig. 20), Dukaj, etj.), ose kur kulla gjendej në anët e trasesë së dhëmbëzuar (Apolloni) (fig. 27, 28). Rasti i fundit është tipik pasi në këtë qytet kulla e lirë, me 4 faqe aktive, nuk është e panjohur (fig. 29).

Në të kundërt në fortifikimet pas mesit të shek. IV p.e.sonë kullat i përmbahen mesores së kthesës, duke e ndarë tepricën e këndit të drejtë në dy pjesë të barabarta (Goricë fig. 30, Dodonë fig. 31, Faza e



Fig. 19

II e Foinikes, etj.) dhe nuk i shmangen skajeve duke qëndruar të lira, me katër faqe aktive. Kjo krijonte mundësi për kontrollin e sulmit nga balli dhe mbulimin e të dy anëve të skajit (Apoloni, fig. 29, 32, 33, Dodonë fig. 31, Rogos, Antigone, faza e II e Elimokastros, Malathre fig. 34 etj.). Së fundi mbrojtja e hyrjeve me kulla rishfaqet sërishmi relativisht vonë, në shek. e IV p.e.sonë. (fig. 35).

Forma planimetrike e kullave. Ndonëse traktet ushtarake të kohës ngulin këmbë që kullat të kenë formë rrethore ose poligonale, kullat katërkëndëshe i lenë mjaft pas vetes kullat rrethore, ndërsa poligonalet janë të papërfillshme. Kullat katërkëndëshe i hasim në të 102 fortifikimet e përforcuara me kulla që njohim nga Iliria, rrethoret në 9 prej tyre, ato në formë të shkronjë «U» në 2, ndërsa poligonalet vetëm

PO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

DO NOT COPY



Fig. 22



Fig. 23



Fig. 24



Fig. 25

Fig. 27





Fig. 26

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 28



Fig. 30



Fig. 29

në një rast, për më tepër të pasigurt[59]. Kullat katërkëndëshe përbëjnë 92, 4% të 266 kullave që njohim, rrethoret 6,4%, kullat «U» 0,8%, ndërsa shumëkëndëshat 0,4%[60]. Ky raport përputhet mjaft mirë me vlerësimin e përafërt prej 90% që jep A. Lorens për kullat katërkëndëshe të fortifikimeve antike helene[61]. Për ta sqaruar këtë dukuri po ndalemi në përparësitë e të metat e secilës formë.

59) Në skicën planimetrike të Ktismates N. Hammond, shënon një kullë të gjerë pesëkëndëshe.

60) Pa dyshim ky nuk është numri real i kullave në fortifikimet ilire, pasi qendrat e kësaj periudhe, veçanërisht ato në territorin Jugosllav, ende nuk njihen tërësisht dhe mirë. Por numri i kullave të njohura lejon nxjerrjen e një raporti, i cili me kohë mund të pësojë vetëm luhatje të vogla.

61) A. Lawrence, **vep.cit,** f. 378.



Fig. 31

Së pari, orët e punës për latimin e blloqeve të harkuara të një kulle rrethore ndaj orëve të punës për latimin e blloqeve paralelopipedë të një kulle drejtëkëndëshe, përjashtuar këtu matjet më të komplikuara, ndërtimin e shabllonëve (Philo A 64) dhe korekturat, qëndrojnë në një raport rreth 2 : 1.[62]. Krahas kësaj latimi i blloqeve të harkuara kërkon padyshim një nivel mjaft më të lartë profesional të gurgdhendësve. Në trasetë në terrene të sheshta ose pak të pjerrëta, të pajisura me kulla rrethore, raporti i blloqeve të harkuara me blloqet me faqe të rrafshta është rreth 1 : 1.5, pra i konsiderueshëm[63]. Por në rastet kur fortifikimet përbëhen prej një xokoli të gurtë dhe një mbindërtimi me qerpiç ose tulla, vështirësia thjeshtohet në punimin e xokolit, ndërsa mbindërtimi ngrihet fare thjeshtë.

Përparësi kryesore e kullave rrethore ndaj kullave drejtkëndëshe është se të parat i «rikoshetojnë goditjet e makinave gurhedhëse pa ju ceduar gurët (Philo A, 6)». Por këto makina kërcënonin vetëm kullat para terreneve të sheshtë ose pak të pjerrët, ku mund të vendoseshin ato. Në të kundërt në terrenet e thepisur flurudha duhej të ndiqte një trajektore të lartë duke e humbur fuqinë.

Perimetrit të kullave rrethore, përkatësisht sasisë së materialit të përdorur, i përgjigjet një sipërfaqe 1,4 herë më e madhe se e katrorit dhe ca më tepër se e drejtkëndshave të tjerë. Kjo sipërfaqe dhe forma e lakuar e ballit lejonte një shpërndarje më të mirë dhe komode të njerëzve e makinave ndaj frengjive dhe gjoksmbrojes. Në këtë drejtim thënia e Uinterit se kulla kënddrejtë është më ekonomike se rrethorja[64] është e përmbysur.

Kullat cilindrike, falë formës rrethore të ballit, siguronin një zjarr panoramik dhe uniform, nga 180° për kullat gjysmë rrethore deri në 360° për kullat me perimetër të plotë, si dhe këmbimin e shpejtë të drejtimit të zjarrit (fig. 36). Por mbulimi anësor i mureve-perde nga kullat drejtkëndëshe, falë faqeve anësore përpendikulare me muret, përkatësisht me drejtimin e sulmit, është më efektiv sesa mbulimi

62) Përpunimi i një blloku paralelopiped me daltat dhe pykat e sotme kërkon 2 herë më tepër punë se një bllok i harkuar me këto përmasa, me faqet anësore në formë pyke. Krahas kësaj rreziku i thyerjes së materialit shtohet në shkallën 10%.

63) Traseja e poshtme në Zgërdhesh, trase për terrenin e rrafshët, ka mure-perde 29.5 m të gjatë dhe kulla drejtkëndëshe rreth 8 m. Në se këto kulla do të ishin rrethore perimetri i tyre do të qe 12,6 m. Duke e pranuar lartësinë e kullës 1.5 herë më të madhe se muri-perde, raporti i blloqeve të harkuara ndaj blloqeve me faqe të rrafshta është rreth 1 : 1.5.

64) Në të kundërt me llogaritjet e paqarta të Uinterit (**vep.cit,** shë.n 112) një perimetri 11 m, i përgjigjet një kullë gjysmë rrethore me sipërfaqen 19,23 m^2, diametër 7 m dhe dalje 3,5 m, ose një kulle katrore 3,6 x 3,6 m, me sipërfaqe 14 m^2 Siç shihet për të njëjtin shpenzim materiali kemi një kullë konsistente gjysmë rrethore ose një kullë fare të vogël katrore. Për kullat drejtkëndshe, jo katrore, ky raport keqësohet më tepër. Të papeshë janë dhe argumentet e J. Adamit (**vep.cit,** f. 48) si ndërtimi më i lehtë i i dyshemesë dhe forma më e lehtë për qëndrim. Një farë vlere ka argumenti se çatija e kullës kuadratike ndërtohet më lehtë.

DO NOT COPY



Fig. 32

Fig. 33



nga kullat rrethore, të cilat i puqen me hark mureve-perde (fig. 37).

Duke i përmbledhur vetitë e mësipërme mund të themi se kullat rrethore ishin më të qëndrueshme ndaj goditjes së makinave gurhedhëse dhe siguronin një zjarr të shpejtë rrethor, panoramik[65], për pengimin e afrimit të mjeteve të sulmit dhe sulmuesve. Kullat drejtkëndëshe qenë më të thjeshta në ndërtim, përkatësisht më të lira, dhe më të përshtatura për hapjen e zjarrit anësor kundër përqëndrimit të armikut dhe mjeteve të sulmit në rrëzë të mureve perde. Rrjedhimisht, terren më i përshtatur për kullat rrethoret nuk ishte terreni i sheshtë, kur vërtet rikoshetoheshin goditjet, por mbulimi anësor nuk ishte i përsosur. Terrene më të përshtatur ishin fashiot e sheshta me një minimum muresh-perde ansore, ku kërkohej zjarri i shpejtë rrethor për ta mbajtur armikun në largësi. Si të tilla kullat rrethore hasen kryesisht në qafat, ku sulmi ka një përqëndrim maksimal zjarri dhe nuk kërkohet mbulimi anësor, dhe më tej në disa prej hyrjeve[66]. Shembull tipik është fortifikimi i qytetit në Zgërdhesh ku dy kullat rrethore gjenden në qafën lindore (fig. 38), dhe hyrjen e akropolit (fig. 39), ku kjo formë u ripërsërit edhe pas prishjes së kullës së parë[67] Në të kundërt në tërë vendet e tjera, madje edhe në rrafshin jugor ku mund të vendoseshin lehtë makina gurhedhëse, kullat janë drejtkëndëshe. Po kështu të vetmet kulla rrethore në Bylis dhe qytetin në Guman shërbenin për kontrollin e qafave. Për më tepër në Guman, si në Zgërdhesh, kullat edhe në terrenet e rrafshta janë drejtkëndëshe.

Synimin për hapje zjarri rrethor e dëshmon mirë struktura e «Portës me kulla» në Buthrot, (fig. 40, 41) ku kulla me ballë të lakuar, në formë të shkronjës «U», qëndron në çift me një kullë katrore. Në se synim kryesor do të qe rikoshetimi, kulla katrore, e cila për më tepër ndodhet nga ana më e goditur, duhet të kishte detyrimisht ballë të lakuar. Kjo tregon se forma e lakuar e ballit të kullës në formë të

DO NOT COPY



Fig. 34



Fig. 35

DO NOT COPY

shkronjës «U», kishte për synim hapjen e një zjarri të papenguar rrethor, nga të tre nivelet e luftimit, për mbrojtjen e hyrjes. Këtë e lehtësonte dhe projektimi i fuqishëm para i kullës.

Por në Apolloni kullat rrethore gjenden përgjatë tërë zonës së rrafshët dhe pak të pjerrët. Në rastin e dhënë ky ndryshim është së pari ndryshim koncepti. Mbrojtje e përforcuar e Apollonisë kombinonte mbajtjen larg të armikut nëpërmjet makinave gurhedhëse të instaluara në kullat[68], me mbulimin anësor nga dhëmbëzimet e trasesë (fig. 27, 28). Brënda kësaj zgjidhjeje kullat rrethore janë më të përshtatshme falë rikoshetimit. Krahas kësaj, shpenzimet shtesë për ndërtimin e tyre qenë tepër të reduktuara, pasi në to i gurtë ishte vetëm xokoli, ndërsa mbistruktura është më tulla. Mbrojtjen me kulla të tilla e vërejmë dhe në qytetin koloni të Ambrakisë, ku tërë kullat janë rrethore[69].

Përhapjen tepër të pakët të kullave në formë të shkronjës «U», të cilat kombinonin anët pozitive të kullave rrethore dhe drejtkëndëshe: zjarrin rrethor dhe rikoshetimin me mbulimin anësor, e shpjegojmë

65) Zjarrin «panoramik» të kullave rrethore e përmend pa e analizuar J. Adam (**vep.cit,** f. 48, 62). Por nga ana tjetër nuk mund të flitet për kënde të vdekur në kullat drejtkëndëshe gjasisht në vazhdim të diagonales. Së pari, kjo zonë e vdekur nuk ekziston për kullat e radhës, pasi kjo hapësirë mbulohej fare mirë nga muri-perde dhe në rastin e kullave skajore, ku muri – perde nuk e siguronte dot mbulimin, këndi i vdekur, mund të shmangej fare lehtë duke e lënë skajin të lirë, pa parapet.

66) Parapëlqimin e kullave rrethore në hyrjet e ve në dukje dhe F. Winter **vep.cit,** f. 195.

67) L. Papajani, **Punimet restauruese në qytetin ilir në Zgërdhesh,** Monumentet 14. 1977, f. 5 – 18.

68) Livi na bën të ditur se në v. 214 p.e.s., pas thyerjes së Filipit V, «Apolloniatët morën katapultat, balistat dhe tërë makinat e tjera të këtij lloji që ishin grumbulluar këtu për të sulmuar qytetin dhe i shpunë në Apolloni për të mbrojtur muret». Vetkuptohet se këto makina mund të vendoseshin vetëm në kullat.

69) N. Hammond, **vep.cit,** f. . . .

DO NOT COPY



Fig. 36



Fig. 37

me domosdoshmërinë e projektimit të fuqishëm para[70]. Kjo sillte mjaft vështirësi për përshtatjen ndaj terreneve të pjerrëta, më karakteristike për fortifikimet ilire se ato greke, dhe koston e dyfishtë, pasi një kullë e tillë faktikisht përbëhej prej një kulle drejtkëndëshe së cilës i bashkangjitej në ballë një kullë rrethore (fig. 40, 41).

Së fundi, numri i papërfillshëm i kullave pesë dhe gjashtëkëndëshe, me gjithë argumentimin e sofisikuar të traktateve ushtarake, spjegohet me avantazhet e pakta praktike. Kështu kullat pesëkëndëshe i ofronin goditjeve ballore një teh të thyeshëm lehtë, ndërsa kullat gjashtëkëndëshe nuk i rikoshetonin goditjet ballore[71].

Kullat katërkëndëshe ju nënshtruan në kohë një evolucioni në drejtim të formës, raportit gjerësi-thellësi dhe përmasave. Kullat e hershme, ndonëse kanë ballë të gjerë, janë mjaft të cekëta[72], kështu kulla veriperëndimore e Nikaes (fig. 14) projektohet fare pak nga muri dhe ka formë të çrregullt planimetrike (1,75 x 9,9 x 3,8 m). Përmasa të paarritura, midis gjerësisë së murit-perde dhe kullës, paraqet dhe zgjerimi 5,1 i ballit të hyrjes tangenciale[73]. I njëjti raport haset dhe në kullat e Amanties (9,2 x 7,7; 7,6 x 2,2; 6,3 x 0,9 m)[74]. Muret e qëndrueshme të këtyre qendrave, ndryshe nga fortifikimet me blloqe të përpunuara ashpër, krijonin mundësi për lartësimin dhe zgjerimin e kullës mbi shtegun e kalimit, duke arritur një gjerësi 4 – 7 m. Kjo strukturë, falë lartësisë dhe ballit të gjerë, lejonte një mbrojtje të kënaqshme ballore të sektorëve të kërcënuar. Por ajo ishte e pavlefshme për mbulimin anësor, detyrë që në të vërtetë nuk i kërkohej. Më tej, nga fundi shek. V – gjysma e parë e shek. të IV p.e.sonë, kullat katërkëndëshe synojnë ndaj formave të rregullta drejtkëndore dhe përmasave krahasimisht të mëdha (rreth 10 m

70) Ky tip kulle nuk pati përhapje tepër të madhe dhe në Greqi (F. Winter, f. 193). Këto kulla hasen kryesisht në Heraklea (F. Krischen, **Die Befestigungen von Herakleia am Latmos,** Berlin, 1922); Assos (J. Clarke, F. Bacon, R. Koldeway, **Investigations at Assos,** Cambridge Mass 1902), Pire (W. Judeich, **Tapographie von Athen,** Münich, 1931).

DO NOT COPY



Fig. 38



Fig. 39

në Oshanicë) (fig. 42). Në gjysmën e dytë të këtij shekulli, veçanërisht në kapërcyellin midis tij dhe shek. III, përmasat luhaten rreth 6 – 8 metrave, dukuri që shoqërohet me një shpërndarje uniforme dhe shpeshtësim të tyrin. Ky evolucion ndihet dhe në raportin e përmasave të kullave drejtkëndëshe. Kullat me përmasa 6 – 8 m zenë 62 % të numrit të përgjithshëm, kullat me përmasa 4 – 5 m 15 %, ndërsa ato me përmasa 9 – 10 m 20%[75].

Në shumicën e tyre kullat me planimetri drejtkëndëshe e kanë ballin më të gjerë se faqet anësore. Kjo spiegohet me brishtësinë që do shkaktonte përzgjatja e tepërt e faqeve anësore dhe problemet që u sillte ndërtuesve terreni i pjerrët. Por në katin e II kullat zgjeroheshin mbi shtegun e luftimit duke arritur një formë katrore ose lehtësisht të përzgjatur. Ky zgjerim ndiqet në një sërë qendrash. Përmasat e kullës së hyrjes në kështjellën në Goricë (7,5 x 5,6 m), forma planimetrike e së cilës kapet qartë, mund të arrihen nga kulla e mesit (4,3 x 6 m) vetëm po qe se faqeve anësore do t'i shtonim gjerësinë 3,10 m të murit perde. Po kështu zgjerimi i dëshmuar i kullave të Antigonesë (fig. 43) mbi tërë shtegun e luftimit, e kalon planimetrinë nga forma kuadratike e katit të I (6,3 x 6,4 m) në një formë të përzgjatur (6,3 x x 9,25 m) të katit të II. Siç shihet kullat drejtkëndëshe të shek. IV – III i përmbahen raportit gjerësi--thellësi, në katin e II, nga 0,68 : 1 (Antigone) deri në 1,05 : 1 (Oshanicë). Ky raport krijonte një formë më të qëndrueshme ndaj goditjeve nga balli dhe më të ekuilibruar për luftim.

Kullat rrethore, ashtu si dhe në fortifikimet e tjera bashkëkohëse[76], pararendon prej kullave të ashtuquajtura «tip dardhë». Një kullë të tillë e gjejmë

71) Përdorimin e rrallë të kullave poligonale dhe në Greqi e vëren A. Lawrence **vep.cit,** f. 387, 389.

72) Për kullat helene para luftës së Peleponezit këtë fenomen e ve në dukje Y. Garlain **vep.cit.** f. 151.

73) Nga mesi i anës veriperëndimore ndodhet një kullë tjetër po e cekët 7,4 x 2,5 m. Ndonëse superstruktura e saj i takon riparimit të shek. IV p.e.sonë, ka gjasë që ajo të ngrihet mbi themele të fazës së parë.

74) N. Ceka **Qendrat e fortifikuara të Amantëve ...** f. 25.

75) Këto të dhëna i kemi bazuar në ballet e matur, të një serije prej 207 kullash. Më hollësisht kemi këto përqindje: Kullat 4 – 4,4 m 5%; 4,5 – 5,4 m 10%; 5,5 – 6,4 m 20%; 6,5 – 7,4 m 21%; 7,5 – 8,4 m 21%; 8,5 – 9,4 m 10%; 9,5 – 10;4 m 10%. Pa dyshim që këto përqindje nuk mund të merren si definitive por sasija prej 207 kullash na jep një propabilitet të kënaqshëm.

76) Kulla të tilla arkaike hasen në fortifikimet autoktone në Siçili, në Mendolito dhe Monte Finochito, dhe në Becli, në Halai (P. Pelagati, **Mendolito,** Kokalos 10-11, 1964-65, f. 245-252, H. Goldman, **The acropolis of Halae,** Hesperia, 9, 1940, f. 381-396, cituar nga Y. Garlain, **vep.cit,** f. 151, A. Lawrence **vep.cit.** f. 378). Zhdukja e këtij tipi nga mesi shek. V p.e.sonë përkon mirë me rezultatet e gërmimeve të Labovës.



Fig. 40

në fortifikimin në Labovën e Kryqit, në mbrojtje të hyrjes (fig. 44). Kullat e tjera gjysmëcilindrike, të cilat në arkitekturën helene fillimisht shfaqen nga kapërcyelli i shek. VI-V[77], i përkasin kryesisht shek. IV p.e.sonë (Lis, fig. 25 Matohasanaj, fig. 16, Ambraki, Lahanokastro, Guman, Babunjë, Zgërdhesh, fig. 20 Cerje fig. 45 etj.).

Përfaqësuesja më e spikatur e kullave cilindrike, me sa dimë kulla më e madhe rrethore e tërë fortifikimeve antike, gjendet në Apolloni, në zonën e rrafshët veriperëndimore (fig. 27)[78]. Për nga përmasat ajo i hap rrugë vetëm për 0,60 m kullës në Sunion dhe le mjaft pas vetes, për 2 m, kullën e dytë për nga madhësia, Burgun e Shën Pavlit në Hefes. Kulla me xokol-guri dhe mbistrukturë tulle, ka diametër 16.65 m. Kulla zhvillohej mbi shtegun e luftimit, duke arritur një formë thuajse cilindrike, çka jepte mundësi për hapjen e një zjarri panoramik, 360 gradësh, dhe rikoshetimin e plotë të goditjeve. Muret tej masës të gjerë, 2,10 m[80], e tregojnë kullë tepër të fuqishme, gjasisht trekatëshe, të individualizuar plotësisht. Këto përmasa që nuk ripërsëriten nga kullat e tjera të kësaj ane, dëshmojnë për një kullë artilerie dhe pikë komandimi e koordinimi zja-

77) Më të hershmet të Megara Hybleas i përkasin v. 510-484 (Y. Garlain **vep.cit.** f. 151) ndërsa ato të murit të gjatë të Korinthit mesit shek. V – v. 397 (R. Scranton, **Greek Walls,** Cambridge Mass, 1941, f. 86-87), por të rëndomta ato bëhen në shek. e IV p.e.sonë.

78) V. Dimo, **Gërmime në murin rrethues të Apollonisë,** Iliria, 1, 1984, f. 200.

79) Kulla e Sunionit (17,25 x 14,2 m) në W. Wrede, **Attische Mauern,** Berlin, 1933, f. 26-7, 46-7, 104-7; Burgu i Shën Pavlit (14,6 x 14,6 m) në A. Lawrence **vep.cit.** f. 390; Troizeni (13 x 9,5 m) në G. Welter, **Troizen und Kalaureia,** Berlin, 1941, pl. IV.

80) A. Lawrence, **(vep.cit,** f. 389), e quan gjerësinë prej 2,2 m të mureve të kullave të Pergamit, «të pafundshme».

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 41



Fig. 43



Fig. 42



Fig. 44

rri[81]. Pareti i brendshëm i kullës është punuar mjaft mirë, çka e tregon atë fillimisht kullë të zbrazët. Më tej në brendi të katit të parë u ndërtua një sterë me diametër 7 m, ndërsa hapësira midis saj dhe paretit të kullës u mbush me dhe, për rritjen e qëndrueshmërisë. Gjetja e tubave prej qeramike në brendi[82] e tregon atë sterë uji.

Kullat e radhës në Apolloni dhe në një sërë

81) Në këtë drejtim ajo i gjen paralelet në Paravola, ku ndodhet një kullë po e pajisur me sterë, dhe në Aigosthenë (P.W.R.E. 13-2, f. 1301 v.).

82) V. Dimo, **Po aty**

qëndrash të tjera kanë përmasa standarte 8 – 9 m (Apolloni 8.65 m, Babunjë, Zgërdhesh 8 m, fig. 38, 39, Cerje fig. 45, Bylis 9 m etj.) dhe janë të mbushura. Ndodhja e tyre në pika kyçe dhe të goditshme, tregon se synimi kryesor i kësaj mbushje ishte rritja e qëndresës ndaj goditjeve.

Kullat në formë të shkronjës «U» hasen rrallë, gjithsejt në 2 shembuj. Në Apolloni kjo kullë (8 x x 8 m)[83] afron më tepër me kullën kuadratike (fig. 28). Balli i saj, në formën e një sektori rrethor të lakuar lehtë, nuk rakordohet me faqet e drejta anësore. Si pasojë, prej saj nuk sigurohej zjarri rrethor i kullave cilindrike, por zjarri tipik i kullave drejtkëndë-



Fig. 45



Fig. 46

she, ndërsa forma e lakuar e ballit shërbente thjesht për rikoshetimin e goditjeve[84].

Kulla «U» në Buthrot[85] (8,25 x 15,55 m), (fig. 40, 41), ka tipare tepër të zhvilluara që e rreshtojnë ndër shembujt më të përsosur të këtij tipi. Kulla e projektuar tej masës nga muri-perde (12,25 m), ndahet prej një muri të përshkuar në mes nga një hyrje, në një ambient drejtkëndësh (6,5 x 5,6 m) dhe një ambient në formë të shkronjës U (6,5 x 7,7 m). Ambienti i parë është pajisur me 2 frëngji, ndërsa i dyti me 3 të tilla. Në mesin e secilit prej tyre gjendet një kollonë e gurtë mbi të cilën mbështetej trau kryesor i dyshemesë, çka tregon tërthorazi për praninë e artilerisë në katin e dytë.

Konstruksioni. Muret e kullave ngrihen mbi shkëmbin e gjallë, të gdhendur në trajtën e një kanali të gjerë sa vetë muri (Lis, Goricë, Dukaj etj.), ose mbi një themel «të gërmuar deri në shkëmb... ose deri në një farë niveli» (Philo A 1). Këto kërkesa janë të vetkuptueshme, pasi presionet e ushtruar nga muret e kullave ndaj tabanit, 2,5 – 3,75 kg/cm^2, nuk përballohen dot pa themel prej asnjë lloj dheu[86].

83) V. Dimo **vep.cit,** f. 203.

84) Kulla të këtij tipi hasen në fortifikimet e shek. IV e këtej, (A. Lawrence **vep.cit,** f. 379). Për territorin ilir ky është shembulli i vetëm që njohim.

85) G. Pani, **Restaurimi i Portës me kulla në Butrint,** Monumentet, 11, 1976, f. 35-44

86) Sipas K. Zhekut **(Teknika dhe materialet e ndërtimit në muret rrethuese të qyteteve ilire të njohura në vendin tonë,** Monumentet, 1980, f. 135) themelet përbëhen «vetëm nga një rresht gurësh» të cilët janë «të vendosur mbi tokë të fortë». Këta gurë sipas tij janë «10-15 cm më të gjerë», nga muri. Por muret – perde dhe veçanërisht muret e kullave, ushtrojnë ndaj tabanit një presion të lartë. Në rastin në shqyrtim muret e kullave, normalisht 10-15 m të lartë, ushtrojnë në çdo cm të tabanit një presion të barabartë me një kollonë guri 1000-1500 cm të lartë dhe peshë 2,5 – 3,75 kg, të përballueshëm vetëm nga shkëmbi, por pa themel prej asnjë lloji dheu. Këtë mendim, të ilustruar me shembuj themelesh e kemi sjellë në artikullin **Vështrim mbi arkitekturën e fortifikimeve antike në vendin tonë,** Monumentet, 17, 1974.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 47



Fig. 48

Themelet vijojnë me blloqe të shtresëzuar, me faqe horizontale të përpunuara (Persqop, fig. 46; Oshanicë; Berat etj.) dhe faqe anësore të vrazhda për kursim pune dhe lidhje më të mirë me terrenin. Në Berat për shmangien e shkarjes së terrenit, balli i kullës pararendet prej një bazamenti të shkallëzuar, prej blloqesh të gdhendura ashpër.

Muret e kullave janë krejtësisht të gurta ose kanë një mbistrukturë prej qerpiçi ose tulle mbi xokolin e gurtë (fig. 47). Në fortifikimet me muraturë poligonale, në skajet e kullave përdoren blloqe katërkëndëshe të vendosura në rreshta më horizontale, e më të pashkëputura se në muret-perde (Lis, etj.). Kërkesën që «gurët e skajeve të kullave të jenë sa më të mëdhenj, sa më të gjerë dhe nga një shkëmb sa më i fortë». (Philo A 66)», mbasi këto



Fig. 49



Fig. 50

DO NOT COPY



Fig. 51



Fig. 53

skaje parapëlqehen për t'u goditur nga makinat gur-hedhëse» (Diod. XVII, 43, 1) e vërejmë nga kullat e punuara me teknikë rudimentare (si Vrgada, fig. 12) e deri tek kullat me blloqe poligonalë. Por në fortifikimet me muraturë pseudoizodomike (Berat etj.) dhe izodomike (Matohasanaj, Rogos, Antigone, Vagalat, fig. 48 etj.) blloqet kanë të njëjtat karakteristika si në muret-perde.

Ashtu si dhe në muret-perde, në kullat përdoren kryesisht blloqe prej guri gëlqeror dhe më tej prej brekçeje shpati, ndërsa blloqet prej formacionesh ranore janë mjaft të rralla (Sarag, Prishtë, Dhespotikon, Babunjë). Por në se muret – perde janë ndërtuar prej këtij formacioni refraktar, blloqet e kullave, në të kundërt me porositë e traktateve ushtarake (Philo A 66), nuk e ndryshojnë natyrën e materialit.

Prej kullave me kat të parë të mbushur më mirë njihet struktura e kullave të Daorsit (Oshanicës)[87] (10 x 10 m.) të cilat kanë parete, krejtësisht të papunuara nga ana e brendshme, për lidhjen sa më të mirë me mbushjen prej dheu dhe gurësh, mbeturina të punimit të blloqeve (fig. 42, 49). Deri nga gjysma e parë e shek. IV mbushja është e thjeshtë, por në fortifikimet e mesit të shek. IV (Goricë, Bylis, Trikastron, Ravenë, Velçistë) mbushja e kullave drejtkëndëshe përshkohet prej një lidhjeje kryqe[88], e cila krijon katër ndarje. Këtë kalim e kapim në Malçan, ku kullat që i ekspozohen më tepër goditjeve, më të hershme në kohë, kanë mbushje të thjeshtë, ndërsa vargu në vazhdim mbushje me lidhje kryqe (fig. 50). Në këtë mënyrë, ashtu si në lidhjet tërthore të



Fig. 52

87) Z. Marić, **Archäologische Erforschungen der Akropolis der illyrischen stadt Daors auf der Gradina in Oschanici bei Stolac vom 1967-72,** Wissenschafttiche Mitteilungen des Bosnisch – Herżegowinischen Landesmuseums, B VI A, Sarajevo, 1979, B VI A f. 61-181.

88) A. Lawrence (**vep.cit,** f. 223) ve në dukje se ky element në fortifikimet helene haset pas v. 400.

mureve-perde, faqet çiftëzohen me njëra-tjetrën duke i shpërndarë më mirë ngarkesat dinamike. Në kullat rrethore lidhja vijon në formë tufe rrezesh. Në Guman 3 rreze të tilla e ndajnë kullën gjysmë rrethore, me diametër 14 m, në 4 ndarje të mbushura me çakëll.

Por struktura me lidhje kryqe nuk mund të merret si dëshmi e padyshimtë e artilerisë mbrojtëse, siç mendon Uinteri[89]. Për ilustrim, në Apolloni kullat e lidhura kryq ndodhen në terrene të thepisura, ku nuk afroheshin dot makinat ndërsa armikut i duhej të ngjitej gjatë një pjerrësie të theksuar. Rrjedhimisht, në to nuk kish asnjë arsye që të vendosej artileria mbrojtëse. Në të kundërt, kulla e madhe rrethore që ndodhej në një terren fushor, ka qenë padyshim e pajisur me artileri. Mungesa e lidhjeve kryqe në këtë kullë flet në të kundërt të përgjithësimit të mësipërm.

Muret e kullave të zbrazëta kanë gjerësi 1-1,2 m (Berat, Buthrot, fig. 40, Antigone, fig. 43, Çukë, Malathre fig. 34 etj.). Në këtë drejtim gjerësia prej 2,1 metrash e mureve të kullës në Apolloni (fig. 27), është e veçantë për mbarë fortifikimet antike[90]. Gjerësia më e vogël e mureve të kullave ndaj mureve-perde spjegohet me strukturën me kontur të mbyllur të kullës, me moment rezistence dhe inercie më të lartë se muri-perde, si dhe me synimin që me kalimin e ngarkesës së lejuar dinamike, kulla të shembej si amortizator, pa e cënuar murin-perde. Gjerësitë e mësipërme arrihen nëpërmjet vendosjes së dy blloqeve, brinjazi njëri-tjetrit, të këmbyer, zakonisht në çdo 2 m gjatësi, me një bllok të tërthortë. Në ndërtimet me muraturë izodomike vërehet këmbimi i rregullt i blloqeve të tërthorta me blloqet gjatësore.

Në mënyrë që goditjet e makinave të mos shkarkonin lëvizjen e blloqeve të kullave duhej «që gurët e fundit të lidhen me njëri-tjetrin me plumb, hekur dhe gëlqere» (Philo A 5-8). Ndonëse rrallë, pasi për konstatimin e kësaj dukurije kullat duhet të kapen ose të jenë të lexueshme në nivelin e lidhjes, këtë kërkesë e gjejmë të zbatuar në një varg fortifikimesh[91]. Prej tyre në Zgërdhesh rreshtat e kullës rrethore lidhen me kllapa të thjeshta[92], ndërsa në Guman kllapat që lidhin blloqet rezorë të kullës rrethore, me njëri-tjetrin dhe me blloqet perimetrale, kanë formë fluture (12 x 11 – 6 cm).

Pajisja e skajeve të kullave me vijë peshimi (fig. 51) madje dhe në rastet kur blloqet kanë faqe të rrafshët (Apolloni fig. 52, Faza e II e Lisit etj.), dëshmon për kujdesin e veçantë ndaj vertikalitetit të faqeve. Për më tepër në Apolloni në brinjën e takimit të kullës me murin-perde, janë përdorur edhe kanalet e peshimit (fig. 47).

Në të kundërt me udhëzimet e traktateve ushtarake se «muret-perde nuk duhen lidhur me kullat..., se po të lindnin dëmtime në muret dhe një pjesë e tyre do rrëzohej, ata do tërhiqnin me vete tërë ndërtimin (Philo A 62-63)», kullat e lidhura me këta mure janë më të shumta në numër. Kjo lidhje kryhet me shkëmbim blloqesh dhe blloqe në formë të shkronjës «L» (Antigone), e njëfishtë, vetëm me faqen e jashtme të murit-perde, ose e dyfishtë, me të dy faqet (Malçan fig. 50 etj.). Ky synim shihet dhe në akropolin e Zgërdheshin, ku muri i periudhës së parë të hekurit u ça tejpërtej për ndërfutjen e kullave të reja (fig. 15). Nëpërmjet kësaj lidhjeje kullat e kontrafortonin lëvizjen sizmike horizontale, veçanërisht të rrezikshme në traktet e pjerrëta[93], dhe shmangnin shkepjen e trakteve të gjata në rastet e përdorimit masiv të mjeteve të sulmit, veçanërisht të minimit. Kullën e palidhur e hasim në Kaninë, ku blloqet e kullës ndërfuten vetëm 2 – 3 cm brenda murit perde, sa për të shmangur shkepjen me leva (fig. 53). Terreni para kësaj kulle është i rrëshqitshëm dhe i lartë, çka në fakt ka shkaktuar dhe rrëzimin prej kohësh të kullës. Në këtë mënyrë ndërtuesit i kishin paradalë rrezikut të tërheqjes së murit-perde prej kullës.

Sipas Garlanit fragmenti i Filonit shpreh auto-

89) F. Winter, **vep.cit,** f. 115 shën. 32.

90) A. Lawrence, **vep.cit,** 222, Konstaton se gjerësija e zakonshme është 1 m dhe vetëm në raste të jashtëzakonsnme ajo arrin në 1,4 – 1,8 m.

91) F. Winter, **vep.cit,** f. 178 ve në dukje përdorimin mjaft të rrallë të kllapave Y. Garlain (**vep.cit,** f. 340), tregon përdorimin në 25 raste, nga të cilët 4 i takojnë Epirit, sipas N. Hammond (**vep.cit,** f. 58, 84, 99) në Rogos, Guman, Cukë e Ajtoit, Heksamil (Demë). Nga këto bindes është Gumani ku jepet përshkrimi i plotë. Përsa i përket Çukës së Ajtoit dhe Demës nuk e kemi konstatuar praninë e tyre.

92) L. Papajani, **Punimet restauruese ...,** f. 9.

93) A. Lorens, mendon se kullat nuk lidhen kur fondet në dispozicion janë të pakëta, pasi lidhja e kullës me murin nuk ka asnjë ndryshim me lidhjen e zakonshme të pareteve të mureve-perde. Rrjedhimisht në se gjatë një muri – perde ka 20 – 30 lidhje të tilla futja e dy lidhjeve më shumë nuk sjell ndonjë ndryshim në kosto.



Fig. 54

nomizimin e kullës si dhe synimin që rrëzimi i murit-perde të mos sjellë rrëzimin e kulles dhe, në të kundërt, rrëzimi i kullës të mos sjellë rrëzimin e murit-perde[94]. Por nga këto dy rrëzime padyshim mjaft më i rrezikshëm isnte ai i murit-perde që riparohej me vështirësi dhe hapte rrugën për marrjen e fortifikimit[95].

Trajtimi vëllimor. Kullat e fortifikimeve të hershme (Labovë, Pepel, Nikae, Amantie), me gjithë zhvillimin e pakët të mjeteve të sulmit, kanë qenë të mbushura deri në nivelin e shtegut të luftimit[96]. Kjo mbushje spjegohet me shkaqet konstruktive: teknikën rudimentare (Labovë, Pepel) dhe gjerësinë e pakët të kullave (Nikae, Amantie). Më tej kjo mbushje (Oshanicë, Lis, Apolloni, faza e I e qytetit në Matohasanaj, qytetit në Malçan etj.) spjegohet me perfeksionimin e mjeteve të sulmit.

Kullat e zbrazëta dëshmohen relativisht vonë nga fillimet e shek. IV p.e.sonë, por këto kulla nuk i ekspozohen goditjeve të makinave. Kështu në qytetin e poshtëm në Lis, kullat e zbrazëta që komandojnë katarahun e hyrjes jugperëndimore janë të brendshme[97] (fig. 35). Përdorimi i gjerë i kullave të zbrazëta edhe në zonat e rrafshta e të goditura, nis nga mesi i shek. IV p.e.sonë[98] (Zgërdhesh fig. 20, Berat, Antigone fig. 43 etj.). Në vështrim të parë kjo zgjidhje duket paradoksale, pasi kulmin e zhvillimit makinat e sulmit e arritën pikërisht në mesin e shek. IV p.e.sonë. Krahas kësaj kulla e zbrazët është më e shtrenjtë, për shkak të murit dy radhësh me punim nga të dy faqet dhe më pak e qëndrueshme ndaj goditjeve. Por një pjesë e rrezikut të dëmtimit të katit të parë të zbrazët pakësohej kur kulla, zhvillohej në terren të pjerrët. Kjo lejonte një xokol të mbushur në nivelin e dyshemesë së katit të parë, deri në 3,5 m të lartë (Vagalat) fig. 48, 54, 55, i cili shmangte goditjet në ambient të zbrazët prej dashit dhe breshkës.

Për F. Uinterin dhe A. Lorensin[99], kati i I zbrazët nuk ka qëllim ushtarak, por është i nevojshëm për qëndrimin e garnizonit ose refugjatëve dhe për magazina për makinat e municionin. Por, pavarësisht nga fakti se ambientet e katit I mund të përdoren fare mirë për këto qëllime (**Thuc,** 2,18 **Pausan,** IV 20.7), kjo nuk do ta justifikonte vlerën mjaft më të lartë dhe qëndresën më të ulët ndaj goditjeve. Në



Fig. 55

94) Y. Garlain **vep.cit,** f. 196.

95) Për dy raste rrëzimi të kullës pa marrë me vete murin-perde shih **Arrian Anab.** I, 20, 7, **Polib,** XVI, 30,6.

96) Përcaktimi i kullave të zbrazta ose të plota është i mundshëm vetëm për qendrat e gërmuara në mënyrë sistematike dhe ato qendra ku kullat janë të lexueshme mbi nivelin e dyshemesë së katit I. Nga tërë fortifikimet e njohura kjo dukuri mund të kapet e plotë në 11 qendra, dhe pjesërisht në 6 qendra të tjera.

97) F. Prendi – K. Zheku, **Rreth zhvillimit urbanistik të Lisit,** Iliria, 1986, 1, f. 51

98) F. Winter **vep.cit,** f. 162.

99) F. Winter **vep.cit,** f. 132, 180. A. Lawrence vep.cit, f. 376, 377, 391.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të vërtetë për këtë qëllim mund të ngriheshin ndërtime të lehta. Një shembull të tillë paraqesin 25 kapanonet (4,8 x 7,2 m) në rrëzë të murit të brendshëm të Lisit[100] (fig. 17, 56), të cilët me shpenzime të pakëta siguronin sipërfaqen dhe vëllimin e duhur, ndërkohë që tek kullat ajo mbetej e kufizuar. Ky shembull e shvleftëson mendimin e A. Lorensit, sipas të cilit kapanonet do të kishin një largësi të pavolitshme nga muri. Së fundi J.P. Adam[101] e spjegon zbrazjen e kullës me synimin për të eliminuar këndet e vdekura rrëzë kullës, nëpërmjet zjarrit horizontal të hapur nga frëngjitë e katit të parë. Por këto frëngji nuk mund të shërbenin kurrsesi, si qëllim më vete, pasi zjarri i hapur prej tyre është i kufizuar dhe i dobët, vetëm për shigjeta, dhe nga jashtë mund të goditej lehtë brenda. Si të tilla ato janë mjaft të rralla, kryesisht në mbrojtje të hyrjeve (Buthrot fig. 40, 41, Matohasanaj).

Spjegimin e këtij konceptimi, të cilin e kemi kapur dhe trajtuar më gjatë në kështjellën e vonë antike në Paleokastër[102], e gjejmë në një fragment të Vitruvit, sipas të cilit «muri duhet të ndërpritet në pjesën e poshtme të kullave me boshllëqe të gjera sa kullat. Shtigjet e luftimit të mureve duhet të kalojnë nga ana e brendshme e kullave, të pafiksuar me gozhdë... në mënyrë që armiku të mos i arrijë dot pjesët e tjera të mureve, veç po u hodh kokë-poshtë nga lart» (Vitruvi De Arch. I, 5-4)[103]. Nga fragmenti kuptojmë se kalimi për në shtegun e luftimit kryhej nëpërmjet kullave. Në fakt në tërë fortifikimet me kulla me kat të parë të zbrazët (Zgërdhesh, Berat, Dukaj, Antigone etj.) mungojnë shkallët e jashtme, të pranishme në fortifikimet me kulla të mbushura. Në këtë mënyrë armiku, i cili arrinte të ngjitej në shtegun e luftimit nga jashtë, i nënshtrohej goditjes prej kullave, pa mundur të kalonte nga një mur-perde tek tjetri[104]. Për të hyrë në brendi të fortifikimit atij i duhej ose të tërhiqte nga jashtë



Fig. 56



Fig. 57

100) K. Zheku, **Restaurimi i portës së brendshme në qytetin ilir të Lisit,** Monumentet, 1974, 7-8, f. 9 – 24. Për baraka të tilla rrëzë murit në v. 429 na bën të ditur dhe Thukididi (III. 21). Të tilla gjenden dhe në kodrën veriore të Olynthit, ku për më tepër muri rrethues ishte prej qerpiçi (Robinson – Graham, **Olynthos,** VIII, 39-41, 69-70, tek F. Winter, **vep.cit,** f. 164) ndoshta dhe në Side (A. Mansel, **Die Ruinen von Side,** Berlin, 1963, f. 29).

101) J.P. Adam **vep.cit,** f. 48, 91.

102) A. Baçe, **Kështjella e Paleokastrës,** Iliria 1981, 2, f. 165-235.

103) Nga fragmenti nuk kuptohet qartë në se udhëzimi është që shtigjet të kalojnë brenda kullave ose nga pas tyre, në formë ballkoni. Sidoqoftë nga ai kuptohet mirë synimi për kontrollin e shtegut të kalimit dhe prania e shkallëve të kontrolluara, brenda kullave.

104) Për një konceptim të përafërt na bën të ditur Thukididi (III, 21-3) sipas të cilit në murin e Platesë «Çdo 10 gjoksmbroje ndodhej një kullë e lartë, e gjerë, sa muri, që lidhte pa ndërprerje faqen e jashtme dhe të brendshme të mureve, në mënyrë që tërë kalimet të kryheshin përmes kullave». Por kjo mënyrë ndonëse siguronte kontrollin e shtegut nuk lejonte dërgimin e shpejtë të ndihmave.

Synimin për ndërprerjen e shpejtë të shtigjeve të mureve perde e tregon Filoni (A 15) sipas të cilit një pjesë e shtigjeve duhet të ndërtohej me ballkone të heqshme druri.



Fig. 58



Fig. 59

shkallët, i goditur ndërkohë nga kullat, ose të kërcente me armatim të plotë nga një lartësi mbi 5 m, veprime këto tepër të vështira në mes të parealizueshme. Në të kundërt, nëpërmjet shkallëve të kontrolluara, brenda kullave, pikat e kërcënuara përforcoheshin shpejt dhe sigurt me kontigjente të freskëta, të cilat mund të dilnin drejtpërdrejt në shteg nga hyrjet e saj anësore, ose të luftonin me armikun nga katet e sipërme. Së fundi, vemë në dukje se kujdesin për kontrollin e kalimit e shohim edhe në disa fortifikime me kulla të mbushura në katin e I (Lis), ku shkallët zhvillohen vetëm nga ana e tyre e pasme (fig. 57, 25).

Në kullat e zbrazëta, përjashtuar kullën e Rencit, nuk vërehen shkallë të gurta për kalimin nga kati i I në katin e II, çka tregon se kalimi kryhej me shkallë të drunjta, gjasisht të heqshme. Një zgjidhje të veçantë paraqesin shkallët në Antigone, ku pas derës së hyrjes për në kullë, nga të dy anët e korridorit 3,5 metërsh që të çonte në brendi të katit të parë, vijojnë dy palë shkallë të inkorporuara në trupin e murit-perde, pas kullës. Shkallët të nxirrnin në brendi të katit II të kullës, mbi korridorin e hyrjes së katit të I, prej nga nëpërmjet dyerve anësore kalohej për në shtegun e luftimit (fig. 43).

Kullat që njohim kanë në katin e parë një hyrje me gjerësi 1,00 (Malathre fig. 34) deri 1,4 m (Antigone fig. 43) të mbuluar me arkitra guri. (Berat 0,4 x x 0,43 m). Hyrja zakonisht ndodhet në mes, por ajo mund të vijojë dhe e zhvendosur nga boshti (Vagalat fig. 55, 58), ose, në kullat e lira skajore, me kënd 45° (Malathra fig. 34), Frëngjitë që njohim nga kjo kohë kanë formë pyke me ngushtim jashtë: 1 x x 1 (0,10 m) në Buthrot (fig. 40, 41), dhe 1,5 x 1 (0,10 m) në Vagalat (fig. 58, 59). Në këtë të fundit faqet anësore përforcohen dhe me orthostatë.

Së fundi, gjetja në një sërë kullash e fragmenteve të tjegullave (Antigone etj.) tregon se një pjesë e tyre mbulohej me çati tjegullash. Tullat në formë pyke, në Çukë, ndoshta tregojnë dhe për një tarracë solide mbi qemer. Por shqyrtimin e kateve të sipërme nuk do ta shtymë më tej, nga mangësitë e gjurmëve.

Kullat e veçuara hasen në Çukë, Metoq (rr. Sarandës) dhe Kropisht (rr. Vlorës). Prej tyre, e para shërbente si kullë vrojtimi ndaj detit, prej të cilit gjendet rreth 1 km larg, ndërsa dy të tjerat për vrojtimin[105] e rrugëve të kalimit. Kulla e Metoqit që gjendet në Qafën e Gjashtës, e cila të kalonte nga Foinikia në Onhesëm (Sarandë), luante dhe rolin e një releje ndërlidhëse, midis kullës së Çukës dhe Foinikës, dhe mund të kryente kontrollin fizik të ka-

105) Aristoteli tregon se «patrullat e terrenit dislokohen në kulla roje (fylakteri)... të cilat duhet të kenë salla ngrënie në mënyrë që të kryhet shërbimi rojes» (Ath. Pol. 42. 3). Përshkrimin e këtyre kullave në Greqi e jep A. Lorens (**vep.cit,** f. 187-197). Sipas tij këto kulla, janë të shumta në numër. Për masat e tyre luhaten rreth 8-9 m dhe mjaft rrallë i kalojnë 10 metrat. Lartësia luhatet nga 10 në 15 m.

DO NOT COPY

limit në qafë. Kulla e Çukës[106] (fig. 60) ka planimetri katrore (11 x 11 m) dhe mure të jashtme 1,1 m të gjerë. Mure të tërthortë 0,70 m të gjerë e ndajnë katin e saj të parë, 3,40 m të lartë, në korridorin e hyrjes, 3 ambiente (4,8 x 5,45, 3,40 x 4,10; 2,70 x 4,65 m) dhe kafazin e shkallëve për në katin e dytë. Formulim të ngjashëm kishte dhe kati i II, pasi muret ndarës të katit të parë janë të llogaritur për mbajtje ngarkese. Korridori i hyrjes (1,05 x 8,20 m) është trajtuar në formë labirinthi me tri bërryla. Pas portës së hyrjes, nga mesi i tij, ndodhej një portë e siguruar me 4 lloza metalike dhe katarah. Nga fundi i saj gjasisht kishte dhe një portë të tretë. Ngushtësia, kthesat dhe portat e mësipërme e vështirësonin mjaft sulmin dhe shmangnin përdorimin e mjeteve thyerse (trarëve e dashit). Korridori të nxirrte në ambientin kryesor, në rolin e një nyje shpërndarëse, prej nga kalohej në dy ambientet e tjera ose, me anën e shkallëve (0,94 m të gjera dhe 45° të pjerrta), në katin e dytë. Suvatimi me llaç hidroizolues e tregon këtë ambient qëndrimi, ndoshta sallë ngrënie.

Kulla, duke u nisur nga gjerësia e mureve, ka qenë 2-3 katëshe me lartësi rreth 10 ose 14 m. Këto lartësi arihen në rast se katit të parë, 3,4 m, i shtojmë lartësinë e katit II, gjasisht dhe të III, dyshemesë dhe gjoksmbrojës. Muratura e katit të I është me blloqe poligonale, ndërsa shumica e tullave të gjetura tregon se katet e mësipërme vijonin me tulla të lidhura me llaç balte.

B. DHËMBËZIMET

Dhëmbëzimet, dy kthesa të njëpasnjëshme të murit-perde të cilat nuk kërkojnë ndonjë shpenzim të veçantë, janë elemente mjaft racionale dhe të lira. Por, nga ana tjetër, shpeshtësia dhe cilësia e zjarrit anësor të hapur prej tyre mbetet mjaft mbrapa kullave, pasi ato kanë vetëm një nivel luftimi, me lartësi sa muri perde dhe gjerësi sa shtegu i luftimit. Kjo lartësi e pakët dhe mungesa e platformave të gjera, e kufizonte numrin e mbrojtësave dhe shmangte përdorimin e artilerisë mbrojtëse, duke ulur kështu ndjeshëm fuqinë e zjarrit anësor.

Hipoteza e Uinterit se dhëmbëzimet qenë pararendësit e kullës[107], në vështrim të parë duket tërheqëse dhe bindëse. Në të vërtetë dhëmbëzimet në fazën e hershme, kur mjetet e sulmit qenë të kufizuara, mund të kryenin një mbulim të kënaqshëm anësor të murit-perde, por nga ana tjetër ndërtimi i tyre kërkonte një nivel të caktuar teknik për sigurimin e qosheve kënddrejta dhe traseve drejtvizore. Këtë nivel në territorin ilir teknika e ndërtimit e arriti në shek. VIII-VII p.e.sonë. Në të kundërt, siç e shqyrtuam më sipër, kullat me gurë të papunuar kishin lindur të paktën në bronxin e vonë. Kjo tezë shtrihet dhe tej territorit ilir. Kështu kullat me gurë të papunuar i gjejmë në Jeriko (mijvjeçari VII p.e.sonë) dhe ishullin Syros (bronx i hershëm), mjaft kohë para shfaqjes së dhëmbëzimeve. Rrjedhimisht, përparësia në kohë i përket kullës dhe jo dhëmbëzimeve[108].

Teknika e re më e përparuar e punimit të gurit solli përshtatjen e trasesë ndaj terrenit me trakte të drejtë, në të cilët kontrolli anësor nuk pengohej më



Fig. 60

106) F. Guralumi, **Kulla e Çukës** (Material në arkivin e Institutit të Monumenteve).
107) F. Winter, **vep.cit,** f. 152.
108) R.J. Braidwood **vep.cit,** f. 73-81, Zschietzman **vep.cit,** s.v. Syros.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

nga lakimi i konturit, dhe kthesa me kënd, të cilat e shtangnin trasenë dhe siguronin një mbulim të kënaqshëm anësor të mureve-perde. Por hipotezat për kohën e lindjes së trasesë së dhëmbëzuar ende nuk përputhen me njëra-tjetrën. Skranton, në mënyrë evazive, mendon se traseja e dhëmbëzuar është përdorur gjatë tërë periudhave të historisë ushtarake[109], ndërsa Uinter sjell një sërë shembujsh bindës të shek. VI p.e.sonë[110]. Në të kundërt Marten e quan atë një «shpikje helenistike», Garlan cakton si «terminus post quem» kohën e Filipit II[111], Lorens vitin 350 p.e.sonë[112] (Prienën) dhe së fundi Adam shkruan se «traseja e dhëmbëzuar, e njohur nga Tyrinthi dhe Troja 6, rishfaqet kuriozisht vetëm në shek. e IV p.e.sonë»[113]. Ky debat shpesh kryhet pa marrë parasysh se ç'kupton autori tjetër me termin trase e dhëmbëzuar. Rrjedhimisht, mendojmë se në radhë të parë duhet qartësuar thelbi i trasesë së dhëmbëzuar. Sipas nesh përcaktues në këtë drejtim është shkaku i lindjes dhe funksioni që kryejnë dhëmbëzimet konstruktive, për shtangien e trasesë dhe përfshirjen e daljeve shkëmbore, ose mbrojtës. Në të kundërt shpeshtësinë dhe rregullsinë e tyre e shohim si një dukuri të dorës së dytë. Për paralelizëm në se një fortifikim të pajisur me kulla, sado të rralla, e quajmë pa hezitim fortifikim me kulla, edhe trasenë e pajisur me dhëmbëzime me funksione të qarta mbrojtëse nuk ka arsye që të mos ta pranojmë si trase të dhëmbëzuar.



Fig. 61

Së pari, po shqyrtojmë shembujt tipikë të dhëmbëzimeve konstruktive. Në Kasope, muret-perde të rrethimit të jashtëm, mbi 90 m të gjatë, në vendet ku e lejon terreni thyhen me kënd, ndërsa buzë rrëpirës, ku hapësira është e kufizuar dhe linja e detyruar, dhëmbëzohen. Qëllimi i thyerjeve dhe dhëmbëzimeve të mësipërm është shtangia e trasesë për shmangien e rrezikut të shkarjes së trakteve tepër të gjatë. Këtë zgjidhje e hasim dhe në fortifikimet e tjera të shek. VI – V, në Paliaroforon, ku traseja lëviz e shqetësuar me trakte 10 – 60 metërsh, në Embesos[114] dhe në vende të tjera. Dhëmbëzimet konstruktive për shkak të lëvizjeve të terrenit[115] përfaqësohen mirë me dhëmbëzimin e dyfishtë në anët juglindore të qytetit në Melan (fig, 61), të shkaktuar prej përfshirjes së një daljeje shkëmbore në konturin e fortifikuar[116]. Ky rast paraqet dhe shembullin tipik ku dhëmbëzimi i lindur nga shkaqe konstruktivë fitoj edhe funksion mbrojtës, mbulimin me zjarr anësor të perdes murale.

109) R. Scranton, **Greek Walls,** Cambridge Mass, 1941, f. 149-157.

110) Halai në Lokridë (H. Goldman, Hesperia, 9, 1940, f. 381 cituar nga F. Winter, **vep.cit,** f. 151, 248), Abai (R. Scranton **vep.cit.** f. 37-8), Thermopilet dhe Muri Fokian i Herodotit (Meyer, Athenische Mitteilungen, 71 1956) (cituar nga F. Winter, **Po aty).**

111) Y. Garlain **vep.cit,** f. 151, 248.

112) A. Lawrence, **vep.cit,** f. 351, Në Prienë dhëmbëzimet vijojnë me vargje dyshe, katërsh dhe tetësh.

113) J. Adam, **vep.cit,** f. 66.

114) N. Hammond, **vep.cit,** f. 244.

115) Përfshirjen e shkëmbinjve në konturin e rrethimit për kursim pune, e ve në dukje A. Lawrence (**vep.cit,** f. 393). Por në rastin e Amanties vërehet një zgjidhje tjetër, jo tipike, ku shkëmbi është prerë vertikalisht për 3-4 m, duke u kthyer në pjesë të murit dhe duke e përdorur racionalisht materialin e përfituar për punimin e blloqeve.

116) Përveç pranisë së shkëmbit ndërtimi i dhëmbëzimit në funksion të terrenit, kuptohet nga që kulla në të djathtë të tij, e cila përfshin gjithaq një dalje shkëmbore, ndodhet 35 m larg, ndërsa kulla në të majtë, megjithëse gjendet në një terren mjaft më të pjerrët, ndodhet 80 m larg.



Fig. 62

Përsa i përket dhëmbëzimeve me funksion mbrojtës, edhe sikur të pranonim se traseja e dhëmbëzuar, do kërkonte rregullsi dhe rritëm, siç kërkojnë Marten, Garlan, Lorens dhe Adam, një rregullsi dhe rritëm të tillë e hasim mjaft më herët se mesi i shek. IV, në një sërë fortifikimesh të shek. VI-V p.e.sonë. Kështu në Kasope ndarja e brendshme i kundërvihet pjerrësisë së terrenit me tre dhëmbëzime (50 – 60 x x 2,5 m) me funksione të qarta mbrojtëse (fig. 62). Seritë dyshe dhe treshe i hasim dhe në Nikae, ku karakter të qartë mbrojtës kanë dhëmbëzimet e anës jugore, si dhe në Velian[117]. Dhëmbëzime të tilla edhe më të qarta hasim në një varg fortifikimesh të tjera të shek. V (Buthrot, Çukën e Ajtoit, fig. 63, Borsh, Kallogjerisë, Gotistën e madhe dhe Mazaraq)[118].

Dhëmbëzimet me funksion të qartë mbrojtës mund të grupohen në dy kategori kryesore: në dhëmbëzime të shkëputura, ku largësia e mënjanon çdo mundësi bashkëveprimi, dhe dhëmbëzime të njëpasnjëshme sipas një ritmi, në varg ose bateri që sigurojnë bashkëveprimin me njëri tjetrin.

Dhëmbëzimet e veçuara hasen që nga fundi i periudhës së parë të hekurit (Karalibej – rr. Sarandës, Samobor fig. 13 etj.). Këto dhëmbëzime marrin përsipër dhe mbrojtjen e hyrjeve, detyrë që nga mesi i shek. IV p.e.sonë i kalon kryesisht kullave. Dhëmbëzimet në mbrojtje të hyrjeve në tërë rastet e njohura, ndodhen nga ana e djathtë e pambrojtur, e sulmuesve dhe janë mjaft të gjera, për të mbartur



Fig. 63

DO NOT COPY

një numër sa më të madh mbrojtësish (Samobor fig. 13, Veljan, Amotopos fig. 64). Synimi për t'i kundërvënë sulmit një numër sa më të madh mbrojtësish kuptohet qartë në fortifikimin e Paleomanestrës (rr. Sarandës), ku dhëmbëzimi brinjas hyrjes është rreth dy herë më i gjerë (6m) se dhëmbëzimet (fig. 65) e tjerë.[119] Në rastin e hyrjeve tangenciale kjo skemë paraqitet e përmbysur. Hyrja kryhej përmes dhëmbëzimit, ndërsa mbulimi anësor nga muri ballor (fig. 63).

Dhëmbëzimet e veçuara, kryesisht në shek. e IV p.e.sonë, gjenden dhe në mes të dy kullave, kur largësia midis tyre është më tepër se një e hedhur ushte. Në këto raste muri-perde fitonte një mbulim të dyfishtë me zjarr të rëndë kryesor nga kulla dhe zjarr ndihmues nga dhëmbëzimi. Kjo zgjidhje kapet në anën veriore të kështjellës së Shën Ilisë (shkambi Shënlliut rr. Elbasanit fig. 18) dhe në kështjellën e Cerjes (rr. Vlorës fig. 45). Në këtë të fundit, me përjashtim të humnerës jugore tri anët e



Fig. 64



Fig. 65

DO NOT COPY

117) N. Hammond, (**vep.cit,** f. 71-72) e përshkruan Velianin si një fortifikim me hyrje të thjeshtë ballore të mbuluar me arkitra, pa kulla, por me dhëmbëzime, të papajisur me vija peshimi në skajet. Këto tipare, në të kundërt me datimin e paargumentuar të Hamondit në v. (**vep. cit,** f.) e përcaktojnë fortifikimin e mësipërm në shek. e VI p.e.sonë.

118) S. Islami (**Qyteza në Çukën e Ajtoit,** Saranda, Almanak 2, 1982, f. 9-18), i bazuar në gjetjet dhe tipologjinë, e daton këtë qendër në fundin e shek. V – fillimin e shek. IV. N. Ceka (**Fortifikimi antik i Butrintit,** Monumentet, 12, f. 35) e zbret këtë datë në mes të shek. IV, ndërsa Gj. Karaiskaj, (**5000 vjet fortifikime në Shqipëri),** 1981, f. 71, i nisur vetëm nga stili i mureve, e ul edhe më tepër deri në shek. e III p.e.sonë. Por gjetjet dhe arkitektura përputhen mirë me njëra-tjetrën duke na shpënë pikërisht në shek. e V p.e.sonë, siç mendon S. Islami. Buthroti dhe Borshi tek A. Baçe (**Vështrim. . .)** Tri qendrat e fundit përshkruhen shkurtimisht nga N. Hammond, **vep.cit,** f. 158, 181, 197. Për datimin jemi nisur nga vetitë arkitektonike.

119) Sipas planimetrive të botuara: nga C. Praschniker – A. Schober, **vep. cit,** f. 91-94, (Samobori), N. Hammond, **vep.cit,** f. 71-72, (Veljoni) S. Dakaris, W. Hoepfner, L. Schwander, V. Gravani, **Anaskafi, ston Ammotopo,** Dodona, 5, 1976, f. 431-436 (Amotoposi). F. Prendi – Dh. Budina, **Kalaja e Irmajt,** Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, ser. shk. shoq. Tiranë 1963, 4, f. 30-60, Paleomanestra sipas rilevimit në vend të autorit.

DO NOT COPY



Fig. 66



Fig. 67



Fig. 68

tjera përgjysmohen nga dhëmbëzimet mes kullave. Dhëmbëzimet vlejnë dhe për fuqizimin e zjarrit në pikat e brishta, si në kështjellën e mesit shek. IV p.e.sonë në Goricë (Berat) ku muri-perde në brinjë të hyrjes, vetëm 35 m i gjatë, thyhet për lindjen e një vatre të re zjarri, e cila ndihmonte kullën për kontrollin e afrimit tek hyrja (fig. 19).

Dhëmbëzimet e vargëzuar. Nga 102 fortifikime të ndërtuara me blloqe të latuara, 76 janë pajisur vetëm me kulla, 17 me kulla e dhëmbëzime dhe 9 vetëm me dhëmbëzime. Këto të fundit i hasim vetëm në Epir, 5 prej tyre në territorin tonë (Buthrot, Çukë e Ajtoit, Rrips, Borsh, Paleomanestër). Sipas formës planimetrike këto dhëmbëzime mund të grupohen në 3 tipe kryesore (trase e shkallëzuar, dhëmbëshaRre dhe meandër).

DO NOT COPY



Fig. 69



Fig. 70



Fig. 71

Tipi i parë, më racional dhe më i hasur, formohet nga trakte të drejta e të gjata, të cilat këmbehen ritmikisht me ballët e ngushtë, të drejtuar gjithnjë nga e njëjta anë. Por kjo trase, në kundërshtim me rekomandimet (Philo A 37), me përjashtim të një rasti (Kastrion), fig. 66), haset e pastër, e papërforcuar me kulla[120]. Rrallësia e tyre spjegohet me faktin se këto kulla janë irracionale, vetëm me një faqe aktive. Emërtimi i këtij tipi është ende i pakristalizuar: Termi i përdorur nga Filoni, trase me mure oblike (A.55), deri më sot nuk ka fituar qytetari, pasi përfytyrimi del i zbehtë dhe vetë fragmenti nuk është i qartë. Marten, Garlan dhe Adam përdorin termin kremaljerë, por dhëmbët simetrikë e të rrumbullakosur të një kremaljere nuk i afrohen formës planimetrike të trasesë në shqyrtim. Së fundi Uinter përdor termin trase e dhëmbëzuar; por të dhëmbëzuara janë dhe dy trasetë e tjera, shara dhe meandri. Rrjedhimisht duke mbetur në fushën e një emërtimi konvencional do parapëlqenim emërtimin trase e shkallëzuar, pasi forma planimetrike e kësaj traseje i përgjigjet mirë formës së shkallës. Traseja e shkallëzuar gjendet në terrene relativisht të rrafshëta dhe në terrene të pjerrëta, tërthor me vijat rrushkulluese. Prej tyre, të parat, dy herë më të rralla se trasetë e shkallëzuara në terrene të pjerrët, haseren kryesisht në qendrat e hershme (Nikae, fig. 14, Amotopos, Foinike, qyteti në Çukën e Ajtoit fig. 63). Më e hershme prej tyre është traseja e shkallëzuar në Nikae, ku kalimit të mundshëm buzë rrëpirës jugore i kundërvihen dy dhëmbëzime.

Në terrenet e pjerrëta traseja vijon përpendikular me terrenin. Ky synim kapet qartë në murin jugor të Foinikes, ku ajo kthehet nga mesi me një kënd 120°, për të vazhduar tërthor me vijat rrushkulluese (fig. 67). Traseja e shkallëzuar në këto terrene

120) Përforcimi me kulla i traseve të dhëmbëzuara është i rrallë dhe në Greqi, si shembull klasik mund të sillet Halkisi dhe pak raste të tjerë.

ku sulmi lëviz nga poshtë – lart, është mjaft e efektshme dhe rracionale, rrjedhimisht dhe më e shpeshtë (Kasope, Lis, fig. 17 Foinike, qyteti në Gurzezë, kështjellat në Rrips, fig. 68, Paleomanastër fig. 69 etj.). Në këto terrene ballet e dhëmbëzimeve luajnë një rol të dyfishtë. Së pari, sigurojnë gjymtyrizimin e domosdoshëm në terren të pjerrët të mureve-perde tepër të gjatë, i cili nuk arrihej dot nga kullat që nuk e shkëpusin trasenë, por vetëm i bashkangjiteshin asaj. Së dyti, ballet i kundërviheshin drejtpërsëdrejti lëvizjes nga poshtë – lart ose këmbenin rolin me murin-perde duke goditur brinjasi sulmuesit që afroheshin nga anët, duke kryer një mbulim të mirëfilltë anësor. Në rastet kur traseja zbret nga e djathta në të majtë të sulmuesit, dhëmbëzimet ndodhen në anën e tij të djathtë. Në të kundërt në se traseja zbret nga e majta në të djathtë, dhëmbëzimet ndodhen në anën e majtë të sulmuesit. Kjo dukuri kapet qartë në Lis (fig. 17) dhe Foinike, ku muret zbresin me dhëmbëzime nga të dy anët e kodrës. Ndonëse më i preferuar do të qe dhëmbëzimi i djathtë, i cili e godet sulmuesin nga ana e majtë e pambrojtur prej shqytit, përcaktues është terreni. Kjo pasqyrohet në shpërndarjen thuajse të barabartë: Nga 16 trase të dhëmbëzuara 7 vijojnë majtas (ana veriore e Nikaes fig. 14, juglindore e Amanties, perëndimore e Çukës së Ajtoit fig. 63, veriperëndimore e Lisit fig. 17, perëndimore e Gurzezës, veriore e Foinikes, Amotopos, Antigone) dhe 9 djathtas (ana jugore e Nikaes, fig. 14, juglindore e Çukës së Ajtoit fig. 63, veriperëndimore verilindore dhe jugore e Foinikes fig. 67, verilindore e Lisit, fig. 17, Rrips fig. 68, Paleomanestër fig. 65, Guman). Rrjedhimisht përfundimi i J. Adamit se dhëmbëzimet ndodheshin vetëm nga ana e djathtë, e



Fig. 72

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 73



Fig. 74

sulmuesit, nuk mbështetet as nga logjika as nga faktet[121].

Këto trase i përkasin një diapazoni të gjerë kohor, nga fundi i shek. VI – fillimi shek. V, deri në fundin e shek. III p.e.sonë. Trasenë më të hershme e hasim në rrethimin e brendshëm të Kasopesë, ku dhëmbëzimet vijojnë 50 – 60 m larg njëri tjetrit, me ballë të cekët 2.5 m, (fig. 62) dhe Nikae, ku largësia arrin në 120 m (fig. 14). Siç shihet ballët janë të ngushtë, sa për qëndrimin e 2 – 3 luftëtarëve, ndërsa largësia, veçanërisht në Nikae, është më e madhe nga largësia mes kullave që kërkohej nga traktatet ushtarake të shek. IV, 100 bërryla (46.24 m) ose një të hedhur ushte larg (Vitruv. De Arch. I.5.4). Kjo tregon për një mbulim të zbehtë anësor të bazuar në zjarrin e harkut, i cili synonte vetëm pengimin e ngjitjes me shkallë dhe shmangien e zonave të vdekura rrëzë murit.

Në shembujt e mëvonshëm vihet re shpeshtimi i dhëmbëzimeve (Lis 44 m, Foinike 20 – 40 m, Paleomanestër 7-13m) dhe zgjerimi i ballit të tyre (Rrips fig. 68, Foinike, Paleomanestër 2,5 – 6 m, fig. 65, Lis fig. 69), çka sjell një rritje të ndjeshme të fuqisë së zjarrit dhe mundësinë e mbulimit me makina predhahedhëse. Në Kasope dhe Goricë, ballet e dhëmbëzimeve janë pajisur me portëza për daljen e shpejtë (fig. 70), ndërsa në Çukën e Ajtoit në këto balle vendosen hyrjet e mirëfillta të tipit tangencial (fig. 63). Ndryshe prej tyre në murin jugor të Foinikes, Rrips (fig. 68) dhe Paleomanestër, hyrjet ndodhen në skaj të dhëmbëzimit.

Tipi i dytë emërtohet nga Filoni (A.84) trase sharrë, për shkak të formës tepër të ngjashme me dhëmbët trekëndëshe të sharrës. Këtë tip, të rekomanduar prej tij në terrene shkëmbore (A. 44, 48), e hasim në murin perëndimor të Foinikes, i cili vijon në një terren shkëmbor sinusoidal, i pajisur thepave me kulla drejtkëndëshe[122] (fig. 71). Por në të forma e «dhëmbëve» të sharrës» nuk është krejt e pastërt, pasi muri-perde ndërmjet thepave 130 gradësh thyhet në 3 trakte (60, 35,50m) duke fituar një formë të përafërt me trasenë gjysmë rrethore (hemiciklon) të përshkruar po nga Filoni (A. 39)[123].

121) J. Adam (**vep.cit,** f. 66). Për ilustrim sjellim dhëmbëzimet e majta në anën jugperëndimore të murit të Prienës, që dallohet për rregullsinë e dhëmbëzimeve të djathta (T. Wiegand, H. Schrader **Priene,** Berlin, 1904, planimetria e fortifikimit).

Ndërtimi strukturor i kishave

Gjatë studimit të tipologjisë, kemi parë se ndërtimi vëllimor, pra dhe i strukturave, ishte një ndër aspektet themeltare në drejtim të klasifikimit tipologjik të ndërtesave të kultit. Kështu kishat e Shqipërisë, për periudhën në studim, i takojnë tre tipave: ndërtimeve njënefshe, bazilikave dhe kishave kryq i brendashkruar me kupolë[3]. Të tre tipat kryesore të kishave kanë ndërtim dhe punë të ndryshme të strukturave. Megjithë ndryshimet në organizimin vëllimor dhe rezultatin arkitektonik, ndërtimet njënefshe me çati druri dhe ato bazilikale, kanë të njëjtin parim strukturor. Në to mbulimi bëhet me çati druri dhe ngarkesat kalojnë në tokë nëpërmjet mureve anësore dhe në rastin e bazilikave edhe nëpërmjet harkadave dhe mureve mbi to.

Mbulesa me kapriata apo çati vendi, është e ndërtuar me materiale, jetëgjatësia e të cilëve është e kufizuar dhe për këtë shkak asnjë çati origjinale nuk ka ardhur deri në ditët tona. Për më tepër, shumica e kishave janë meremetuar në pjesën e sipërme të mureve. Mundësia e mbulimit të hapësirës të dritës së çatisë (gjerësia e kishës) ka përcaktuar dhe vetë madhësinë e ndërtesës. Kështu, janë të pakta kishat që kalojnë gjerësinë 8 m, ndërkohë që gjatësia e tyre luhatet në përmasa më të mëdha. Përgjithësisht, kapelat duhet të kenë qenë ndërtuar me çati vendi, dmth me trarë horizontalë (zinxhirë), mbi të cilët nëpërmjet baballëkëve dhe trarëve gjatësorë, që

1) A. Meksi, **Periodizimi dhe tipologjia e ndërtimeve të kultit në shekujt VII-XV,** «Monumentet» 2, 1986, 37-46.

2) A. Meksi, **Monumentet mesjetare të kultit dhe rrënjët e tyre në antikitetin e vonë,** «Iliria» 1983, 217 – 222.

3) A. Meksi, **Periodizimi** .... 37.

lidhin strukturën dhe shpërndajnë ngarkesat, mbështeten mahitë, të cilat nga ana e tyre mbajnë patavrat e tjegullat. Kjo përbën një zgjidhje sipas traditës ndërtimore vendëse. Kisha të mëdha e të rëndësishme, si katedralja e Shën Stefanit në Shkodër[4], ka shumë mundësi që të jenë mbuluar me kapriata, jo vetëm për vetë rregullshmërinë strukturore dhe anën estetike të brendësisë, por dhe sepse duhet të ketë qenë i vështirë sigurimi dhe transporti i trarëve të gjatë për zinxhirët. Me kapriata duhet të kenë qenë mbuluar dhe nefet qendrore të bazilikave, një pjesë e të cilave është dhe me pretendime arkitektonike.

Në rastin e bazilikave, çatia mbështetet në murin mbi arkadat që ndajnë nefet dhe ngarkesat, të cilat kalojnë në tokë nëpërmjet sistemit të harkuar, pilastrave në muret anësore dhe pilastrave apo kolonave në pjesën e naosit. Në aspektin që përmendëm mund të dallojmë rastin kur këto mbështetje janë kolona, si në Perhondi[5], apo pilastra me prerje katrori, në Shirgj[6], por kemi dhe pilastra, në të cilat gjatësia kalon disa herë gjerësinë e murit, si në Shën Mëri[7] dhe Sulovë[8].

Një grup më vete ndërtimesh, në aspektin strukturor, paraqesin kishat njënefshe të mbuluara me qemer cilindrik. Në to ngarkesat e mbulesës i kalojnë mureve anësore në formën e ngarkesës vertikale (pesha e strukturës dhe mbulesës) e shtytjes horizontale. Për të përballuar sidomos shtytjen horizontale, është e domosdoshme që rezultantja e ngarkesave të bjerë brenda bërthamës së inercisë së murit, që të mos kemi as përmbysje e as sforcime tërheqëse. Për këtë qëllim bëhet kufizimi i hapësirës të dritës së qemereve (gjerësisë së kishës) dhe rritja e trashësisë së mureve. Të tilla kapela janë kishat e Maligradit, Sopit, Himarës, Herbelit[9], Mazrekut[10]. Kjo zgjidhje vërehet dhe në absidën drejtkëndore të kishës së Çetës[11], mbuluar me qemer me profil të mprehtë.

Për të mos trashur tej caqeve muret dhe për t'i lehtësuar ata, ndërtuesit, veç tirantave kanë përdorur pilastrat në mure dhe harqe të verbër mbi ta. Kështu del e trashur pjesa e mureve (mbi harqet e verbër) dhe bërthama e inercisë njësohet për tërësinë pilastër-mur. Që kjo tërësi të jetë funksionale për këtë aspekt, duhet që pilastrat të jenë pak a shumë afër. Këtë skemë e kemi në disa kisha të Shqipërisë së Veriut, si në Blinisht e Kakariq[12]. Këto pilastra mund të jenë dhe në anën e jashtme, duke plotësuar dhe funksione arkitektonie, si në kishën e Vaut të Dejës[13]. Në këtë rast, për të patur një gjerësi më të madhe, kemi dhe harqe mbajtëse tërthore, pikërisht atje ku janë pilastrat. Këto pilastra të jashtme i takojmë edhe në kishën e Çelës, si rezultat i përfshirjes së kishës në arkitekturën romaniko-gotike, por që përdoren vetëm për arsye estetike[14].

Një mbulesë më të zhvilluar, sipas skemave të arkitekturës romaniko-gotike, paraqet absida e kishës së Shën Stefanit në Shkodër[15]. Nga mbetjet që ruhen, kuptohet qartë, se absida drejtkëndore ka qenë mbuluar me qemer të kryqëzuar dhe me brinjë (nervatura), gjë që flet për një nivel të lartë, si në drejtim të ndërtimit të strukturave ashtu dhe në aspektin teknik të realizimit. Këtu duhet të përmendim se kisha romaniko-gotike, me mbulesa të harkuara me nervatura, ka patur dhe në Durrës. Për këtë gjykojmë nga fragmentet mjaft të qarta që ruhen në muzeun e atjeshëm.

Një hap përpara në aspektin e organizimit strukturor, që kërkon një nivel më të lartë ndërtimor, paraqesin kishat e tipit kryq i brendashkruar me kupolë. Këto kisha janë mjaft të përbëra në drejtim të strukturës dhe në to, ekuilibri i tërësisë është në vartësi të punës së përbashkët strukturore të gjithë elementeve[16]. Duke qenë me struktura të lakuara (harqe, qemere, kësula, sferike e kupolë) peshat kalohen në tokë si ngarkesa vertikale dhe shtytje horizontale. Përballimi i të parave, dmth kalimi i tyre në tokë, bëhet nëpërmjet mureve anësore, pilastrave dhe kolo-

4) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut,** «Monumentet» 2, 1983, 80 – 81, Tab. I.
5) A. Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë,** «Monumentet» 5 – 6, 1973, 19 fig. 3.
6) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë...** «Monumentet» 2, 1983, 82-85. Tab. VI-VII.
7) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë...,** «Monumentet» 1, 1984, 107 – 108, Tab. III.
8) A. Meksi, **Bazilika në Klos të Sulovës,** «Monumentet» 5-6, 1973. 189, Tab. I.
9) A. Meksi, **Disa kapela bizantine të vendit tonë,** «Monumentet», 10, 1975, 75 – 86.
10) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë...,** «Monumentet» 2, 1983, 89-90 T. XIII.
11) A. Meksi, **Vep.cit,** Tab. II.
12) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë...,** «Monumentet» 2, 1983, 93 – 94, Tab. XVIII-XX.
13) **Po aty,** 86 – 88, Tab. X.
14) A. Meksi, **vep.cit.** 106.
15) A. Meksi, **vep.cit.** Tab. V.
16) Për këto probleme shih M. Rumpler, **La coupole dans l'architecture byzantine et musulmane,** Strasbourg 1956.

DO NOT COPY

nave, ndërsa përballimi i shtytjeve horizontale, bëhet nëpërmjet shpërndarjes së tyre nga qendra në anët dhe kalimit nepër muret, brenda bërthamës së inercisë. Për të mos e realizuar këtë nëpërmjet trashjes së mureve anësore, përdoret ekuilibrimi reciprok i shtytjeve të strukturave të veçanta, duke zbritur ngarkesat nga lart-poshtë, gjithnjë brenda bërthamës së inercisë. Në këtë mënyrë, ndërtimi i kishave të këtij tipi, kërkonte patjetër njohjen reale të këtij baraspeshimi, çka është dhe shkaku i futjes me vonesë dhe vështirësi i këtij tipi. Është e rëndësishme të nënvizohet se kjo zgjidhje statike në hapësirë, varet dhe nga zgjidhja arkitektonike, me një organizim të vëllimeve, të panjohur deri atëhere, nga mjeshtërit ndërtues vendës. Në këtë mënyrë hapësira e brendshme dhe pamja e jashtme e ndërtesës është në përputhje me strukturën ndërtimore të organizuar sipas parimit të baraspeshimit reciprok të ngarkesave dhe veprimit shtytës të tyre, që përbën një realizim ndërtimor të kërkesave arkitekturore të mbështetura në simbolikën e kohës.

Le ta ilustrojmë këtë me dy shembuj të ndërtimeve të këtij tipi: me kishën e Shën Mëhillit dhe të Shën Triadhës në Berat, që paraqesin respektivisht variantin pambështetje të brendshme dhe atë me mbështetje të brendshme, si dhe me Shën Kollin e Mesopotamit, që paraqet një rast të veçantë.

Në kishën e Shën Mëhillit[17], ngarkesat e kupolës, përballohen nga tamburi masiv dhe sistemi i brezave në nivelin e mbështetjes së kupolës, të cilat thithin forcat tërheqëse sipas perimetrit të bazës. Këto shtytje, pesha e kupolës dhe pesha e tamburit cilindrik, janë të tilla që bien brenda bërthamës së inercisë, në bazën e tamburit. Megjithëkëtë, për këto ngarkesa, të cilat mund të jenë në kufi të qëndrueshmërisë, është krijuar një bazament katror, i cili veç të tjerave bën dhe një shpërndarje të ngarkesave vertikale në një gjerësi sa më të madhe të qemereve të krahëve të kryqit. Qemeret e krahëve të kryqit i transmetojnë ngarkesat tek muret, në formën e peshave dhe shtytjeve. Pra muret nën harqet e qemereve nuk mbajnë veçse peshën e tyre, sepse gjithë ngarkesat u kalojnë pilastrave në qoshet ku mbështeten thembrat e harqeve mbajtëse (qemeret e krahëve të kryqit). Në këtë mënyrë ngarkesat, nga niveli i bazës së tamburit ulen në nivelin e thembrave të harqeve mbajtëse, duke u zvogëluar momenti përmbysës i shtytjeve, duke u shtrirë komponentja vertikale, ose të shprehemi ndryshe, duke u rritur ndaj horizontales kendi i rezultantes së ngarkesave. Kjo eshtë dhe arsyeja që këto pilastra janë masive, në mënyrë që rezultantja përfundimtare të kalojë në to-kë, brenda bërthames së inercisë.

Në këtë mënyrë, përmasat dhe format e të gjithë elementeve të ndërtesës janë të ndërvarura, sepse një hallkë e llogaritur keq prish baraspeshimin e gjithë ndërtesës. Nga ana tjetër, cilësia e materialeve lidhëse që siguron kohezionin e harqeve dhe mureve, duhet të jetë sa më e lartë, për të përballuar sforcimet që krijohen gjatë ndërtimit dhe në fazën fillestare të jetës së ndërtesës. Në kishën e Shën Mëhillit, shtytjet e harqeve mbajtëse, janë zvogëluar duke i dhënë një profil të mprehtë atyre, duke i ngritur më lart se gjysmë rrethi.

Kisha e Shën Triadhës, në Kala të Beratit[18], paraqet ndërtimin më të përkryer të kishave kryq i brendashkruar të variantit provincial, me dy pilastra dhe dy kollona si mbështetje të brendshme. Edhe në këtë rast, në të njëjtën mënyrë si më lart, ngarkesat e tamburit me kupolën i kalojnë bazamentit të tamburit, i cili mbahet nga qemeret e krahëve të kryqit. Qemeret e krahëve të kryqit mbështeten në muret anësore (në anën lindore këtë rol e luajnë qemeret që mbulojnë ambientet këndore), duke siguruar një kalim në nivel edhe më të ulët të ngarkesave dhe shtytjeve horizontale. Në këtë rend piramidal të ngarkesave, kanë vendin e tyre dhe mbulesat e ambienteve këndore, që janë në nivel më të ulët se qemeret e krahëve të kryqit. Të njëjtat parime, që spleguam në shembullin e parë, janë zbatuar këtu, me një nivel të lartë realizimi teknik, sepse kishin përvojën e përdorimit të tyre në kishën e Shën Mërisë së Vllahernës. Në kishën e Shën Triadhës një rol përforcues lot dhe narteksi.

Rruga e përvetësimit të kësaj skeme kërkonte dije, nivel të lartë teknik dhe materiale ndërtimi të cilësisë së mirë. Të parat kërkonin një kohë për t'u përvetësuar, të dytat kërkonin një nivel të mirë ekonomik të shoqërisë mesjetare shqiptare. Në të mirë të tezës se kemi të bëjmë me mjeshtër ndërtimorë vendës, mendojmë se flet numri i monumenteve që ruhen dhe ngritja e tyre jo vetëm në qendra të rëndësishme, por edhe në brendësi të vendit.

Në se këtë kishë do ta krahasojmë me Shën Mërinë e Peshkëpisë së Sipërme[19], do ta kemi më të lehtë për të kuptuar vështirësitë e futjes së këtij

17) A. Meksi, **Tri kisha bizantine të Beratit,** «Monumentet» 4, 1972, 73 – 82, Fig. 19 – 27, Tab. IX-XII.

18) **Po aty,** 63 – 73, fig. 6 – 18, Tab. IV – X.

PO KOPJOJ

tipi në provincën tonë arkitekturore dhe nga ana tjetër konen e nevojshme për këto proçes. Përpjesëtimet e kishës së Presnkepisë së Siperme, trashësitë e mureve, lartësitë e pjesëve të veçanta, muret — përdë me kalime të vogla, që janë në rolin e mbështetjeve të brendshme, lidhin për pasigurimë e ndërtuesve për t'ia besuar mbajtjen e peshave dhe shtytjen kolonave, apo pilastrave.

Një skemë e avancuar e kishave kryq i brendashkruar me kupolë, përpara në vetvete dhe rreziqe. Mënyra e ekuilibrimit të ngarkesave me kolonë ndërmonet nga ngurtësimi i ndërsave, por kur cilësia e materialeve lintë për të dëshiruar kemi dëmtime në elemente të strukturave dhe për pasojë prishjen e punës së përbashkët të përbërësve të strukturës. Një dukuri vërehet në kishën e Apollonisë e në atë të Shën Merisë së Vllahernës. Krejt tjetër paraqet ulja e themeleve dhe mureve, kur kisha është mbështetur në terren të dobët. Ulja e pjesëve të veçanta bën që shtytjet të mos përballohen. Dëmtime të tilla vërehen në Shën Merí të Vllahernës dhe në kishën e Kurjanit, ku kupola dhe pjesët e sipërme janë rrënuar, në Presnkepi të Siperme, ku janë bërë përforcime në brendësi dhe në anën e jashtme, në Labovë të Kryqit, Lavdar e gjetke. Në kishat e ndërtuara në nivel të mirë teknik, me materiale të mira dhe mbi të gjitha në terren shkëmbor nuk vërehen kësi lloj dëmtimesh. Kështu në kishat e Shën Menilit dhe të Shën Triadhës në Berat, nuk kemi as më të voglën plasje në strukturat e monumentit.

Kisha e manastirit të Shën Kollit në Mesopotam, paraqet një rast unikal në arkitekturën bizantine dhe prandaj ndërtimi strukturor ka interes të veçantë. Kështu, ashtu siç është e veçantë arkitektura e saj në kuadrin e arkitekturës bizantine edhe zgjidhja strukturore i përgjigjet këtij kuadri dhe përshtatet me arkitekturën. Le të shohim ndërtimin e saj dhe mënyrën e zgjidhjes së strukturave. Ky parashtrim mund të bëhet vetëm duke shqyrtuar kishën në gjendjen fillestare, mbi bazën e rikonstruksionit hipotetik të saj. Ngarkesat e mbulesave të naosit me katër kupola, i kalojnë, nëpërmjet harqeve mbajtëse, kolones qendrore, pilastrave në muret anësore dhe murit ndarës të bemës, si dhe arkadës naosnarteks. Me ndryshime të vogla, shtytjet e harqeve mbajtëse në kolonën qendrore eliminohen me njëra-tjetrën, duke i kaluar peshat vertikalisht në tokë nëpërmjet kësaj kolone. Shtytjet dhe peshat që shkarkohen në harqet mbajtëse në muret anësore, megjithëse të ulura në një farë lartësie, tentojnë të përmbysin pilastrat, të cilat duket se përballonin ato në kufi të qëndrueshmërisë së tyre. Një rol ndihmës loznin portikët, nëpërmjet pilastrave në anën e jashtme dhe harqeve tërthor portikut, që kryejnë rolin e harqeve përforcuese duke ndihmuar për përballimin më të mirë të ngarkesave. Dy aspekte vlejnë për t'u shënuar këtu. Së pari, që në ndërtimin strukturor, pjesët ndërmjet pilastrave dhe nënharqe mbajtëse janë në rolin e mbushjes dhe si të tilla ja në më të holla dhe me dritare të mëdha. Së dyti duhet të vemë në dukje ngjashmërinë e zgjidhjes së portikut të këtushëm me harqe e qemere në rolin e harqeve përforcuese, me zgjidhjen e arkitekturës gotike.

Puna strukturore e kishës së Mesopotamit, dëshmon për nivelin e lartë të ndërtuesve të saj, në konceptimin dhe realizimin e një skeme unikale brenda zgjidhjeve të kohës. Është e kuptueshme se një zgjidhje e tillë, ku baraspeshimi i formave i lihet tërësisë, mbart në vetvete dhe rrezikun e dëmtimit, ku një nga përbërësit nuk është në gjendje të përballojë ngarkesat. Me kalimin e kohës në këtë kishë janë shfaqur ulje apo të çara, për të cilat është nevojitur të përforcohet kollona qendrore. Më vonë rrenohet portiku, çka dëmton rëndë ekuilibrin e ndërtesës, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e saj. Mbas këtyre rrënimeve rindërtohen pjesët munguese, por jo tërësisht sipas pamjes së mëparshme.

Analiza e punës së kishave me kupolë, të tipi kryq i brendashkruar, madje dhe ato që dallohen nga ky tip (Labovë e Kryqit Mesopotam), ka treguar qartë se ndërtuesit tanë njihnin dhe zbatonin me mjeshtëri parimin e përballimit të ngarkesave brenda strukturave të ndërtesës, kalimin e tyre nga lart-poshtë dhe nga qendra me kupolën në muret anësore, çka përbën një karakteristikë dalluese të këtyre ndërtimeve.

Në të gjitha këto ndërtime mesjetare, tërësia përbëhet prej elementesh të veçantë si: kupolë, qe-

19) A. Meksi, **Kisha bizantine në rreth të Gjirokastrës,** «Monumentet» 9, 1975, 77-82, fig. 1-3, Tab. I-V.

20) A. Meksi, **Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apollonisë,** «Monumentet», 1, 1971, 103-115, fig. 1-8, Tab. I-V.

21) A. Meksi, **Tri kisha bizantine,** «Monumentet» 59-61, fig. 1-5, Tab. I-III.

22) A. Meksi, **Dy ndërtime të tipit trekonkësh,** «Monumentet» 7-8, 1974, 229-234, fig. 1-4, Tab. I-III.

23) A. Meksi, **Dy kisha...,** 82-105, fig. 4-7, Tab. VI-X.

24) Këto aspekte i kemi trajtuar gjerësisht dhe me imtësi në **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Mesopotamit në Sarandë,** (Disertacion) Tiranë 1977, 48-104.

Botoret

mer, hark, breza e tiranta, mure e themele. Ndërtimi i secilës prej tyre dhe niveli i teknikës së realizimit, përbëjnë dëshmi me vlerë për të gjykuar për arkitekturën mesjetare. Për këtë arsye do të shqyrtojmë veçmas këto elemente për rastet që kemi mundur të vërejmë, krahas materialeve të përdorura.

Kupolat, qemeret dhe harqet. Gjatë gjithë kohëve, ndërtimi i kupolave ka qenë një nga detyrat më të vështira për ndërtuesit. Mbulimi i një hapësire, sado të vogël, kërkon materiale të zgjedhura e me cilësi të lartë, mundësi teknike të realizimit, përfshirjen e saj në struktura, të cilat përballojnë ngarkesat që transmeton vet kupola. Në kishat tona kupolat janë të ndërtuara mbi tambure cilindrike, të cilat nga ana e tyre ngrihen mbi një bazë katrore. Kalimi nga ky katror, në tamburin cilindrik me prerje rrethore, në të gjithë shembujt tonë, është realizuar nëpërmjet trekëndëshave sferik (vela – pendantiva). Mund të shënojmë se në kishën e Mesopotamit takojmë trompa brenda velave të kupolës juglindore. Po kështu kupola e kishës së Armenit[25] paraqet një paraboloid eliptik, për shkak të ndërtimit të saj të çrregullt. Në të tamburi shquhet vetëm në ndërtimin e jashtëm. Në këtë rast, si dhe në Shën Mërinë e Dhërmiut, nuk kemi trekëndësha sferikë të mirëfilltë.

Tamburin, mbi të cilin ngrihet kupola, e hasim të ndërtuar me gurë, (Marmiro, Peshkëpi, Zervat) me tulla, (Kosinë), apo dhe me gurë e tulla (Mesopotam, Berat, Lavdar, Zvërnec). Për të mos ulur qëndrueshmërinë e tamburit (qoftë prizmatik apo cilindrik), dritaret, janë në pjesën e poshtme dhe gjithnjë katër. Kupola në vetvete është e ndërtuar me gurë të zakonshëm (Marmiro), me gurë të lehtë çmërsi (Mesopotam) dhe me tulla (Berat, Mborje, Pojan).

Në të gjitha rastet gurët e përdorur janë të skuadruar, shpesh në formë pyke dhe me madhësi sipas vendit ku ndodhen. Përdorimi i gurit të çmërsit jep lehtësi ndërtimi (gdhendje e lehtë, peshë e vogël) dhe krijon një kupolë më të lehtë, pra me shtytje më të vogël. Një masë tjetër e praktikuar nga ndërtuesit, është ndërtimi i çatisë konike që kërkon muraturë të tamburit mbi thembrat e harkut. Kjo realizohet duke trashur thembrën e kupolës (Marmiro, Labovë e Kryqit, Mborje, Peshkëpi e Sipërme, Zervat), ose duke lartësuar këtë mur të shkëputur nga kupola (Kosinë). Në rastin e kishave të Beratit, mbulesa valëzohet mbi faqet e tamburit prizmatik.

Në të gjitha kishat kemi mbulesën me një çerek sfere të absidave. Në ndërtimet e mira forma e saj gjeometrike zbatohet rigorozisht. Edhe tullat apo gurët vendosen sipas meridianeve, por nuk mungojnë dhe rastet kur ato vendosen sipas paraleleve, apo dhe në forma të tjera. Në mjaft ndërtime që nuk shquhen për rregullshmërinë e ndërtimit, konka e absidës është rudimentale (Armen, Himarë). Mbi kupolë, tjegullat e mbulesës, vendosen mbi një shtresë llaçi e cila siguron lidhjen e tyre.

Në të gjitha kishat e tipit kryq i brendashkruar, krahët e kryqit mbulohen me qemere cilindrike. Po kështu dhe absida e kishës së Çetës. Këto janë të ndërtuara me gurë ose tulla të vendosura sipas rrezeve. Ka dhe raste, si në Sop, ku në qemer janë përdorur gurë dhe tulla, Përgjithësisht thembrat e qemereve ndërtohen njëherazi me murin pranë, më tej qemeri vazhdon i palidhur me të. Në këtë rast ai duhet të jetë ndërtuar me ndihmën e kallëpëve prej guri. Gjurmë të qarta të tij me llaç shohim në Sop dhe Armen.

Qemeret cilindrike, që hasim në kishat e vendit tonë, kanë prerje gjysmë rrethi. Nuk mungojnë dhe qemeret me profil të mprehtë të harkut si në Berat dhe Çetë, shenjë e ndikimeve të arkitekturës perëndimore. Rast më vete, siç treguam më lart, përbënte mbulimi me qemere të kryqëzuara në absidën e Shën Stefanit në Shkodër, ku ruhen gjurmët e mbështetjes së tij mbi mur në anën jugore dhe fillimet e nervaturave në këndin jugperëndimor, si dhe rastet e sipërpërmendura të Durrësit.

Harqet janë ndër elementet strukturore të lakuara që takohen gati kudo. Si mbulesa të dyerve dhe dritareve, apo si elemente përbërëse të arkadave, harqet përdoren për shkak të lehtësisë së ndërtimit, sepse në të kundërt do të duheshin gurë të mëdhenj një copë. Harqet janë ndërtuar kurdoherë me kallëpe, por duhet thënë që në disa raste, kur kemi hapësira drite mjaft të vogla për të mbuluar, harku është i rremë dhe i krijuar nëpërmjet gdhendjes në një copë guri (Kamenicë, Pllanë e gjetkë). Harqet janë të ndërtuara me gurë, tulla si dhe me gurë e tulla që këmbehen. Në to veçohen për nga vendi që zenë gurët e thembrave dhe kyçet. Në Mesopotam ka dhe harqe të ndërtuara me tulla në formë pyke.

Në pikëpamje të punës së tyre harqet janë: harqe konstruktive, dmth që mbajnë ngarkesa dhe zbukuruese, të cilat, nuk mbajnë asnjë ngarkesë, por janë vënë për arsye estetike. Në këtë grup duhet të futen dhe harqet e varura ose harqet lombarde (Vau i Dejës, Zvërnec, Kurjan). Me harqe të tillë jo konstruktive janë mbuluar dhe niket.

Mbulesa e dyerve apo dritareve në mjaft raste

25) A. Meksi, **Disa kapela...**, 76-77, Tab. II-III

DO NOT COPY

janë me hark vetëm në anën e jashtme, duke patur në anën e brendshme arkitrarë druri, kalbja e të cilëve mjaft herë ka kërkuar rindërtimin e tyre. Kuptohet që zgjidhja e anës së jashtme në kësi rastesh është diktuar nga kërkesa estetike. Megjithë këtë, duhet thënë se në këtë mënyrë evitohet vendosja e elementeve të drunjta në anën e jashtme, për të mos qenë në kontakt me veshjet. Nuk duhet të lemë pa përmendur dhe disa raste të harqeve me profil të ulët, si në Shën Markun e Vaut të Dejës, në Shkodër e gjetkë.

Brezat dhe tirantat. Në të gjitha kishat me mbulesa të lakuara, gjejmë përdorimin e elementëve të drunjta që kanë për detyrë të thithin shtytjet e harqeve dhe qemereve. Këto janë tirantat, përdorimi i të cilave flet për një kuptim të drejtë të punës strukturore. Tirantat i takojmë gati në të gjitha kishat e tipit kryq i brendashkruar, si dhe në mjaft kisha njënefshe, mbuluar me qemere.

Tirantat janë të vendosura në thembrat e harqeve mbajtëse të qemereve të krahëve të kryqit dhe në të gjitha harqet e veçuara, apo dhe në arkada. Përgjithësisht ato janë me dru lisi, me përmasa 12 x x 12 cm, 16 x 16 cm.

Në disa kisha të tipit kryq i brendashkruar me kupolë, si në Pojan, Shën Triadhën në Berat, dhe Labovën e Kryqit, ruhen një pjesë e tirantave në harqet mbi mbështetjet dhe në qemeret e krahëve të kryqit. Të tilla tiranta ka dhe në arkadën naos-narteks të kishës së Mesopotamit. Në kishat mbuluar me qemere cilindrike, në Armen, Sop, Himarë, Blinisht dhe Mullet gjejmë gjurmë të qarta të tiranteve të vendosura në nivelin e fillimit të harqeve.

Puna e përbashkët e tirantave me qemerin, apo me harkun, mund të sigurohet vetëm nëpërmjet lidhjes së tirantit me thembrën e harkut. Është e kuptueshme që kjo nuk mund të ndodhte për fërkim, por vetëm nëpërmjet lidhjes me një sistem brezash në brendësi të mureve. Gjatë studimit të monumenteve, e sidomos gjatë punimeve restauruese në kishat tona, ne kemi patur mundësi ta njohim mirë këtë problem.

Duke patur parasysh se brezat nuk i qëndrojnë kohës dhe shpesh shkëputen nga muret ku mbërthehen, kështu që rolin e tyre më të madh e lozin në periudhën e ndërtimit dhe në vitet e para, kur llaçi akoma nuk ka arritur fortësinë e duhur. Më tej, siç tregon shembulli i monumenteve të ruajtura, strukturat e harkuara janë në gjëndje të përballojnë këto shtytje.

Brezat që kemi hasur në lartësinë më të madhe, janë ato të Shën Triadhës të vendosura në nivelin e thembrës së kupolës, për të thithur sforcimet tërheqëse që lindin aty. Me që prej tyre ruheshin vetëm gjurmët në brendësi të strukturës, nuk mundëm të merrnim të dhëna për mbërthimin e tyre. Sistem tjetër të brezave, kemi gjetur në bazamentin e tamburit të kupolës. Këtë e kemi takuar në Mesopotam, në vendtakimin e kupolës me harqet mbajtëse, në Shën Triadhë e Shën Mëhill të Beratit, në bazamentin, e tamburit. Në kishën e Mesopotamit ne arritëm të shohim një çift brezash të kryqëzuar me përmasa 12 x 12 cm. Në kishën e Shën Triadhës ishin dy breza 10 x 10 cm dhe 10 x 12 cm, të vendosur në brendësi të murit, që lidheshin duke u kryqëzuar e mbërthyer me brezat normalë në faqet e tjera të bazamentit. Në kishën e Shën Mëhillit takuam vetëm një binar që mbërthehej duke u kryqëzuar me atë që vinte nga faqja tjetër. Përmasat e tyre ishin 12 x x 19 cm dhe 15 x 15 cm, pra ktëu kemi një rritje të përmasave të tyre. Ata ishin 52 dhe 42 cm, në brendësi të murit. Në Kosinë kishte gjithashtu breza që kryqëzoheshin me nga dy binarë 10 x 12 cm secili.

Në kishat kryq i brendashkruar me kupolë, më me rëndësi ishte sistemi i brezave, që qarkonte tërë muret perimetrale të ndërtesës në nivelin e dritareve, të frontoneve, të krahëve të kryqit. Këto breza lidheshin dhe me sistemin e tirantave në brendësi të kishës, duke krijuar, në këtë mënyrë, një harmonizmi lidhjesh mjaft të mirë të ndërtesës, që shërbente edhe si brez antisizmik. Këtë sistem, patëm mundësi ta vrojtojmë në kishën e Shën Triadhës në Berat, dhe në atë të Shën Kollit të Mesopotamit (brezi ishte me përmasa 20 x 20 cm). Ky sistem takohet dhe në kishën e Shën Mëri Vllahernës[26].

Kemi takuar breza dhe në ndërtesa të tjera, jo të këtij tipi. Kështu në kishën e Perondisë, brezat janë si në muret anësore, rreth 1 m nga toka, ashtu dhe në muret mbi arkada, nën nivelin e dritareve që ndriçojnë nefin qendror. Këto të fundit ishin akoma të padëmtuara, me përmasa 16 x 12 cm dhe 14 x x 11 cm, dhe në brendësi të murit. Një rresht tjetër brezash, që mbase i takon një rindërtimi të çatisë, ndodhej nën zinxhirët e saj dhe përbëhej nga tre binarë 12 x 10 cm.

Breza në brendësi të murit, kemi takuar dhe në kishën e Shirgjit si dhe në mjaft kisha të tjera. Të

26) G. Samimi, **Restaurimi i një monumenti të periudhës bizantine në Berat,** Në «Vepra të mjeshtërve tanë», Tiranë 1983, 107.

FOTOCOPY

gjitha këto lozin rolin e brezit antisizmik, duke krijuar monolitizimin e strukturave jo elastike, të cilat nuk u qëndrojnë sforcimeve tërheqëse. Nga ana tjetër, brezat shërbejnë edhe për një shpërndarje më të mirë të ngarkesave, edhe si një mjet lidhës në fazën ndërtimore e në vitet e parë.

Ne kemi takuar dhe ndërtime pa breza, ashtu siç kemi vërejtur një dukuri interesante e të veçantë në kishën e Marmiroit[27] dhe në ndërtesat e fshatit rrënojë të Kamenicës[28]. Në tamburin e saj gjejmë vrima tërthor murit, që janë të formuara nga degë pemësh me diametër 6-8 cm. Mendojmë se janë vënë për të siguruar një lidhje tërthore në kohën e parë të jetës së ndërtesës, Mundësi tjetër, që të jenë vrima ajrimi, ne e përjashtojmë sepse aty ka dritare.

Tërësia e brezave dhe tirantave, që si zgjidhje arrin nivelin më të lartë në kishat me kupolë, flet dhe një herë për një kuptim të drejtë të punës strukturore nga ana e mjeshtërve ndërtues. Ata janë vendosur atje ku duhet.

Teknika e ndërtimit të mureve. Studimi i monumenteve të vendit tonë, ashtu si dhe në vende të tjera, ka treguar se mënyra e ndërtimit të mureve ka një ecuri të vetëm, që ndryshon në kohë duke u zhvilluar, apo edhe duke iu rikthyer formave të mëparshme. Veç kësaj, gjatë gjithë kohës gjejmë përdorimin e teknikave të njëjta si rezutlat i përdorimit të materialeve rrethanore, i kushteve të njëjta ekonomike dhe i nivelit të njëjtë të ndërtuesve. Kështu muri me gurë të papunuar, lidhur me llaç gëlqere, mund të takohet në kohë të ndryshme. Në mungesë të të dhënave të tjera, kjo teknikë ndërtimi nuk mund të vendoset në kohë.

Karakteristika të veçanta ndërtimore, kanë ndërtimet ku përdoren guri dhe tulla. Gjatë shekujve të parë të mesjetës, në disa nga rindërtimet e fortesave, u përdorën gurët e periudhës antike, të cilët për t'u vendosur në mur, ashtu siç iu vinte radha dhe me më pak mund e harxhime, afroheshin me njëri-tjetrin sa të ishte e mundur më pranë dhe fugat ndërmjet tyre mbusheshin me copa tullash të vendosura horizontalisht duke u lidhur me llaç. Vendosja e tullave nuk bëhej thjesht për të kursyer llaçin, por edhe sepse gjendeshin me bollëk në rrënojat e shkaktuara nga koha dhe që mënyra më praktike për të mbushur ndryshe fugat e mëdha. Po kështu një ose dy tulla njëra pas tjetrës, apo dhe në rreshta të shkurtra, vendosen në fugat horizontale, që krijohen shpesh ndërmjet rreshtave të gurëve. Kjo teknikë, me një pamje mjaft të qartë e të dallueshme, shihet në rindërtimet e shek. VIII-XI në kalatë e Lezhës[29] dhe Butrintit[30].

Kjo mënyrë e veçantë e ndërtimit të mureve përdoret dhe në shumë kisha, duke filluar nga shek. X – – XI. Shembujt e mëparshëm, sikurse janë ndërtimi i çrregullt me tulla në bazilikën e Durrësit[31] dhe rindërtimi i gjysmës së dytë të shek. IX në bazilikën e Butrintit, me gurë e me tulla të vendosura tek-tuk pa ndonjë rregullsi, në fugat horizontale, teknikë kjo që e gjejmë dhe në kapelat e kësaj kohe në Butrint[32] dëshmojnë për një kohë më të lashtë. Kisha e Shën Kollit në Perhondi është monumenti ku këtë teknikë karakteristike me gurë e tulla ndërmjet tyre e gjejmë thuajse të njëjtë me format e ndërtimeve bashkëkohëse në vendet fqinje[33]. Rrënjët e kësaj teknike, që ne u munduam t'i spjegojmë më lart, shtrirja në vendin tonë e ndërtimeve të mureve në këtë mënyrë dhe larmia e formave të saj, flasin qartë që kjo nuk mund të lidhet me vende apo popuj të veçantë, por është një teknikë e ndërtimit të mureve, që me dallime jo thelbësore, zhvillohet dhe përdoret në territore të gjëra të provincave.

Në kishën e Perhondisë, ai paraqitet si një ndërtim i rregullt dhe me pretendime, duke vendosur tri tulla njëra mbi tjetrën në fugat ndërmjet gurëve, ndërsa tulla në rreshta horizontale që ndërpriten ja-

27) A. Meksi, **Restaurimi i kishës së Marmiroit** «Monumentet» 2, 1971, 73-82, fig. 1 – 10, Tab. I – III.

28) A. Meksi, – E. Riza, **Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës,** «Monumentet» 7 – 8, 1974, 149.

29) Gj. Karaiskaj, **5000 vjet fortifikime në Shqipëri,** Tiranë 1981, 135-138.

30) Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet mesjetare të Butrintit,** «Monumentet» 20, 1980, f. 14, **Po ai, Butrinti dhe fortifikimet e tij,** Tiranë 1984, 92.

31) Duhet të shënojmë se pranë absidës qendrore takojmë me një vend, copa tullash njëra mbi tjetrën dhe ndonjë tullë vertikale ndërmjet gurëve. Kjo tregon se si teknika me tulla ndërmjet gurëve ashtu edhe kluasonazhi duhet të njiheshin në Durrës.

32) A. Meksi, **Bazilika e madhe dhe baptisteri i Butrintit,** «Monumentet», 1, 1983, 49, Tab. IX-XII.

33) N. Mavrodinov, **Starobellgarskoto iskustvo,** Sofija, 1959, 103, 112, P. Milkoviq – Pepek, **Vodoca,** Skopje 1975, 23, 60, shën. 118, P. Vokotopoullon, **I eklesiastiki arhitektoniki eis tin Dhitikin sterea Ellada kai tin Ipeiron,** Thesaloniki 1975, 185 – 192.

Document

në në fugat ndërmjet radhëve. Në ndërtime të tjera, që mund të datohen në shek. XI-XII (Himarë, Dhërmi, Berat, Shën Todri) tullat dhe sidomos copra tjegullash vendosen njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve. Këtë teknikë të përdorur në pjesë të veçanta të ndërtesës e gjejmë dhe në Peshkëpi të Sipërme, Buhal dhe Zervat, Në Shqipërinë e Jugut, ku tullat janë një material i rëndomtë ndërtimi, gjatë mesjetës, kjo teknikë mbetet në përdorim për një kohë të gjatë. Në Shqipërinë e Veriut, ku guri është materiali tradicional i ndërtimit kjo teknikë nuk gjen përdorim.

Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XII, në vendin tonë, futet në përdorim kluasonazhi, që gjetkë fillon të përdoret që nga shek. X[34]. Këtë e takojmë për herë të parë, të përdorur në mënyrë fragmentare, në kishën e Shën Mërisë së Kosinës[35]. Shembulli i një ndërtese, ku kluasonazhi përdoret gjerësisht, i takon fillimit të shek. XIII sikurse është kisha e Shën Mëri Vllahernës në Berat. Megjithatë dhe në këtë kishë, kjo teknikë përdoret në pjesën e sipërme të ndërtesës, kurse në pjesën e poshtme kemi teknikën e mëparshme, me gurë e copra tjegullash ndërmjet tyre, që përdoret në gjithë faqen e murit. Faqja lindore dhe absida janë tërësisht me teknikën e kluasonazhit. Vetëm me tulla ndërtohen dritaret dhe në rastin e Shën Triadhës dhe tamburi.

Ndërtimin e mësipërm, me dy breza, e takojmë në Sop dhe në trapezarinë e manastirit të Apolonisë. I njëjti princip me dy breza është dhe në kishën e Shën Mërisë të Labovës së Kryqit. Brezi i sipërm këtu është i ndërtuar me teknikën që takojmë në një sërë kishash, të Kosturit të datuar në shek. IX-XI, si edhe më vonë në disa kisha të Artës. Në Labovë të Kryqit, brezi i poshtëm është ndërtuar me kluasonazh, ku tullat vertikale janë bashkë me tulla e gjysma tullash të pjerrëta, sipas gërmës «K», ndërsa brezi i sipërm është me tulla të plota, këlliç e të vendosur 45°, pra teknikë e diktuar vetëm nga arsye estetike. Motivi i tullave të vendosura pjerrëtas takohet dhe në Kosinë, Buhal e Cerckë, të tria zona në vartësi të peshkopatës së Kosturit.

Teknika me copra tullash e tjegullash ndërmjet gurëve, takohet dhe gjatë shek. XIII-XIV, në Shqipërinë e Jugut (Himarë, Dhërmi, Kamenicë e gjetkë), që dëshmon për kthimin tashmë të saj në një teknikë tradicionale për këto territore.

Me interes, për shtrirjen e përdorimit të ndërtimit të mureve me teknikën e kluasonazhit, janë riparimi i fundit të shek. XIII në bazilikën e Xhamisë Fatihe në Durrës[36] dhe të kishës së Shën Ndout në Rodon[37], që krahas disa fragmenteve në kalanë e Krujës dhe kishën e Shqefnit në Peshkopi, përbëjnë dëshmitë më veriore të përhapjes së kësaj teknike, karakteristike për arkitekturën bizantine. Po kështu, raste të veçanta të ndërtimit vetëm me tulla përbëjnë bazilika e sipër përmendur në Durrës dhe kisha e Kurjanit, ndërtuar me materiale antike. Përdorimi i kluasonazhit dhe në ndërtime mbrojtëse, si në Krujë e Berat[38], flet qartë për familjarizimin e mjeshtërve vendës me këtë teknikë.

Ndryshe qëndron puna në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Materiali bazë ndërtimor, në ndërtimet e këtyre zonave, për vetë rrethanat e zhvillimit ekonomik e shoqëror, është guri dhe teknika e ndërtimit me gurë, është teknika bazë në këto zona. Edhe në shkollën e Veriut, mund të dallohet rruga e zhvillimit të kësaj teknike, duke filluar nga ndërtimet me muraturë të çrregullt, me atë me gurë të skuadruar e më tej në shek. XV, me gurë të skuadruar thuajse katrorë. Në këto raste, që i takojmë në Vaun e Dejës dhe në Shën Markun e Danjës, në kambanoren e Rashkullës në Katedralen e Shkodrës dhe Mazrek, me gurë të skuadruar ndërtohen pastër vetëm faqet e jashtme, të cilat shpesh rrënohen nga që nuk lidhen mirë me bërthamën mbushëse.

Si elemente të veçanta të teknikës së ndërtimit të mureve, duhet të përmendim dhe fugat. Përgjithësisht, ndryshe nga shekulli i fundit i periudhës paraardhëse, (Durrës) fugat janë pak a shumë të holla, me llaç, pa mbushës të trashë, me përjashtim të rastit kur ai është material rrethanor. Në muret me gurë të skuadruar pastër, fugat janë shumë të holla dhe lidhja e gurëve bëhet në brendësi të murit si në Mesopotam, Shkodër, Vau i Dejës e gjetkë. Në muret me gurë e tulla me teknikë të rregullt, fugat janë të kujdesshme. Kështu, në Perhondi, ato janë të punuara me mistri dhe në prerjen tërthore paraqesin një trekëndësh të thelluar në brendësi të murit. Mbas përfundimit të murit, ky kanal është mbushur me një

34) E. Stikas, **To oikodomikon hronikon tis monis Osiou Louka Fokidos,** Athina 1970, 178.
35) P. Thomo, **Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare në shek. XI-XIV,** Studime historike, 4, 1972, 51-52, fig.
36) A. Meksi, **Dy bazilika mesjetare të panjohura,** «Monumentet» 13, 1979, 72, fig. 1.
37) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë...,** «Monumentet» 1, 1984, 104, 105, Tab. I.
38) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** «Monumentet» 2, 1972, Tab. IV, 2.

DO NOT COPY

llaç, të kuqërremtë, ku duken thërmijat e tullave. Në Mesopotam dhe Çiflig[39] fugat janë të rrafshuara në brendësi të murit dhe mbi to është kaluar një pastë gëlqerore, në ngjyrë okër, e përpunuar me një vegël speciale, teknikë karakteristike në arkitekturën bizantine[40].

Në të gjitha këto raste, përpunimi i fugave është bërë thjeshtë për të plotësuar kërkesat estetike. Mjeshtrit ndërtues me rrugë të ndryshme kanë arritur zgjidhje të mira në pikëpamje të pamjes së mureve. Në muret me gurë të skuadruar, fuga bëhet e pandjeshme, për t'u dukur muri i njëtrajtshëm, ndërsa në muret me gurë e tulla, ajo ngjyroset njëlloj si tullat, për të theksuar kontrastin gurë-tulla.

Në një numër të madh monumentesh, ndër to ka dhe me vlera arkitektonike, ruhen vrimat e skelave në faqet e murit. Të tilla vrima, në radhë të rregullta, ruhen në Mesopotam, Shirgj, Shën Triadhë Berat, Pllanë, Çiflik e gjetkë. Këto janë si në muret e poshtme, ashtu dhe deri tek tamburi i kupolës, (Berat). Mbas përfundimit të murit, ato në anën e jashtme janë lënë pa mbushur. Me interes janë dhe një sërë fugash ndërtimore, të cilat kanë qenë të nevojshme gjatë proçesit të ndërtimit, për të lejuar ngritjen e kupolave dhe pjesëve më të larta, pa u kushtëzuar nga pjesët anash tyre. Të tilla fuga kemi takuar në kishën e Mesopotamit, në Shën Triadhën e Beratit e gjetkë.

Vrojtimet tona në drejtim të ndërtimit të themeleve kanë qenë jo të plota dhe kjo është e kuptueshme. Të dhënat që ne kemi, janë më shumë nga vrojtime direkte se sa nga sondazhe të kryera për këtë qëllim. Ndërtuesit janë munduar të mbështesin në taban të fortë ndërtesat dhe për këtë kanë parapëlqyer terrenin shkëmbor, i cili mënjanon uljet. Kështu janë mbështetur në shkëmb shumica e kishave të Shqipërisë së Veriut (Kala e Danjës, Mazrek, Nënshat, Bokian, Rubik, Balldre, etj.). Po në këtë mënyrë është zgjidhur ky problem, në Shën Mëhillin dhe Shën Triadhën në Berat. Në këto raste, muri dhe themeli, kanë përgjithësisht të njëjtën gjerësi. Në rastet kur tabani shkëmbor nuk është afër, themelet janë në thellësi dhe kemi një zgjerim të tyre, me xokol ndaj mureve (Mesopotam, Shkodër, Shirgj).

DO NOT COPY

39) Është vendi të ndalemi në mendimin e shprehur nga S. Dashi **Një xhami monumentale në qytetin e Beratit,** në «Tradita në arkitekturë dhe në art» Tiranë 1980, 62, se kishat e Shën Triadhës dhe Shën Mëhillit në Berat ngjajnë për nga teknika ndërtimore me xhamitë e shek. XV-XVI, që muret i kanë të ndërtuara me teknikën e kluasonazhit, dhe për këtë dhe ato janë të kësaj kohe. Ky mendim është i gabuar dhe i pathemeltë, sepse janë xhamitë e shekujve XV-XVI që ndërtohen me teknikën e kluasonazhit, deri atëhere të përdorur në kishat bizantine dhe që për rrënjët e thella të traditës vijon të përdoret edhe në ndërtimet e kultit mysliman.

39) A. Meksi, **Dy bazilika . . .,** 75.

40) A. Choisy, **L'art de batir chez des byzantines,** Paris, 1883, 13, Të njëjtën mënyrë pune e hasim dhe në kishën e Pantanases në Filipiadhe të datuar në shek. XIII. P. Vokotopoullou, **Nea stoiheia peri ton Katholikon tis moni Pantanassis Filippiadhos,** A.A. of. A.1 1972, 87-96.

PËRMASAT E TULLAVE TË PËRDORURA NË KISHAT MESJETARE

Monumenti	Përmasat në cm			Sqarime
	Gjatësi	Gjerësi	Trashësi	
Profet Ilia-Buhal.	30	30	4	
Shën Mëria Peshkëpi e Sipërme,	30		3.5	
	25	13	3	Shtesa jugore
	40	18	4	»
Shën Mëria Kosinë.	41	23	5	
	40	30	6	
	40	16	4.5	
Ristozi Mborje	20	14	4	
	28	18	4	
Bazilika në Klos.	30.5	17.5	4	
	25	15	4	
Shën Kolli Perondi	31	17	4	Faza I
	31	21	4.5	»
	32	19	3	Faza II
	28	11	3	»
	32	22	4.5	»
	29	19	4	»
Shën Jovani Boboshticë				
Kamenicë	33	15	4.5	
Shën Sergji e Baku, Shirgj	26.5	13.5	4.5	
Shën Stefani Blinisht	28	28	4	
	35	28	5	
	32	27	8	
	36	23	8	
Shën Mëria Labovë e Kryqit	43	30	4	
	28	28	6	
	20	20	5	
Shën Kolli Mesopotam	44	24	7.5	
	44	25	7	
	44	24	4.5	
	30	16	3.5	
	30	13	3.5	
	18	11	3	
	20	14	3.5	
Shën Gjini, Shëngjin	21	14	4	
Shën Mëri Vllaherna, Berat	42	15	5	
	33	13.5	4	
Shën Triadha, Berat	33	20	5	
	36	19	5	
	33	17	5	
	29	19	4	
Shën Mëhilli, Berat	38	18	4	
	21	14	4.5	
Shpërfytyrimi, Herbel	45	21.5	4.5	

DO NOT COPY

TAB. I



Perondi



Shirgj



Shkodër



Perondi



Rrashkull



Pojan (Apoloni)

DO NOT COPY

TAB. II



Sh. Mëria e Vllahernës – Berat



Boboshticë



Trapezeria – Apoloni



Çiflik



Mesopotam



Labovë e Kryqit

DO NOT COPY

TAB. III



Sh. Triadha – Berat



Zvërnec



Pojan



Marmiro

Çiflik





Shkodër

DO NOT COPY

TAB. IV



Sh. Mëhilli – Berat



Marmiro



Blinisht



Perondi



Armen

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

DONNEES SUR LA TECHNIQUE DE LA CONSTRUCTION DES EGLISES DU XIIe SC AU XVe SC EN ALBANIE

RESUME

L'étude des églises médiévales sous les différents aspects de leur architecture, exige la connaissance des particularités qui se rattachent au mode et à la technique de construction. Sur la base des recherches effectuées, dans cet article nous allons donner un tableau commun des différents aspects de la large problématique de la technique de construction des églises médiévales.

A la période en question remonte la construction de trois types architectoniques, les constructions à une seule nef, les basiliques et les églises à croix inscrite avec coupole. La construction et les structures des trois types sont différentes. Malgré les différences dans le volume et le résultat architectonique, les constructions à une nef en toit de bois et celles basilicales, suivent le même principe structural. Leurs poids se déchargent à terre par l'intermédiaire des murs latéraux et dans le cas des basiliques même par les arcades et les murs qui les surmontent. Les grandes églises importantes ont dû être couvertes de charpentes non seulement par la régularité structurale et le côté esthétique de l'intérieur, mais aussi par les difficultés qu'on rencontre pour assurer de longues poutres. Il paraît que même les nefs centrales des basiliques ont été couvertes de charpente.

Quant à l'aspect structural, les églises à une nef, couvertes de voûte cylindrique, occupent une place à part. Ici, les charges passent sous forme de charges verticales et de poussées horizontales. Afin d'y remédier, on fait passer leur résultante au centre de l'inertie du mur. Ceci, exige l'accroissement de l'épaisseur des murs ou la limitation de la travée. Pour alléger les murs, les constructeurs, à part les tirants ont, également utilisé des pilastres surmontées d'arcs aveugles. Nous rencontrons cette solution dans quelques églises de l'Albanie du Nord (Blinisht, Kakariq). A Vau i Dejës, il y a des pilastres même au côté extérieur du mur. Parmis les couvertures en voûte il faut mentionner l'abside de Saint Stéphane à Shkodra, couverte de voûtes croisées et de nervures. il faut ajouter qu'à Durrës aussi, il y a eu des églises romaniques-gothiques surmontées de voûtes et de nervures. On en conserve quelques fragments bien distincts.

En général les églises du type croix inscrite avec coupole, où tout l'équilibre dépend du travail commun structural de tous les éléments particuliers, se trouvent à un niveau plus élevé au point de vue organisation structurale et construction. Les difficultés de l'assimilation de cette conception et de sa réalisation pratique, qui se rattachent au niveau technique matériel de la société et des constructeurs, furent les raisons de l'introduction ultérieure du type. Les nombreux monuments conservés, ainsi que le fait qu'ils se trouvent partout, même à l'intérieur du pays, démontrent qu'ils sont réalisés par des maîtres-maçons authoctones. La voie de l'assimilation de ce schéma peut être illustrée par une comparaison entre la construction la plus ancienne l'église de Notre Dame à Peshkëpi e Sipërme et l'une des églises les plus évoluée de ce type, l'église de Sainte Trinité à Berat.

L'étude des monuments particuliers ainsi que les interventions de restauration y effectuées, ont montré que l'utilisation des matériaux de construction de faible qualité même pour la construction des fondations, amène à une dégradation du travail commun des composants de la structure. On remarque de pareils délabrements à l'église d'Apolloni, à Notre Dame de Vllahernë, à Saint Nicolas de Kurjan, à Notre Dame de Peshkëpi e Sipërme etc.

Les deux cas particuliers des églises avec coupole: Mesopotam et Labovë e Kryqit, témoignent assez bien du niveau des ateliers authoctones et de la juste assimilation du travail structural à de pareilles constructions.

Dans toutes les églises médiévales, le tout est composé d'éléments particuliers tels coupoles, voûtes, arcs, murs, fondations. La construction de chacun d'eux ainsi que le niveau de la technique de réalisation, constituent de même un témoignage précieux pour juger l'architecture médiévale. C'est pour cette raison que l'article traite particulièrement, ces éléments et les matériaux de construction qui y sont utilisés.

A l'intérieur des églises albanaises les coupoles sont soutenues par des pendentifs et des tambours. Les tambours sont en pierres (Marmiro, Peshkëpi, Zervat), en briques (Kosinë) ou en pierres et en briques (Mesopotam, Berat, Lavdar, Zvërnec). La coupole, est construite en pierres (à Marmiro) en pierres légères (à Mesopotam) et en briques (à Berat, Mborje, Pojan). Les coupoles sont généralement surmontées d'un toit cylindrique, seulement à Berat les faces du tambour du toit sont ondulées.

Dans les églises en forme de croix avec coupole, les bran-

ches de la croix sont surmontées, de voûtes cylindriques alors que celles des églises à une nef sont couvertes de voûtes. Elles sont construites en pierres et en briques disposés en forme radiée. Les voûtes ont généralement une coupe semi-circulaire. A Berat et à Çetë on trouve des voûtes en ogive, signe de l'influence de l'architecture occidentale, tandis qu'à Shkodër et Durrës il y a des voûtes croisées avec des nervures, des constructions incluses à l'architecture romanique-gothique.

Les arcs courbés de ces églises sont construits en pierres, en brique, ou avec les deux en altérnance. Presque partout les arcs sont constructifs, mais il n'y manque pas les arcs aveugles d'ornementation ainsi que les arcs lombards (Vau i Dejës, Kurjan, Zvërnec) Généralement les arcs se présentent en plein cintre. A Shkodra et à Famje on a utilisé des arcs segmentaires.

Dans toutes les églises surmontées de voûtes, sont utilisés des éléments en bois qui soutiennent les poussées des arcs et des voûtes tirants. Ils sont disposés aux talons des arcs et des voûtes des églises à une nef (Armen, Sop, Himarë, Mullet, Blinisht) et aux branches de la croix (Pojan, Berat, Labovë, Mesopotam). Afin d'assurer le travail commun de la voûte avec le tirant, ceux-ci sont attachés à un sistème de chaînes à l'intérieur des murs. On en rencontre dans les coupoles des églises de Berat, à la base des tambours à Mesopotam, Berat, Kosinë, ainsi qu'à l'intérieur des murs, au niveau des tirants. En outre nous avons trouvé des chaines même dans les murs verticaux, comme à Perhondi à Shirgj et ailleurs lesquelles servent de chaînes antisismique et monolithique du mur, afin d'assurer une meilleure distribution des charges.

L'étude des monuments en Albanie, ainsi qu'ailleurs, a montré que le mode de construction des murs connaît un essor qui lui est propre et qui diffère dans le temps en évoluant ou en se retournant aux formes précédentes. A part cela, on retrouve tout le temps les mêmes techniques résultant de l'utilisation des matériaux environnants, des même conditions économiques et du même niveau des maîtres-maçons. Dans les constructions réalisées avec des pierres et des briques, apparaissent des caractéristiques de construction particulières. Au début du Moyen Age, pour la construction de quelques forteresses furent utilisées les pierres de la période antique lesquelles pour être disposées comme il faut, furent rapprochées tant que possible, et les jointures furent remplies de morceau de briques liées avec du mortier. Dans quelques cas on utilisa, parmi les pierres, des morceaux de briques et de tuiles. Cette technique se distingue assez bien dans les reconstructions de VIIe-XIe sc à Lezhë et à Butrint. Nous remarquons le même appareil dans une série d'églises, depuis le XIe sc. Le meilleur exemple en est l'église de Saint Nicolas à Perhondi. Dans quelques autres constructions qu'on peut dater du XI-XIIe sc (Berat, Himarë, Dhërmi, Herbel) parmis les pierres sont utilisés des morceaux de briques et de tuiles. A cette époque on retrouve cet appareil seulement en quelques parties de l'édifice à Peshkëpi, Zervat, Buhal, Aux XIII-XV sc cette technique continue à être utilisée au Sud de l'Albanie (Kamenicë, Dhërmi, Himarë). A la deuxième moitié du XIIe sc fut introduite l'appareil du cloisonnage (Kosinë). Au début, cet appareil s'appliquait dans la partie supérieure de la construction, mais il y a des cas aussi où l'on le trouve dans toute la hateur. (Saint Michel à Berat).

Il faut noter les constructions en briques (Durrës et Kurjan), celles en briques parmis les pierres, selon la technique des églises de Kastoria (Labovë e Kryqit, Buhal et Cerckë).

Il se passe autrement en Albanie Centrale et celle du Nord, où le principal matériel de construction fut la pierre et la principale technique celle de la construction des murs en pierres. Même à l'école du Nord on aperçoit une voie de l'évolution de cette technique, depuis les constructions en appareil irrégulier à celui en pierres équarries et plus tard au XVe sc en pierres équarries presque carrées. Dans ces cas-là, seulement le parois extérieur du mur est bien façonné.

Les jointures de la maçonnerie sont régulières et dans les importantes constructions elles sont réalisées par des outils spéciaux, comme p.ex. à Mesopotam, Penrondi, Çiflik. Dans les églises en pierres équarries, les jointures extérieures sont très minces, afin que le mur apparaisse uniforme.

Au cours de la restauration on a bien étudié les fondations. Les maçons ont essayé d'appuyer leurs constructions sur de fortes assises et pour cela, ils ont préféré le rocher qui évite l'abaissement, comme c'est le cas de la plupart des églises du Nord et celles de Sainte Trinité et de Saint Michel à Berat Dans le cas où il n'y a pas d'assises rocheuses, les fondations sont assez profondes. (Mesopotam, Shkodër, Shirgj).

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Prof. Dr. N.C. MUCOPULLOS

REZULTATET E GËRMIMEVE NË BAZILIKËN E SHËN AKILIT NË PRESPË*

Bazilika e Shën Akilit ndodhet në ishullin e vogël të Shën Akilit, në skajin verior të liqenit të Prespës së Vogël, pjesa më e madhe e të cilit ndodhet në territorin grek, në prefekturën e Follorinës, në kufi me Shqipërinë dhe Jugosllavinë. Bazilika ka qenë objekt studimi për shumë historianë e bizantologë. I pari ndër ta ishte Arkimandriti rus Antonini, i cili me ndihmën e disa skicave përshkroi rrënojat e këtij monumenti[1]. Që prej asaj kohe bazilika është dëmtuar mjaft. P. Miljukovi i cili e vizitoi 40 vjet më vonë, në vitin 1898, vërejti se Antonini, falë ruajtjes më të mirë të monumentit, kishte mundur të jepte një përshkrim mjaft më të plotë se ç'mund të jepte ai në kohën e vizitës së tij.[2]. J. Ivanovi më 1907 i gjeti këto rrënoja në një gjendje akoma më të keqe[3]. Siç rezulton nga botimet e M. Zlokoviçit[4], G. Sotiriut më 1925[5], të K. Mijatevit[6], të G. Sotiriut[7] përsëri dhe të S. Pelekinadhisit[8], bazilika po pësonte dëmtime gjith-

*) N.C. Moutsopoulos, **Ereunes stin Kastoria kai ton Agio Ahilleio** «Epistimoniki epetiris tis Polutehnikis Skolis tou Aristotelei ou Panepistimiou tis Thessalonikis» (Më tej E.E.P.S.) Volumi II, 1965 -66, fq. 93-244, Tab. 1 – 41, A.I'. **Anaskafi tis bazilikis tou Agiou Ahilleiou, deutera (1966) kai triti (1967) periodos ereunon** «E.E.P.S», Vol. IV, 1969-1970, fq. 63-192, Tab. 1 – 99, A'B'. **Anaskafi bazilikis Agiou Ahilleiou,** «Praktika tis arhaiologikis etaireias» (më tej PAE.), 1967, fq. 55 – 69, Tab. 35 – 47; **Anaskafi basilikis Agiou Ahileiou,** PAE 1969, fq. 37 – 41, Tab. 44 – 50. **I basiliki tou Agiou Ahileiou sti Mikri Prespa,** «Deltion tis hristianikis arhaiologikis etaireias», periodos IV, volum IV, Athenes 1964, fq. 138-159, Tab. 14 – 20, **«Byzantinische und Nachbyzantinische Baudenkmaler aus Klein – Prespa und aus Hl. German»,** Byzantinische und Neugriechische Jahrbücher, t. XX, 1970, fq. 1-49, **Agios Ahileos,** «Makedonikon Imeriologion» 1966, fq. 177-183, **Sumpliromatika dedomena gia ton tafo tou diakonikou tis basilikis tou Agiou Ahilleiou,** «Thessaliki Estia», Vol. II, Larissa 1974, 3, fq. 441 – 447. **«Grobnicata na car Samuil v bazilikata sveti Ahil v Prespa,»** Madara-Preslav, Mai 1984, f. 3. **Le tombeau du tzar Samuil dans la basilique de Saint Achile à Prespa.** «Etudes Balkaniques» (Academie Bulgare des Sciences Institut d'études Balkaniques), no 3, Sofia 1984. fq. 114 – – 126.

1) **Archimandrita Antonina Kapustina pojeżdka v Rumeliju,** II, St. Petersbourg, 1886, Tab. X.

2) P.N. Miljukov, **Christianski drevnosti zapadnoi Makedoni»,** Izvestija russkogo arheologiçeskogo Instituta v Konstantinopolé, IV, I, Sofia, 1889, f. 48.

3) J. Ivanov, **Car Samnilovata stolica v Prespa,** «Izvestia Bollgarskova Archeollogiçeskogo Drushtva» I, Sofia, 1910, f. 68-69.

4) M. Zlokoviç, Starinar III, Beograd, Seria III, 1924/25 f. 116. fig. 2, f. 117, fig. 3, f. 118 fig. 4, f. 119 fig. 5.

5) G. Sotiriou, **Imerologion tis Megalis Ellados,** 1926, fq. 152, fig 2, fq. 160 dhe Byzantinische Zeitschrift, vol. 30, 1929, tab. X, 4.

6) K. Mijatev, **Bëllgarskoto Iskustvo,** Bëllgarija 1000 godini 1927-1927 Sofia, 1930, f. 165, fig. 32, 33.

7) G. Sotiriou, **Praktika tis Akadimias,** Athinon, vol. 20, 1945.

8) S. Pelekanides, **Bizantina kai metabizantina mnimeia tis Prespas,** Thessalonique, 1960, tab. XX, fig. 1, 2. Shih gjithashtu G. Bošković, **Architektura Srednjeg Veka,** Beograd 1962, f. 131, fig. 172.

monë edhe më të rënda, përderisa shërbimi arkeolo gjik grek, vendosi të marrë disa masa provizore për të ruajtur pjesët më të larta të monumentit.

Problemet historike dhe morfologjike që shtron studimi i Bazilikës së Shën Akilit, për të cilat arkeologët nuk janë gjithnjë të një mendje, mund t'i përmbledhim si vijon: 1) Verifikimi i planit të Bazilikës, 2) Zgjidhja e problemeve të veçanta morfologjike (çatia e bazilikës) 3) Data e ndërtimit të Bazilikës, 4) Në se kjo është bazilika e ngritur nga Samueli në kryeqytet pas kthimit të tij nga pushtimi i Larisës, 5) Në se Samueli vendosi në këtë bazilikë reliket e Shën Akilit, që mori nga Larisa.

Në një kumtesë të D. Striçeviçit në Kongresin e XII Ndërkombëtar të Studimeve Bizantine të Ohrit, gjejmë një përmbledhje të mendimeve të shprehura mbi bazilikën e Prespës, para vitit 1961[9]. Autorë të ndryshëm kanë shprehur hipoteza të shumta mbi formën e planimetrisë së kësaj kishe. Por meqë pjesa më e madhe e bazilikës ndodhej nën tokë, këto hipoteza ishin pjesërisht të gabuara dhe të mangëta. P. Miljukovi[10] skicoi mjaft saktë pjesën e protezisit, që ruhet edhe sot, si dhe nënstrukturat nën kupolë. Përsa i përket kupolës protezisit, diakonikonit si dhe dritares treshe të absidës, planimetria që kemi botuar më 1964[11] është më e saktë se ajo e J. Ivanovit[12] dhe Pelekanidhisit[13]. Planimetria e J. Ivanovit u përsërit në botime të tjera, më të vona, nga K. Mijatevi[14], V. Petkoviçi[15], N. Mavrodinovi[16], M. Biçevi[17] dhe G. Boshkoviçi[18].

Ne kemi mundur të japim skicën e qemerit të vogël të protezisit, sinthronin, dyshemenë me pllaka të bazilikës si dhe përcaktuam vendin dhe formën e radhëve të shtyllave, hyrjet e narteksit dhe vendin e hyrjes së dytë të nefit verior. Në të njëjtën kohë, çliruam dhiakonikonin nga grumbulli i dheut që e mbulonte ndërsa në nefin jugor gjetëm katër varre. Gjatë punimeve, konstatuam një diferencë niveli ndërmjet nefit qendror dhe nefit jugor, si dhe një gjurmë në formë patkoi në brendësi të harkut të ngritur, gjysmë rrethor të absidës. (fig. 1).

Protezisi i bazilikës, simetrik si diakonikoni, paraqet një kapelë në formë kryqi të brendashkruar katrorit, që mbulohej nga një kupolë e vogël, nga e cila kanë mbetur shumë pak gjurmë[19]. Por në bazë të matjeve ne mundëm ta rikonstruktojmë atë[20]. Protezisi paraqet mjaft interes për shkak të zbukurimeve me tulla dhe pllaka katrore, të vendosura në formë fushe shahu (opus reticulatum), të cilat formojnë një friz mbi dritaret e tamburit. Kupola e vogël përforcohet me nervatura, çka ka mjaft rëndësi për datimin[21]. Ky dekoracion qeramik ngjan së tepërmi me dekoracio-

9) D. Striceviç, **La renovation du type basilical dans l'architecture ecclesiastique des pays centraux des Balkans au IX-XIe siécles,** «Actes du XIIe Congres International d'Etudes Byzantins», vëll. I. Beograd,1963, f. 195.

10) P.N. Miljukov, **vep. cit,** f. 48, fig. 11.

11) N. Moutsopoulos, **Basiliki tou Agiou Ahilleiou stin Mikri Prespa** «Deltion tis hristianikis arhaiologikis etaireias», Seria 4, vol. 4, Athenes 1964, f. 167, fig. 1.

12) J. Ivanov, **Vep. cit,** f. 67, fig. 9.

13) S. Pelekanidis, **Vep. cit,** f. 70, fig. 10.

14) K. Mijatev, **Vep. cit,** f. 65, fig. 32.

15) V. Petković, **Revue des monuments religieux dans l'histoire du peuple Serbe.** Beograd 1950, f. 261, 1051, fig. 800.

19) G. Sotirio, **Byzantinai bazilikai makedonias kai pallaias ellados,** Byzantinische

17) M. Bitchev, **L'architecture en Bulgarie,** Sofia, 1961, f. 31, fig. 18.

18) G. Boskoviç, **Architektura srednjeg veka,** Beograd, 1962, f. 131, fig. 172.

19) G. Sotiriou, **Byzantinai bazilikai makedonias kai pallaias ellados,** Byzantinische Zeitschrieft, 30, 1929, Tab. X, fig. 4. M. Zlokoviç, «Starinar» seria III, 1924 -25, fq. 118, fig. 4.

20) N. Moutsopoulos, **Ereunes stin Kastoria kai ton Agio Ahileio** «Epistinomoniki epetiris tis polytehnikia skolis» vol. II, Thesalonique 1965, f. 130.

21) P. Lemerle, **(Philippes et la Macedoine Orientale a l'epoque chretienne et byzantine,** Paris, 1945, f. 451) konstatoi një ndërtim të tillë në kupolën qëndrore të bazilikës: shih M. Rumpler, **La coupole dans l'architecture byzantine et mususlmane,** 1956, f. 58. Nervura analoge ka në kupolat e vogla të narteksit dhe ekzonarteksit të katolikonit të Nea Monit në Hios: A. Orlandos, **Monuments byżantins de Chios,** Athenes 1932, tab. 10. Nervatura të bëra me copa mermeri gjenden të inkorporuara në kishën oktogonale të Kristianout në Trifili, të cilën Eustath Stikas e daton në çerekun e tretë të shek. XIX. **(L'eglise octogonale de Christianou, en Triphylie, Peloponnese et les autres edifices du meme type,** Paris 1951, f. 18, 49, fig. 16-17, Tab. I). Bazilika e Shën Akilit paraqet ngjashmëri të mëdha si dhe ndryshime me një sërë bazilikash, të cilat i kemi përmendur në një studim tjetër. (N. Moutsopoulos, **I. Baziliki tou Agiou Ahileiou,** f. 174-187). Kur të mbarojë gërmimi i monumentit do t'i rikthehemi përsëri studimit tipologjik të bazilikës ba-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1 – Planimetria e bazilikës së Shën Akileut në Prespë.
Fig. 1 – Plan de la basilique de St Achillee à Prespa.

nin e kishës së Shën Germanit në fshatin fqinj German (v. 1006)[22] dhe me atë të Kubelidhicës së Kosturit[23] të padatuar përfundimisht. Kupola ka mjaft ngjashmëri me kupolat e monumenteve të shek. X. Zbukurimi qeramik ngjan me zbukurimin e kupolave të vogla dhe të absidës së kishës së Palea Episkopit

shkëkohëse të Shën Nikonit në Spartë, e cila paraqet probleme analoge. Fatkeqësisht gërmimet nuk na japin material të mjaftueshëm për të përcaktuar formën e çatisë së dy santuarëve anësorë; G. Sotiriou, **Anaskafainenti Palaia Sparti,** «PAE» 1939, Tabelat jashtë tekstit. Shih. dhe P. Vocotopoulos, **Paratiriseis sti baziliki to agion Nikonas,** Praktika Diedna, Synea, Pelepon, Spoudon. II. Athenes 1976-78, f. 273 – 285.

22) Një fotografi të vjetër të kupolës së Shën Germanit, ku dallohet struktura e muraturës së tamburit para se ajo të humbasë nën shtresën e re të suvatimit, ka botuar së fundi B. Filov **(Geschichte der Altbulgarischen Kunst,** Berlin – Leipzig, 1932. f. 21, Tab. B). N. Mavrodinov, **Starobëllgarskoto Iskustvo,** Sofia 1959, fq. 269, fig. 324. N. Moutsopoulos, **Ekklisies tou nomou Florinis,** Thessalonique, 1964, f. 9,: **Byzantinische Baudenkmaler aus Klein Prespa und aus HI. German,** «Byzantinische und Neugriechische Jahrbucher» 20, 1967, fq. 38 – 41.

23. Një fotografi e vjetër e kupolës para anastilozës është botuar nga G. Millet

të Tegesë[24] në Arkadi, me atë të kishës së Fjetjes së Shën Mërisë në Labovë të Kryqit[25], dhe kishën e manastirit të Stilos në Kalabri[26].

Rikonstruksioni i kupolës së vogël të protezisit, ndihmon për studimin e monumenteve bizantine ku është zbatuar teknika opus reticulatum, meqë ai datohet rreth vitit 986.

Muratura e të dy kishave, Shën Akileut dhe Shën Germanit paraqet disa ngjashmëri me kishën e Shën Anargjirëve dhe të Taksiarkëve të Kosturit. Data e sigurt e ngritjes së bazilikës së Shën Akilit në dhjetëvjeçarin e nëntë të shek. X dhe Shën Germanit në vitin 1006, si dhe ngjashmëria e tyre me shumë kisha të Kosturit (Kubelidhisa, Shën Anargjiri, Shën Stefani dhe Taksiarku)[27] na shtyn të mendojmë se kishat e Kosturit duhet të jenë më të hershme. Kjo do të përputhej me konkluzionet e reja lidhur me datimin e shtresës më të vjetër të freskave të tyre (p.sh. tek Taksiarkët dhe Shën Stefani)[28].

Muri gjysmë rrethor i absidës së madhe të altarit 0,99 m i gjerë, mbulohet me një konkë çerek sferike. Në nivelin e bazamentit të kupolës ndodhet një kornizë e hollë horizontale me pllaka. Nga kjo pjesë e monumentit janë ruajtur shumë pjesë murature. Konka çerek sferike është ndërtuar me gurë porozë, pak a shumë kubikë, të vendosur në rreshta që alternojnë me dy breza horizontalë tulle. Sot pjerrësia e rreshtave dallohet mjaft qartë për shkak të gjendjes në të cilën ndodhet monumenti. Pasi konstatuam një sërë vrimash ndërmjet rreshtave të gurëve, arritëm në konkluzionin se për ndërtimin e konkës, muratorët kishin përdorur një skelë druri, nga ana e brendshme e absidës. Çatia e konkës së absidës, duke u nisur nga gjurmët që dallohen dhe në figurën në artikullin e G. Sotiriut[29], paraqitet e lakuar pasi trashësia e murit në këtë pikë zvogëlohet për arsye statike. Ky fenomen vërehet edhe në ndërtime të tjera më të vjetra, bashkëkohëse dhe më të reja[30]. Dritarja e absidës ndahet në tri pjesë prej shtyllëzash të ndërtuara me gurë e tulla, të lidhura me fuga të gjera llaçi. Harqet prej tulle në formë patkoi mbështeten me ndihmën e një rrjeti të drunjtë mbi disa shtylla të vogla, çka paraqet mjaft interes nga pikëpamja ndërtimore (fig. 2). Përdorimi i brezave prej druri (imantosis-i i bizantinëve) dëshmohet në shumë pjesë të ndërtesës. Në brendësi të harkut dallohen vrimat e skeleteve në stuko. Formën e tyre ne mundëm ta rikonstruojmë nëpërmjet fragmenteve që u gjetën në shtresën e dheut në brendi të altarit. Në anën e brendshme të dy shtyllëzave të dritares treshe, dallohen gjurmët e vrimave të fiksimit të faqeve anësore të fronit peshkopal (fig. 2). Shqyrtimi i këtyre gjurmë-

---

(L'ecole grecque dans l'architecture bizantine, Paris, 1916, fq. 93. fig. 47. A. Orlandos, **Arheion ton Byzantinon Mnineion tis Ellados,** vol. 4. 1938, 126 fig. 87).

24. A. H. I. Megaw, **Byzantine Reticulat revetmens,** «Haristirion eis A. K. Orlandon», vol. 3, Athenes 1964, fq. 17. përmend një paraqitje tjetër të kishës të Palea Episkopit para anastilozës të publikuar nga S. Lampros **(Istoria tis Ellados,** Athenes 1908, f. 901), ku dallohet eleganca e kupolave të vogla dhe hijeshia e porpocioneve të tyre. Shih. dhe G. Millet, **L'ecole grecque,** f. 270, fig. 127 dhe A. Orlandos, **«Arheion ton bizantinon mnimeion tis Ellados,** vol. I, 1935, f. 146, fig. 7.

25. F. Versakis, Bizantiakoi naoi tis Voreiou Epeirou, i Koimisis tis theotokou tou ano Lampovou «Arhaiologiki Efimeris», 1916, f. 113, fig. 8. f. 114. fig. 8a; A. Megaw, **vep.cit,** tab. 15b; P. Vokotopoulos, **I ekklisiastiki arkitektoniki eis nin dotiki sterea Ellada kai tin Epeiro apo ta teli tou mehri ta teli tou 10 aion Thesaloniki,** 1975, fq. 86-92, 129-132, **Monumentet e arkitekturës në Shqipëri,** Tiranë 1973, tab. 72 – 74.

26. E.H. Freshfield, **Cellae Trichorae,** vol. I, 1913, Tab. 47 dhe A. Megaw, **vep. cit,** tab. Va. Ky i fundit **(vep.cit,** f. 18) vëren me të drejtë që shpesh katolikoni datohet në shek. XI ose më vonë, ndërsa forma gjysmë rrethore e apsidave dhe kupolave të vogla cilindrike është një element më tepër karakteristik për një epokë më të hershme. M.G. Sotiririou, **To katholikon tis monis petraki Athinon,** «Deltion tis hristianikis arhaiologikis etairas, sera 4, vol. II, 1960-61, Athenes 1962, fq. 106, 107.

27. Kisha e Shën Anargjirit sipas Orlandos datohet në çerekun e dytë ose të tretë të shek. XI. **(Arheion ton bizantinon mnimeion)** 4, 1938, fq. 15, fig. 7, fq. 60).

28. S. Pelekanidhis, **I piu antichi affreschi di Castoria,** «Corsi di Cultura sull'arte Ravenate e bizantine», Ravenna, 1964, fq. 354, Po nga ai në një kumtesë në Kongresin e XIII Ndërkombëtar të Studimeve Bizantine në Oksford. A. Megaw **vep.cit,** fq. 19. **Epeiro apo ta teli tore tou mehri ta teli tou 10-ou oion,** Thessaloniki, 1975, fq. 85 – 92, 129 – 132. Monumente të arkitekturës në Shqipëri.

29. G. Sotiriou Byzantinische Zeitschrieft, 30, 1929, tab. X, fig. 4.

30. N. Moutsopoulos, **I baziliki tou Agiou Ahilleiou,** fq. 169-170. Po nga ai **Ereunes stin kastoria kai ton Agion Ahilleio,** «Epistimoniki, Epetiris tis Polytehnikis Skolis», vol. II, 1966, fq. 141.

FOTOCOPY



Fig. 2 – Prerje tërthore e bazilikës së Shën Akileut.
Fig. 2 – Coupe transversale de la basilique de St Achillee.

DO NOT COPY

ve na çoi në përfundimin se ndërtimi i sinthronit dhe i fronit të patriarkut u krye pas ndërtimit të plotë të bazilikës, por para pikturimit të mureve. Gjurmët në formë patkoi të planimetrisë së absidës dhe harku që përvizon dritaren tripjesëshe, janë elemente që dëshmojnë për një datë të vjetër të ndërtimit të kishës.

Sipërfaqja e brendshme e murit të absidës, ashtu si e gjithë ndërtesa, ishte rimbuluar me llaç gëlqereje. Në të dallohen ende dy shtresa pikturash të njëpasnjëshme. Në shtresën e parë më të vjetër, në anën veriore, në të majtë të absidës gjysmë rrethore, shihen dhe sot gjurmë të dobëta pikture. Këto piktura paraqesin 8 peshkopë-shenjtorë të cilët zenë pjesën e murit, ndërmjet kornizës që vijon ndërmjet fundit të konkës dhe pjesës së sipërme të një radhe harqesh të pikturuara (fig. 2). Ato i përkasin gjithaq shtresës së parë të afreskut. Në anën e djathtë të absidës gjenden gjurmët e 8 figurave të peshkopëve të tjerë. Peshkopët që paraqiten në pamje ballore, në këmbë, duke bekuar, janë veshur alternativisht me himation të kuq e tunikë të bardha ose me epitrahil të bardhë. Pah heqjes së një pjese llaji mjaft të dëmtuar të shtresës së dytë, u shfaq fytyra e njërit prej këtyre hierarkëve, e të gjashtit duke filluar nga e majta. Gjurmët e shtresës së parë të afreskut vijojnë mbi dritaren tripjesëshe (Melismos?). Në sipërfaqen e kësaj dallohen gjurmët e goditjeve, të një instrumenti me majë, për përgatitjen e sipërfaqes së murit për shtresën e dytë të llaçit. Sfondi rreth e rrotull figurave të dy peshkopëve, ndahet në lartësi në tri zona. Sipas gjurmëve, zona e sipërme duhet të ketë pasur ngjyrë mjaft të errët, thuajse të zezë, zona e mesme ngjyrë të gjelbërt ulliri dhe zona e poshtme ngjyrë okër. Në gjurmët e dobëta të shtresës së dytë, mundëm të dallojmë figura të tjera peshkopësh në këmbë, të cilët spikasin në një sfond të zi të qarkuar nga një kornizë e kuqe. E njëjta kornizë haset edhe në shtresën e parë. Gjasisht më parë në këtë pjesë të kishës, ashtu si dhe në pjesët e tjera,

kishte një shtresë të tretë llaçi të pikturuar, e cila sot është prishur.

Në sipërfaqen e brendshme të konkës në shtresën e dytë të llaçit, poshtë kornizës, ruhen gjurmët e një mbishkrimi greqisht. Gjendja e tij në v. 1898, gjatë vizitës së Milukovit, ishte mjaft më e mirë[31]. Ky mbishkrim kishte gjatësi të njëjtë me harkun patkua 13, 46 dhe lartësi jo më tepër se 0,34 m. Shkronjat janë pikturuar me një ngjyrë të zezë të errët, mbi një sfond ngjyrë okër. Shirita të kuq të errët qarkojnë mbishkrimin. Nga këto shkronja ω; ka lartësi 0,23 m dhe gjerësi 0,196 m, γ ka lartësi 0,254 m dhe gjerësi 0,234 m. Shkronja e parë e dukshme e mbishkrimit ndodhet 1.5 m larg fillimit të murit në anën e majtë të absidës. Shkronjat e tjera po i paraqesim në tabelën e mëposhtme. Në të shifrat e rreshtit të parë përfaqësojnë shkronjat e ruajtura dhe ato të rreshtit të tretë gjatësinë në cm të vendit të zenë nga shkronjat dhe pjesët boshe. Nëpërmjet kësaj tabele mund të përcaktojmë numrin e përafërt të shkronjave për tërë mbishkrimin.



Miljukovi, na ka lënë një skicë të mbishkrimit, e cila në atë kohë ruhej në gjendje më të mirë.



duke shtuar në fund[34]. «në jetë të jetëve».



Një mbishkrim analog ndodhej, në të njëjtin vend në kishën e Shën Sofisë të Nikesë[35], sot të prishur. Këtë kishë Shlumbergeri[36] e daton ndërmjet shek. X dhe XI ndërsa Sharl Dili e rijep mbishkrimin si më poshtë: «Streha jote, o zot, duhet bekuar në jetë të jetëve»[37].

37)



Siç shihet, ky mbishkrim paraqet një ngjashmëri të madhe me atë të Shën Akilit. Në të ka gjithsej 42 shkronja, ose 43 në qoftë se do të shtonim kryqin. Mbishkrimi ynë, sipas llogarive tona, përmban 57 (5 + 6 + 3 + 1 + 6 + 3 + 33) shkronja. Në qoftë se heqim hapësirën boshe para fillimit të mbishkrimit, 5-6 shkronja të gjatë dhe një hapësirë analoge pas tij, duke supozuar në këtë rast se mbishkrimi nuk zinte të gjithë gjatësinë e brezit, në dispozicion do të na mbetej një gjatësi që i korrespondon 47 shkronjave, afërsisht sa ajo e mbishkrimit të Shën Sofisë në Nike.

Mbishkrimi i Nikesë, ashtu si ai i Shën Akileut, nuk ka intervale ndërmjet fjalëve. Nëse shkronjat e të dy mbishkrimeve i vendosim poshtë njëra-tjetrës, do të vërenim këto përkime:

Ky krahasim na lejon të dallojmë se disa shkronja përkojnë me njëra tjetrën dhe boshllëqet që ek-

Mbishkrimi (Inscriptions)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42
Nike (Nicée) +	Τ	ω	Ο	Ι	Κ	ω	C	Ο	Υ	Π	Ρ	Ε	Π	Ε	Ι	Α	Γ	Ι	Α	C	Μ	Α	Κ	Ε	Ε	Ι	C	Μ	Α	Κ	Ρ	Ο	Τ	Η	Τ	Α	Η	Μ	Ε	Ρ	ω	Ν
Prespe (Prespa)	Τ		ω	Υ	Κ	Ο	σ	ο	υ	Π	ρ	ε	π	ε	ι	α	Γ	Ι	Α	σ	μ	α	χ	ε	ε	ι	ς	μ	α	κ	ρ	ο	τ	η	τ	α	η	μ	ε	ρ	ω	ν
	1	2	3	4	5	6				7	(1	2	3	4	5	6)	8	9	10																								

31. N. Moutsopoulos, **Ereuneš stin Kastoria kai ton Agio Ahilleio,** fq. 200. fig. 28.
32. P.N. Miljukov, **vep.cit,** fq. 49, shën. 2.
33. Llogaritja e shkronjave që mungonin u bë me anë të krahasimit me disa distanca të tjera të njohura që kanë një numër të njohur shkronjash.
34. N. Miljukov **Vep.cit,** fq. 49.
35. Ch. Dichl, **Mosaiques byzantines de Nicee,** Byzantinische Zeitschrieft, 1/1892, fq. 78.
36. Schlumberger **Sigillographie byzantine,** fq. 37, 39.
37. Një mbishkrim i ngjashëm dhe në të njëjtin vend ndodhet në kishën e Shën Lukës në Fokidë: Ch. Diehl, **L'eglise et les mosaiques du couvent de St. Luc en Phocide.** fq. 71. dhe R. W. Schultz – S.H. Barnsley, **The monastery of Saint-Luke of Stiris in Phocis,** London, 1901, fq. 58.

DO NOT COPY

zistojnë në mbishkrimin e Shën Akileut i korrespondojnë numrit të shkronjave analoge të mbishkrimit të Nikesë. Këto krahasime na lejojnë të plotësojmë mbishkrimin:

" Τῷ υκο[38] [σου] π[ρέπει ἀ]γ[ί]α[σμα κ[ύρι]ε εἰς μακρότητα ἡμερῶν][39]

Gjatë pastrimit të një pjese të monumentit, nën konkën u gjendën copa të shumta suvaje të rrafshët, tepër të dëmtuara, të cilat kishin gjurmë ngjyrash në të dy anët. Pas një sërë supozimesh ne arritëm në përfundimin se kemi të bëjmë me mbeturina të shtresës së dytë të afreskave të absidës. Ndër to gjendeshin, gjithashtu, fragmente të mbishkrimit të shtresës së dytë, të cilat në anën e mbrapme ruanin gjurmët e një mbishkrimi më të vjetër. Mbeturinat e tjera të mbishkrimit të shtresës së dytë për shkak të veprimit të gjatë të agjentëve atmosferikë janë në një gjendje mjaft të keqe. Për këtë arsye u vendos që fragmentet të hiqen.

Ky mbishkrim, më i vonë, ishte shkruar me shkronja të zeza në një sfond ngjyrë okre. Korniza mbi frizë është e zezë dhe gjerësia e saj ndryshon (0,025 m). Ajo ndiqet nga një vijë në ngjyrë të kuqe të errët dhe më tej nga një tjetër në ngjyrë të zezë. Këto breza përbëjnë bordurën e afreskut të konkës (fig. 2,3). Ky mbishkrim, me disa boshllëqe, mund të transkiptohet si më poshtë (fig. 3). «Kur të shohësh tryezën e shenjtë të zotit, qëndro shpirtdridhur o njeri, dhe përulu se aty brenda krishti flijohet përditë»[40].

Meqë numri i shkronjave të lexueshme është mjaft i vogël, mendojmë se plotësimi i tij nuk do të

"(Ὁρῶν) τό βῆμα τῆς τραπέζης (Κυρίου/στῆθι τ)ρέμων (ἄνθρωπε καί κα)τω (ν/εύων/ Χ(ριστό)ς γα)ρ ἔνδον θύεται καθημέραν" [40]

ishte oportun. Nga ana tjetër përderisa ai ka një interes të veçantë për kishën, problemet e tija do të jenë objekt i një studimi të veçantë.

Pjesa e poshtme e afreskut të absidës, mbi sinthronin paraqet një seri harqesh të pikturuara me ngjyrë të kuqe. Këta harqe janë 18, nga 9 në çdo anë të dritares treshe.[41] (fig. 4). Miljukovi[42] thotë se i është dashur të heqë shtresën e dytë të suvasë që mbulonte një pjesë të mirë të harqeve. Edhe mbi këtë shtresë ishin pikturuar harqe, por nuk dukej ndonjë mbishkrim. Gjurmët e shtresës së dytë të pikturës që kemi mundur të vëzhgojmë, na çojnë në përfundimin se në këtë shtresë nuk ka pasur mbishkrim. Nën harqet, në vitin 1898, Miljukovi[43] kishte

38. Në kishën «Fjetja e Shën Mërisë» në Skripu në Beoti, ndodhet një mbishkrim i vitit 873/4, i Leonit Pratospathar perandorak, ku lexohet «epi ton ukiakon». J. Strzygowski, **Inedi ta der Architectur und Plastik aus der Zeit Basileios.** (867 – 886) «Byzantinische Zeitschrieft, vol. 3, 1894, fq. 7 dhe M.G. Sotiriou, **Onaos tis Skripous tis Voiotias** «Arhaiollogiki efimeris, 1930, fq. 155 dhe fig. 38. Shih. S. Kyriakides, **Byzantinoi Meletai** «Epistim. Epetiris filozofiki skolis Thesaloniki, Vol. III, 1934, fq. 436: «+ Konstant-(i)no B(asi)liko / Proto(spath)a(rio) epi / t(on) uk(jakon) (kriti) (?) tis / (thra)kis (?)». Për sa i përket mbishkrimit shih J. Strzygowski, **Die Baukunst der Armenier in Europa,** I, 1918, fq. 31. fig. 32. dhe G. Stuhlfauth, **Kleine Beiträge zur altchristlichen Epigraphik,** «Byzantinische und Neugriechische Jahrbücher 6, 1, 2, 1928, fq. 164, i cili hasi një mbishkrim të tillë të shek. V-VI, në bazilikën paleokristiane të Ererukut:», në një tabula ancata, në fundin lindor të anës jugore të bazilikës paleokristiane të Ererukut».

39) Bëhet fjalë për Psalmën 93/5.

40) S. Radosheviç-Maksimoviç, **Jedan epigram iz bazilike Sv. Ahileja na malloj Prespi,** Zbornik radova vizantolloshkog Instituta, XII. 1970, f. 9-12. Nga pikpamja morfologjike shkronjat e mbishkrimit ngjasin me shkronjat e mëdha të shek. X. Për këtë shih mbishkrimin grek në një disk ari të shek. X me origjinë nga Preslavi **(Kunstschatze in Bulgarischen Mussen und Klostern),** f. 143, Tab. 199.

41. Miljukov **(Vep.cit,** fq. 50) përmend 15 absida. Shih. dhe A. Grabar, **Deux temoignages archeologiques sur l'autocephalie d'une eglise «Prespa et Ochrid** «Recueil des travaux de l'Institut d'Etudes Byzantines de Belgrade VIII (Melanges G. Ostrogorsky II)» fq. 164.

42. N. Miljuka **Vep.cit,** fq. 50.

DO NOT COPY



Fig. 3 – Mbishkrimi i bëmës së bazilikës së Shën Akileut.

Fig. 3 – L'inscription de l'abside du sanctuaire de la basilique de St. Achillée

lexuar emrat e selive peshkopale. Më vonë, më 1908, Ivanovi i gjeti ato më pak të qarta; Lartësia e harqeve të pikturuara është 1,18 m dhe gjerësia e brendshme 0,43 m. Kolonat e pikturave ashtu si dhe harqet kanë një gjerësi 0,12 m dhe përbëhen prej tufash vijash të gjera, herë dy, herë tri. Mbi çdo kolonë qëndron një kapitel i thjeshtë i zbukuruar me motive të lehta floreale. Mbi serinë e harqeve, shtrihet një shirit i gjerë i kuq dhe një tjetër i zi. Harqet të parregullt e të përzgjatur në lartësi, mbështeten mbi kollona me kapitele të një tipi të veçantë, por pa bazamente (fig. 2). Harqet e pikturuara kanë këto veçori: a) nuk kanë bazamente dhe mbështeten mbi një brez të gjerë të kuq, b) janë mjaft të përzgjatur c) kapitelet janë të një tipi të veçantë d) janë të zbukuruar me një dekor në formë brezash. Harqet analoge, që i ndeshim në miniaturat e manuskripteve bizantine të shekujve IX dhe X janë gjysmë rrethore

43) **Po aty,** f. 50-51.

DO NOT COPY

ose në formë patkoi dhe mbahen nga kolona me kapitele të stilit korintik[44].

Gjatë vizitave tona të para, nuk kemi mundur të dallojmë gjurmë mbishkrimesh nën harqet e pikturuara[45]. Por shqyrtimi i vëmendshëm e sistematik i gjurmëve të pikturave, na lejoi të dallojmë nën harqet e pikturuara disa shkronja të shkruara me penel me ngjyrë të zezë. Por nën emrat e pikturuar me ngjyrë të zezë mbi shtresën e parë të llaçit, ndodheshin të tjerë emra peshkopësh, të pikturuar me ngjyrë të kuqe, ashtu si harqet në brendi të të cilave gjendeshin. Këto gjurmë mbishkrimesh i përkisnin periudhës së parë të pikturimit të absidës së Altarit[46]. Sot ato janë të palexueshme dhe ndoshta mund të jenë fshirë qëllimisht, para se të ripikturoheshin mbishkrimet me shkronja të zeza. Pra, mbi emrat fillestarë të shkruar në të njomë (à fresco) me ngjyrë të kuqe, më vonë, sigurisht para periudhës së dytë të pikturës murale, u shkruan me ngjyrë të zezë, këtë herë jo më në të njomë, por në të thatë (à seco), ose me një teknikë tjetër. Për këtë arsye këto mbishkrime u dëmtuan mjaft, sidomos pas shqitjes së shtresës së dytë të afreskut. Gjatë punimeve për shtresën e dytë të dekorit, shtresa e re e suvasë që u vendos e njomë thithi një sasi të shkronjave të zeza. Pas rënies së shtresës së dytë, lagështia dhe agjentët atmosferikë thuajse i fshinë të gjitha shkronjat. Në fig. tonë numëri 2 përfaqëson shtresën më të vjetër të suvasë mbi të cilën ishin shkruar mbishkrimet me shkronja të zeza, ndërsa numuri 1 paraqet pjesët e zbuluara gjatë pastrimit të mëvonshëm të ndërtesës. Për efekt studimi vizatuam harqet e pikturuara duke i emërtuar sipas radhës së propozuar nga Miljukovi[47]: nga e majta ata paraqitën me shifrat I – IX dhe nga e djathta X-XVIII (fig. 2).

Në tabelën e mëposhtme po shënojmë numrin e selive që kemi mundur të deshifrojmë (II – XIV) si dhe tekstin e Miljukovit dhe tonin[48].

Ne propozojmë leximin e mëposhtëm:

II Throni i Prisdrianon -it, III, Throni i Videnis-it, Throni i Kefalonias, V Throni i Beroias, VI Throni i Irakleias, VII, Throni i Belebouzdion-t IX Throni i Selasforou-t, X Throni i Skopion-it, Throni i Sardikis-it, XI Throni i Edessis-it.

II. + Θρό(νος) πο Πρισδριάνων, III. + Θρόν(ος)που Βιδενη<ς> + , + [Θρόνος πο] Κεφαλονίας, V. Θρ-(όνος) π(ο) Βεροίας, VI. + Θ(ρόνος πο) Ἡρακ-λείας, VII. Θρ(όνος) πο Βελεβουσδίου (?), IX. Θρόν-(ος). Σελασφόρου +, X. + (Θρό)νος που Σκωπί-ων, XI. + Ὁ Θρόν(ος) πο Σαρδικῆς, XI. + Θρό-νο(ς) που Ἐδέσσης.

Duke u nisur nga vendi që zenë harqet e pikturuara mbi sinthronin si dhe nga emrat e selive peshkopale rezulton se kemi të bëjmë ose me selitë peshkopale në vartësi të Patriarkatit bullgar, gjatë qëndrimit të tij të përkohshëm në Prespë, ose me selitë peshkopale që vareshin nga kryepeshkopata autoqefale e Ohrit, e krijuar nga Vasili II, pas rënies së Samuelit.

44) K. Weitzmann, **Die byzantinische Buchmalerei des 9 und 10 Jahrhunderts,** Berlin, 1935, ku takohen shpesh minjatura ose tekste, poshtë harqeve të mbështetur mbi kollona dyshe. Tab. XI, 56, 57, XVII, 87, 88, 90, 94, XVIII; 96, 97, 98, XXII, 116, 118, LXIII, 375, 377, 378, LXXIV, 450.

45) N. Moutsopoulos, **I Basiliki tou Agiou Ahilleiou,** f. 168, ku shkruajmë se «Miljukovi lexon ndenjëset e fronave peshkopalë».

46. Miljukovi (**Vep.cit,** fq. 50) konstaton që nën mbishkrimet e shkruara me shkronja të zeza kishte mbishkrime të tjera më të vjetra, me shkronja të kuqe.

47. **Po aty,** fq. 50.

48. **Po aty,** fq. 50, 51, fig. 12.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4 — Harqet e absidës së bëmës me mbishkrimet e peshkopatave suragane në bazilikën e Shën Akileut.

Fig. 4 — **Les arcs de l'abside du sanctuaire avec les inscriptions des évêchées soufragants à la basilique de St. Achilée.**

Andre Grabari[49] ve në dukje se këtu nuk mund të bëhet fjalë veçse për kryepeshkopatën e shtetit të Samuelit, pasi ndërmjet selive peshkopale, përmendet ajo e Vidinit, të cilën Vasili II do ta kishte shkëputur nga kryepeshkopata e Ohrit më 1002. Përvej kësaj ai shtron pyetjen se «përse Prespës në kohën e Vasilit II duhet t'i jepej kjo formë e veçantë (me mbishkrime murale dhe «throna të inkuadruara») që të kujton përbërjen e kryepeshkopatës, të cilën ky perandor e rimëkëmbi pas fitores, duke caktuar Ohrin si seli kryepeshkopale[50].

Një gravurë e vjetër e shek. XVII e botuar nga Grabari[51], e cila paraqet mozaikët e absidës së kishës së Shën Ambrozit në Milano, në gjendjen e tyre

49) **Deux tempignages archaeologiques sur l'autocephalie d'une église: Prespa, Ochrid,** f. 163. v.

50) **Po aty,** f. 165.

51) **Po aty,** f. 166.

fillestare (ai u mbulua në shek. e XII, kur u zëvendësua me mozaikun që zbukuron edhe sot absidën), tregon gjendjen e sotme, theofaninë qendrore dhe skena të historisë së Shën Martinit të Turit. Por më poshtë tyre në gravurë shohim dhe një radhë personazhesh të ulur, tashmë të hequr. Ata janë peshkopë të ulur në frona dhe spjegimet që shoqërojnë këto figura i quajnë peshkopë të dioqezave në vartësi të selisë kryepeshkopale të Milanos.

Grabari arrin në përfundimin se «Në rastet e Prespës dhe të Milanos, ndodhemi përpara përpjekjesh për të konkretizuar strukturën administrative të një kryepeshkopate, duke grupuar rreth kryepeshkopit, peshkopët e tij sufraganë».

Në një artikull më të hershëm se ai i Grabarit, M. Skriçeviç[52] synon të përcaktojë periudhën gjatë së cilës u realizuan mbishkrimet e Prespës. Ai i kujton Miljukovit se këto mbishkrime dëshmojnë se kisha ishte e lidhur me selinë patriarkale bullgare, pasi në to bëhet fjalë për një listë peshkopësh të varur nga patriarkati, i cili, sipas autorit, gjatë periudhës nga largimi i patriarkut nga Moglena e deri në vendosjen e tij në Ohër, e kishte selinë në Prespë. Meqë ndër mbishkrimet e deshifruara përmenden edhe peshkopatat e Vodenës, Verrisë, Petrës, Miljukovi e vendos kohën e ndërtimin e kishës në periudhën e shkurtër midis transferimit hipotetik të selisë patriarkale nga Moglena në Prespë dhe marrjes së Vodenës nga perandori Vasili II, në fillim të fushatës së tij kundër Samuelit në v. 1002.

Sipas mendimit të Miljukovit, megjithëse kjo kronologji është më e mundshmja, ekziston dhe mundësia që këto mbishkrime të jenë bërë pas vitit 1020, kur Vasili II rimëkëmbi juridiksionin e kryepeshkopatës së Ohrit në kufijtë e saj të parë[53]. Dëshmitë e Skylicës dhe Cedrenit kanë mjaft rëndësi për përcaktimin e datës së ndërtimit të bazilikës së Shën Akilit[54]. Veçanërisht në se tekstet e tyre i krahasojmë dhe i plotësojmë me tekste të tjera Cedreni[55] përmend vetëm Samuelin: «dhe arriti të nënshtrojë shumë qendra të fortifikuara, prej të cilave më e rëndësishmja ishte Larisa, banorët e së cilës i shpërnguli familjarisht në brendësi të Bullgarisë dhe, si i përfshiu në listat e ushtarëve të vet, i përdorte si aleatë kundër Romejve. Eshtrat e Shën Akilit, peshkopi i Larisës në vitet e Kostandinit të Madh, pjesëmarrës në Sinodin e parë ku ishin edhe Regjini i Skapelëve me Diodorin e Trikës, i mori e i vendosi në Prespë, ku kish pallatin e vet mbretëror».

Në këtë pikë përfundon teksti i Cedrenit (tek Skylica, ed, Bon, II f. 436, II). Por dorëshkrimi i Skylicës (codex Vind. hist. Graec. 74. fol. 15 v. 27 – 25 r I) e plotëson këtë citim duke i dhënë zgjidhje problemit të datimit të kishës së Shën Akilit. Dorëshkrimi vazhdon: «Për nder të emrit të tij ndërtoi një shtëpi fort të bukur e shumë të madhe»[56].

"Οἶκον κάλλιστον καί μέγιστον ἐπί τῷ ὀνοματι αὐτοῦ δομησάμενος" [56]

Duke komentuar tekstin e Cedrenit G. Sotiriu[57] supozon se kisha e mësipërme u ndërtua në vend të një kishe të vogël, që ekzistonte më parë. Këtë supozim të Sotiriut, Pelekanidhesi e ripërsërit në studimin e tij[58], ku shkruan se Cedreni «i cili nuk përmend ndërtimin e ndonjë kishe, thotë thjesht se Cari Samuel e vendosi reliken e Shën Akilit në një kishë ekzistuese të panjohur». Por dëshmia e kodeksit «U» të cituar më poshtë, thekson se me rastin e transferimit të relikes së Shën Akilit, «Samueli ndërtoi për nder të tij (Shën Akilit) një ndërtesë të mrekullueshme dhe mjaft të madhe, në ishullin e Prespës së Vogël», ku ngrihej pallati i tij mbretëror. Fraza «për nder të tij» e përjashton supozimin se kisha ekzistonte më parë dhe i kushtohej një shenjti tjetër, dhe e çon ndër-

52) M. Skricevic, **La renovation du type basilical,** f. 197 v.

53) **Po aty,** f. 198, nr. 154, vëren se G. Sotiriu dhe Pelekanides **(Byzantina kai Metabyzantina Mnimeia tis Prespa,** Thesalonique, 1960, fq. 67) kanë interpretuar gabim tekstin e Miljukovit duke thënë se sipas tij basilika duhej të datohet në vitet 1002-1020.

54. S. Pelekanidhes **(vep.cit,** fq. 64) shkruan se «asnjë burim historik nuk përmend kishën. Citimet e Skilicës dhe Cedrenit nuk mund të shërbejnë si dëshmi për ndërtimin e kishës».

55) Cedrenos, ed. Bonn II, fq. 436.

56) B. Prokić, **Die Zusäsze in der Handschrift des Johannes Skylitzes (Codex Vindobonensis hist. Graec. LXXIV),** München, 1906, fq. 29.

57) **O Byzantinos naos tou Agiou Ahilleiou tis Prespas kai ai Boullgarikai peri tis idruseos, toutou apofeis,** «Praktika tis akadimias Athinon, vol. 20, 1945, fq. 13;

58) M. Pelekanides **Vep.cit,** fq. 65.

DO NOT COPY

timin e kishës[59] pikërisht në kohën e marrjes së Larisës.

Një nga shqetësimet kryesore të Samuelit ishte stabiliteti i selisë së tij në Prespë dhe vendosja e Patriarkatit në këto vende. Sipas zakoneve të asaj kohe, ishte e domosdoshme që metropoli të shugurohej me një relike të shenjtë. Veç kësaj ky veprim mund të lehtësonte mardhëniet e Carit me selinë e Shenjtë. Deri në atë kohë patriarku i Samuelit[60] nuk kishte një seli të qëndrueshme dhe varej nga zhvendosja e kryeqyteteve të Samuelit. Sipas diplomës së dytë të Vasilit të I (1020)[61]. «Pas kësaj arkipeshkopët lëviznin nga njeri vend në tjetrin, njëri në Triadicë, tjetri në Vodenë dhe Moglenë. Më pas gjetëm në Ohër arkipeshkopin e tanishëm.».

"μετά δέ τοῦτο ἀπό τόπου εἰς τοπον μεταβαινόντων τῶν αρχιεπισκόπων, τοῦ μέν εἰς Τριάδιταν, τοῦ δέ ἐν τοῖς Βοδηνοῖς καί ἐν τοῖς Μογλαίνοις, εἶθ' οὕτω ἐν τῇ 'Αχρίδῃ τόν νῦν εὕρομεν ἀρχιεπίσκοπον".

Kjo do të thotë se pas Triadhës (Sredeci, Sofia), ai u vendos provizorisht në Vodenë (Edesa), në Moglenë dhe më në fund në Ohër. Sipas një mendimi tjetër, pas Vodenës patriarkati bullgar u vendos në Prespë[62]. Patriarku Germanos, i quajtur gjithaq Gabriel, qëndroi për një kohë të shkurtër në Prespë. Në Manuskriptin grek 880 të Bibliotekës Kombëtare të Parisit, lexojmë «Germani i quajtur ndryshe edhe Gavril, në Vodenë dhe në Prespë».

« Γερμανός ὁ καί Γαβριήλ ἐν Βοδινοῖς καί ἐν τῇ Πρέσπᾳ »

Germanosi ishte patriarku i parë bullgar, pas shfronësimit të Damianit nga bizantinët, në v. 971/72[64]. G. Konidaris shkruan[65] se: «pas rënies së Damianit, Triadhica (Sofia) u bë kryeqyteti fetar e politik i bullgarëve. Këtu u zgjodh padyshim edhe patriarku i ri Germanos ose Gabrieli. Më tej kryeqytet u bë Prespa e më vonë Ohri. Ky i fundit që shërbeu për pak kohë si kryeqytet Samuelit më tej do bëhej qendra kishtare e Ballkanit Perëndimor. Germanosi me sa duket vdiq në ishullin e Prespës dhe u varros në fshatin e afërt Ajos Germanos, në një kishë të vogël të tipit kryq i brendashkruar që i kushtohej Shën Germanit. Në këtë kishë edhe sot gjendet një varr, që sipas traditës krahinore, është ai i Shenjtit.[66].

59) Shih. N.C. Moutsopoulos, **Eklisies tou Nomou Fllorinis,** «Etaireia Makedonikon spoudon, Idruma Meleton Hersonisou tou Aimou», nr. 69», Thesalonikue, 1964, fq. 3.

60) **Ek ton katailopon Hrysostomou A, Papadopolou, arhiepiskopou Athinon kai pasis Ellados, IB** «I. Eklisia Boullgarias 865-1938», botuar nën kujdesin e J. Rampos, Athenes 1057, fq. 38.

61) H. Gelzer, Byzantinische Zeitschrieft, II, 1893, fq. 44 – 45.

62) **Ek ton katailopon Hrysostomou A. Papadopolou,** ... fq. 38. G. Konidaris **«Hristianiki kai Ithiki Egkuklopaigeia»** II, fq. 541.

63) H. Geltzer, **Der Patriarchat von Achrida,** Leipzig 1902, fq. 6. N. Moutsopoulos, **I Basiliki tou Agiou Ahilleiou,** fq. 198.

64) Shih H. Gelzer, **vep.cit,** fq. 3.

65) **I Elliniki Ekklisia os politistiki dynamis en ti istoria tis Hersonisou tou Aimou Athenes 1948,** fq. 52.

66) N. Moutsopoulos, **Ekklisies tou Nomou Florinis,** tab. 28, fig. 47, Tab. 29.; **«Byzantinische und Nachbyzantinische Baudenkmäler aus Klein Prespa und Hl. German»** në Byzantinische und Neugrichiesche Jahrbücher; fq. 32., fig. 31. I. Snegarov (Izvestija na Instituta na Istorija, vol. 11, Sofie 1962, fq. 241 – 250), pranon që kisha e Shën Germanit u ndërtua nga Patriarku i Bullgarisë Germani gjatë jetës së tij për nder të «Padronit të tij qiellor».

DO NOT COPY

Prof. Dr. N. C. MOUTSOPOULOS (Grèce)

RESULTATS DES FOUILLES A LA BASILIQUE DE SAINT-ACHILEE A PRESPA

La basilique de Saint-Achilée qui se trouve à la petite île Saint-Achilée située à l'extremité Nord du lac de la Petite-Prespa, dont la plus grande partie se trouve en territoire grec, notamment dans la Prefecture de Florina, limitrophe de l'Albanie et de la Yougoslavie a fait l'objet d'études historiques de la part de plusieurs historiens et byzantinologues. Le premier à avoir décrit les ruines de ce monument à l'aide de croquis fut l'archimandrite Antonin. (1). Depuis lors le monument a beaucoup souffert. P.N. Miliukov(2) qui visita les lieux quarante ans plus tard, en 1898, observe qu'Antonin avait été en mesure d'en donner une description plus complète que la sienne. C'est dans un état encore moins satisfaisant qu'à son tour J. IVANOV (3) trouva les ruines lors de sa visite à Prespa, en 1907. Et il est clair que depuis la publication de M. Zlokovic (4), les visites de G. Sotirion (5) en 1925, de K. Mijatev (6), de G. Sotiriou (7), encore, et enfin de S. Pelekanides (8), la basilique avait subi de graves dommages, de plus en plus considérables, jusqu'au jour où le Service archéologique hellénique décida de prendre quelques mesures provisoires, pour protéger les parties les plus élévées de l'édifice.

Les problèmes que pose l'étude de la basilique de Saint-Achilée qu'ils soient historiques ou morphologiques (les archéologues d'ailleurs ne sont pas d'accord entre eux), peuvent être résumés ainsi: 1. Vérification du plan de la basilique. 2. Solution de problèmes morphologiques particuliers (toiture de la basilique etc). 3. Date de construction de la basilique. 4. S'agit-il de la basilique érigée par Samuel dans sa capitale au retour de son invasion de Larissa? 5. Est-ce dans cette basilique que Samuel déposa les reliques de Saint Achilée rapportées de Larissa?

On trouvera dans une communication de Stricevic (9) au XII e Congrès Int. d'Etudes Byzantines d'Ohrid, un résumé des

DO NOT COPY

*) N.C. Moutsopoulos, **Ereunes stin Kastoria kai ton Agio Ahilleio** «Epistimoniki epetiris tis Polutehnikis Skolis tou Aristotele ou Panepistimiou tis Thessalonikis» **(E.E.P.S.)** Vol. II, 1965-66, pp. 93 – 244, Pl. 1 – 41, A′ – I′. Idem **Anaskafi tis bazilikis tou Agiou Ahilleiou, deutera (1966) kai triti (1967) periodos ereunon** «E.E.P.S», Vol. IV, 1969 – 1970, pp. 63 – 192, pl. 1 – 99, A′ – B′. Idem **Anaskafi bazilikis Agiou Ahilleiou,** «Praktika tis **arhaiologikis etaireias»** (P.A.E.), 1967, pp. 55 – 69, Pl. 35 – 47. **Anaskafi basilikis Agiou Ahileiou,** PAE 1969, pp. 37 – 41, Pl. 44 – 50. **I basiliki tou Agiou Ahilleiou sti Mikri Prespa,** «Deltion tis hristianikis arhaiologikis etaireias» periodos. IV, vol. IV, Athènes 1964, pp. 138 – 159, Pl. 14 – 20. **«Byzantinische und Nachbyzantinische Baudenkmäler aus Klein – Prespa und aus Hl. German»,** Byzantinische und Neugriechische Jahrbücher, t. XX, 1970, pp. 1 – 49. **Agios Ahileos,** «Makedonikon Imeriologion» 1966, pp. 177 – 183. **Sumpliromatika dedomena gia ton tafo tou diakonikou tis basilikis tou Agiou Ahilleiou,** «Thessaliki Estia» vol. II, Larisa 1974, 3, pp. 441-447. Idem **«Grobnicata na car Samuil v bazilikata sveti Ahil v Prespa»,** Madara-Preslav, Mai 1984, p. 3. Idem. **«Le tombeau, du tzar Samuil dans la basilique de Saint Achile à Prespa»,** Etudes Balkaniques (Academie Bulgare des Sciences. Institut d'études Balkaniques), no 3, Sofia 1984, pp. 114-126.

1. Archimadrita Antonina Kapustina, Poezdka v Rumelizu, II, St Petersbourg, 1886, Pl. X.
2. P. N. Miljukov, «Christianski drevnosti zapadnoi Makedonii, etc.» Izvestija russkogo arheologičeskago Instituta v Konstantinopolê, IV, I (Sofia 1889), p. 48.
3. J. Ivanov, «Car Samuilovata Stolica v Prespa», Izvestia de la Société Archéologique Bulgare, I, Sofia 1910, p. 68-69.
4. M. Zloković, Starinar III, Beograd. Serie III, 1924 25, p. 116, fig. 2, p. 17, fig. 3, p. 118, fig. 4, p. 119, fig. 5.
5. Imerologion tis Megalis Ellados 1926, p. 152, fig. 2, p. 160, et Byzantinische Zeitschrift t. 30, 1929, Fl. X, 4.
6. Bălgarskoto Izkustvo, Bălgarija 1000 godini 927-1927, Sofia, 1930, p. 165, fig. 32, 33.
7. Praktika tis Akadimias, Athinon t. 20. 1945.
8. **Bizantina kai metabizantina mnimeia tis Prespas.** Thessalonique 1960, pl. XX, fig. 1, 2. Voir aussi. G. Bošković, **Architektura Srednjeg Veka,** Beograd 1962, p. 131, fig. 172.
9. La rénovation du type basilical dans l'architecture ecclésiastique des pays centraux des Balkans au IX-XIe siècles, dans Actes du XIIe Congrès International d'Etudes Byzantins, t. I, Beograd, 1963, p. 195 s.

opinions émises sur la basilique de Prespa, avant 1961. De nombreuses hypothèses sur la forme du plan de cette église ont été proposées par divers auteurs. Mais cependant comme la plus grande partie de la basilique restait sous terre ces hypothèses étaient incomplètes et en partie erronées. Milukov (10) dessina avec assez de précision la partie de la prothésis qui subsiste encore, ainsi que les substructures sous la coupole. Le plan que nous avons publié en 1964 (11) est plus exact que celui d'Ivanov (12) et de Rélékanidis (13), en ce qui concerne la coupole, la prothésis et le diakonikon, ainsi que la fenêtre trilobée de l'abside. Le plan d'Ivanov fut repris dans d'autres publications, plus ou moins récentes; Kr. Mijatev (14), Vl. Petkovic (15). N. Mavrodinov (16), Milko Bitchev (17), et G. Boscovic (18). Nous avons pu, de plus, dessiné l'élévation de la petite voûte de la prothésis, le synthronon, ainsi que le dallage de la basilique. Nous avons également déterminé l'emplacement et la forme des rangées de piliers, les ouvertures du narthex et la place de l'entrée secondaire de la nef Nord. Nous avons enfin débarassé le diakonikon du tas de terre qui le recouvrait. En outre, nous avons trouvé dans la nef Sud quatre tombeaux. Ajoutons qu'une d férence de niveaux entre la nef central et la nef Sud a été co statée au cours de nos travaux, ainsi qu'un tracé en forme fer à cheval à l'interieur du demicercle surélevé de l'absi (fig. 1).

La prothésis de la basilique, toute comme le diakonik symmétrique, est une chapelle en forme de croix inscrite da un carré (Croix ramassée); elle a été surmontée d'une peti coupole dont très peu de traces existent encore (19). En mes rant les empreintes de cette coupole nous avons réussi à reconstituer (20). Elle présente un interêt particulier à cause sa décoration de briques (décor ceramoplastique) et des pl quettes carreés disposées en damier (opus reticulatum) qui fo ment une frise au-dessus des fenêtres du tambour. La peti coupole présente des nervures, ce qui est très important po la datation (21). Sa décoration céramoplastique ressemble à décoration analogue de l'église de Saint Germain dans le v lage voisin de German (1006) (22) et à celle de la Koulélidiki

10. Op. cit. p. 48, fig. 11.
11. N. Moutsopoulos, **Basiliki tou Agiou Ahilleiou stin Mikri Prespas,** Deltion tis hristianikis arhaiologikis etaireias». Serie 4, t 4, Athènes 1964, p. 167, fig. 1.
12. Op. cit., P. 67, fig. 9.
13. Op. cit., p. 70, fig. 10.
14. Op. cit., p. 65, fig. 32.
15. Revue des monuments religieux dans l'histoire du peuple. Serbe, Beograd, 1950, p. 261, 1051, fig. 800.
16. Ctarobălgarskoto Izkustvo, Sofia, 1959, p. 100, fig. 90.
17. L'architecture en Bulgarie, Sofia, 1961, p. 31. fig. 18.
18. Architektura srednjeg veka, Beograd, 1962, p. 131, fig. 172.
19. G. Sotiriou, **Byzantinai bazilikai makedonias kai pallaias elladɔs.** Byz. Zeit., 30, 1929, Pl. X, fig. 4. Milan Zloković dans Starinar III, série III ,1924-25, p. 118, fig. 4.
20. N. Moutsopoulos, **Ereunes stin Kastoria kai ton Agio Ahilleio,** dans «Epistinomoniki epetiris tis polytehnikia skolis» t. 2, Thessalonique 1965, p. 130.
21. Paul Lemerle, **Philippes et la Macédoine Orientale à l'époque crhétienne et byzantine,** Texte, Paris, 1965, p. 451, constata une pareille construction à la coupole centrale de la Basilique B. Cf. Margueritte Rumpler, **La coupole dans l'architecture byzantine et mususlmane,** 1956, p. 58. A voir des nervures analobues aux petites coupoles du narthex et de l'exonarthex du cotholikon de la Néa-Moni à Chios: A. Orlandos, **Monuments byzantins de Chios,** Athènes 1932, Pl. 10. En outre des nervures, incorporées dans la construction, faites de morceaux de marbre, existant dans l'église octogonale de Christianou, en Triphylie, que Eustathios Stikas **(L'église byzantine de Christianou en Triphylie, Peloponnése et les autres édifices du même type,** Paris, 1951, p. 18, fig. 16, 17, Pl. I) date du 3ème quart du XIe siècle (p. 49). La basilique de Saint Achilée présente de grandes ressemblances ainsi que de differences à une série de basiliques dont nous avons fait mention dans une autre étude (N. Moutsopoulos, **I. Baziliki tou Agiou Ahilleiou** pl. 174-187); quand la fouille du monument sera complétée nous y reviendrons pour l'étude typologique de la basilique Contemporaine à la basilique de Saint Achilée et présentant de problémes analogues est celle de Sain Nikon de Sparte. Malheureusement la fouille furnit, paraît-il, des éléments insuffisants pour en conclure la forme de la toiture de deux petits sanctuaires latéraux: G. Sotiriou, **Anaskafaien ti Palaia Sparti «PAE»** 1939, Pl. hors texte. P. Vocotopoulos, **Paratiriseis sti baziliki to agion Nikonas,** Praktika, Syned Pelopon. Spoudon. II. Athenes 1976-78, PP. 274-285.
22. Une vieille photographie de la coupole de Saint German où l'on distingue la structure de la maçonnerie du toumbour avant que celle-ci disparaisse sous le mortier récent, publie B. Filov, Geschichte der Altbulgarischen Kunst, Berlin – Leipzig, 1932, p. 21, Pl. b. N. Mavrodinov, Ctarobalgarscoto Izkustvo, Sofia 1959, p. 269, fig. 324. N. Moutso-

DO NOT COPY

Kastoria (23) qui cependant n'a pas encore été définitivement datée. Dans son ensemble la petite coupole présente également une grande ressemblance avec celles des monuments datés, d'habitude, du Xe siècle, ainsi quant à sa décoration céramoplastique avec les petites coupoels et l'abside du catholikon de l'église dite Paléa Episcopi de Tégé(24), en Arcadie, avec celle de l'église de la Dormition à Ano-Lampovo(25), près d'Argyrocastro, en Albanie et du catholikon du monastère de Stilo en Calabre(26).

La reconstitution de la petite coupole de la prothésis à laquelle nous avons abouti, contribue à l'étude des monuments byzantins de l'époque comportant de l'opus reticulatum, *étant donné qu'il s'agit, comme nous le verrons, d'un édifice pouvant être sûrement daté vers 1986.*

shembjes së Perandorisë bizantine dhe marrjes nën zotërim të zonës bregdetare të Shqipërisë, nga venecianët në vitin 1204. Në këto rrethana ish peshkopata e Glavinicës dhe e Kaninës, siç duket, në pamundësi që të ketë marrëdhëniet e mëparshme me qytetet dhe krahinat bregdetare të pushtuara nga Venediku, kërkon lidhje të reja me qytete që fillojnë të zhvillohen në këtë kohë siç është Berati. Sikurse dokumentohet edhe nga mbishkrimi i epitafit të Ballshit[25]. Sipas një gojëdhëne që ruhej në qytetin e Beratit, ky epitaf së bashku me ikona e relike kishtare të tjera janë të manastirit të Shën Mërisë së Ballshit, dhe kanë ardhur në Berat nga manastiri i Shën Gjergjit të Mbreshtanit.[26] Duke ndjekur rrugën që kanë bërë materialet kishtare të peshkopatës së Glavinicës për të vajtur në Berat ne shohim se kj episkopatë i humb gjurmët e saj në kohën e okupacionit turk, kohë në të cilën krijohet peshkopata Beratit, Kaninës dhe Shpatit.

Problemi i lokalizimit të Glavenicës, i shtrua në mënyrën që paraqitëm na shtyn në përfundimir se Glavenica është një vazhdimësi e qytetit të Bylisit në të njëjtën truall, deri në shek. XII. Ky përfundim mendojmë se është më bindës se lokalizimi i Glavinicës në Ballsh të Mallakastrës. Botimi i plotë i rezultateve të gërmimeve arkeologjike të bëra në kishën bazilikale të Ballshit dhe në mënyrë të veçantë të dhënat e reja që do të sjellin gërmimet arkeologjike në qytetin e Bylisit, sigurisht që do t'i japin këtij problemi një përgjigje përfundimtare.

DO NOT COPY

25) Th. Popa, **Të dhëna...**, f. 157-200, Th. Popa, **Glavinica...**
26) Aleksudhi, **Vep. cit,** f. 48.

Koço ZHEGU

DO NOT COPY

GLAVINICA ET LE PROBLEME DE SA LOCALISATION

RESUME

Glavinica ou Kefalinia est déjà mentionnée dans les sources historiques médiévales des IXe-XIVe sc. Tout d'abord elle aparaît dans les actes religieux de l'année 886, plus tard au diplôme de Vasil II, en 1019. Glavinica est mentionnée aussi par Anne Comnène, dans les opérations de combat byzantines-normanes, qui se déroulèrent dans notre territoire vers la fin du XIe sc. et le début du XIIe sc.

Glavinica apparait sous le nom Kefalini-Glavinice, dans la biographie de Clément d'Ohrid où entre autres on dit que l'on voit la colonne en pierre avec l'inscription parlant de la conversion du peuple bulgare et du roi Boris en christianisme. Au début du XIIIe sc, Glavinica était un centre important, mentionné comme «cartulaire de Glavinica», avec trois au quatre petits villages. Dans l'inscription de l'épitaphe de Ballsh, datant de 1373, on mentionne pour la dernière fois l'évêque de Glavinica et de Berat, Kalisti.

Les documents dont on a parlé manquent de données exactes sur la position que cette ville occupait, donc le problème de sa localisation laisse toujours à discuter. Quand même il faut avouer que jusqu'à maintenant on admettait l'idée que Glavinica ou Kefalini se situait à Ballsh de Mallakstra.

Le principal document qui en fit preuve est l'inscription trouvée dans les ruines de l'église de Ballsh au début de notre siècle, qui nous renseigne sur la conversion de Boris et du peuple bulgare en christianisme, au IXe sc. Mais, à notre avis, d'après ce que nous allons voir plus tard, cette localisation est démentie par les nouvelles fouilles archéologiques.

Après le déblayage complét de l'église de Ballsh par S. Anamali et l'édition préliminaire du matériel archéologique, se créa une nouvelle situation plus complète que celle des découvertes et des éditions précédentes. L'opinion exprimée par S. Anamali, que l'église de Ballsh était une basilique episcopale construite par Patakatianos au VIe sc nous paraît douteuse. De même, les opinions qu'on avance pour démontrer que Ballsh était un centre habité de la Basse Antiquité créé après la chute ou le déménagement de la ville de Bylis dans ce centre, que Ballsh était un épiscopat «synchrone» à Byllis et le bynome Bylis-Ballsh représente une continuation illyrienne-albanaise, nous paraissent discutables A la lumière des fouilles récentes quelques-unes de ces opinions furent corrigées. Enfin, la découverte de l'inscription de Ballsh où l'on mentionne l'activité constructrice de Justinien et la construction des murs d'enceinte de Bylis par Victorin démontre que les quatre blocs avec des inscriptions, trouvés dans l'église de Ballsh, revenaient des restes des murs d'enceinte de la ville de Bylis et ne furent apportés à Ballsh que plus tard. Par conséquence, même l'inscription de Victorin découverte à Ballsh au début de notre siècle, ne peut plus être considérée comme un document qui affirme l'existence de Ballsh comme centre habité depuis la Basse Antiquité. Il est déjà clair que les pierres avec les inscriptions du temps de Justinien et tous les éléments architectoniques antiques et paléochrétiens sont apportés à Ballsh pour être réutilisés en tant qu'éléments architectoniques à la construction de l'église, plus tard que le VIe sc. Ces fragments architectonique et aux dimensions de l'église de Ballsh prouvent qu'ils n'appartiennent pas à cette église mais aux monuments et aux églises de Bylis qui en diffèrent par leur architecture et leurs dimensions. De tous les éléments architectoniques trouvés dans l'église de Ballsh, seulement pour les colones de granit on a trouvé des traces qui montrent qu'elles ont été réutilisées dans leur propre fonction (d'après notre avis, elles ont été prises dans les ruines d'une autre église). Il parait que les fragments des autres colonnes ainsi que les divers éléments architectoniques sont réutilisés tout simplement comme matériaux de construction.

Nous pensons que du point de vue de la planimétrie et de la technique de construction, l'église de Ballsh ne possède pas les traits caractéristiques d'une église paléochrétienne du VIe sc., comme on l'a considérée jusqu'à l'heure actuelle. Même les éléments architectoniques paléochrétiens découverts à Ballsh n'ont rien à faire avec la composition architectonique de cette église. La colonne monolithe où se trouve l'inscription de Pakatianos (fig. 1) conserve des traces qui attestent sa fonction en tant que colonne disposée à la droite de l'entrée d'un autel, lequel correspond aux dimensions d'une église beaucoup plus grande que celle de Ballsh. Dans l'église de Ballsh on a trouvé quelques autres colonnes, gravées d'un style différent de celui qui porte l'inscription de Pakatianos. Dans ces colonnes il y a des traces qui prouvent qu'elles sont des fragments d'un autre autel aux plus petites dimensions que le premier qui, parait-il, appartenait à une autre église de Bylis.

Du précédent exposé, nous pouvons conclure que l'église découverte à Ballsh ressemble plutôt aux églises du milieu du Moyen Age, construite essentiellement avec des matériaux trouvés dans les ruines des murs d'enceinte et des monuments antiques et paléochrétiens de Bylis, alors que cette ville fut ravagée et abandonnée par sa population. Nous pensons que dans les matériaux de construction apportés de Bylis, il faut inclure la colonne avec l'inscription de Boris (IXe sc) et de Robert de

Montefort (XIe sc) (fig. 2) ainsi que de divers éléments architectoniques des X-XI sc. Ces opinions sont renforcées en plus par le fait que l'inscription de Boris, qui se rattache à l'épiscopat de Glavinice, représente en même temps, un document qui commémore son baptême par le nom Michel I. Ce fait important, nous incite à penser que la cérémonie commémoriale a dû avoir lieu et être éternisée par une inscription dans l'église cathédrale de l'épiscopat. En considérant l'inscription de Boris comme un fragment apporté de Bylis de pair aux autres inscriptions du temps de Justinien, pour être utilisés comme des pierres pour la construction de l'église de Ballsh, nous avons l'occasion de supposer la localisation de Glavinica à Bylis.

La documentation de la reconstruction du système fortifié de Bylis, au VIe sc, ainsi que la découverte dans cette ville des églises paléochrétiennes à sol pavés de mosaïque, font preuve de son essor économique et culturel au cours de la Basse Antiquité. D'autre part, nous ne trouvons pas juste l'opinion que Bylis subit le phénomène de la métastase et fut installée à Ballsh au VIe sc. Au contraire, d'après quelques données, Bylis, survécut pendant plusieurs siècles après le VIe sc, jusqu'à sa complète destruction. Les traces conservées dans les murs d'enceinte et les tours défensifs du côté septentrional et oriental montrent qu'après le VIe sc. on a entamé des travaux de reconstruction, ce qui prouve la continuation de la vie dans la ville de Bylis même après le VIe sc. Les deux périodes de reconstruction du système fortifié de cette ville sont assez distinctes du point de vue de la technique et des liants utilisés.

Si nous admettons que l'inscription de Boris et de Montefort furent prises à l'église ruinée de Bylis, il ressort que la destruction de cette église et de toute la ville a dû avoir lieu au début du XIIe sc, pendant les combats byzantins-normans, dans la vallée de Vjosa.

Avec la localisation de Glavinica à Bylis, même les sources historiques deviennent plus compréhensibles et trouvent un appui plus sûr si l'on situe Glavinica à une position si dominante sur la vallée de Vjosa, telle qu'était la position de l'ancienne ville de Bylis. De cette façon même les combats entre les byzantins et les normans sur la côte au sud – est de l'Adriatique décrits par Anne Comnène, deviennent plus clairs et plus compréhensibles.

Pour la localisation de Glavinica aida aussi le toponyme «Balide la forte» qu'on trouve dans la chanson de Rolland. Ce toponyme se rattache à la forteresse de Bylis, comme l'une des formes que le nom de cette ville prend dans les documents grecs et latins du Moyen Age (Belidhos, Beliadhos, Bylide et Bylidensis). Si l'on a en vue que l'épisode de Baligand, que mentionne «Balide la forte» appartient à la fin du XIe sc, à la période des combats entre les byzantins et les normans, on reconnaîtra que nous avons à faire à une utilisation simultanée des deux noms de la ville de Bylis. Dans les sources byzantines la ville est nommée Glavinice ou Kefalini tandis que dans celles occidentales elle est mentionné avec le nom Balide. Ce fait montre que le nom Glavinice que les bulgares donnèrent à la ville de Bylis, n'était pas connu à l'Occident. Nous pensons que «Balide la forte» correspond à la forteresse de Glavinice, dont parle Anne Comnène dans la description qu'elle fait aux opérations de combat déroulées dans la vallée de Vjosa à la fin du XIe ec.

Les constructions monumentales et les murs d'enceinte de Bylis et Glavinice ravagés par la guerre deviennent une source de matériaux de construction qu'on utilisa à reconstruire les églises aux alentours de cette ville. Même le matériel hétérogène utilisé à la construction de l'église de Ballsh, fut pris dans les ruines de Bylis-Glavinica au cours du XIIe sc. C'est à cette époque qu'a dû être réalisée la construction de l'église de Ballsh.

Il paraît que la construction de l'église de Ballsh se rattache aux besoins de la réorganisation du siège épiscopal ruiné de Glavinica, mais il ne s'agit pas ici de l'installation de la ville de Glavinica à cet endroit, parce qu'il est clair que comme ville, Glavinica, après sa ruine ne laisse aucune autre trace que celle du nom de son épiscopat situé, d'après la tradition orale au Monastère de la Sainte Marie à Ballsh.

D'après tout ce que nous avons dit dans cet article Glavinica, fut une continuation de la ville de Bylis sur le même endroit jusqu'au XIIe sc.

Foto Cop

NR. 2 1987

monumente

DO NOT COPY

Gjergj FRASHËRI

KOMPLEKSI NDËRTIMOR I HYRJES NË KALANË E KRUJËS

(Gjurmime dhe konservime)

Një nga strukturat më të rëndësishme fortifikuese të kalasë së Krujës, është hyrja e saj në anën veriore (fig. 1). E vendosur në pjesën më pak të aksidentuar të terrenit, hyrja e kalasë së Krujës është pajisur gjatë mesjetës me një sistem kullash e muresh dhe sot na paraqitet me pamjen e një kompleksi mbrojtës të veçantë. Për të, trashëguam një varfëri të theksuar të dhënash prej burimeve të shkruara dokumentare. Po ashtu kanë munguar edhe studimet analitike mbi historinë arkitektonike të saj[1]. Me rastin e ndërhyrjeve konservuese e restauruese të kryera në kalanë e Krujës gjatë viteve 1975 – 82, u bënë përpjekje edhe për vlerësimin e kompleksit të hyrjes.

Hyrja e kalasë paraqet një kalim të harkuar (gjatësi 28,87 m) që vijon nga verilindja në juglindje. Strukturat që qëndrojnë në krahët e këtij kalimi përbëjnë dy bastione të fuqishme (A dhe B), të formuara nga ndërtime në periudha të ndryshme mesjetare (fig. 2). Mbi bastionin e majtë (B) qëndronte një ndërtesë banimi. Në kalimin e harkuar të hyrjes janë vërejtur gjurmët e tri portave[2], të cilat e ndajnë atë në korridorin e hyrjes (hapësira përpara portës së parë), në galerinë e parë (1-1' deri 2-2') dhe në galerinë e dytë (2-2' deri 3-3').

1. **Korridori i hyrjes** (gjatësi 7 m) formohet nga strukturat e dala jashtë portës së parë (fig. 3). Prej tyre ruhen vetëm muret e krahut të majtë (10-6), që janë ato lindore e veriore të bastionit B. Ato ngrihen mbi formacion shkëmbor dhe kjo duket në dy vende, ku shkëmbi është gdhendur rrafsh me faqen e



Fig. 1. Kalaja e Krujës, kompleksi i hyrjes (viti 1977)

murit. Takimi i tyre në ekstremin verior është zbutur nga një faqe e ngushtë 1 m. gjerësi, e cila shkon duke u ngushtuar dhe pjerrur lehtësisht në lartësi (4-5). Ajo ruan teknikë tjetër ndërtimi, realizuar me gurë të skuadruar në format 33 – 50 x 60 – 90 cm (të quajtur nga vendësit «grac»), në rreshta të rregullt horizontale dhe me fugë shumë të hollë llaçi. Ndërsa në murin verior të bastionit vërehet aplikimi i kluasonazhit, ku në vend të tullave janë përdorur rrasa shtufi të holla. Edhe këtu muratura është mbaj-

1) Të vetmin studim të mëparshëm për hyrjen e kalasë e kemi nga S. Adhami. **Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës,** «Monumentet» 1, 1970,

2) **Po aty.** Vërejmë se planimetria e dhënë nga autori ka disa pasaktësi.

DO NOT COPY



Fig. 2. Kompleksi i hyrjes në kalanë e Krujës, genplan (viti 1977)

tur në rreshta horizontale dhe shpesh për të kapur gjerësinë e rreshtit janë përdorur dy gurë njëri mbi tjetrin. Kluasonazhi i paraqitur ndryshon dukshëm nga ai i realizuar me tulla në faqen perëndimore të kullës së sahatit, apo në kullën prane Hamamit dhe tregon për një kohë kur kjo teknikë ishte e mirënjohur dhe në përdorim të gjerë nga ndërtuesit e kalasë. Kështu e shohim atë si prodhim i shek. XIII-XIV, nëqoftë se do të pranojmë, se mungesa e tullës dhe fugat shumë të ngushta të llaçit, janë diktuar nga nevoja për të shtuar soliditetin e muraturës ndaj goditjeve (llaçi i saj, paraqitet midis markave më të larta të përdorura në periudhat ndërtimore të kalasë). Vërehet, gjithashtu, se nivelimet që i janë bërë herë pas here muraturës, fshehin praninë e binareve gjatësore të murit (seksion 15 x 15 cm), dhe të atyre tërthore. Kuotat në lartësi të këtyre brezave përkojnë me hapin e gurëve të faqes së ngushtë veriore (largëria midis dy brezave respekton 2 ose 3 rreshta të gurëve të gdhendur) dhe kjo për mendimin tonë është e mjaftueshme për të kuptuar se krejt muri (10-6) i takon një dore ndërtimi.

Dy gjurmë treguan se edhe në krahun e djathtë të korridori i hyrjes anësohej dikur në lartësi nga një kullë. Njëra i takonte qoshes së saj në ekstremin perëndimor (52), e cila vinte në planimetri në formën e një gjysmë rrethi. Tjetra, kishte të bënte me disa gurë të dalë jashtë faqes së murit të djathtë të korridorit (në pikën 8), që i takonin një muri tjetër në drejtimin verior. Gjithashtu ekzistonte edhe një fotografi e realizuar në fillim të shekullit tonë[3], ku shikohen mbetjet e kullës (fig. 4). Me këto të dhëna u kryen gërmimet për zbulimin e saj. Prej kullës ruheshin mbetjet e murit perëndimor dhe një pjesë e murit verior. Ajo ka patur planimetri katërkëndëshe, me mure 1 m gjerësi (fig. 5). Teknika dhe materiali i ndërtimit të përdorur rezultuan krejt të njëjtë me ato të murit (5-6) të korridorit të hyrjes. Gjithashtu edhe drejtimi i murit lindor të kullës (8-53) përkonte me



Fig. 3 Hyrja e kalasë së Krujës, kati përdhe (përpara gjurmimeve 1977)

3) Th. Ippen. **Denkmaler verschiedener Altersstufen in Albanien.** Wien 1907, f. 61.

DO NOT COPY



Fig. 4 Hyrja e kalasë në fillim të shek. XX (marrë nga Th. Ippen).

qoshen e korridorit (4-5). Mbetjet e kullës (8-53) përkonin me qoshen e korridorit (4-5). Mbetjet e kullës C, të njëkohshme me ato të murit të përkundrejtë (5-6), mund t'i datojmë kështu në shek. XIII-XIV, me mundësi më të mëdha në shek. XIV. Forma katërkëndëshe në planimetri flet për një ndërtim më të herët se shek. XV dhe për këtë mjafton ta ballafaqojmë me kullat me seksion rrethor të ndërtuara nga Skënderbeu. Madje, rrumbullakimi i qoshes së kullës, përbën një element që tregon se jemi në periudhën e rritjes së forcës goditëse të artilerisë mesjetare, por ende larg fuqisë së topave me barot të shek. XV. Nga



Fig. 5 Kulla C, planimetria pas gërmimeve.

kjo kohë, ndërtimin e kullës e largojnë edhe muret e hollë dhe mbushja me dhé e brendisë së saj. Si provë të fundit, do të sillnim rrënimin dhe braktisjen e saj, në një kohë që ndërtimet e shek. XV ende qëndrojnë në këmbë, rrënim ky, që siç mund të gjykohet nga mungesa e fazave të tjera të ndërtimit të kullës, vjen direkt nga veprimet luftarake të rrethimeve të Krujës në shek. XV.



Fig. 6. Galeria e parë e hyrjes, planimetria pas gjurmimeve.

2. Fillimin e **galerisë së parë të hyrjes** e tregon dalja tërthor e një pature të lartë muri, mbetur sot me pamjen e një pilastre (6). Galeria e parë (gjatësi 7,72 m) realizon tërë kalimin në formë kthese të hyrjes (gjërësi 3 m), kur traseja ngjitet me pjerrësi të theksuar (20%). Në pjesën fundore, hapësira e saj zgjerohet nga prania e një nikeje për vendroje në secilin krah (fig. 6). Strukturat më të ruajtura janë ato të krahut të majtë, të cilat arrijnë gati në nivelin e fillimit të mbulesave.

Muratura me gurë e pilastrit ndërpritet nga dy breza nivelues tullash, i poshtmi prej 3 rreshtash, ndërsa i sipërmi prej 6 rreshtash horizontale dhe me fugë llaçi 2 cm (fig. 7, 8). Mbi këtë të fundit shihen gjurmët e mbështetjes së një harku, i konstruktuar prej një rreshti tullash në drejtim të rrezeve dhe i mbyllur nga sipër me kornizë prej 3 rreshtash të shtrira. Mbarimi i pilastrit kuptohet nga një fugë vertikale (18), e cila dallohet deri në nivelin e fillimit të harkut, pasi më sipër mbistruktura e galerisë është e lidhur me tulla. Në mesin e pilastrës është lënë qëllimisht gjatë ndërtimit një kanal vertikal (i gjerë 12 cm), i cili përtej harkut zgjerohet me 9 cm të tjera. Siç e ka vërejtur edhe S. Adhami, kjo gjurmë tregon për praninë e një porte të lëvizshme vertikalisht[4] (portkulis), nëpërmjet sistemit të çikrikëve. Kanati një fletësh duhet të ketë qenë prej hekuri, rrëshqitjen e të cilit e ndihmonte një kontruksion statik (udhëzues), i vendosur në pjesën më të gjerë të kanalit.

Pranë portës rrëshqitëse të bie në sy në lartësi, një gur gëlqeror, i dalë paksa nga faqja e murit, i mpetur në trajtën e një menxole. Ai është punuar me seksion të rregullt (25 x 30 cm) dhe duket se ka qenë më i gjatë, pasi ka shenjat e thyerjes. Ai flet për praninë e një arkitrau, i cili duhet të ketë qenë mbështetur në strukturat e humbura të krahut tjetër të galerisë. Përmasat dhe pozicioni i tij në lartësi na vuri në kërkim të një porte të dytë, fare pranë portës vertikale. Prej një sondazhi u zbuluan me të vërtetë dy ekstremet e pragut të portës, të cilat treguan se ai kishte qenë formuar nga një gur i vetëm me gjerësi në shkelje 50 cm. Madje, faqja e mbrapme vertikale e arkitraut përputhet me po këtë faqe të gurit të pragut, ndërsa në anën e përparme, faqja e arkitraut projektohet në mes të shkeljes së pragut, duke lënë akoma jashtë edhe gjysmën tjetër të tij (25 cm). Të dy kanatat e portës duket se kanë qëndruar mbi këtë pjesë të përparme të shkeljes së pragut. Për një pozicion të tillë të fletëve të portës flasin edhe dy gjurmë të tjera, një vrimë e rregullt (22 x 14 cm) e zbuluar nën mbetjen e arkitraut dhe një tjetër e zbuluar vertikalisht poshtë në xokolin e murit. Ato tregojnë dy vendet e mbërthimit të njërës prej kanatave të portës, të cilat kanë qenë hapur nga ana e jashtme e galerisë, në krahun e portkulisit. Hapjen nga brenda të kanatave nuk e lejon niveli gjithnjë në ngjitje i kalldrëmit. Ndërsa hapja nga jashtë e tyre, detyrimisht nuk mund të realizohej pa tërheqjen e plotë nga sipër të portës me rrëshqitje vertikale. Zbulimi i kësaj porte, deri sot të panjohur, të cilën do ta emër-



Fig. 7. Gjurmët e portës së parë dhe mbetjet e arkitraut prej guri.



Fig. 8 Galeria e parë e hyrjes, gjurmimi i strukturave të krahut të majtë.

4) S. Adhami. **Gjurmime,** f. 89.

DO NOT COPY



Fig. 9 Galeria e parë, fuga e qemerit të dytë.



Fig. 10 Galeria e parë, qemeri i nikes së majtë.

DO NOT COPY

tonim si «portë të dytë» na çon për herë të parë në përfundimin se hyrja e kalasë së Krujës, ka qenë e mbrojtur, jo nga tre, por nga katër porta.

Gjurmime u kryen edhe për mbulesat e galerisë. Kështu u vërejt se syprina e sipërme e arkitraut formon një rrafsh me nivelin e mbështetjes së harkut të pilastrës. Disa rreshta tullash më sipër, tregojnë për mbetjet e qemerit të parë të galerisë, i cili ka pasë vazhduar deri në fugën 12, duke mbuluar të dy portat e saj. Po ashtu, mbi këmishën e harkut të nikes së majtë, shihet një fugë tjetër vertikale (fig. 9), e krijuar nga 14 tulla (në pikën 13). Muratura prej tulle midis pikave 12-13, tregon për bazamentin e një qemeri të dytë të galerisë, i cili ka qenë 97 cm më lart nga i pari.

Nikja e vendrojeve të krahut të majtë, e cila ruhet mirë, ka hapësirë drite më të vogël (3.20 m ndaj 4.41). Ajo mbulohet me qemer tulle trung-konik, duke rënë në brendi (fig. 10). Kjo formë mund të jetë kushtëzuar prej ekzistencës së ndërtimeve të mëparshme në këtë anë të kompleksit, përderisa nikja e djathtë mbulohet me qemer gjysmë cilindrik. Ato janë realizuar tërësisht me tulla[5], të konturuara nga sipër vetëm me një radhë tullash të shtrira. Vërehet se fugat e llaçit kanë qenë të rrafshuara me mistri. Ka gjasë që brendia e nikeve të ketë qenë suvatuar nga një cipë e hollë llaçi.

Mbi mbulesën e nikes së majtë, u panë gjurmët e fillimit të një harku të verbër tulle (15), i cili rezulton nga matjet të ketë përfunduar në rrafshin ku shkarkon qemeri i dytë i galerisë (13). Në të dy anët e tij, u vërejtën shenjat e dy pendentivëve (fig. 11). Në krahun e djathtë ai është formuar nga disa tulla, të cilat ngrihen në lartësi në formën e një trekëndëshi. Ndërsa në të majtin, tullat mungojnë prej dëmtimit të mbistrukturës, por ka mbetur një mbushje e mëvonshme në formën e një pyke (13), e cila është plotësisht simetrike me të parën. Prania e dy pendentivave na vuri në kërkim të ekzistencës së një kupole.

Qemerin fundor të galerisë e tregojnë tullat e mbetura në pilastrin e majtë (15-2), i cili përkon me kuotat dhe hapësirën e qemerit të dytë të saj (fig. 12, 13). Sipas drejtimit të tyre, ky qemer nuk ka shkarkuar mbi pilastrin (17-2'), por mbi harkun e nikes së djathtë (në pikën 23), një shfaqje konstruktive kjo e njëj-

5) Në mbulesat e galerisë së parë vihet re përdorimi i tullave në përmasa të ndryshme. Më tepër janë 29,5 x 14,5 x 4 cm apo 29 x 14 x 4,5 – 5, por dëndur gjenden edhe ato me përmasa 29 x 12,5 x 6,5 cm ose 28,5 x 12,5 x 6 cm dhe më rrallë 27 x 12,5 x 4 cm. Mund të mendohet se të tilla tulla janë marrë nga ndonjë qendër antike përreth Krujës. Por kjo nuk do të saktësohet nga zbulimi i varrit me tulla të shek. IV-VI, pranë murit verior të kalasë (D. Komata, **Të dhëna të reja arkeologjike mbi kalanë e Krujës,** Iliria 1/1982) përmasat e të cilave janë të diferencueshme qartë ndaj të gjitha llojeve të përdorura në hyrjen e kalasë. Kjo për ne tregon se tullat e galerisë së parë janë një prodhim mesjetar, por jo larg ndikimit të teknologjisë së prodhimit të tyre të kohës së vonë antike.

DO NOT COPY



Fig. 11. Galeria e parë, mbetjet e harkut të verbër dhe të padentinëve në krahët.



Fig. 12. Galeria e parë, mbetjet e qemerit të verbër dhe të pendentinëve në krahët.

të me shkarkimin e qemerit të dytë të galerisë (në pikën 13)[6]. Së fundi u vërejt se kuota e shigjetës së qemerit të nikes së djathtë përkonte me atë të nikes përballë[7]. Në këtë mënyrë arritëm të përfytyrojmë se hapësira midis qemerëve të dy nikeve (13-15 dhe 23--16), atij të dytë (13-16) dhe të fundit të galerisë, me tendencë për t'u bërë kuadratike (me brinjë 2,65 m, 3 m, 2,90 m, 2,51 m), dhe me dy pendentivat në qoshet 13 dhe 15, ka qenë krijuar për ndërtimin e një kupole (fig. 14). Madje, ekzistojnë të gjitha mundësitë që mbi qemerin e nikes së djathtë të kenë qenë pendentivët e tjerë në qoshet (16 dhe 23) si dhe harku i verbër, respektivisht mënyrës së konstruimit në anën e përkundrejtë. Me këto të dhëna jemi përpjekur të japim rikonstruksionin grafik mbi pamjen origjinale të galerisë së parë (fig. 15).

3) **Galeria e dytë e hyrjes** (gjatësi 14,5 m) zhvi-



Fig. 13. Galeria e parë, gjurmimi i strukturave të krahut të djathtë.

6) Përderisa krahu i djathtë i galerisë është më i gjatë, detyrimisht qemerët do të kenë një bazë më të gjerë në këtë anë (siç e tregon këtë qemeri i nikes së majtë). Kështu janë zgjidhur edhe dy qemerët e parë të galerisë (6-12 dhe 12-13), të cilët sipas drejtimit që tregonin tullat në fugën 12, kanë shkarkuar në anën e përkundrejtë në pikën 22, mbi një bazë më të gjerë.

7) Qemeri i nikes së djathtë lexohet në mes të hapësirës, deri aty ku në murin fundor të saj, shihet një fugë që zbret duke u lakuar poshtë dhe tregon dy muratura të ndryshme në anët. Pjesa e muraturës ndën qemerin e ruajtur i takon ndërtimeve origjinale të galerisë (me rërë lumi). Strukturat e tjera, që i korrespondojnë anës ballore të bastionit, janë rindërtime në një periudhë të dytë mesjetare, ndërsa qemeri nuk është plotësuar më,

DO NOT COPY



Fig. 14 Galeria e parë, planimetri e mbistrukturës, përmasat pas gjurmimeve.



Fig. 15. Galeria e parë, rikonstruksion grafik.

llohet në vijë të drejtë dhe me trase kalldrëmi në plan horizontal. Pjesa e galerisë mbi portën e tretë qëndronte e mbuluar me qemer guri, madje, gjurmë të tjera tregonin qartë se e tërë galeria e dytë ka qenë dikur e tillë. Porta e tretë e hyrjes (2-2')[8], e vetmja që ruan pamje të plotë, i bën një ngushtim të ndjeshëm hapësirës së galerisë (fig. 16). Dy shpatullat e saj përfundojnë secila me nga një gjysmë kapiteli të ornamentuar thjeshtë, mbi të cilat shkarkon një hark krejtësisht gjysmë rrethor, i punuar me finesë të ngjashme me atë të portaleve të banesave të shekujve të fundit. Fugat vertikale, në murin tërthor të portës, tregojnë se ajo i përket një rindërtimi, me mjaft mundësi, në gjysmën e dytë të shek. XVIII, kur feudalët Toptanë bënë rindërtime në muret fortifikuese të kalasë në kohën e rrethimit të Krujës nga Bushatllinjtë e Shkodrës (ato me frëngji pushke). Data e këtij rindërtimi duhet të ketë qenë shkruar në pllakën e gurtë, të vendosur mbi portë.[9]

Në të dy anët e mureve anësore të galerisë së dytë të bie në sy një fugë vertikale, (fig. 17), e cila përkonte me mbarimin e qemerit të ruajtur të galerisë (30-30'). Fugat na diktuan që galerinë e dytë të hyrjes ta vështrojmë në dy pjesë – në pjesën e parë të lidhur me portën e tretë (2-30-30'-2') dhe pjesën e dytë të lidhur me niket dhe portën e katërt (30-3-3'-30').

Muret anësore në pjesën e parë të galerisë paraqesin një teknikë ndërtimi të veçantë. Aty janë përdorur gurë relativisht të mëdhenj (grac, gëlqerorë, shtufi), të konceptuar në rreshta horizontale, mbushur me shumë copa gurësh të vegjël për nivelim e skuadrim në qoshet. Një nivelim tjetër më i qartë, horizontalisht u është bërë atyre në çdo dy ose tre rreshta gurësh, me gurë shtufi në formën e rrasave. Lidhësi, gjithashtu i ndryshëm nga strukturat e tjera të hyrjes krijon shpesh fuga të trasha llaçi. Tendenca e nivelimeve të dëndura të kujton më tepër natyrën

8) Pas zbulimit të portës së dytë, emrtimet e dy portave të tjera në vijim i kemi ndryshuar.

9) Vendin e pllakës e tregon një telajo e thelluar (50 x 70 cm) në murin mbi portë, në qendër të së cilës u gjet një copë hekuri e inkasuar në thellësi. Në kornizën e telajos shihen gurë të marrë nga ndërtime të mëparshme.

e teknikave të antikitetit të vonë, por këtu shihet prania e brezave të drurit. Në takimin me fugën, muret përfundojnë me qoshe të rregullta dhe kjo e veçon këtë pjesë të galerisë si kohë ndërtimi.

Pjesa e dytë e galerisë është e pajisur me nga dy nike për vendroje në secilën anë, (fig. 18), të mbyllura me qemere gjysmë cilindrike (hapësirë rreth 3,50 m). Dy niket e krahut të majtë nuk kanë lidhje me ambiente të tjerë. Ndërsa nikja e parë e krahut të djathtë krijon një hapësirë tjetër të vogël në brendësi, e mbyllur po ashtu me qemer gjysmë cilindrik. Ky ambient është në esencë një nike e vogël, bijë e nikes më të madhe, i krijuar me sa duket për zmadhimin e hapësirës së veprimeve të luftëtarëve në mbrojtje të portave. Një dukuri e tillë shihet edhe në galerinë e parë, ku nikja e djathtë është gjithashtu më e madhe dhe kjo ndoshta është kërkuar me qëllim, pasi krahu i djathtë i galerisë është më i gjatë dhe më i mundshëm për vërshimin e forcës kryesore të sulmit të armikut. Në murin fundor të nikes së dytë është lënë e hapur, qysh në ndërtimin origjinal, një hapësirë e kufizuar (0,75m), e cila komunikon prej këndej me ambientin me planimetri në formë kryqi (fig. 19). Pozicioni dhe përmasat e hapësirës së saj flasin më tepër për një «portëzë» komunikimi të rojeve kur portat e qytetit qëndronin të mbyllura. Domosdoshmëria e lëvizjes së luftëtarëve në këto kushte brenda galerive është evidente, për shumë probleme që lindin gjatë sulmit të armikut mbi portat e hyrjes. Në fugën vertikale midis dy pjesëve të galerisë (30 dhe 30') u vërejt se strukturat e pjesës së dytë i bashkangjiten të parës. Si gjurmë për këtë, shërben gjerësia mjaft e vogël e pilastrave (0,60 m) të nikeve, të cilat mbështeten në fugë. Po të mos kishin qenë muret e pjesës së parë të galerisë,



Fig. 16 Porta e tretë.



Fig. 17 Galeria e dytë, brendi, para restaurimit.

DO NOT COPY



Fig. 18 Galeria e dytë, nikja e parë, e vendrojeve në krahun e majtë.

kjo këmbë e nikes nuk mund të ishte bërë në asnjë rast aq e hollë, pasi konstruktivisht nuk qëndron.

Të gjithë qemerët e nikeve janë konstruktuar me dy këmisha gurësh çmërsi, të punuar imët dhe të puthitur mjaft mirë, një teknikë kjo që dallon nga



Fig. 19 Galeria e dytë, nikja me portëzën.

mbulesat e tjera të hyrjes. Prej portës së katërt ruheshin vetëm 5 copë gurë të gdhendur, të mbetur nga pragu dhe patura e majtë (pika 3). Në lartësi u rilevuan mbetjet e fillimit të një qemeri, i cili ka pasë qëndruar mbi portë. Ajo ka qenë gjithashtu dy kanatëshe. Mbetjet e paturës në krahun e majtë, treguan se kanatat, ashtu si edhe porta e dytë, hapeshin në anën e përparme të hyrjes. Nga matjet për rilevimin e shigjetës së harkut të qemerit të galerisë, rezultoi se ai ka qenë më i shtrirë se gjysmë cilindrik, me shigjetën e harkut të ndryshueshme, prej 77 cm në pjesën e saj më të ngushtë (30-30') dhe deri në 96 cm në pjesën më të gjerë (31-31'). Ai gjithashtu ka qenë ndërtuar me dy këmisha gurësh çmërsi.

4. **Ambienti me planimetri në formë kryqi** është i vetmi që lidhet me galerinë e dytë. Hyrja në të bëhet nga brendia e kalasë, nëpërmjet një porte të çelur në anën jugore. Ambienti formon në planimetri një kryq simetrik me gjatësi të krahut 6,85 m. Të katër krahët e kryqit mbulohen me qemere gjysmë cilindrike, ndërsa pjesa qëndrore me një kupolë gjysmë sferike, të mbështetur mbi katër pendentivë. Ambienti ka një dritare me hark në murin perëndimor dhe dy frëngji ndriçimi, njëra mbi lartësinë e kësaj dritareje, tjetra në faqen jugore mbi portë. Dritarja sot është e mbyllur me muraturë dhe kjo është bërë me rastin e ndërtimit më vonë të shkallëve (fig. 20) në faqen perëndimore të bastionit A[10]. Një numër dukurish nga pikëpamja e teknikës dhe materialit të përdorur në mure e mbulesa, të soliditetit dhe konstruksionit të muraturës, tregojnë se ambienti në fjalë është jo vetëm i një dore ndërtimi në pjesën jugore të galerisë së dytë, por edhe rezultat i të njëjtit projekt.

Përsa i takon funksionit të ambientit me planimetri në formë kryqi, janë shprehur disa mendime. Midis tyre S. Adhami mendoi se ai është përdorur si depo baruti, duke na kujtuar edhe tregimtarinë gojore, e cila thotë se ajo përdorej si burg[11]. Ndërsa Gj. Karaiskaj e shikon atë si kishë të tipit «kryq i lirë», të ndërtuar në shek. XII-XIII, duke përdorur si argument faktin se ky tip kishe ka patur përhapjen më të madhe në vendin tonë në këtë periudhë, si dhe dokumentin e viteve 1431-32, ku përmendet një

10) Shkallët të ngjisin në katin e dytë të bastionit nga brendia e kalasë. (Për gjendjen e tyre të mëparshme shih: **Projektin e restaurimit në vitin 1967,** K. Zheku, Dosja Kalaja e Krujës, Arkivi IM.K, Një foto e marrë në vitet e para të shekullit tonë (Th. Ippen, **Denkmaler,** f. 61), tregon se në këtë kohë shkallët kanë qenë të plota dhe në funksionim. Ato janë të palidhura dhe i mbështeten kullës rrethore dhe ambientit të truprojes. Për një kohë shumë të vonë të ndërtimit të tyre flet edhe teknika krejt e zakonshme e muraturës.

11) S. Adhami, **Gjurmime,** f. 89. Ky funksion i takon shekullit të fundit.

DO NOT COPY



Fig. 20 Kompleksi i hyrjes në anën JP (shkallët) në fillim të XX (marrë nga Th. Ippen).

kishë «brenda në kullë të Akçahisarit» (kalaja e Krujës)[12]. Lidhur me funksionin origjinal të këtij ambienti, një sondazh u krye në anën e jashtme të krahut jugor të kryqit (pranë portës), për të parë gjurmët e mbetjeve të ndonjë abside, por këtu me përjashtim të themelit të bastionit, nuk u pa asnjë lloj shenje, si dhe nga sondazhi tjetër që u bë ndën «portëzën». Po ashtu, sipërfaqet e mbulesave nuk tregojnë për ekzistencën e dikurshme të ndonjë suvatimi apo patine. Mungesa e këtyre elementeve nuk na bind aspak për identifikimin e tij si një kishë. Pavarësisht nga zgjidhja planimetriko-volumore kryq i lirë, gjatë mesjetës së mesme strukturat me qemere dhe kupola, si mjete konstruktive të kohës, dihet se janë përdorur edhe për ndërtime të tjera. Në këtë drejtim të bie në sy prezenca e mureve mjaft të trasha në tërë anën jugore të kompleksit të hyrjes (prej 2,00 deri 2,65 m), të cilat flasin se ky kompleks ka qenë parashikuar të mbrohej në vetvete edhe në rast se armiku arrinte të hynte në brendinë e kalasë. Kjo mund të spjegojë më tepër zgjedhjen e këtij tipi për nevojat e një ambienti të fortifikuar, se sa praninë e një kishe.

Përdorimi i këtij ambienti si depo baruti i takon padyshim një funksioni më të hershëm nga ai i periudhës së fundit për burg, por jo i fazës fillestare. Po të ishte kështu, ai duhet të qe projektuar plotësisht i izoluar nga çdo komunikim me galerinë[13]. Krijimi i portëzës qysh në projektin fillestar, e mjaftueshme kjo për kalimin e një njeriu në konditat e një fortifikimi të plotë, evidenton nevojën e komunikimit të ambientit me galerinë e dytë, kur portat e qytetit qëndronin të mbyllura. Ai mund të emërtohet kështu si ambienti i vendqëndrimit të rojeve. Përmasat e kufizuara të portëzës, krijonin mundësi që ajo të mbrohej prej sulmit të ushtarëve armiq, të cilët tashmë kishin arritur deri përpara portës së fu-



Fig. 21 Hyrja e kalasë së Krujës, kulla rrethore.

12) Gj. Karaiskaj. **5000 vjet fortifikime në Shqipëri.** Tiranë 1981, f. 162-165.

13) Nuk na duket bindëse, që truproja e portave të ketë patur të nevojshme një rezervë të tillë baruti, kur dihet se përdorimi i armëve të zjarrit prej luftëtarëve të mbyllur në galeri, ka qenë i kufizuar bile i pamundur.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 22 Hyrja e kalasë së Krujës, kati i parë (përpara gjurmimeve 1977).

pësirë cilindrike me thellësi 5,74 m dhe diametër 3,30 m, qendra e rrethit të të cilit, përputhet plotësisht me atë të rrethit të kullës (fig. 23). Nga sipër, kjo hapësirë cilindrike ka qenë mbuluar me një kupolë gjysmë sferike, e ndërtuar me dy këmisha gurësh çmërsi. Kupola ndahet prej murit perimetral të kullës me një hapësirë të ngushtë në trajtën e një galerie që i qarkohet asaj, e cila ka qenë e mbuluar me qemer të shtrirë po prej gurësh çmërsi. Brenda saj, me pak vështirësi, mund të qarkullonte një njeri në këmbë. Një funksion i tillë, kuptohet nga përdorimi për sterë uji i hapësirës cilindrike, për të cilën flasin prania e një cope tubi qeramik të murosur, me diametër 8 cm (43), që mblidhte ujërat e shirave dhe gjurmët e një dritareje të hapur në muraturën e kupolës (42), që ka shërbyer si grykë e sterës (fig. 24). Prej saj, uji nxirrej me anën e kovës.

Galeria e sterës ndiqet deri aty ku humbet muri perimetral i kullës (muri i hollë që shohim sot është ndërtuar kohët e vona). Nga disa pastrime të imta, mundëm të rilevonim vazhdimësinë e kësaj galerie në anën veriore dhe duket se ajo ka përshkruar një

ndit, por sigurisht kur ambienti nuk ishte një depozitë baruti.

5. **Kulla me seksion rrethor** formon ballin e bastionit të majtë të hyrjes (A), në anën veriperëndimore të kompleksit (fig. 21). Në pjesën e sipërme kulla ka formën e një cilindri, ndërsa poshtë zbret duke u zgjeruar në trajtën e një skarpati trung koni). Bazamenti i saj është krijuar nga dy unaza më të gjera murature dhe kulla ruan kështu lartësinë rreth 20 m (fig. 22).

Pjesa e sipërme cilindrike e kullës (diametër 11,70 m) e evidentuar prej punimeve të pastrimit të viteve 1966-67[14], është çpuar në brendi nga një ha-



Fig. 23 Kulla rrethore, planimetria pas gjurmimeve.

14) S. Adhami, **Gjurmime**, f. 87-90.

DO NOT COPY



Fig. 24 Kulla rrethore, gryka e sterës.



Fig. 25 Kulla rrethore, kati i parë — rikonstruksion grafik.

gjysmë rrethi (fig. 25). Përpara hyrjes së saj, me vështirësi dallohen mbetje shkallësh, që komunikonin me tarracën e kullës. Në anën jugore galeria merr dritë nga një frëngji, e cila shikon 45° në lartësi, me dalje në faqen jugore perimetrale të kullës. Nevoja për një ndriçim të tillë, tregon se galeria ka qenë krejtësisht e mbyllur. Mbetjet e kupolës së sterës tregojnë se pjesa mbi të ka qenë niveluar nga një tarracë, e cila ka shërbyer si dysheme e katit të dytë të kullës. Madje, në anën jugore, u lexua planimetria e një hapësire që e çpon tejpërtej murin perimetral, në formën e një katërkëndëshi këndrejtë, me dyshemenë fare pak të ngritur nga ajo e tarracës së kupolës. Aksi gjatësor i saj kalon plotësisht në qendrën e rrethit të kullës. Në faqen e jashtme të kullës, kjo hapësirë mbyllej në ballë nga një mur-perde me gjerësi 0,4 m dhe planimetri në formën e gërmës V. Këto elemente i takonin një frëngjie topi me shpatulla të drejta, me gjerësi të brendshme 1,30 m. dhe me gjerësinë e dritares së grykës së topit në fasadë rreth 0,30 m. Funksioni i kësaj frëngjie mbetet i paqartë, përderisa gryka e topit të saj shikon në brendinë e kalasë[15]. Më tepër mund të mendohet se funksioni i këtij topi ka qenë për të mbrojtur kullën në vetvete, në rast se kalaja do të binte në dorë të armikut.

Nëpërmjet shembujve të zbuluar, deri sot është pranuar se frëngjitë për top me shpatulla të drejta të ndërtuara njëherësh me kullat, i hasim kryesisht në fortifikimet e shek. XVI-XVII[16]. Në këtë drejtim, rasti i Krujës përbën shembullin më të hershëm të këtij tipi frëngjie dhe që për më tepër, mund të datohet me saktësi në vitet 1450-1451[17]. Ai tregon për mendimin tonë se ky tip frëngjie nuk përbën një zgjidhje rastësore të kushtëzuar nga nevoja e adaptimit (përshtatjes) të ndërtimeve më të hershme të kalave, siç është rasti i frëngjisë në kalanë e Drishtit[18], por një tip i formuar qartë dhe që preferohet qysh herët në ndërtimet e mirëfillta të fortifikimeve tona të artilerisë, krahas frëngjive të topave me ngushtim nga jashtë.

Në të dy anët e mureve anësore të saj dolën gjurmët e dy çifteve paturash (kanalesh) të thelluara cekët, ku me sa duket aty kanë qenë fiksuar kanate vertikale. Çifti i parë (0,50 m brenda murit ballor të

15) Me saktësi, aksi i frëngjisë shikon mbi rrugën e brendshme, kryesore të kalasë.

16) Gj. Karaiskaj, **Frëngjitë për topa në fortifikimet mesjetare, origjina dhe evolucioni i tyre,** në «Monumentet» 1, 1986, f. 99.

17) Si burim për datimin e kullës me seksion rrethor shërben njoftimi i Barletit, i cili thotë se një nga ndërtimet më të rëndësishme që kreu Skënderbeu në kalanë e Krujës direkt pas rrethimit të parë (1450), është ngritja nga themeli «i një pirgu shumë të madh dhe të fuqishëm pranë portës së qytetit». Megjithëse ai ishte i madh, spjegon Barleti, ndërtuesit «nuk nxuarrën mbi faqen e mureve përpara, por e lanë si më të ulët, me qëllim që të mos i shtrohej dëmit e t'u shmangej goditjeve të makinave. Ne, nga forma si të këmbës, e quajmë me një fjalë popullore të veçantë: scarpa» (M. Barleti, **Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut,** përkthyer nga S. Prifti, Tiranë 1964, f. 291). Fjalën «scarpa» autori e ka përkthyer «këpucë», por ka gjasë që ajo të ketë këtu kuptimin e «skarpatit» (pjerrësisë), siç është faqja ballore e kullës.

18) Gj. Karaiskaj, **Frëngjitë,** f. 99.

frëngjisë), tregon se ka qenë vendosur një kanat me trashësi 0,17 m, ndërsa çifti i dytë (akoma edhe 0,6 m më në brendësi), ka mbajtur një fletë më të hollë kanati (0,12 m). Si rast të ngjashëm mund t'i referohemi frëngjisë së madhe në kalanë e Kepit të Rodonit, me ndryshimin se këtu ndodhet vetëm një çift kanalesh dhe se njëri prej tyre, mjaft i thellë, lejon hapjen e portës nëpërmjet futjes së kanatit në thellësi të murit[19]. Në rastin e Krujës, kanatet janë të cekët dhe një mundësi analoge e fshehjes së kanatit në krahët nuk ekziston. Mund të supozohet se portat kanë qenë dy kanatëshe dhe se paturat në muret anësorë kanë shërbyer për mbërthimin e kasës së tyre. Por për mendimin tonë, mundësia më e madhe i takon që ato të kenë qenë me ngritje vertikale, pasi nuk duken gjurmë për ekzistencën e kasave në dyshemenë e frëngjisë. Ashtu si në frëngjinë e Kepit të Rodonit (1451-1463) edhe në frëngjinë jugore të kullës me seksion rrethor të kalasë së Krujës (1451--1452), prodhime këto të ndërtuesve të Skënderbeut, prezenca e portave ka të bëjë me mbylljen në rast nevoje të shtegut të kalimit të armikut brenda në kullë, në rast se ata do të arrinin të rrëzonin murin--perde në ballë të frëngjisë[20].

Gjurmët e një frëngjie të dytë topi u gjendën në anën lindore të kullës. Prej saj ruheshin vetëm mbetjet e murit të djathtë anësor dhe pjesërisht ai ballor. Muri anësor, më i gjatë nga ai i frëngjisë jugore (3,20 m), ndërpritej nga një hapësirë me gjerësi 0,80 m, ku u panë shenjat e një shkallareje, e cila dukej se të ngjiste në dyshemenë e një kati të tretë të kullës. Prej saj ruheshin vetëm tre shkeljet e para, por kuptohej se ajo zhvillohej në formë të lakuar. Madje, nga matjet u vërejt se ky lakim i korrespondonte rrezes së dalë nga qendra e rrethit të kullës. Të nisur nga parametrat e një shkeljeje dhe lartësia e përafruar prej 2 m të katit të dytë, na rezultoi se shkallarja ka patur 10 këmbë dhe ajo ka përfunduar mbi qemerin e frëngjisë jugore (fig. 26). Ky kompozim përkon edhe në planin e zgjidhjes më të mirë funksionale. Në frontin rrethor të kullës vendi i kësaj shkallareje zë harkun më të paangazhuar të luftimit. Ajo tregon, se mbi katin e frëngjive të kullës duhet të ketë funksionuar të paktën një platformë e hapur, e rrethuar me bedena.

Frëngjia lindore ka patur përmasa më të mëdha dhe ka qenë e destinuar për një top të kalibrit më të madh. Për rilevimin e plotë të saj u kërkua të përcaktohej aksi gjatësor. Muri mbyllës i frëngjisë puqej në kënd të drejtë me murin e ruajtur anësor. Duke hequr një paralele me këtë të fundit me pikënisje nga qendra e përafruar e grykës së topit rezultoi që ajo të kalonte nëpër qendrën e rrethit të kullës. Aksi i gjetur na dha mundësi të rilevonim për simetri pjesët munguese të krahut të majtë të frëngjisë, e cila rezultoi po ashtu e tipit me shpatulla të drejta, por me hapësirë drite të topit më të madhe nga ajo jugore. Prania e këtij tip frëngjie në kullën cilindrike të hyrjes së kalasë së Krujës, kur dihet se ato janë më pak rezistente ndaj artilerisë në krahasim me ato me ngushtim nga jashtë, vjen për mendimin tonë, nga pozicioni i lartë dhe mjaft i mbrojtur i tyre, ndaj kuotave të mundshme të sulmit të armikut. Bindjet për ekzistencën e frëngjive lindore na i shton edhe një dukuri tjetër — horizonti i poligonit që ka përpara. Gryka e topit të saj ka nën kontroll platformën e gjerë që krijohet përpara hyrjes deri në brigjet e rrugës së sotme të Pazarit të Vjetër, i cili ka qenë front kryesor i mësymjeve të osmanëve gjatë rrethi-



Fig. 26 Kulla rrethore, kati i dytë, — rikonstruksion grafik.

19) **Po aty,** f. 94.

20) Për rilevimin në lartësi të kësaj frëngjie topi, paraprakisht u evidentua kuota e dritares së frëngjisë së vogël të galerisë së sterës, në faqen perimetrale të kullës. Duke i shtuar të paktën edhe 0,4 m lartësi muraturës konstruktive për mbulesën e saj, rezultoi se kulla ka qenë rreth 3 m më e lartë nga mbetjet e sotme. Lartësia në brendi e frëngjisë së topit lëviz kështu në 1,40 — 1,50 m.

Do not COPY



Fig. 27 Kulla rrethore, sondazhi pranë frëngjisë jugore.

meve të Krujës. Nevoja për gryka zjarri në këtë sektor na jep të drejtë të supozojmë, se nga kjo pikë shikimi, edhe në dyshemenë e katit të tretë të kullës, duhet të ketë patur të paktën një të tillë. Pozicioni i frëngjisë lindore tregon gjithashtu, se në kohën kur ajo u ndërtua, muret e pjesëve të përparme të kompleksit të hyrjes (galeria e parë) kanë qenë mbajtur nën kuotën e saj. Po ashtu mund të supozohet prania të paktën e një frëngjie tjetër në krahun perëndimor të kullës, gryka e topit të së cilës të ketë patur nën kontroll terrenin përgjatë mureve të kësaj ane. Mbi këto të dhëna jemi përpjekur të hartojmë një rikonstruksion grafik të katit të parë, të dytë dhe të dyshemesë së katit të tretë të kullës cilindrike. Lidhur me këtë, u vu re se kulla ka qenë e pambuluar. Llaçi hidroizolues i sterës u gjend i shtruar edhe në dyshemenë e katit të dytë dhe në faqet e brendshme të murit perimetral të kullës, gjë që tregon se krejt ky kat ka patur edhe funksionin e ujëmbledhësit.

Ngjashmëria e teknikës dhe materialit të ndërtimit të kupolës së sterës dhe qemerit të galerisë së saj, me mbistrukturat e ambientit të rojeve dhe të nikeve të galerisë së dytë, na detyroi të ndërmerrnim një sondazh për të verifikuar nëse këto struktura i takonin apo jo të njëjtës periudhë ndërtimi. Ai u krye pranë frëngjisë jugore, ku u pa se deri në thellësinë 1,80 m të sondazhit, kulla e ruante muraturën e rregullt, e cila të linte përshtypjen se dikur kjo pjesë e sipërme e saj kishte qenë e ekspozuar (fig. 27). Më poshtë u gjend një shtresë e niveluar harasani, e cila vazhdonte e tillë në brendësi të muraturës së mbulesave të ambientit të rojeve. Në takimin me faqen e kullës, kjo shtresë harasani i mbivishej asaj duke u ngritur lart në formën e një gjuhe, ashtu siç mbyllen vendet e bashkimit të një tarrace me një mur vertikal. Ndën këtë shtresë, qëndron në faqen e kullës, një rrip i dallueshëm murature, ku u gjendën gurë lidhës me muraturën e ambientit të rojeve, që flisnin për të njëjtën kohë ndërtimi të strukturave në fjalë. Akoma më në thellësi hasëm me një shtresë të dytë, harasani në anën e ambientit të rojeve, por kësaj radhe shtresa nuk lidhej me faqen e kullës. Të dy këto shtresa u takonin mbulesave të ambientit të rojeve (fig. 28).

Këto gjurmime treguan se kulla me seksion rrethor, ambienti i truprojës dhe hapësira e fundit e ga-

DO NOT COPY



Fig. 28 Kulla rrethore, dhe ambienti vendrojes, gjurmët pas sondazheve (prerje gjatësore).



Fig 29 Kulla rrethore dhe ambienti vendrojes – rikonstruksion grafik i fazës origjinare, mesi i shek. XV (prerje tërthore).

lerisë së dytë përbëjnë një periudhë të veçantë ndërtimore të kompleksit të hyrjes[21]. Ato janë të lidhura në mënyrë të sigurtë me punimet që Skënderbeu kreu pas dëmtimeve masive që pësoi kalaja e Krujës në rrethimin e parë dhe në veçanti hyrja e saj, si një prej pikave kryesore të sulmeve të pareshtura të armikut[22]. Ndëhyrjet ndërtimore të kohës së tij jo vetëm e rritën në mënyrë të konsiderueshme fuqinë mbrojtëse të saj, por sollën diçka të re në artin e të ndërtuarit të fortifikimeve – arkitekturën e artilerisë me barot (fig. 29).

6) **Muri i portës së tretë të hyrjes** meritoi vëmendje, fillimisht për marrëdhëniet me kullën cilindrike. Prej një sondazhi (fig. 30) u pa se ai i futej kullës në brendësi, duke treguar se ishte i një faze më të hershme nga kulla cilindrike dhe se përpara ndërtimit të saj, ai kishte pasë vazhduar më tej në këtë anë (në drejtim të pikës 39). Dy sondazhe të tjera nxorën në dukje, se faqet e murit të portës së tretë ndaheshin me fugë të qartë nga strukturat, që i qëndronin atij në anën veriore (të përparme) dhe në atë jugore (të mbrapme), për të cilat rezultoi se i qenë mbështetur si ndërtime të mëvonshme. Kështu, stratigrafikisht, ai ishte një nga konstruksionet më të hershme të kompleksit të hyrjes.

7. **Banesa mbi bastionin e majtë të hyrjes** (B) (me shtrirje 193 m^2), kishte një planimetri formën e germës P, me bishtin e drejtuar nga jugu. Në tri anët, veriore, perëndimore e jugore, muret e saj ngriheshin në buzët e strukturave të katit të parë të bastionit (fig. 31, 32). Pjesa veriore e saj mbulohej me çati druri e tjegulla vendi, ajo jugore mbulohej nga një tarracë b/arme e ndërtuar përpara disa dekadash. Meqenëse banesa pengonte gjurmimin e tërë strukturave më të hershme të bastionit të majtë, u desh të mbahej qëndrimi vlerësues i saj. Ajo i takonte periudhës së fundit ndërtimore të kompleksit (shek. XVIII-XIX), kur qyteti i Krujës u shtri në varoshin e tij dhe kalaja e humbi funksionin e dikurshëm të fortifikimit kolektiv qytetar. Mbi muret e kalasë mesjetare, u dukën në këtë kohë banesat e qytetarëve të veçantë. Studimi tregoi se banesa ruante tri faza ndërtimi (fig. 33). Prej strukturave të fazës së parë ishin

21) Mundësia që ambienti i rojeve dhe niket e krahut të djathtë të galerisë së dytë të jenë ndërtuar më parë, përjashtohet nga fakti se ato i mbështeten kullës cilindrike jo me faqe të rregullt, por me muraturë mbushjeje. Madje, këto struktura mbështetëse janë fare të holla (0,4), sa nuk mund të kuptohet që të jenë ndërtuar të tilla, po të mos i mbështeteshin një muri egzistues. Nga ana tjetër prania e muraturës lidhëse të kullës është

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 30 Sondazhi midis murit të portës së tretë dhe kullës rrethore.



Fig. 31 Banesa mbi bastion e majtë.

edhe muret 31 – 45 dhe 3 – 49, të cilat lidheshin dikur mbi hapësirën e qemerit të galerisë. Rezultoi kështu, që banesa me pamjen e sotme të jetë ngritur si rrudhje e strukturave të katit të dytë të kompleksit të hyrjes, pas prishjes së qemerit të galerisë, gjë e cila duhet të ketë ndodhur jo më vonë se gjysma e shek. XVIII. Nevojat për restaurimin e qemerit të galerisë së dytë, i bënë të domosdoshme çlirimet e mureve të fazës së dytë e të tretë të banesës. Prej fazës së dytë u ruajt vetëm një pjesë e murit 2-48, për arsye të



Fig. 32 Bastioni i majtë (prerje tërthore përpara ndërhyrjeve)

dëshmi e qartë e avancimit të njëkohshëm në lartësi të saj me muraturën e ambientit të rojeve. Me këtë rast vemë në dukje se prezenca e frëngjisë jugore dhe e dy shtresave të harasanit të ambientit të rojeve, treguan se në periudhën origjinale të ndërtimit, në anën jugore të kompleksit nuk ka ekzistuar një kat i dytë.

22) M. Barleti, **Historia,** f. 250.

qëndrueshmërisë statike të strukturave të ambientit kryesor të banesës.

8. **Gërmimet në brendësi të bastionit të majtë** (B) u shtrinë në të gjithë sipërfaqen e tij (fig. 34). Fillimisht ato u kryen në anën perëndimore të bastionit në dy hapësira (31 – 3 – 54 – 46 dhe 31 – 45 – 47 – 2) dhe më pas në brendinë e ambientit kryesor (45 – 47 – 5 – 46).

Në hapësirën e parë të gërmimit, mbi niket e galerisë, u ndeshëm me një shtresë harasani, kuota e së cilës përkonte plotësisht me atë të gjendur mbi ambientin e rojeve (fig. 35). Në pjesën jugore, mbi të u dukën mbetjet e një blloku murature (55-56) që tregoi se në një kohë më të vonë, dyshemetë e krijuara fillimisht mbi niket e galerisë, ishin ngritur në lartësi. Në anën lindore, u gjend në thellësi një fragment i një dyshemeje prej harasani mbi kalldrëm. Gjithashtu u pa se muri (45-47) i banesës ngrihej mbi qemerin e një galerie të improvizuar, të mbështetur në njërin krah mbi murin e nikes së parë, ndërsa në anën tjetër, mbi mbetjet e një muri më të hershëm (57-59). Kjo galeri hynte në thellësi duke u ngushtuar në formën e një pyke dhe mbyllej me murin e nikes së parë (në pikën 60). Muri i hershëm (57-60) ishte ndërprerë nga ndërtimi i galerisë së dytë. Së bashku me krahun tjetër të tij (57-58), ato përbënin mbetjet e një ambienti të dikurshëm të hyrjes, më të hershëm se koha e ndërtimit të galerisë së dytë. Si dëshmi tjetër, që zbulimi i fragmentit të ujësjellësit. Nga nevoja për kalimin e tubacjionit, muri në fjalë ishte çpuar në pjesën e poshtme dhe meremetuar përsëri. Duke ditur tashmë vitin 805 h. (1402-1403) të ndërtimit të këtij ujësjellësi, sipas mbishkrimit më të vjetër të çezmës së kalasë[23], rezulton, pra



Fig. 33 Muret e fazës së parë të banesës.

23) Prej gjurmimeve tona, del se truallin e kalasë e kanë përshkuar dy sisteme ujësjellësish, njëri me tuba të shkurtër qeramike (gjatësi 24 cm), tjetri me tuba më të gjatë (34 cm), të cilat u takojnë kohëve të ndryshme ndërtimi. Për datimin e tyre, shërbejnë dy mbishkrimet në gur që ndodhen në çezmën e kalasë, përpara kompleksit të hyrjes. Sipas Ippenit, njëri prej mbishkrimeve lajmëron sjelljen e ujit nga veziri i madh osman i shek. XV, Gazi Evrenozi, në vitin 850 të hexhirës, që sipas autorit i takon vitit 1446. Por vetë ai nuk i beson kësaj date të mbishkrimit, duke arsyetuar se më 1446 Kruja ishte nën zotërimin e Skënderbeut dhe se për më tepër Evrenozi i përmendur, nuk jetonte më (**Denkmaler,** f. 62-63). Ndërsa sipas arsimtarit krutan H. Korbi, mbishkrimi tregon se çezma është ndërtuar në vitin gregorian 1434 (H. Korbi **Krueja,** në «Leka», Maj 1933, f. 145-147). Shënojmë se viti 1434, i supozuar nga H. Korbi është i saktë po të llogaritet viti 850 i mbishkrimit me kalendarin greko-bizantin (shih për këtë edhe V. Buharaja. **Mbishkrime turko-arabe në vendin tonë.** Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë – dorëshkrim), por edhe kjo nuk mund të pranohet. Arsyeja qëndron në faktin se ky kalendar nuk përdorej në periudhën në shqyrtim dhe se Gazi Evrenozi, nuk jetonte më.

Në mbishkrimin e çezmës ka mundësi që të jetë skalitur gabimisht 850 në vend të

DO NOT COPY



Fig. 34 Bastioni i majtë i hyrjes së kalasë pas gjurmimeve.

DO NOT COPY



Fig. 28 Kulla rrethore, dhe ambienti vendrojes, gjurmët pas sondazheve (prerje gjatësore).



Fig 29 Kulla rrethore dhe ambienti vendrojes – rikonstruksion grafik i fazës origjinare, mesi i shek. XV (prerje tërthore).

lerisë së dytë përbëjnë një periudhë të veçantë ndërtimore të kompleksit të hyrjes[21]. Ato janë të lidhura në mënyrë të sigurtë me punimet që Skënderbeu kreu pas dëmtimeve masive që pësoi kalaja e Krujës në rrethimin e parë dhe në veçanti hyrja e saj, si një prej pikave kryesore të sulmeve të pareshtura të armikut[22]. Ndëhyrjet ndërtimore të kohës së tij jo vetëm e rritën në mënyrë të konsiderueshme fuqinë mbrojtëse të saj, por sollën diçka të re në artin e të ndërtuarit të fortifikimeve – arkitekturën e artilerisë me barot (fig. 29).

6) **Muri i portës së tretë të hyrjes** meritoi vëmendje, fillimisht për marrëdhëniet me kullën cilindrike. Prej një sondazhi (fig. 30) u pa se ai i futej kullës në brendësi, duke treguar se ishte i një faze më të hershme nga kulla cilindrike dhe se përpara ndërtimit të saj, ai kishte pasë vazhduar më tej në këtë anë (në drejtim të pikës 39). Dy sondazhe të tjera nxorën në dukje, se faqet e murit të portës së tretë ndaheshin me fugë të qartë nga strukturat, që i qëndronin atij në anën veriore (të përparme) dhe në atë jugore (të mbrapme), për të cilat rezultoi se i qenë mbështetur si ndërtime të mëvonshme. Kështu, stratigrafikisht, ai ishte një nga konstruksionet më të hershme të kompleksit të hyrjes.

7. **Banesa mbi bastionin e majtë të hyrjes** (B) (me shtrirje 193 m^2), kishte një planimetri formën e germës P, me bishtin e drejtuar nga jugu. Në tri anët, veriore, perëndimore e jugore, muret e saj ngriheshin në buzët e strukturave të katit të parë të bastionit (fig. 31, 32). Pjesa veriore e saj mbulohej me çati druri e tjegulla vendi, ajo jugore mbulohej nga një tarracë b/arme e ndërtuar përpara disa dekadash. Meqenëse banesa pengonte gjurmimin e tërë strukturave më të hershme të bastionit të majtë, u desh të mbahej qëndrimi vlerësues i saj. Ajo i takonte periudhës së fundit ndërtimore të kompleksit (shek. XVIII-XIX), kur qyteti i Krujës u shtri në varoshin e tij dhe kalaja e humbi funksionin e dikurshëm të fortifikimit kolektiv qytetar. Mbi muret e kalasë mesjetare, u dukën në këtë kohë banesat e qytetarëve të veçantë. Studimi tregoi se banesa ruante tri faza ndërtimi (fig. 33). Prej strukturave të fazës së parë ishin

21) Mundësia që ambienti i rojeve dhe niket e krahut të djathtë të galerisë së dytë të jenë ndërtuar më parë, përjashtohet nga fakti se ato i mbështeten kullës cilindrike jo me faqe të rregullt, por me muraturë mbushjeje. Madje, këto struktura mbështetëse janë fare të holla (0,4), sa nuk mund të kuptohet që të jenë ndërtuar të tilla, po të mos i mbështeteshin një muri egzistues. Nga ana tjetër prania e muraturës lidhëse të kullës është

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 30 Sondazhi midis murit të portës së tretë dhe kullës rrethore.



Fig. 31 Banesa mbi bastion e majtë.

edhe muret 31 – 45 dhe 3 – 49, të cilat lidheshin dikur mbi hapësirën e qemerit të galerisë. Rezultoi kështu, që banesa me pamjen e sotme të jetë ngritur si rrudhje e strukturave të katit të dytë të kompleksit të hyrjes, pas prishjes së qemerit të galerisë, gjë e cila duhet të ketë ndodhur jo më vonë se gjysma e shek. XVIII. Nevojat për restaurimin e qemerit të galerisë së dytë, i bënë të domosdoshme çlirimet e mureve të fazës së dytë e të tretë të banesës. Prej fazës së dytë u ruajt vetëm një pjesë e murit 2-48, për arsye të



Fig. 32 Bastioni i majtë (prerje tërthore përpara ndërhyrjeve)

dëshmi e qartë e avancimit të njëkohshëm në lartësi të saj me muraturën e ambientit të rojeve. Me këtë rast vemë në dukje se prezenca e frëngjisë jugore dhe e dy shtresave të harasanit të ambientit të rojeve, treguan se në periudhën origjinale të ndërtimit, në anën jugore të kompleksit nuk ka ekzistuar një kat i dytë.

22) M. Barleti, **Historia**, f. 250.

qëndrueshmërisë statike të strukturave të ambientit kryesor të banesës.

8. **Gërmimet në brendësi të bastionit të majtë** (B) u shtrinë në të gjithë sipërfaqen e tij (fig. 34). Fillimisht ato u kryen në anën perëndimore të bastionit në dy hapësira (31 – 3 – 54 – 46 dhe 31 – 45 – 47 – 2) dhe më pas në brendinë e ambientit kryesor (45 – 47 – 5 – 46).

Në hapësirën e parë të gërmimit, mbi niket e galerisë, u ndeshëm me një shtresë harasani, kuota e së cilës përkonte plotësisht me atë të gjendur mbi ambientin e rojeve (fig. 35). Në pjesën jugore, mbi të u dukën mbetjet e një blloku murature (55-56) që tregoi se në një kohë më të vonë, dyshemetë e krijuara fillimisht mbi niket e galerisë, ishin ngritur në lartësi. Në anën lindore, u gjend në thellësi një fragment i një dyshemeje prej harasani mbi kalldrëm. Gjithashtu u pa se muri (45-47) i banesës ngrihej mbi qemerin e një galerie të improvizuar, të mbështetur në njërin krah mbi murin e nikes së parë, ndërsa në anën tjetër, mbi mbetjet e një muri më të hershëm (57-59). Kjo galeri hynte në thellësi duke u ngushtuar në formën e një pyke dhe mbyllej me murin e nikes së parë (në pikën 60). Muri i hershëm (57-60) ishte ndërprerë nga ndërtimi i galerisë së dytë. Së bashku me krahun tjetër të tij (57-58), ato përbënin mbetjet e një ambienti të dikurshëm të hyrjes, më të hershëm se koha e ndërtimit të galerisë së dytë. Si dëshmi tjetër, qe zbulimi i fragmentit të ujësjellësit. Nga nevoja për kalimin e tubacjionit, muri në fjalë ishte çpuar në pjesën e poshtme dhe meremetuar përsëri. Duke ditur tashmë vitin 805 h. (1402-1403) të ndërtimit të këtij ujësjellësi, sipas mbishkrimit më të vjetër të çezmës së kalasë[23], rezulton, pra



Fig. 33 Muret e fazës së parë të banesës.

23) Prej gjurmimeve tona, del se truallin e kalasë e kanë përshkuar dy sisteme ujësjellësish, njëri me tuba të shkurtër qeramike (gjatësi 24 cm), tjetri me tuba më të gjatë (34 cm), të cilat u takojnë kohëve të ndryshme ndërtimi. Për datimin e tyre, shërbejnë dy mbishkrimet në gur që ndodhen në çezmën e kalasë, përpara kompleksit të hyrjes. Sipas Ippenit, njëri prej mbishkrimeve lajmëron sjelljen e ujit nga veziri i madh osman i shek. XV, Gazi Evrenozi, në vitin 850 të hexhirës, që sipas autorit i takon vitit 1446. Por vetë ai nuk i beson kësaj date të mbishkrimit, duke arsyetuar se më 1446 Kruja ishte nën zotërimin e Skënderbeut dhe se për më tepër Evrenozi i përmendur, nuk jetonte më (**Denkmaler,** f. 62-63). Ndërsa sipas arsimtarit krutan H. Korbi, mbishkrimi tregon se çezma është ndërtuar në vitin gregorian 1434 (H. Korbi **Krueja,** në «Leka», Maj 1933, f. 145-147). Shënojmë se viti 1434, i supozuar nga H. Korbi është i saktë po të llogaritet viti 850 i mbishkrimit me kalendarin greko-bizantin (shih për këtë edhe V. Buharaja. **Mbishkrime turko-arabe në vendin tonë.** Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë – dorëshkrim), por edhe kjo nuk mund të pranohet. Arsyeja qëndron në faktin se ky kalendar nuk përdorej në periudhën në shqyrtim dhe se Gazi Evrenozi, nuk jetonte më.

Në mbishkrimin e çezmës ka mundësi që të jetë skalitur gabimisht 850 në vend të

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 34 Bastioni i majtë i hyrjes së kalasë pas gjurmimeve.



Fig. 35 Gjendja pas gjurmimeve në hapsirën e parë (prerje tërthore).





Fig. 36 Mbetjet e murit të portës, së tretë dhe të fugave që e ndajnë atë nga qemeri i galerisë.

DO NOT COPY

vitit 805 hixhri, sepse në grafinë arabe këto dy shifra kanë një farë ngjashmërie. Në fakt, në vitin 805 hixhri, i cili fillonte në gusht 1402 dhe mbaronte në korrik 1403, Gazi Evrenozi ishte gjallë. Veçse deri tani nuk dihet që në vitin 1402-1403, Kruja të ketë qenë nën sundimin osman. Megjithatë, mundësia që Kruja të ketë patur, të paktën një garnizon osman, nuk duhet të përjashtohet **a priori.** Jemi në vitin e betejës së Ankarasë (1402) kur turqit osmanë kishin depërtuar thellë në drejtim të Shqipërisë dhe mjaft zotër feudalë shqiptarë ishin shpallur vasalë të sulltanit osman. Madje, disa prej tyre, midis të cilëve thuhet se ishte edhe Gjon Kastrioti, morën pjesë si vasalë të sulltan Bajazitit në betejën e Ankarasë, kundër hordhive mongole të Timurlengut.

Në bazë të shqyrtimeve në terren u pa se sistemi i hershëm i ujësjellësit ishte ai me tuba më të shkurtër, i ndërtuar në vitin 1402-1403 (805 h). Ndërsa sistemi i dytë, me tuba më të gjatë, i takon mbishkrimi i dytë, viti i të cilit sipas V. Buharasë është 1834-1835 (1250 h). Tubacioni i zbuluar në hyrjen e kalasë i takon sistemit të parë të ujësjellësit.



Fig. 37. Mbetjet e strukturave në hapsirën e parë e të dytë të gërmimit (prerje gjatësore).



Fig. 38. Gjendja pas gjurmimeve në hapsirën e dytë dhe të tretë.

që këto mbetje të jenë më të hershme se viti 1403.

Në hapësirën e dytë të gërmimit, doli në evidencë vazhdimësia e murit të portës së tretë (30-61). Faqja jugore e tij ishte e suvatuar dhe ai vazhdonte në thellësi. Kjo tregoi përfundimisht se strukturat e nikeve i qenë mbështetur atij (fig. 36, 37). I njëjti suvatim u vërejt edhe në faqen e jashtme të tij (2-64), ku doli se në të, qe mbështetur edhe galeria e parë. Muri i portës së tretë rezultoi kështu më i hershëm nga strukturat me tulla të galerisë së parë, të cilave deri më sot u është atribuar vjetërsia më e madhe (shek. XI-XII)[24]. Këtu bën përjashtim qemeri i portës së tretë, i cili u pa nga gërmimi i palidhur me murin e hershëm dhe i njëkohëshëm me portën e tretë (rindërtimet e Toptanëve, gjysma e dytë e shek. XVIII). Në anën lindore, mbetjet e murit të portës së tretë, tregonin se dikur ai mund të kishte vazhduar në vijë të drejtë deri në ekstremin lindor të kompleksit, ku fillojnë muret rrethuese të kalasë.

Në stratigrafinë e varfër të gërmimit me interes u paraqit një shtresë e përbërë nga copa të pikturës murale, e cila u konkretizua më tej me zbulimin e një kishe në hapësirën e tretë të gërmimit. Muri verior i saj (65-71) me mbetje të pikturës, murale u gjend i puthitur

24) Gj. Frashëri. **Problemi i restaurimit të oborrit të fortifikuar të kalasë së Krujës,** «Monumentet» 12, 1976; A. Ducellier. **La facade maritime de l'Albanie au Moyen age.** Thessaloniki 1981, f. 14.

DO NOT COPY

pas faqes së brendshme të murit të korridorit të hyrjes (fig. 38, 39, 40, 41). Ai vinte duke u ngushtuar drejt qoshes 65 dhe kjo ishte bërë me sa duket për t'i ruajtur një orientim të caktuar ndërtesës. Nga ana e brendshme, atij i puthitej një mur tjetër, prej të cilit ruhej vetëm rreshti i poshtëm i gurëve, i palidhur në krahët, me pamjen e një muri – mveshës (fig. 42). Struktura tjetër anësore e ndërtesës së kishës u gjend në anën jugore (59-74). Në mes të gjatësisë muri ndërpritej nga një prishje deri në themel, e shkaktuar prej nevojës së kalimit të tubacionit më të vjetër të ujësjellësit të kalasë. Kjo tregonte se muri i kishës ishte më i hershëm nga koha e ndërtimit të ujësjellësit dhe se paskësaj ndërhyrje, ai nuk kishte funksionuar më. Në anën perëndimore, muret anësore ishin të lidhura me mbetjet e një muri 0,60 m gjerësi (62-65), në mes të hapësirës të të cilit, ruheshin gjurmët e një pragu porte, i shtruar me rrasa guri shtufor. Dyshemeja e kishës, e meremetuar, ishte shtruar me tre lloj materialesh, me tulla (24,5 x 23 x 4 cm) dhe rrasa shtufi në forma jo të rregullta në anën perëndimore, ndërsa me harasan në anën lindore. Kuota e saj përkonte me atë të dyshemeve mbi mbulesat e nikeve dhe kjo tregonte se kisha ekzistonte në kohën e ndërtimit të galerisë së dytë dhe se ndërtuesit kishin përshtatur një platformë komunikimi midis tyre. Mbi dyshemenë e kishës, u gjendën edhe tri mbetje muresh. Njëri (75-76) e coptonte në më tepër se një të tretën hapësirën e sallës dhe qëndronte i ndarë nga strukturat e tjera të zbuluara. Faqja e tij ishte e rrafshuar në formën e një suvatimi. Në anën tjetër të dëmtuar, u vunë re gjurmët e disa brezave horizontalë të skuadruar me seksion relativisht të madh (10 x 12 cm), në krahasim me nevojat konstruktive të këtij muri. Duket se ato kishin shërbyer për të mbajtur një konstruksion druri me ndonjë funksion të veçantë prej adaptimit të ndërtesës në një periudhë të mëvonshme. Struktura tjetër (78-79-80-81) ishte akoma më e rrënuar. Madje, në fragmentin 79-80-81, kishin mbetur në dysheme vetëm shenjat e lëna të një muri. Ai i mbështetej murit të vjetër anësor të kishës dhe ngjasonte me murin (75-76). Midis tyre ishte lënë një hapësirë kalimi prej 0,75 m. Struktura e fundit (71-72), ishte gjithashtu e palidhur me murin anësor verior. Me interes u vërejt se fragmenti (80-81) përkonte në drejtim me të dhe ngjasonte në materialin e ndërtimit, duke treguar se ato i takonin mureve anësore të absidës. Prej tyre



Fig. 39. Hapsira e tretë e gërmimit, zbulimi i strukturave të kishës dhe i ujësjellësit.

mund të ndërtohej një gjysmë rrethi me diametër plot 2 m. Sigurisht që ky rilevim i murit lindor të kishës nuk i takonte fazës së parë ndërtimore, jo pse drejtimi i tij nuk është në kënd të drejtë me muret anësore të saj, por sepse në mbetjet e murit (79-80-81) nuk u gjend asnjë shenjë dëmtimi apo riparimi e krijuar nga instalimi i ujësjellësit. Madje, një gjurmë tjetër për këtë ishin edhe mbetjet e tryezës së altarit. Drejtimi i faqes së përparme të saj qëndronte perpendikularisht me muret e jashtme anësore të ndërtesës dhe se i tillë duhet të ketë qenë edhe drejtimi i murit të absidës në një fazë të mëparshme[25]. Së

25) Vendndodhja e murit të absidës të kësaj kohe u pa e mundshme nga ana jonë. Si mbështetje për këtë na shërbeu shqyrtimi i murit jugor të kishës në pikën 73, ku ende nuk dukeshin gjurmët e qoshes së tij. Ai konsistoi në ruajtjen e gjerësisë prej 2,90 m vendosjes së murit të absidës përpendikular me ato anësore të kishës. Sipas këtij modelimi, hapësira e brendshme e sallës së faltores fiton përmasat 6,50 x 4,10 m (pa llogaritur absidën).

DO NOT COPY



Fig. 40. Stratigrafia e tre hapësirave të gërmimit.

fundi, nën dyshemenë e kishës u gjend një varr në ekstremin JP të saj (95), i ndërtuar me mure të rregullta dhe me orientim LP. Stratigrafia e gërmimit mbi dyshemenë e kishës na tregoi për një djegie masive, e cila vjen në kohë pas rindërtimit të fundit të saj.

Në themelin e murit perëndimor të kishës, u evidentuan mbetjet shumë fragmentare të një muri (93--68-64-94) me gjerësi 0,60 m, i palidhur me të. Stratigrafikisht, ai i përkiste një ndërtimi më të hershëm prej mureve të shqyrtuar deri më tani të kishës. Madje, ai ndryshonte prej tyre edhe nga materiali i ndërtimit, realizuar me gurë grac të madhësive mesatare dhe lidhur me llaç me ngjyrë rozë, një dukuri e rrallë kjo në ndërtimet e kalasë. Njëra faqe e tij (94-64), ishte vazhdimi i asaj të murit të portës së tretë (51-64), gjë e cila nuk mund të ishte rastësi. Ky drejtim përkonte pak a shumë edhe me ato të mureve anësore të kishës të ndërtuara më vonë. Për mendimin tonë, kjo strukturë i takonte një kishe akoma më të hershme, e lidhur me kohën e rrudhjes së murit të portës së tretë, prej fortifikimit, të mëtejshëm të bastionit në anën e përparme.

DO NOT COPY



Fig. 41. Hyrja e kalasë së Krujës, mbetjet e bastionit të majtë dhe të kullës C pas gjurmimeve (prerje gjatësore).

DO NOT COPY

Në krahun tjetër të murit perëndimor të kishës, qëndronte një mbushje e vonë muri në formë pilastri (62-63). Faqja veriore e tij ruante një rrafsh me faqen e paturës së derës së kishës. Ndën pilastrin u gjend një vrimë e rregullt, e cila tregonte për ekzistencën e dikurshme të një trau druri (me seksion 25 x 25 cm), i shtrirë përpara pragut të derës së kishës. Ai dukej se lidhej me bazamentin e ndonjë shkalle druri, e cila në një periudhë të vonë do të ketë siguruar kalimin prej pjesës së sipërme të murit të portës së tretë, në brendësi të bastionit, kur është mbyllur komunikimi me platformën e krijuar mbi tarracën e nikeve (prej ngritjes së nivelit të saj). Me çlirimin e pilastrit, u pa se faqja e jashtme e murit perëndimor të kishës kishte qenë e suvatuar dhe e ngjyrosur, çka donte të thoshte se dikur ajo kish qenë e ekspozuar. Madje, suvatimi vazhdonte në thellësi, duke treguar se substruksionet që ndodheshin midis murit të kishës dhe murit të portës së tretë ishin mbushje më të vona. Ndërsa pjesa e muraturës ndën pragun e derës, pa suvatim, ishte e tjetërsuar në teknikën e ndërtimit dhe kjo tregonte se fillimisht dera e kishës kishte qenë në një kuotë më të ulët nga e sotmja, çka përputhej edhe me të dhënat e një sondazhi në dyshemé[26]. Ngritja në kuotë e derës ekzistuese, respektivisht edhe të dyshemesë së sotme, lidhet me kohën e ndërtimit të nikeve të galerisë së dytë.

Në mesin e hapësirës së sallës së kishës u zbuluan edhe dy kollona (77 dhe 78), të përfshira më vonë brenda mureve të shqyrtuar. Në pjesën e poshtme të tyre, u gjendën fragmente të pikturës murale. Llaçi i tyre rakordohej me rrasat e tullat e dyshemesë, të cilat respektonin vendet e kollonave. Nga kjo kuptohej se kollonat ishin të njëkohshme me dyshemenë e gjetur nga gërmimi.

Nëpërmjet shqyrtimit të hollësishëm të mbetjeve shumë të pjesshme të kishës, kemi mundur të përcaktojmë katër periudha kryesore ndërtimi të saj (fig. 43). Nga periudha origjinale kemi vetëm fragmentin e murit (64-94-93-68), gjurmimi i mëtejshëm i të cilit është hëpërhë i pamundur. Të periudhës së dytë, ose më mirë të fazës së parë për faltoren e themeluar

26) Ai u krye pranë murit 79-80, prej të cilit dolën një numër i konsiderueshëm copash afresku, nga rezultoi se kisha kishte patur më parë një dysheme, nën kuotën e asaj të shfaqur nga gërmimi.



Fig. 42. Kisha mbi bastionin e majtë të hyrjes, planimetria.

në truallin e së vjetrës, janë muret perimetrale të kishës (70-65-71, 65-62 dhe 62-74-73) dhe dy kollonat. Ngritja e kësaj faltoreje të re, mbetet tërësisht e lidhur me kohën e ndërtimit të murit të korridorit të hyrjes, i cili duket se ka sjellë nevojën e një risistemimi të objekteve funksionale të brendisë së bastionit. Sipas datimit të murit të korridorit të hyrjes, themelimi i kishës së re, i takon shek. XIV. Faqja e jashtme e murit perëndimor në këtë kohë ka qen e ekspozuar deri në një kuotë më të poshtme ng e sotmja. Përpara saj ka patur një hapësirë komu nikimi dhe dera ka qenë në një kuotë më të ulë Ngjitja në të është realizuar detyrimisht me shkall të ndërtuara në anën jugore.

Ndërtimi i ujësjellësit të kalasë në vitin 1402 -1403, duket se ka sjellë ndryshime jo vetëm për ki shën, por edhe për murin lindor të bastio nit, i cili zgjerohet. Në këtë fazë të dytë, hapësira sallës së kishës zvogëlohet (5,30 x 3,25 m), duke ruajtur deri diku simetrinë e mëparshme. Tashmë mu ri i vjetër jugor i kishës braktiset. Muri i absidës hy në brendësinë e sallës rreth 1,25 m, ndërsa në të d krahët e tij ndërtohen perde të reja muresh anësore puthitur pas atyre më të vjetrave. Muri i ri në anër jugore (79-80), kthehet në mes të hapësirës dhe li dhet me njërën nga kollonat (78), duke krijuar një lloj izolimi të hapësirës JP, e përdorur për varrezë. Perdja tjetër, e cila i puthitet murit verior (71-65), nuk shihet të jetë ndërtuar për ndonjë arsye konstruktive, por vetëm për efekt ruajtje simetrie, të sallës së re të kishës. Zgjerimi i murit lindor të bastionit, bëhet i pranueshëm nga vetë pozicioni i tij strategjik. Së bashku me kullën C, ato kanë qenë strukturat më të ekspozuara në frontin e sulmit të armikut, por me një ndryshim. Ndërsa pushtimi i kullës C nga armiku krijonte vetëm dobësimin e mbrojtjes së portave, pushtimi i murit lindor të bastionit do të thoshte futja e ushtarëve armiq brenda në qytet. Madje, në këmbët e murit lindor të bastionit, qëndron një platformë e zbutur e terrenit, mjaft e përshtatshme për përqendrimin dhe manovrimin e mjeteve dhe të forcave njerëzore sulmuese. Ka mjaft mundësi pra, që zmadhimi i gjerësisë së tij të jetë kryer me rastin e hapjes së punimeve për shtrirjen e tubacioneve të ujësjellësit, i cili në fakt u gjend i murosur në të.[27]

Në fazën e tretë, hapësira e sallës së ndërtesës rrudhet më tej dhe merr pamjen e një kapele me planimetri të çrregullt. Ky ndryshim vjen pas ndërtimit të galerisë së dytë, duke e patur vitin 1451 një terminus post quem (gjurmë për këtë është cënimi qoshes JP të kishës). Sipas nesh, më tepër ky ndryshim duhet kërkuar pas rrënimeve masive të mureve perimetrale të bastionit të majtë (6-5-4-9-10), në rrethimin e dytë dhe të tretë të Krujës (1466-1467).

27) Kjo dukuri nuk është konstatuar vetëm në murin lindor të bastionit, por edhe më tej, në rrugën që ai bën nga çezma e kalasë deri aty. Nga gjurmimet tona, u pa se tubacioni (me tuba të shkurtër) gjendej i murosur në brumin e murit rrethues të kësaj ane të kalasë, çka tregon se edhe kjo pjesë muri është ndërtuar në këtë kohë.

DO NOT COPY

Salla coptohet në dy pjesë, prej ndërtimit të murit (72-84-76-75), i cili ka përfshirë edhe kollonën veriore (77) dhe si faltore ka shërbyer vetëm pjesa jugore, duke dëshmuar më tepër për ekzistencën e saj simbolike në kompleksin e hyrjes. Me këtë pamje ajo ka dalë jashtë funksionit, me rënien e Krujës në duart e osmanëve (1478).

Në anën e jashtme, murit të portës së tretë i lidhej në pikën 64 një mur i vonë, njëra anë e të cilit (64-66-67), lakohej drejt pilastrit të portës së parë të hyrjes (6). Në kontakt me strukturat e galerisë së parë, faqja e tij (64-67) linte të dukej një fugë e thellë, e cila vinte e pjerrur në anën e jashtme të vet. Me të kundërtën e kësaj pjerrësie ngrihej në lartësi faqja e brendshme korresponduese e galerisë së parë, e cila rezultonte kështu të qe mbështetur mbi murin e harkuar dhe për rrjedhim të ishte më e vonë se ai. Por ky përfundim nuk qëndronte, pasi muri i harkuar dukej qartë që ishte një strukturë e vonë. Madje, nga një sondazh u pa se të dy këto struktura nuk kishin faqe të rregullta, por të atilla të krijuara nga mbushja me muraturë kundrejt një muri ekzistues. Pjerrësitë dhe materialet e ndryshme të ndërtimit i përjashtonin mundësitë e ngritjes së tyre të njëhershme. Atëhere mbeti që njëra prej këtyre strukturave të ishte zëvendësuar më vonë, duke respektuar vendin e të parës. Meqenëse e njëjta pamje vazhdonte akoma në thellësi për faqen e galerisë së parë, u bë e qartë se muri i harkuar i qe mbështetur asaj më vonë. Por njëkohësisht këtu doli edhe përfundimi tjetër, se në vend të këtij të fundit, muri i mëparshëm i harkuar duhet të kishte qenë me faqe të rregullta dhe se, ai kishte qenë më i hershëm nga strukturat e galerisë së parë. Një sondazh tjetër në pikën 64, tregoi se muri i harkuar i qe lidhur murit të portës së tretë në një kohë më të vonë. Nga pikëpamja kronologjike, ai vendoset kështu, midis kohës së ndërtimit të murit të portës së tretë dhe kohës së ndërtimit të strukturave të galerisë së parë. Ndërsa muri i harkuar i rindërtuar (në vendin e të parit), i cili kishte mbuluar krejt qoshen veriperëndimore të kishës, rezultonte se qe ngritur pas humbjes së funksionit të saj (1478).

Stratigrafia ndërtimore e strukturave fortifikuese të kompleksit të hyrjes

Gjurmimi arkitektoniko-arkeologjik për qëllimet e konservimit na dha mundësi të dallojmë gjashtë etapa kryesore të ndërtimit të strukturave fortifikuese të hyrjes në vend të dy fazave që ishin vërejtur nga studiuesit e mëparshëm[28].

Struktura më e hershme dhe themeluese e kompleksit është fragmenti i mbetur i murit të portës së tretë (fig. 44). Në këtë etapë, hyrja e përbërë vetëm nga një portë, ishte krijuar nga çpimi i një hapësire



Fig. 43. Tre periudhat ndërtimore të kishës mbi bastionin e majtë të hyrjes.

28) S. Adhami, **Gjurmime,** f. 87-90, Gj. Karaiskaj **5000 vjet fortifikime.** Tiranë 1981, f. 162-165.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 44 Hyrja e kalasë së Krujës, mbetjet e periudhës së parë dhe të dytë ndërtimore (shek. VII – X).



Fig. 45. Hyrja e kalasë së Krujës, mbetjet e periudhës së tretë ndërtimore (shek. XIV).

në murin gjatësor (i gjerë 3,70 m). Etapën e dytë e tregon muri i harkuar (64-67), i ngritur në krahun e majtë të portës së vetme të hyrjes. Në pamundësi për të gjurmuar ecurinë e tij në anën veriore, mendojmë se ai i takon njërës faqe të një kulle të shtuar në anën e përparme të hyrjes. Madje, shtimi i kullës, mund ta ketë bërë të panevojshëm vazhdimësinë e murit të portës së tretë në krahun lindor. Ndoshta qysh në këtë etapë, eleminimi i nj pjese të tij, ka bërë të mundur the melimin e kishës së hyrjes, dëshmi më e hershme e së cilës, është frag menti i zbuluar (64-94-93-68).

Etapa e tretë ka të bëjë me vendosjen në anën e përparme të hyrjes të dy kullave të galerisë së parë (fig 45). Kulla e majtë ka shfrytëzuar hapësirën e krijuar midis murit të portës së tretë dhe murit të harkuar, prandaj ajo ka marrë trajtën e një freskoreje në planimeri. Ndërsa për kullën e djathtë, nuk qe e mundur të rilevohej forma planimetrike në anën e jashtme të saj, pasi atë e kanë mbuluar nga sipër në një periudhë më të vonë ndërhyrjet masive të kryera nga Skënderbeu, të cilat i tregon fuga vertikale në murin fundor të nikes së djathtë. Nevoja e rindërtimit ka ardhur si rezultat i dëmtimit nga artileria të strukturave (16-7-19-24), të cilat në fakt përbëjnë perden më të hollë të mureve fortifikuese të kompleksit. Sipas nesh, ky dëmtim i rëndë duhet të ketë ndodhur gjatë rrethimit të parë të kalasë, ndërsa rindërtimi i saj (pa mbulesë), është kryer paralelisht me ngritjen e kullës cilindrike (1450-1451).

Periudhën e katërt ndërtimore e përbëjnë dy strukturat që formojnë korridorin e saj, kulla C në krahun e djathtë dhe muri lindor e verior i bastionit të majtë, të cilat i mbështeten strukturave të galerisë së parë (fig. 46). Ndërtimi i korridorit, ka ardhur me siguri nga nevoja për një parambrojtje e të dy portave të para të hyrjes, të cilat në fakt nuk kanë mundur t'i fshihen rrezes goditëse nga VL. Për kullën C viti 1450-1451 është një terminus ante quem i sigurtë[29], pasi aksi i shikimit të topit mbi kullën cilindrike e përshkon diagonalisht seksionin e saj (në

29) Këtë përfundim na e siguron edhe Barleti. Në prag të rrethimit të parë, kur Skënderbeu ndahet me qytetarët e kalasë, thuhet se ata e përcollën udhëheqësin e tyre deri tek «portat» dhe pasi u ndanë, i kyçën ato. (M. Barleti **Historia,** 179, 250). Këtej del se hyrja ka patur në funksionim në këtë kohë disa porta, gjë që vërtetohet edhe nga gjurmimi. Më tej ai pohon se rruga që të çonte në portën e parë ishte e ngushtë, sa mezi nxinte dy kalorës (**Po aty,** 259). Tërthorazi del se kulla C ka funksionuar në prag të rrethimit të parë të Krujës dhe se hyrja e kalasë nuk ka patur oborr të fortifikuar.

drejtimin 19-53), çka tregon se në këtë kohë ajo nuk ruhej në lartësi dhe se kishte dalë jashtë përdorimit. Roli fortifikues i kullës C është kompesuar plotësisht me ngritjen e kullës cilindrike. Duke patur parasysh edhe njoftimin e Barletit[30], korridori i hyrjes përfshihet kështu midis ndërtimeve të shumta të kryera në mesin e shek. XIV nga Thopiajt[31], sundimtarët e Krujës së asaj kohe.

Etapën e pestë të evolucionit të hyrjes e përbëjnë strukturat e ndërtuara gjatë periudhës 34 vjeçare (1444-1478) të rezistencës shqiptare kundër ushtrive osmane. Këtu hyjnë ndërtimi i galerisë së dytë me niket dhe portën e katërt, ambienti i qëndrimit të vendrojeve me planimetri në formë kryqi, kulla cilindrike dhe muratura lidhëse midis saj dhe strukturave të galerisë së parë (fig. 47). Sipas Barletit, për rindërtimin e mureve të kalasë të dëmtuara nga rrethimi i parë, Skënderbeut i erdhën në ndihmë edhe një numër mjeshtrish të dërguar nga Alfonsi i Napolit[32]. Karakteristikë e teknikës ndërtimore të kësaj etape, është realizimi i mbulesave (qemeri e kupola) me gurë çmërsi të latuar. Ndërtimet e Skënderbeut, e rritën në mënyrë të konsiderueshme fuqinë mbrojtëse të kompleksit të hyrjes, duke i trefishuar strukturat e tij nga pikëpamja volumetrike. Me gjendjen e arritur në epokën e Skënderbeut, ai zë një vend të veçantë midis hyrjeve të fortifikimeve tona mesjetare, si ato të Beratit, Durrësit, Shkodrës, Shurdhahut, Lezhës, etj., për nga fuqia mbrojtëse, zgjidhja specifike planimetriko-volumore, racionalizimi në volume dhe harmonia në evolucionin tradicional të tij në kohë.

Pas vitit 1478, me rënien e Krujës në duart e osmanëve, hyrjen e kalasë e përshkuan vetëm shtesa dhe adaptime të pjesshme. Siç mund të shohim rindërtimin e murit të harkuar mbi bastionin e majtë, daljen nga funksioni të kishës, ngritjen e nivelit të tarracës mbi galerinë e dytë dhe të ambientit të vendrojeve, ndërtimin e shkallëve në anën perëndimore dhe të banesës me ambiente të mëdha (faza e parë), e cila duhet t'i ketë shërbyer garnizonit osman. Me këtë pamje, hyrja e kalasë kalon periudhën historike, kur qyteti mesjetar i Krujës, kishte hedhur themelet e varoshit jashtë mureve të kalasë, elementi fillestar urban i së cilës është ndërtimi i xhamisë së



Fig. 46. Hyrja e kalasë së Krujës, mbetjet e periudhës së katërt ndërtimore (shek. XIV).

30) M. Barleti, **Mbi rrethimin e Shkodrës,** Tiranë, 1962, f. 42. Po ai, **Historia** f. 78. Barleti ia atribuon Karl Topisë rindërtimin e kalasë, por kjo e dhënë e tij vlen për të kuptuar rindërtimet e shumta që u kryen në kohën e tij.

31) Trashësia e mureve (3,80 m në bazament) tregon se ai duhet të ketë qenë më i lartë. Sot muret kanë mbetur në 8 m lartësi, por mendojmë se duhet të kenë qenë edhe 6 m më të lartë. Ka mundësi që kjo pjesë e sipërme të ketë qenë me faqe vertikale (jo të pjerrët). Për këtë supozim na shërbyen disa gurë të gdhendur të ngjashëm me gurët që formojnë faqen e prerë të bastionit (4-5), të cilët u gjendën në anën e jashtme të kalasë, në cepin verilindor të saj. Aty u zbuluan mbetjet e bazamentit të dy tyrbeve me planimetri tetëkëndore, me gurë grac të latuar, si ato të bastionit. Përmasat dhe këndi i gjerë që krijonin të dy faqet, përputhej plotësisht me gurët e faqes së prerë. Për më tepër ato ishin të nxirrë dhe dukej se ishin marrë gjetkë, për të krijuar qoshet e tetëkëndëshit.

32) M. Barleti, **Historia,** 285 – 292.

DO NOT COPY

Pazarit në vitet 1533-1534[33]. Në fund të shek. XVIII, mbulesa e galerisë së dytë gjendet e shembur dhe banesa rrudhet në anën e bastionit të majtë, ndërsa rikonstruktohet porta e tretë dhe pjesa e qemerit mbi të. Prania vetëm e portës së tretë në këtë kohë është e lidhur me funksionin e kalasë tashmë të reduktuar për mbrojtjen e sarajeve të feudalëve Toptanë, zotëruesve të qytetit.

Mbi duart më të hershme të ndërtimit të hyrjes[34]

Pas strukturave të shek. XV (të Skënderbeut) dhe ato të shek. XIV (të Thopiajve), duke ndjekur metodën retrospektive, i takon të merren në shqyrtim strukturat e galerisë së parë[35], të cilat janë datuar në shek. XI-XII. Elemente të tillë, siç janë brezat sipërfaqësorë me pesë rreshta tulle (fugë 2-2,5 cm), prania e tullave të trasha, konceptimi i tyre në rreshta të rregullta horizontale dhe alternimi me rreshta gurësh të ndërmjetëm (mbi qemerin e nikes e gjetkë), mungesa e kluasonazhit, etj, të çojnë deri tek teknikat e kohës së vonë antike, po të mos ishin brezat e drurit. Madje, copat e tjegullave të vendosura për mbushje në linjën horizontale të gurëve (në brendinë e nikes kanë dukuri të ngjashme në kështjellën e Petrelës[3 në muret e ndërtuara në vitin 1205 prej Mihal Kon nenit në Berat[37], në kishën e Shën Kollit në Pe hondi (faza e shek. XI)[38]. Por disa elemente arkitek tonike dhe zgjidhja planimetriko-volumore e gale



Fig. 47. Hyrja e kalasë së Krujës, mbetjet e periudhës së pestë ndërtimore (mesi i shek. XV).

DO NOT COPY

33) S. Dasni dhe Gj. Frashëri, **Zhvillimi i arkitekturës islamike shqiptare të xhamive (Probleme të periudhizimit),** Monumentet 2, 1986, f. 60.

34) Nga të gjashtë etapat e shqyrtuara, S. Adhami dallon vetëm dy periudha ndërtimi te hyrjes, më të hershme strukturat e galerisë së parë dhe më të vona ato që formojnë galerinë e dytë. Për kohën e ndërtimit ai shpreh mendim vetëm për galerinë e dytë, ambientin e rojeve dhe kullën rrethore, të cilat i dallon me të drejtë si nderhyrje të mirëfillta te Skenderbeut, pa e zbuluar murin e portës së tretë. (S. Adhami. **Gjurmime,** 87-90). Gjithashtu dy periudha ndërtimi shikon edhe Gj. Karaiskaj. Ai daton me përafërsi në shek. XI-XII galerinë e parë dhe tjetrën në shek. XII-XIII. Si argument për këtë ai ka përdorur ambientin e rojeve, të cilën e shikon si një kishë të tipit «kryq i lirë». Ndërhyrjet e Skënderbeut, ai i redukton vetëm në veshjen e jashtme te kullës me seksion rrethor, dhe me pjerrësi në pjesën e poshtme (Gj. Karaiskaj. **5000 vjet,** 162-165).

35) Ndertimin e galerisë së parë në një kohë më të hershme, e përcakton mbështetja në të e strukturave të korridorit të hyrjes. Madje, nga një sondazh i kryer përpara pilastrës (6), u pa se faqja e saj ballore ruhej edhe në thellësi. Po ashtu ruheshin edhe brezat e tullave, të cilat theksoheshin në trajtën e një brezi dekorativ, gjë që tregonte se kjo faqe kishte qenë e ekspozuar për një periudhë kohe, përpara ndërtimit të murit verior të bastionit.

36) A. Baçe dhe Gj. Karaiskaj. **Kështjella e Petrelës,** në Monumentet 5-6, 1973, f. 148.

37) A. Baçe. **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** në Monumentet 2, 1971, f. 49.

38) A. Meksi. **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perhondisë,** në Monumentet 5-6, 1973; Gj. Karaiskaj. **5000 vjet,** f. 141-142.

risë na bënë të shihnim një datim më të hershëm se shek. XII.

Megjithëse në drejtimin gjatësor, ajo zhvillohet me kthesë mjaft të lakuar, galeria i është përmbajtur plan-skemës kompozicionale «kryq i brendashkruar me një kupolë të vetme» (dy krahët anësore të kryqit janë shfrytëzuar për niket e vendrojeve). Të katër krahët e kryqit janë të mbuluar me qemere, mbi të cilat mbështetet kupola e vetme. Ndryshe nga mënyra klasike e kësaj skeme konstruktive, në të cilën qemerët shkarkojnë mbi pilastrat, këtu thembrat e qemerit jugor e verior shkarkojnë mbi muraturën e harqeve të nikeve. Megjithatë, kjo shmangie e pjesshme konstruktive, nuk e largon në esencë galerinë nga skema kompozicionale e zgjedhur. Në arkitekturën tonë mesjetare, këtë skemë të arkitekturës bizantine e kemi ndeshur deri më sot vetëm tek faltoret e krishtera. Rasti i Krujës, megjithëse i adoptuar për një hapësirë asimetrike, tregon qartë, se ky sistem konstruktiv është përdorur edhe në fortifikimet tona mesjetare.

Skema konstruktive-hapësinore e galerisë i përgjigjet sistemit qemer-pendentiv-kupolë dhe kjo dukuri na jep mundësinë, të vendosim fillimisht një kufi të poshtëm kohor për ndërtimin e saj. Në përputhje me orientimin e arkitekturës së përgjithshme bizantine në rajonet ballkanike, shek. X është padyshim një terminus post quem për ndërtimin e galerisë së parë[39]. Orientimi arkitektonik i periudhës parakomnene (shek. X-XI), për ta bërë më të hedhur hapësirën qendrore të naerteses nepermjet tamburit te larte cilindrik të mbuluar me kupolë, shihet në venain tonë në ndërtesat bazilikale (shen Meri e Apolonisë)[40], por në veçanti tek kishat, si tek ato te tipit kryq i jashtëshkruar (kisha e Marmiroit), ashtu edhe tek ato të tipit kryq i brendashkruar (kisha e Kosinës), krahas transeptit, që është një dukuri e stilit perëndimor (kisha e Perhondisë). Struktura e galerisë së parë, në hyrjen e kalasë së Krujës, i përket këtij orientimi të arkitekturës bizantine të shek. X-XI, i cili, siç dihet, lulëzoi si stil arkitektonik (fundi i shek. XI deri në gjysmën e shek. XIII) dhe u përsos më tej (shek. XIII-XIV)[41]. Madje, vërehet se ka egzistuar mundësia që planimetria në formë trapezi, të mbulohej me një kupolë pa qenë nevoja të deformoheshin qemeret përgatitëse (mbajtëse) në anët dhe kjo tregon se ndërtuesit, megjithëse përdornin me guxim sistemin qemere-kupolë, nuk e njihnin trompën. Mungesa e përdorimit të këtij elementi konstruktiv, e daton galerinë e parë përpara shek. XIII, kohë e cila është një terminus ante quem për të[42].

Veçori që flasin për një periudhë parakomnene të ndërtimit të galerisë së parë, janë për mendimin tonë, mungesa e tamburit të lartë, prirja për ta thek-

---

39) Përpara kësaj kohe sistemi qemer-pendentiv-kupolë nuk ka shenja të jetë përdorur në venain tone, por është përdorur sistemi i mbulimit me qemere mbi dy mure mbajtese, si në bazilikat, kishat njënefshe apo në ndërtimet e tjera të kohës.

40) Klasifikimi dhe periudhizimi i kishave që runen në Shqiperi (**Histori e arkitekturës shqiptare** (maket), Tiranë 1980, f. 201-222, 271-312, 368-396, A. Meksi) tregojnë, per mendimin tonë, se këtu arkitektura e tyre të sterës lindore në skemën e bazilikave me kupolë të vetme mbi tambur, është në zhvillim të vazhdueshëm dhe ndjek rrugën e vet qysh nga shek. X, krahas dukurive origjinale të arkitekturës dhe jo më vonë, siç është interpretuar në ndonjë rast (Kjo çeshtje është trajtuar më gjerë në punimin e Gj. Frasherit **A ka arkitekturë shqiptare në mesjetë?** Bisedë me çiftin Buschauzen, Nëntori 2 (1985) 161-196.

41) Edhe dukuritë arkitektonike dhe artistike që mbartin kishat e ruajtura në vendin tonë nga këto etapa të tipit «kryq i brendashkruar me kupola mbi tambur» (kisha e Vllahernës, e Peshkopisë së Sipërme, e shën Triadhës në Berat, etj.), për mendimin tonë, janë rezultate të një zhvillimi paralel në kohë me ato të arkitekturës në rajonet ballkanike.

42) Sistemi konstruktiv më i përhapur për kupolën qendrore ishte kombinimi i katër trekëndëshave sferikë (pendentivave) mbi katër mbështetje (kollona), të cilat mbajnë peshën e tamburit të lartë, ku qëndron kupola. Mënyra tjetër, isnte zëvendësimi i pendentivave me katër trompa. Perdorimi i këtij sistemi të dytë konstruktiv vihet re se është përdorur pas shek. XIII dhe në pjesën jugore të Ballkanit (The Byzantine Empire **Byzantium and its Neighbours,** The Cambridge medieval history, Part. II, 333). Megjithatë, nuk duhet menduar se sistemi i pendentivave nuk u përdor pas kësaj kohe. Ai vazhdoi të përdorej, për kupola me hapësira të vogla, të cilat nuk paraqisnin nevojën të mbështeteshin në tetë pika, siç është përshembull rasti i mbistrukturës së ambientit të vendrojeve në hyrjen e kalasë së Krujës (shek. XV), apo ajo e turbes së Nuses në Mullet (shek. XVI), etj, (Gj. Frashëri dhe S. Dashi. **Dy varre monumentale në qytetin e Tiranës,** Mjeshtërit dhe arkitektura popullore. Tiranë 1976, f. 170-175). Konkretisht, meqenëse hapësira qendrore e galerisë, ka ardhur e detyruar me planimetri në formë trapezi, mbështetja e

DOCUMENTATION COPY



Fig. 6

ranës në kohë, e për rrjedhim kalimi nga variantet e thjeshta me një ambient e çardak (fig. 6/a), në variantin me çardak të vogël para odës së miqve (fig. 6/b) e më vonë në variantet me çardak të madh e skema planimetrike me një apo dy krahë (fig. 6/c, 6/d). Gjatë këtij evolucioni, hajati i thjeshtë e i patrajtuar, ndodhet në dy kate, duke i lënë vend organizimit të çardakut në katin e sipërm (fig. 7).

Në fillim hajati paraqitet shumë i thjeshtë, një hapësirë pozitive-negative (HPN_2) e patrajtuar me elemente funksionale, e pangritur dhe jo e shkëputur nga rrafshi i oborrit, i lidhur me të me ballë të gjerë, ku të vetmet elemente të formulimit të saj janë çatia që e mbulon dhe rreshti i kollonave në



Fig. 7

ballin e tij, që e shkëput nga hapësira e oborri

Më vonë shkallëzimit hapësinor i shtohet ed një hallkë tjetër, fillon e shfaqet çardaku (fig. 7/ Ky çardak nuk është gjë tjetër veçse një ballkona brenda hajatit. Kjo hallkonadë, e ngritur tani katin e sipërm, tenton të shndërrohet në hapësi të jashtme me ngarkesë të madhe emocionale, s pse është një vend i preferuar për ndenjje. Fun sionet e punës veçohen tani kryesisht në hajatin poshtëm, ku vetëm një pjesë e vogël shërben p komunikim. Hapësira e hajatit fillon e merr më shu më domethënie nëpërmjet prezencës së shkallës q të ngjit në katin e sipërm. Shkalla vendoset e orien tuar në drejtim të kundërt të dyerve të hajatit q çojnë në ambientet e katit përdhe. Në këtë mënyr arrihet një shkëputje e qartë e hapësirës së çardak kut nga funksionet shtëpiake duke e paracaktuc atë vetëm për dhomën e miqve (fig. 7, d, 8).



Fig. 8

Ky çardak i vogël na shfaqet si elementi arkitektonik më i gjetur dhe si hapësirë e jashtme më emocionale, sepse është vendi më i preferuar për ndenjje. Kjo hapësirë që i është shkëputur hapësirës së brendshme (H.P.) të banimit, ka formulim të fortë hapësinor, sepse së pari është e rrethuar nga të tri anët me mure, së dyti, është e mbuluar dhe në anën e lirë ka parmak druri, së treti, ka kuotë të lartë, meqë është vendosur në katin e dytë. Ky formulim bën që kjo hapësirë të jetë më afër interierit

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9

se sa hajati dhe në disa raste, edhe më shumë se çardaku i banesës shkodrane e beratase, duke e kthyer këtë në pjesë të pandarë të dhomës së miqve. (fig. 9). Mënyra e trajtimit si hapësirë e jashtme, me pamje nga oborri, e afron këtë çardak me natyrën, duke vënë në dukje qëllimin për të cilin është krijuar kjo hapësirë me vektor drejt hapësirës pozitive-negative të oborrit (fig. 9). Nga kjo mënyrë trajtimi hapësinor dhe nga zgjidhja arkitektonike, dallojmë se mjeshtërit ndërtues dhe porositësi i japin zgjidhje interesante një kërkese shumë të veçantë, siç është pritja e miqve dhe për këtë, funksionit që zakonisht kryhet në interier i vishet një formë organizimi hapësinor e eksterierit. Në këto raste shkallëzimit hapësinor i shtohet një nënhapësirë gjysmë e brendshme, hapësira e çardakut (fig. 10).

Në këtë nënhapësirë përqendrohet gjithë ngarkesa emocionale e hapësirës së jashtme, sepse vetëm prej këndej përfshihet e plotë panorama, hapësira e oborrit, bukuria e natyrës dhe ambientit të gjelbëruar rrethues dhe kësisoj bëhet vend ndenjje e shlodhje.

Në variantet më të zhvilluara të banesës tiranase, (fig. 6/c, 6/d) ndarja e funksioneve në hajat dhe çardak bëhet më e plotë. Në përgjithësi poshtë kryhen shërbimet dhe lart ndenjja e shlodhja pa përjashtuar ndonjë aktivitet pune. Çardaku zmadhohet e bëhet hapësirë e përbashkët për gjithë pjesëtarët e familjes dhe hajati humbet shumë nga vlerat estetike, që tashmë i kalojnë plotësisht çardakut lart. Nëpërmjet kësaj ndarje funksionale realizohet edhe një dallim cilësor i këtyre dy hapësirave pozitive-negative (HPN_2) në pikëpamje të drejtimit të vektorit hapësinor.

Së pari, hapësira e çardakut është hapësirë centrifugale përkundrejt hapësirës së brendshme (HP) të banesës dhe priret drejt hapësirës (HPN_1) së oborrit. Vetëm nga çardaku oborri soditet mirë, prezantohet më i plotë dhe shikuesi rrok më tutje, drejt rrugës apo ambientit të jashtëm rrethues (fig. 11).

Së dyti, hapësira e çardakut konsiderohet centrifugale, sepse gjatë ndenjjes në çardak njeriu i kthen shpinën anës së brendshme dhe sodit ambientin, pra tërhiqet nga hapësira e jashtme.

E kundërta ndodh me hajatin. Kjo hapësirë është centripetale përkundrejt hapësirës së brendshme të banesës dhe nuk ka funksion soditës. Duke qenë e përcaktuar për aktivitete pune, ka vektorin drejt ambientit të brendshëm. Prej saj vështrimi është më i kufizuar dhe panorama më e fshe-



Fig. 10



Fig. 11

hur. Muret rrethuese të oborrit, formuluese të hapësirës së tij dhe lartësia e ulët e katit të hajatit, kufizojnë frymëmarrjen e kësaj hapësire të krijuar kryesisht për punë (fig. 11).

Analizuam deri tani hapësirën e brendshme në eksterier të banesës (HPN_2), tiranase duke e marrë këtë të ndarë në dy format e shfaqjes së saj, në hapësirë të hajatit dhe të çardakut. Nevojat funksionale dhe ato estetike kanë diktuar organizime interesante e të shumëllojshme hapësinore edhe brenda vetë hapësirave të çardakut apo hajatit. Këto veçori spikatin më qartë në organizimin funksional të hapësirës së çardakut (fig. 12). Në këtë organizim të brendshëm merr rëndësi të madhe drejtimi i hyrjes në të e për pasojë mënyra e vendosjes së shkallës në çardak.



Fig. 12

Duke shënuar rrugët e kalimit nëpër çardak dallojmë zonat e qeta të caktuara për ndenjje e shlodhje. Por jo çdo zgjidhje është e realizuar me nivel të lartë për t'iu përgjigjur plotësisht kësaj kërkese. Në variantin e banesës tiranase me një ambient, (fig. 12/a) kemi një ekuilibër të të dy drejtimeve panoramike, ekuilibër i arritur nëpërmjet vendosjes së shkallës së skajin diagonal me hyrjen në interier. Drejtimi diagonal i lëvizjes në çardak shtyn nëpër skaje funksionet që kërkojnë qetësi ndenjje e shlodhje.

Në variantin me një ambient përbri çardakut (fig. 12/b) vendosja e shkallës dhe drejtimi i lëvizjes nëpër çardak, përcaktojnë dy zona të qeta prej të cilave njëra, e djathta, është më e hapur e më panoramike dhe e majta, më intime e më e fshehur, sepse mbështetet në një faqe muri dhe është më e mbrojtur.

Në variantet me dy ambiente anash (fig. 12/c) çardaku është shumë i copëtuar nga drejtimet e shumta të lëvizjes dhe zonat e qeta janë të kufizuara. Në këtë rast vetëm një korrigjim në vendosjen e shkallës (fig. 12/d) bën që çardaku të fitojë të tjera veti, është më i qetë nga lëvizjet e brendshme që tani kryhen në thellësi të tij dhe i gjithë balli është i lirë për ndenjje, shlodhje e soditje.

Tërë kjo larmi zgjidhjesh në organizimin e hapësirës së brendshme në eksterier (HPN_2) të çardakut, tregon qartë lidhjen organike që ekziston ndërmjet hapësirës së brendshme (HP) të banesës dhe hapësirës së jashtme (HPN_1) të oborrit. Kjo lidhje e organizuar në nivele e forma të ndryshme, nëpërmjet hapësirës së çardakut, ka diktuar dhe përcakton organizimin funksional dhe vetitë hapësinore të pjesëve të veçanta apo tërësisë së këtij të fundit.

Vlerat hapësinore të analizuara për hajatin dhe çardakun e banesës tiranase, shfaqen në nivele e forma të ndryshme arritjesh edhe në tipa të tjerë të banesës qytetare shqiptare. Këto vlera hapësinore, të pasuruara nëpërmjet organizimit të nënhapësirave përbërëse, brenda hapësirës së oborrit apo hapësirës së hajatit, apo çardakut, nëpërmjet formave të ndryshme të organizimit hapësinor apo nëpërmjet shumëllojshmërisë së elementeve formuluese të hapësirës, japin arritje të tjera me nivele të ndryshme emocionale e me veti të reja arkitektonike, të vlefshme për analiza e studime të vazhdueshme.

DO NOT COPY

Maksim MITROJORGJI

DO NOT COPY

L'AMENAGEMENT DE L'ESPACE EXTERIEUR DE L'HABITATION DONT LA «MAISON DU FEU» VA DU REZ-DE-CHAUSSEE AU PREMIER ETAGE.

RESUME

L'évolution de l'habitation de Tirana, depuis les types les plus simples à ceux les plus évolués, représente, dans le cadre de l'habitation albanaise, son caractère original assez différent et particulier des autres types de notre habitation citadine. Cette différence apparait tant sur le plan fonctionnel que sur celui architectonique.

L'habitation de Tirana, le long de toute sa voie d'évolution conserva comme élément de base et centre de composition «la maison du feu», une pièce d'une superficie considérable assez volumineuse. Par la position centrale qu'elle occupe, on comprend tout de suite que c'est ici que se déroule toute l'activité vitale et quotidienne de ses habitants.

«La maison du feu» représente la pièce la plus importante et la plus stable dans le temps, de ce type d'habitation et à part sa fonction principale elle peut accepter d'autres fonctions.

Sous l'aspect fonctionnel «la maison du feu» nous est présentée comme une unité à plusieurs fonctions et à des qualités spatiales topologiques.

A cause de ces particularités dans l'organisation planimétrique, fonctionnelle et architectonique, les conceptions qui dirigent l'organisation de l'espace intérieur et extérieur sont particulières. De l'espace non traité de l'ambiance, espace neutre que nous allons appeler «négatif» (E.N), on a détaché et formulé une petite superficie. Cette partie de l'espace commun est un espace extérierur et en même temps intérieur pour les habitants, parce qu'il représente un espace privé entouré de hauts murs qui limitent la vue et en tant que tel, il résulte simultanément négatif et positiv ($E.P.N_1$).

A part cette étendue entourée de mur qui précise l'ambiance où sera construite l'habitation, à l'intérieur de l'habitation déjà construite, on distingue deux sortes d'espaces. Tout d'abord c'est l'espace du porche, qui bien que couvert de toit, demeure un espace extérieur et peut être considéré comme une partie de l'espace intérleur avec une ambiance extérieure, dans un espace positif-négatif de deuxième degré ($E.P.N._2$). On distingue aussi l'espace intérieur complètement formulé, détaché de l'ambiance exterieure. Cet espace, en tant que pôle opposé de l'espace négatif de l'ambiance naturelle sera appelé l'espace positif (E.P).

Pour l'espace positif-négatif ($E.P.N_1$) de la cour, créé et formulé distinctement par le mur d'enceinte, la présence de la principale porte d'entrée dans ce mur, revêt une grande importance. A part sa fonction simplement fonctionnelle, la porte remplit une autre fonction, celle de l'élément de liaison des deux espaces, celui négatif de l'ambiance avec celui positif-négatif de la cour (fig. 3).

De l'extérieur à l'intérieur cela fait naitre chez le passant le sentiment de la propriété privée, de la limitation de la liberté, du mouvement, de l'écartement de la vie sociale. De l'intérieur à l'extérieur on éprouve des sentiments contraires celui de la vie collective, de la participation dans la vie sociale, d'une plus grande liberté psichologique et de mouvement. Donc, la porte ne représente pas seulement un élément physique de la liaison de l'intérieur avec l'extérieur mais aussi un élément social et psychologique de cette liaison ou séparation.

Si l'on établissait une comparaison, d'autres particularités tout à fait contraires, apparaîtraient dans l'habitation populaire de Korça. Ici l'entourage de la cour par un parapet avec des grilles, soit d'un seul côté, fait que l'espace positif-négatif de la cour appartienne au réglement extérieur spatiel en collaborant avec l'espace extérieur négatif de la rue et ce sont les murs de l'habitation même, qui limitent l'espace intérieur de celui extérieur (fig. 4). Ces deux modes tout à fait différents de la conception de l'espace dans la cour de l'habitation de Tirana et celle de Korça, font preuve de deux modes de vie différents, de deux degrés différents de l'essor économique-social et par conséquence de deux différents niveaux de l'évolution de ces villes, de la neutralité de leurs habitants. La gradation spatiale dans l'habitation de Tirana, réalise un passage aisé de l'espace extérieur négatif à celui intérieur positif (fig. 5). L'organisation planimétrique fonctionnelle et architectonique du porche ou du «tchardak», et par conséquence, celle de leur espace, se présente sous diverses formes (fig. 6). On y distingue clairement l'évolution que l'habitation de Tirana a subie dans le temps. Au cours de cette évolution, le simple porche non-traité, occupe les deux étages permettant ainsi l'organisation du «tchardak» à l'étage supérieur (fig. 7).

Au début le porche se présente assez simple, un espace positif-négatif ($E.P.N_2$). Plus tard, à la gradation spatiale fut ajoutée une nouvelle forme, le «tchardak». Alors les travaux domestiques, s'accomplissent essentiellement au porche inférieur dont seulement une petite partie sert de communication.

Ce petit «tchardak» apparaît comme un meilleur élément architectonique et un espace extérieur plus impressionnable parce qu'il est l'endroit le plus préféré pour se réposer. Cet espace qu'on a détaché de l'espace intérieur (E.P) de l'habitation représente une forte conception spatiale parce que de trois côtés il est entouré de mur, il est couvert et le côté ouvert est limité d'un parapet de bois, et enfin il a une cote élevée puisqu'il se trouve au deuxième étage. Cette conception fait que cet espace soit plus proche de l'intérieur avec un vecteur vers l'espace positif-négatif de la cour (fig. 9).

L'espace du «tchardak» est un espace centrifuge envers l'espace intérieur (E.P.) de l'habitation et tente vers l'espace (E.P.N$_1$) de la cour. L'espace du «tchardak» est considéré centrifuge parce que quand qq. un reste au «tchardak», il tourne le dos à l'espace intérieur et contemple l'ambiance, donc il est attiré par l'espace extérieur.

C'est le contraire avec l'espace du porche inférieur. Cet espace est centripète envers l'espace intérieur de l'habitation, il est destiné à des travaux domestiques, donc son vecteur se dirige vers l'espace intérieur. Les besoins fonctionnels et ceux esthétiques ont dicté des organisations spatiales intéressantes et variées même à l'intérieur du «tchardak» ou du porche. Ces particularités sont bien distinctes à l'organisation fonctionnelle du «tchardak» (fig. 12). En marquant au crayon les passages vers le «tchardak» nous distinguons les zones destinées au repos. Dans la variante de l'habitation de Tirana à une pièce (fig. 12/a) il y a un équilibre de deux directions panoramiques.

Dans la variante à une pièce en face du «tchardak» on définit deux zones calmes dont l'une, celle de droite, est plus ouverte et plus panoramique.

Dans les variantes à deux pièces latérales (fig. 12/c) le «tchardak» est morcellé par les nombreuses directions du mouvement et les zones calmes sont limités. Seulement un déplacement de l'escalier (fig. 12/d) apporterait de nouvelles qualités au «tchardak» qui serait plus calme par les mouvements à l'intérieur.

Toute cette variété de solutions dans l'organisation de l'espace intérieur à l'extérieur (E.P.N$_2$) du «tchardak», montre clairement le lien organique qui existe entre l'espace intérieur (E.P.) de l'habitation et l'espace extérieur (7.P.N$_1$) de la cour.

Les valeurs spatiales analysées pour le porche et le «tchardak» de l'habitation de Tirana, apparaissent sous divers formes et niveaux même dans d'autres types de l'habitation citadine albanaise. Ces valeurs spatiales enrichies par l'organisation des sous-espaces à l'intérieur de l'espace de la cour ou de l'espace du porche et du «tchardak» par les différentes formes de l'organisation spatiale ou par la diversité des éléments qui formulent l'espace, donnent d'autres réalisations à de différents niveaux émotifs et à de nouveaux traits architectoniques précieux pour les analyses et les études continuelles.

DO NOT COPY

NR. 2 1987

monumente

DO NOT COPY

Shuaip MANE

KALAJA E GORICËS

Përballë kalasë së Beratit, në anën tjetër të Osumit, ngrihet kodra e Goricës me kuotë pak më të lartë se ajo e kalasë. Kodra lidhet me një qafë të butë me vargun malor të Tërpanit. Të dyja këto kodra ndahen nga njëra – tjetra në pikën më të ngushtë të grykës që ka çarë lumi Osum.

Para 15 vjetësh, në vazhdim të gjurmimit për të plotësuar hartën arkeologjike të rrethit të Beratit, ne ndeshëm në kodrën e Goricës një material të pasur arkeologjik në sipërfaqe dhe shenjat e zbehta të murit rrethues. Këto u bënë shkak për një gjurmim shumë vjeçar që solli daljen në shesh të një vendbanimi të fortifikuar, gjurmët e të cilit duket se përfshijnë një territor afërsisht 1,5 ha.

Kodra e Goricës, mbi të cilën është ngritur qendra e fortifikuar, ka pozitë të mirë strategjike dhe një mbrojtje mjaft të mirë, duke përjashtuar anën juglindore. E ndodhur në këndin e bashkimit të lumit Osum dhe afluentit të tij, lumit të Velabishtit, ajo kontrollon të dy luginat dhe fushën që vjen e zgjerohet në veriperëndim. Në anën veriore kodra bie thikë mbi Osum, kështu që mbrojtja nga kjo anë i është lënë për 300 m, në një vijë të gjarpëruar pikërisht humnerës. Në anën lindore dhe jugore, një mur i fuqishëm me kulla, kompenson mbrojtjen e dobët natyrore. Në perëndim, pjerrësia është më e madhe. Gjurmë të shumta muresh duken në të gjithë sipërfaqen, por linja e murit rrethues, që ndërpritet te porta perëndimore, nuk është përcaktuar ende me saktësi.

Deri sot ruhen 167 m mure mbrojtës, dy hyrje, 3 kulla dhe disa fragmente muresh, që ndodhen kryesisht në pjerrësirën perëndimore, një pjesë paralel me vijat rrushkulluese dhe një pjesë tjetër tërthor ose pjerrët vijave rrushkulluese. (fig. 1). Në anën lindore muret nisin dreit nga gremina. E tërë kjo anë paraqitet e drejtë 87m e gjatë, me një kthesë fare të lehtë, gati të pandieshme, nga mesi ku gjendet një kullë. Një hyrje sekondare e tipit tangencial, që ndodhet 10,5 m larg greminës, shërben njëkohësisht edhe si dhëmbëzim mbrojtës. Në një largësi 42 m prej saj ndodhet një kullë (fig. 2), (5,6 x 4,2 m) dhe 35 m më tej një kullë e dytë (fig. 3), (5,6 x 4,2 m). Në këtë pikë muri kthehet në ndjekje të vijës rrushkulluese për të vijuar drejt hyrjes. Muri rrethues këtu, lëviz i shqetësuar me një dhëmbëzim dhe një kthesë duke e ndarë distancën në tri kurtina, e para 16,5 m, e dyta 17,5 m dhe e treta 13 m. Nga kulla deri tek dhëmbëzimi, terreni nis e pjerret, ndërsa më tej deri tek kthesa, muri vijon me një terren 45° të pjerrët. Nga kthesa deri tek porta perëndimore, muri ndjek një terren të sheshtë duke vazhduar 6 m paralel me kullën. Në këtë mënyrë ai krijon korridorin e hyrjes tangenciale (fig 4,5). Nga kulla e hyrjes (fig. 2,7) muri vazhdon në drejtimin verilindor edhe për 2,30 m, por më tej ai shkëputet. Në vazhdim të tij ruhet një fragment i vetmuar rreth 1,5 – 2 m, por me një teknikë të çrregullt. Më tej muri rrethues ndërpritet përfundimisht. Vazhdimi i murit rrethues me këtë teknikë është pak i mundshëm. Por ka mjaft mundësi që në pjesën e mbetur të gjendet traseja e një muri më të vjetër.

Në anën nga gremina muri është vendosur drejt e mbi shkëmbin, i cili ndodhet mbi sipërfaqe. Në anën e jashtme, shkëmbi është latuar me daltë. Në anët e tjera muret ngrihen mbi themele horizontale, të shkallëzuara në përshtatje me terrenin. Mbi themelet ngrihet xokoli 10 – 30 cm i lartë. Muri i mirfilltë vazhdon mbi këtë të fundit i tërhequr 10 – 12 cm në thellësi. Në pjesën më të madhe të xokolit, buza e jashtme është punuar me një dhëmb 3 – 5 cm të lartë, i cili siguron murin nga shkarja. Muret në kurtinat 1-2, 2-3, 3-4, dhe 5-6 kanë gjerësi 3 m (fig. 6). Vetëm kurtina 4-5, ka gjerësi 2,6 m. Muret janë ndërtuar me dy parete të mbushur brenda me gurë të madhësive të ndryshme, të lidhur tërthor me njëri-tjetrin.

Teknika e ndërtimit të mureve është disi e ngjashme me atë të fazës së parë në kalanë e Beratit. Muret janë punuar me blloqe të nxjerrë në vend nga

DO NOT COPY



Fig. 1

formacionet gëlqerore. Ata janë punuar mjaft mirë në faqen e bashkimit. Faqja e prapme është lënë pa punuar ndërsa faqja e përparme është latuar vetëm në buzët e bashkimit dhe rrallëherë është trajtuar edhe pjesa e bymyer. Nuk mungojnë rastet kur e gjithë faqja e përparshme është vendosur e papunuar duke thyer vetëm pjesët e dala. Blloqet janë vendosur në rreshta horizontale. Shpesh përdoren kllapëzimet. Por ndonëse në këto raste lartësia e rreshtit nuk ruhet, horizontaliteti nuk preket asnjëherë. Në mënyrë të dukshme mbizotërojnë fugat vertikale dhe vetëm në raste të rralla gjenden edhe fuga të pjerrëta si dhe ndonjë bllok i punuar në formë trapezi të çrregullt. Lartësia e rreshtave luhatet nga 50 deri 95 cm. Gjatësia e blloqeve lëviz nga 2.20 m – 0,40 m, me parapëlqimin e gjatësive 0,70 m – 1,40 m.

Hyrja kryesore, (fig. 4,5) që ka mundësi më të madhe për të lejuar afrimin e mjeteve me rrota, mbrohet mirë nga kulla dhe kthesa që ndodhet 12,5 m në jug të portës. Skema e hyrjes është racionale. Faqja e brendshme e kullës dhe faqja paralele e kurtinës krijojnë një korridor 3,05 m të gjerë dhe 6,15 m të gjatë, i cili kontrollohet dhe mbrohet plotësisht nga lart. Në vendin ku vendoset porta muret kanë një dhëmbëzim 20 cm për paturat e kasave të portës. Në të dy anët në bazamentin e gurit janë hapur bira rrethore me diametër 13 cm dhe thellësi 4 cm për rrotullimin e 2 kanatave të portës. Gjatë pastrimit brenda korridorit u zbulua një shtresë rreth 50 cm dhé i bardhë, i ndryshëm nga formacionet që ndodhen në këtë zonë. Ndoshta një spjegim i tij mund të jetë lartësimi i mureve me blloqe qerpiçi.

Hyrja lindore është 1,30 m e gjerë. Gjatësia e korridorit nuk ruhet e plotë, por gjurmët e ruajtura në brendësi të faqes së brendshme janë 3,2 m. Kjo hyrje është paralel me murin dhe si koncept është i

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

njëjtë me atë të portës kryesore. Qenia afër greminës; mbrojtja nga muret e dy kurtinave dhe platformës që krijohet mbi portë, në nivelin e shtegut të kalimit të rojeve, e sigurojnë atë plotësisht. Madje në këto kushte ajo ka më tepër karakter tektik dhe shërben për dalje dhe sulme të befasishme.

Të tri kullat ruhen plotësisht si planimetri dhe secila na jep mundësi për të dalluar disa nga elementët e teknikës së ndërtimit. Dy kullat e para janë ndërtuar në përforcim të murit rrethues duke e ndarë atë në dy kurtina. Ato e mbrojnë murin nga sulmi dhe e bëjnë më të qëndrueshëm nga ana statike. Kullat janë katërkëndëshe kënddrejta dhe projektohen nga muri rrethues 4,2 m. Gjerësia e tyre është 5,6 m. Teknika e përdorur këtu është më e mirë. Është treguar kujdes sidomos në gurët e qosheve, të cilët janë të mëdhenj dhe alternojnë gjatësinë e tyre herë tërthor me murin rrethues dhe herë paralel me të. Gjerësia e kullës, ashtu si në muret, përshkohet kryq me dy radhë blloqesh, të cilët lidhin faqet e kullës dhe brendësinë e saj. Kullat janë të lidhura në mënyrë organike me murin rrethues dhe brendësia është mbushur edhe këtu me gurë e dhê. Qoshet e kullave janë të pajisura me vija peshimi. Gurët janë të dimen-



Fig. 4



Fig. 5

sioneve të ndryshme, kryesisht 0,7 – 1,9 x 0,5 – 0,7 m.

Në kalanë e Beratit ka fragmente me faqe të punuara dhe në përgjithësi rreshtat janë të rregullt me ndonjë kllapëzim në të rrallë. Në Kalanë e Goricës e gjithë fasada të krijon një ndjenjë ashpërsie megjithëse ka përpjekje që përveç sigurisë për qëndrueshmëri statike të ruhet disi edhe ana estetike. Kështu, me finesë janë punuar kllapëzimet dhe rreshtat plotësuese për të siguruar horizontalitetin. Duke u nisur nga teknika e ndërtimit të mureve si dhe nga qeramika, muri rrethues i takon shek. IV-III p.e.sonë.

Në gjithë sipërfaqen, duke filluar nga pjesa më e lartë e kodrës dhe deri në skajin e fundit të pjerrësisë perëndimore, atje ku fillon gremina, ruhen gjurmë të shumta ndërtimi.

Në veriperëndim të kullës perëndimore gjendet një fragment muri në formën e gërmës «Z». Muret janë gati një metër të gjerë dhe me një faqe. Gurët janë të papunuar nga kavoja (0,45 – 1,6 x 0,22 – – 0,80 m). Në veri të këtij fragmenti përpendikular dhe paralel me vijat e terrenit gjendet një fragment tjetër dhe në verilindje të këtij të fundit gjurmët e plota të një ndërtese, ndoshta të një punishteje, ku është gjetur mjaft zgjyrë qeramike.

Dy fragmente të tjera muresh që i presin isoipset me një kënd të ngushtë janë ndërtuar me gurë të papunuar. Në vazhdim të tyre drejt juglindjes ndodhet një fragment muri me gurë të mëdhenj të papunuar fare. (0,9 – 1,6 x 0,8 m). Poshtë këtyre mureve ndodhet kavoja që është shfrytëzuar për të nxjerrë gurët e ndërtimeve. Përfund saj kemi zbuluar një fragment muri 3,70 m, i cili duhet të vazhdojë në të dy anët.

Në perëndim, në fund të pjerrësirës dhe gati në buzë të greminës, gjenden dy ndërtime kuadratike paralel me njëri-tjetrin, me rreth 2,5 m distancë. Këto ndërtime i mendojmë kulla me hyrje në mes. Më i plotë është ndërtimi kuadratik nga veriu me faqen ballore 5,8 m dhe faqja ansore 8 m. Muri është ngritur me blloqe të papunuar (0,4 – 1,0 m).

Së fundi, në veri të kuadratit të parë është zbuluar një fragment muri, edhe ky në formën e gërmës «Z», i cili afron drejt buzës së greminës nga veriperëndimi. Blloqet e tij janë të parregullt dhe të papunuar.

Mendimi se kështjella e Goricës u krijua në një kohë me Kalanë e Beratit ka nevojë për rishikim. Shkak për këtë janë gjurmët e reja e të shumta që kemi gjetur gjatë viteve të fundit.

Së pari, rrethimi i fundit i periudhës qytetare është pjesor, çka mendojmë se dëshmon që pjesa tjetër duhet të ketë qenë rrethuar që më parë.

Së dyti qeramika e gjetur datohet në fund të pe-



Fig. 6

DO NOT COPY

riudhës së bronxit, fillim të hekurit dhe në shek. IX--VI p.e.sonë.

Së treti: Dëshmi tërthore për praninë e rrethimit para periudhës qytetare është prania e disa elementeve ndërtimore të cilët çojnë në mendimin se qyteti nuk u ngrit menjëherë, por si rezultat i një proçesi të gjatë.

Përfundimisht mund të themi se kjo qendër banimi fillimisht u krijua e u formua si qendër më vete.

Mbase është akoma shpejt të bëjmë klasifikimin sipas funksionit të kësaj qendre të fortifikuar. Por sidoqoftë një gjë është plotësisht e qartë: ky vend banim i kishte të gjitha kushtet ekonomike, strategjike dhe klimatike. Gjurmët tregojnë se këtu ishte krijuar edhe një qendër e përhershme prodhimi dhe shkëmbimi e cila dora-dorës fuqizohet në shekujt IV-III p.e.sonë.

DO NOT COPY

Shuaip MANE

DO NOT COPY

LA FORTERESSE DE GORICA

RESUME

La colline de Gorica, sur laquelle se dresse le centre fortifié, se situe à une bonne position stratégique et de défense. Se trouvant au coin où se joignent le fleuve d'Osum et son affluent Velabisht, elle surveille les deux vallées ainsi que la plaine qui s'élargit au nord-ouest. Au nord, la colline tombe à pic sur le fleuve Osum, donc la défense de ce côté, le long de 300 m, est assurée par le terrain abrupt. Au côté oriental et méridional, un mur puissant flanqué de tours, compense la faible défense naturelle. A l'ouest, le terrain est en pente. Il y a partout des traces de mur mais, la ligne du mur d'enceinte qui est interrompue par la porte occidentale, n'est pas encore définie avec précision.

A l'heure actuelle, on y trouve 167 m de mur de défense, deux entrées, trois tours et quelques fragments de mur, qui se situent essentiellement sur la pente occidentale. (fig. 2). A l'est le mur s'élève au bord du précipice. Tout ce côté représente une ligne droite, longue de 87 m, au milieu de laquelle il y a un tournant presque invisible flanqué d'une tour. Une entrée secondaire, du type trangentiel, qui se situe 10,5 m loin du précipice, sert en même temps de créneau défensif. 42 m plus loin, se dresse une tour (fig. 2,2) (5,6x4,2m) et 35m plus loin une deuxième tour (fig. 2,3) (5,6x4,2m). A cet endroit le mur tourne vers l'entrée subissant un tournant et une découpure qui divisent la distance en trois courtines, la première 16,5 m la deuxième 17,5 m et la troisième 13 m (fig. 2, 4, 5, 6). De la deuxième tour jusqu'au tournant, le terrain est en pente. Du tournant jusqu'à la porte occidentale le mur suit pendant six mètres un terrain plat, parallèle à la tour. C'est de cette façon qu'est formé le corridor de l'entrée tangentielle. De la troisième tour (fig. 2,7) sur 2,30 m le mur suit la direction nord-est, plus loin il s'interrompt. Plus loin, il y a un fragment isolé, long de 1,5-2 m, réalisé d'un appareil irrégulier(fig. 2,8). Après, on ne trouve plus de traces.

L'appareil des murs ressemble un peu à celui de la première phase de la forteresse de Berat. Les murs sont construits en blocs calcaires extraits sur place. Leurs parements intérieurs sont bruts alors que ceux extérieurs sont aplanis aux arêtes. Il y a des cas où l'on a utilisé des blocs bruts qui ont subi seulement quelques coups de marteau pour éliminer les parties saillantes. Les blocs sont disposés en assises horizontales (fig. 4). Les jointures sont verticales mais rarement on en trouve quelques-unes en pente ou quelques blocs façonnés en forme de trapèze irrégulier (fig. 6). Les assises sont d'une hauteur de 50 cm à 95 cm alors que la longueur des blocs va de 2,20 m à 0,40 m.

La porte principale qui ferme une route carrossable, est bien protégée par la tour et le tournant 12,5 m au sud de la porte. Le schéma de l'entrée est rationnel. Entre la paroi intérieure de la tour et la paroi parallèle de la courtine se forme un corridor long de 6,15 m et large de 3,05 m qui est surveillé et protégé du haut.

La porte orientale parallèle au mur, présente la même conception que celle de la porte principale. La position près du précipice ainsi que sa protection par les murs des deux courtines et la plateforme créée sur la porte au niveau du chemin de ronde des sentinelles, lui assure une complète défense. Dans ces conditions, elle revêt plutôt un caractère tactique et sert de sortie en cas d'attaques inattendues.

Les trois tours dont on conserve une planimétrie complète sont réctangulaires et font saillie au mur d'enceinte de 4,2 m. Leur largeur atteind 5,6 m. Les tours sont réalisées par une technique mieux soignée. On a fait attention surtout au choix des blocs formant les coins qui sont assez grands et disposés de longueur, parfois de travers au mur d'enceinte, parfois parallèlement à lui. Les tours se joignent organiquement au mur d'enceinte et leur intérieur est rempli de terre et de pierres.

Dans toute la superficie de la forteresse, depuis le plus haut point de la colline jusqu'au bout de sa pente occidentale, sont conservées de nombreuses traces de construction.

Les traces découvertes récemment, nous poussent à revenir encore une fois à l'idée que la forteresse de Gorica fut construite en même temps que celle de Berat.

Primo, la dernière enceinte de la fin de la période urbaine est partielle, une partie de cette enceinte a dû être construite avant. Secundo, la céramique mis à jour remonte à la fin de la période de bronze, au début de la période de fer et aux IV-VIe sc. av. n.e. Tertio, la présence de quelques éléments de construction, qui nous incitent à penser que la ville ne fut pas construite tout de suite, mais après un long processus représente un témoignage indirect sur l'existence de l'enceinte avant la période urbaine. Donc, nous pouvons conclure qu'au début, ce centre habité fut créé et formé comme un centre à part.

Peut être il est encore tôt d'établir une classification selon les fonctions de ce centre fortifié: Tout de même une chose est claire: ce centre habité jouissait de toutes les conditions économiques, stratégiques et climatériques. D'après les traces, il fut créé ici un centre permanent de production et d'échange qui peu à peu s'affermit au cours des IV-VIe sc. av.n.è.

NR. 2 1987

monumentet

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

REZULTATE TË KËRKIMEVE ARKEOLOGJIKE NË KARABURUN E NË RRËZËN E KANALIT

Vijëbregu dhe fundi i detit në gadishullin e Karaburunit e në Rrëzën e Kanalit, këto vitet e fundit, kanë qenë objekt i kërkimeve të vazhdueshme arkeologjike[1]. Gadishulli i Karaburunit, 15 km i gjatë, përbëhet nga formacione shkëmbore karstike, me gëlqerorë të kretakut e të paleologjenit. Ai ka një reliev pitoresk, gjire të vegjël, shpella dhe shkëmbinj të thepisur e të thiktë, që paraqesin rrezikshmëri për anijet, gjatë erërave të forta perëndimore e jugore. Maja më e lartë e Malit të Karaburunit është Maja e Koretës, 826 m, që në drejtimin juglindor ulet në formën e një pllaje karstike, të quajtur Pllaja e Ravenës, 200-300 m mbi nivelin e detit. I të njëjtit ndërtim gjeologjik është dhe ishulli i Sazanit që ndodhet vetëm 4,8 km larg tij. Me këtë mjedis gjeografik lidhet dhe jeta e veprimtaria e qyteteve antike e mesjetare të Aulonës (Vlorës), Orikumit, qytetit në Kaninë dhe atij në Kepin e Treportit. Gjiret dhe shpellat karstike të bregut ruajnë gjurmë të shumta arkeologjike, si dhe materiale të anijeve antike e mesjetare. Kërkimet në këtë zonë u përqendruan në gjurmimin e guroreve, mbishkrimeve, vizatimeve dhe relieveve në shkëmb, si dhe të gjurmëve arkeologjike nën det (shih «Harta e kërkimeve arkeologjike në Karaburun e në Rrëzën e Kanalit»).

GURORET

Gurorët e mëdha të pjesës lindore e jugore të gadishullit të Karaburunit, kanë luajtur rol të veçantë për ndërtimet intensive të qyteteve ilire, të zonës së afërt dhe të largët. Kjo del qartë nga analizat e kampioneve të gurit të Karaburunit e të materialeve të ndërtimit në Orikum, Bylis, Amantia, Apolloni, Durrës, duke shtuar këtu dhe materialin e disa relieve e skulpturave.[2]

Gjurmët e këtyre guroreve shihen qartë, nga Gjiri i Dukatit deri në veri të gadishullit, si dhe në Shpellën e Haxhi Aliut, ku vija e bregut është e mbrojtur nga erërat. Shenjat e sipërfaqeve të prera vertikalisht, të gurit shihen në një gjatësi prej 8-10 km. Por, shfrytëzimi e puna më intensive ka qenë përqendruar në disa pika në gjiret Raguza e Parë dhe Raguza e Dytë, Mermer, Ravenë, Shën Vasil dhe Shën Jan. Prej tyre më tepër është shfrytëzuar gurorja e Mermerit,

1) Sektori i arkeologjisë nënujore pranë Muzeut arkeologjik të Durrësit në bashkëpunim me Redaksinë shkencore të TV Shqiptar ka organizuar ekspedita në vitet 1979 – -1981, 1983, 1985 e 1986 (M. Zeqo, Xh. Mato, A. Shima, I. Kasneci, I. Isai, V. Çezari, të udhëhequra nga M. Zeqo.)

Në 1986 nga Qendra e kërkimeve arkeologjike u organizuan dy ekspedita në Gjirin e Gramatës (M. Korkuti, N. Ceka, **Ekspedita-Gramata 1986,** Zëri i Popullit 9.7.86). Përshkrimet e para nga M. Zeqo **Mbishkrimet e vizatimet në shkëmb të Gramatës** «Zëri i Popullit» 3, 1982, **Kartëvizita të shekujve,** «Shqipëria e Re» I, 1983, **Vizatime e relieve të lashta mbi shkëmbinjtë e Malit të vetëtimave,** «Shqipëria e re» 6.1986, N. Ceka, M. Zeqo, **Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujërat e brendshme të vendit tonë,** «Monumentet», 1984/2, 127-140, Në arkivin e TV ekspeditat e mësipërme dokumentohen në filmat «Lashtësi në Bregdet» (M. Zeqo e N. Ceka, Xh. Mato), «Kërkime në Gramatë» (V. Cezari), «Mesazhe të gdhendura në gur» (M. Zeqo, M. Kabo, Xh. Mato).

2) N. Ceka, M. Zeqo, **Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujërat e brendshme të vendit tonë,** «Monumentet», 1984/2.

DO NOT COPY


HARTA E KERKIMEVE ARKEOLOGJIKE NE KARABURUN E NE RREZEN E KANALIT
VLORA
ISHULLI I SAZANIT
K. I TREPORTIT
SHPELLA E HAXHI ALIUT
MEPI I GOLLOVECIT
K. I GIUHEZES
SHEN JANI
PILI
SHEN VASILI
UJE I FTOHTE
KALAIA
KARABURUNI
GJIRI I DAFINES
MERMER
PLLAJA E RAVENES
RAVENA
RAGUZA E DYTE
RAGUZA E PARE
GJIRI I ARIUT
ORIKUMI
SHPELLA E DUKES GJONIT
RREZA E KANALIT
RRUGA E ASHPER
SHPELLA ME RELIEV
MAJA E ZHUPES GRAMATA
SHEN NDREU
Shpjegim
GURORE
MBISHKRIME
RELIEVE E VIZATIME
OBJEKTE ARKEOLOGJIKE NEN DET

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

në vendin e quajtur Zhuri i Zhapovelit (fig. 1,2). Guroret kanë faqe të prera vertikale, me gjatësi rreth 100 metra dhe lartësi 80 m sipër vijës së ujit. Në Mermer kjo lartësi arrin deri në 130 metra. Guroret vazhdonin njëra pas tjetrës, por sfhrytëzimi i tyre duhet të ketë qenë i njëkohshëm, në të gjitha pikat. Pra, duket se kemi të bëjmë me një kompleks kantieri për nxjerrjen e gurit, me qendër në Mermer, ku ishte përqëndruar vëllimi më i madh. Në Mermer gurorja ngjitet sipër në mal, por pika e sipërme i takon një faze të dytë, mbas shfrytëzimit të pjesës së posht-me pranë buzës së ujit.

Këto gurore, në një front kaq të gjerë e të shtrirë pune, presupozojnë një numër të madh punëtorësh e specialistësh. Një pjesë e tyre padyshim që kanë jetuar këtu, çka dëshmohet dhe nga gjetja e monedhave antike prej bronxi.[3]

Teknika e nxjerrjes së blloqeve katërkëndëshe, e njohur dhe nga guroret e tjera antike[4], konsiston në hapjen e kanaleve 12-25 cm të gjerë, në tri anë të bllokut, për ta shkëputur më tej nga poshtë me pyka hekuri (fig. 3). Përmasat e disa blloqeve të nxjerrë janë: 1,75 x 0,70 , 1,50 x 0,60, 1,34 x 1,10, 2 x 0,87 etj. Prerjet në shkëmb, në Guroren e Raguzës së Dytë dhe në Mermer, vazhdojnë horizontalisht, deri në 3 – 5 m thellësi (Fig. 4). Në krijimin e platformave, për nxjerrjen e blloqeve janë përdorur dhe skelat e drunjta, të dëshmuara nga vrimat katërkëndëshe 0,8 x 0,22 m, 0,5 x 0,20 m, që shërbenin për vendosjen e trarëve horizontalë të skelave (Fig. 5). Lëvizja e blloqeve nga lart-poshtë, duket se bëhej



Fig. 3

3) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien, 1904, f. 74.

4) K. Zheku, **Zbulimi i një gurore antike në Shkallë të Konispolit,** BSHSH, I, 1963, f. 228-323. E njëjta teknikë është zbatuar dhe në Bylis, Selcë, Amantia, etj.



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

me anë të rrëshqitjes, duke u ndihmuar nga pjerrësia e terrenit. Këto, grumbulloheshin në pikën ku ishte moli i transportimit (Fig. 6). Në Mermer, në fundin e shkëmbit, gjatë bregu, në një gjatësi prej 5 m, dallohen vrimat e mbetura nga vendosja e dikurshme e pilotave prej druri, si dhe tre blloqe të rënë në det nga anijet, në një thellësi prej 6 – 9 m. Me origjinë nga ky vend, duhet të jenë dhe dy blloqe të mbetura në rënën e bregut të Ujit të Ftohtë, në bregun matanë (1,13 x 0,98 dhe 1,07 x 0,8 m), disa kolona me seksion rrethor (0,92 m), si dhe 8 copë tamburë kolonash rrethore (0,30, 0,34, 0,64, 1,07 m). Blloqe e tambure pamë dhe në gurorën në shpatet e Ujit të Ftohtë, në vendin e quajtur Kalaja (Fig. 7).

Kompleksi i guroreve të bregut lindor të gadishullit, duhet të ketë qenë në lashtësi nën juridiksionin e Orikumit, i cili qe i favorizuar për nga pozita e tij dhe kishte mundësi më të mëdha për shfrytëzimin dhe transportin e tyre. Duket, se pikërisht, nga guroret e nga kantieret e ndërtimit të anijeve, një pjesë e të cilave ndoshta shërbenin për transportin e gurëve,

DO NOT COPY



Fig. 8

Orikumi, përjeton një fuqizim e lulëzim në shekujt III-I p.e.sonë.[5]

Një nga guroret më të mëdha është ajo e Gjirit të Gramatës, (fig. 8) në bregun perëndimor të Rrëzës së Kanalit, 24 km në veri të Palasës. Gjiri i Gramatës paraqet kanionin e një përroi malor, që vijon drejt perëndimit. Përroi i thatë, në shumicën e muajve të vitit, rimbushet në dimër, duke sjellë aluvione e sedimente që kanë mbathur bregun e gjirit, bile dhe fundin e tij, çka e vumë re gjatë zhytjeve me akualang. Shtresa e këtyre mbathjeve duhet t'i kalojë 1,5 m. Kjo vërtetohet nga mbishkrimet dhe vizatimet e skalitura, rrëzë faqeve vertikale, të cilat i zbuluam nëpërmjet një sondazhi, duke e larguar dheun që i kish mbuluar.

Deri vonë, Gjiri i Gramatës është njohur me emrin Gjiri i Dehalilit, ndërsa në një hartë të «Kitabi Bahriye», të detarit e gjeografit të njohur osman, Pir Reizit (1470-1554), gjiri shënohet me emrin Gymys liman – Limani i argjentë[6]. Sot ai njihet si Gjiri i Gramatës ose thjesht Gramatë. Këtë emër ai e ka marrë nga mbishkrimet e shumta në faqet e shkëmbenjve. Gurorja e Gramatës, fillimisht ka nisur të shfrytëzohet tek shkëmbinjtë buzë ujit, në anën jugore. Këtu ndodhen sipërfaqe vertikale të shfrytëzuara që herët, me gjatësi 50 deri 100 m dhe lartësi 20 – 40 m. Mënyra e shfrytëzimit të kujton guroren e Mermerit. Edhe këtu është përdorur e njëjta teknikë, me anën e kanaleve dhe shkëputjes së blloqeve nga lart-poshtë. Në të janë përdorur skelat e drunjta, të cilat dëshmohen nga vrimat për vendosjen e trarëve. Në jugperëndim të gurores ruhet një platformë horizontale shfrytëzimi, e cila sot ndodhet 1 – 1,5 m nën nivelin e detit. Platforma me përmasa 20 x 5 m, ku janë zgavruar dhe dy gropa në formë pitosi me diametër 1,04 m e 0,98 m e thellësi 1,15 m është përdorur si një dysheme katërkëndëshe. Gropat duket se shërbenin për mbledhjen e ujit të rreshjeve. Kjo platformë horizontale e cila është përdorur për banim do të ketë patur padyshim një mbistrukturë të drunjtë. Sot ajo ndodhet nën ujë, por në kohën e shfrytëzimit duhet të ketë qenë nja 3 m mbi nivelin e detit, për të mos u dëmtuar nga dallgët e ngritura nga erërat[7].

Gurorja në breg ka pasur dhe dy faqe të tjera, me gjatësi 36 metra, lartësi 10-15 m, si dhe gjatë-



Fig. 9

5) Dh. Budina, **Gërmime në teatrin antik të Orikumit,** «Studime Historike», 1964/1.

6) N.P. Alpah, **Bregdetet e Shqipërisë në fillim të shekullit të XVI,** «Studime Historike», 1981/3,

7) C. Pagliara, **Skela e faltores në brigjet e kanalit të Otrantos,** Kumtesë në Kuvendin e Dytë të Studimeve Ilire (në shtyp), flet për «ngritje» të nivelit të detit deri në 5,5 m në gadishullin shkëmbor të Rokas, të vërtetuar shkencërisht, gjë që korrespondon dhe me të dhënat në bregun shqiptar të Jonit.

DO NOT COPY

si 20 m e lartësi 17 m, ku gjendet numri më i madh i mbishkrimeve të skalitur. Në anën lindore të gjirit 30 – 50 m më larg dhe përballë këtyre faqeve ka faqe të tjera vertikale, të cilat kanë qenë shfrytëzuar në të njëjtën kohë. Ky mjedis përbën guroren e parë. Më në lartësi 150 metra më tej gjenden gjurmët e një guroreje të dytë me dy faqe vertikale që formojnë me njëra-tjetrën një kënd thuajse të drejtë, me gjatësi 15-20 m dhe lartësi deri 50 metra (fig. 9). Kjo gurore, më e madhja, është e ngritur në drejtim të shtratit të përroit, 10 deri në 50 metra mbi nivelin e detit. Sipas llogaritjeve nga të dy guroret e Gramatës duhet të jenë shkëputur rreth 3 milionë metra kub gurë. Të dy guroret e këtij gjiri kanë qenë vijim i njëra-tjetrës në faqet lindore, perëndimore e jugore. Në anën veriore nuk ka gati asnjë gjurmë shfrytëzimi, pasi kjo anë qe më e prekshme nga erërat e shtrëngatat, çka e vështirësonte tepër punën. Në të kundërt, pjesa e brendshme e gjirit e anët e tjera i kishin kushtet e punës shumë më të përshtatshme e të mbrojtura (shih tab. I).

Guroret e Gramatës në breg të Jonit përbëjnë një njësi tjetër më vete, e cila ka qenë shfrytëzuar për territorin epirot në jug të Rrëzës së Kanalit. Por Guroret e Gramatës nuk janë krejt të shkëputura nga guroret e tjera të Karaburunit. Gjiri i Gramatës lidhet me Orikumin me anë të një rruge tokësore, jo shumë të gjatë, përmes majës së Zhupës, rrugë, që përdoret dhe sot nga banorët e Dukatit.

Guroret, të lidhura me urbanizimin e Ilirisë, duhet të jenë shfrytëzuar nga fundi i shek. të VI p.e.r. dhe kulmin e shfrytëzimit duhet ta kenë arritur në shekujt IV e III p.e.sonë. **Si terminus ante quem,** për këtë shërbejnë mbishkrimet e shek. III p.e.sonë në Gramatë, mbi faqet e guroreve. Nga shek. i II p.e.sonë, duke gjykuar nga materiali arkeologjik i gjetur kryesisht nga amforat, pjesët e poshtme të guroreve duket të kenë pësuar një mbulim nga deti.[8] Kjo duhet të lidhet, ndoshta, me të dhënën historike të Plutarkut (Cicer), që bën fjalë për një lëvizje të bregdetit, gjatë një tërmeti në vitin 58 p.e.sonë, në Dyrrah, si dhe në traktatin «Descriptio Totius mundi et gentium», të shek. të IV, ku flitet për një tjetër fundosje të Dyrrahut në det. Këto të dhëna tregojnë për «ngritjen» e nivelit të ujërave detare, të paktën në dy epoka.

MBISHKRIMET

Shkëmbinjtë e Karaburunit e të Rrëzës së Kanalit ruajnë mbishkrime të shumta antike e mesjetare. Mbishkrimet janë në greqisht e në latinisht. Po japim më poshtë një pjesë të mbishkrimeve, në fillim ato greqisht e më pas ato latinisht, sipas shpërndarjes në terren.

1) Mbishkrimet greqisht

Në disa pika të Karaburunit kemi parë shenja mbishkrimesh të prishura, gati të fshira nga erozioni. Të tilla kishte në një shpellëzë të Gjirit të Raguzës, në njërën faqe të Mermerit në lartësi nga bregu, e në Kepin e Gjuhëzës, në Pirg. Në Gjirin e Pilit, Paçi ka gjetur një reliev me mbishkrim[9], të cilin megjithë kërkimet tona nuk mundëm t'i binim në gjurmë. Mbishkrimet e gjetura po i japim në tabelën II.

1) Mbishkrim me shkronja 2,6 cm (tabela II, 1)[10] brenda shpellës së madhe të Dukë Gjonit, në jug të Gjirit të Ariut.

2) Në një gji të vogël detar, 3 km në veri të Gramatës ndodhen dy shpella karstike. Një njërën nga shpellat (foto 10), ku ka burime me ujë të ëmbël të pishjëm, në të majtë të hyrjes, në lartësi 3,3 m nga sipërfaqja e ujit të detit është skalitur një reliev. Pranë tij në një sipërfaqe të rrafshuar (0,51 x 0,63 m) shihet një mbishkrim 7 rreshtash, me shkronja me lartësi 3,5 e 4 cm (tabela II, 2). Anash një mbishkrim i dytë, me dy rreshta (tabela II, 3; fig. 11). Disa nga shkronjat janë të pajisura me apice. Si shenja pikësimi është përdorur gjethja e skalitur. Për mendimin tonë të dy mbi shkrimet lidhen me relievin. Në to lexohet qartë emri ΗΡΑΚΛΕΙΑ dhe ΝΑΥΚΛΗΡΟ(C) (pronar i anijes). Kjo tregon qëndrimin e një anijeje pranë kësaj shpelle. 3) Në të njëjtën faqe të kësaj shpelle ruhen dy mbishkrime me bojë të kuqe, me shkronja 2,5 e 3 cm (Tabela II, 4, 5). Në anën e djathtë të mjedisit të brendshëm të shpellës në lartësi 3,5 m është një vizatim arkitektonik i gdhendur me gjurma mbishkrimi të palexueshme.

8) N. Ceka, M. Zeqo, **Vep. cit,**
9) C. Patsch, **vep. cit,** fq. 84.
10) Këtë të dhënë e kemi nga shoku M. Kabo, të cilin e falenderojmë.

BOTOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13

Gjurmë mbishkrimesh ka dhe në sipërfaqen e jashtme të hyrjes së shpellës.

Numrin më të madh të mbishkrimeve greqisht e ka gjiri i Gramatës[11] (fig. 12; 13). Me këtë rast po botojmë dhe fotografitë e mbishkrimit të perandorit të Bizantit Joani i V. Paleotog, viti 1369 (fig. 14) e të detarit të lashtë Herakliut nga Ponti (Deti i Zi) (fig. 15) të kopjuara për herë të parë nga Paçi[12]. 3) Në një tabelë (0,14 x 0,15 m) mbishkrim gjashtë rreshtash me shkronja 3 cm (tab. II, 6) kushtuar Dioskurëve. 4) Pak më poshtë mbishkrimit dy rreshtash me 3 cm (tab. II, 7). 5) në një fushë katërkëndëshe (0,43 x 0,12

11) Gjiri i Gramatës ndodhet 26 km në veri të Himarës, 19, 20, 40.co të gjerësisë gjeografike. Për bibliografinë mbi Gramatën shih Petër Soustel, **Nikopolis und Hephallonia,** Wien, 1981. Në 1436 Kiriaku i Ankonës nuk shënon ndonjë mbishkrim greqisht, por mbledh tri mbishkrime latine. I pari që jep mbishkrimet greqisht të Gramatës, është Paçi **vep. cit,** f. 89 – 94. Këto mbishkrime i përmend si fakt dhe L. Hezey **Mision archeologique de Macedoine,,** Paris 1876, fq. 381.

12) C. Patsch, **vep. cit,** fq. 92 – 93.



Fig. 14



Fig. 15

m). Mbishkrim i dëmtuar dy rreshtash me shkronja 3 cm, në një fushë (0,35 x 11 m) (tab. II, 8). 6) Mbishkrim me shkronja 5 cm brenda një fushe katërkëndëshe (tab. II, 9). Mbishkrimi ka vetëm një emër, mesa duket të një anije të vjetër. 7) Emri ilir Gent (tab. II, 10) me shkronja 2,6 cm në një fushë 20 x 18 cm. 8) Mbishkrim tri rreshtash, me shkronja 3 cm në një fushë 0,18 x 0,15 m (tab. II, 11). 9) Mbishkrim me katër rreshta me shkronja 2,7 cm (tab. II, 12) brenda një tabele (13 x 10 cm). 9) Mbishkrim me shkronja 2,9 cm në një sipërfaqe 16 x 10 cm ruan vetëm disa shkronja në tri rreshta (tab. II, 13). 10) Mbishkrimi në katër rreshta me shkronja 2 cm në një kornizë të çrregullt ovale ka formulën e njohur mesjetare. që haset shpesh në Gramada (tab. II, 14). Mbishkrimi nis me shenjën grafike të kryqit. 11) Mbishkrimi dy rreshtash me formulën e mësipërme e shenjën e kryqit, me shkronja 2,3 cm në një kornizë gjatoshe 9 x 4 cm (tab. II, 17). 12) Mbishkrim dy rreshtash me shkronja 1,5 cm në një fushë 4 x 6 cm (tab. II, 16) me shenjën e kryqit. 13) Mbishkrim shtatë rreshtash me shkronja 1,8 cm brenda një fushe ovale (14 x 21 cm) me shenjën e kryqit (tab. II, 17 e foto 17). 14) Mbishkrim gjashtë rreshtash me shkronja 1,6 cm, brenda një katërkëndësi (17 x 15), me shenjën e kryqit në fillim. Sipër kryqit, në të dy anët, inicialet e Krishtit IC XC. Poshtë kryqit NHKA (Fito) (tab. II, 18 e foto 18). 15) Mbishkrim me shkronja 8 mm (tab. II. 19) brenda një fushe të zgavruar në formë katërkëndëshe (15 x 11 cm). 16) mbishkrim një rresht, në një katërkëndësh 7 x 13 cm (tab. II, 20) me shkronja katër cm.

Një sërë mbishkrimesh të shek. XVIII, XIX e fillimit të shek. XX, po i japim si përmbajtje epigrafike



Fig. 16



Fig. 17

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 20

(tab. II, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36).

Sipër gurores së parë të Gramatës ndodhen dy shpella të vogla. Në njërën shpellë (2,5 x 4 m x 2,3 m) janë skalitur afro 15 mbishkrime greqisht, të dëmtuara nga erozioni. Pranë hyrjes gjendet një kryq i skalitur 9 x 5 cm. Ajo komunikon me shpellën tjetër ku ka gjithashtu gjurmë mbishkrimesh. Në të dallohet qartë një kornizë katërkëndëshe që kurorëzohet nga një fronton trekëndësh me një kryq.

II. Mbishkrimet latine

Në Gramata ka një sërë mbishkrimesh latine. Midis tyre po botojmë fotografinë e mbishkrimit të parë nga Kiriaku i Ankonës në 1435 e të botuar



Fig. 19

(CIL, III, 583) (foto 19). Mbishkrimi ishte brenda një kornize 0,29 x 0,33 m, rreshti i parë ka gërma 6 cm, rreshtat e tjerë gërma 2, 3 cm[13]. Në kornizën katërkëndëshe 0,19 x 0,21 m të mbishkrimit latin të V. Klementit botuar së pari nga Paçi, 18) ishin gjurmët edhe të një mbishkrimi tjetër, por të palexueshëm (fig. 20). Kurse për mbishkrimin e P. Heriniusit (CIL, III 1-584) kemi hapur një mbishkrim të dytë që lidhet me të njëjtin person e që flet për vdekjen e tij[14].

13) Transkriptimin i këtij mbishkrimi sipas nesh është: Seleucus/P(ublius) Fabius P(ublius) Q(uestor) Q(uinquenanalia) L(egatus) D(ecriae) Veturi Veturia M(militum) C(onductor) S(enatus) C(onsulitum) P(ro) P(raetore) T(ribunus) M(ilitum).

14) Mbishkrimi i Gramatës që transkriptohet P(roculus) Herennius P(atronus) M(unicipi) L(egatus) L(egionis) D(ecuniator) Com(itor) lidhet me një mbishkrim të gjetur mbi një gur varri në kalanë e Kalivaçit (V. Banga, **Kontribut për hartën arkeologjike të Tepelenës,** Buletini Arkeologjik, Tiranë, 1981, fq. 215.) Mbishkrimi i dytë transkriptohet: P(roculus) Herennius P(ius) F(elix) Legionis V(oltinia tribus). Hic. Situs Est.

DO NOT COPY



Fig. 21 a



Fig. 21 b



Fig. 22

1) Pranë mbishkrimeve të gjetura nga Kiriaku Ankonës, në një kornizë 0,15 x 0,07 m, me gërma k pitale 2,8 cm, është skalitur emri «ANTEROS» emër një anije (fig. 21 a). 2) Në një sipërfaqe 0,10 x 0,14 mbishkrimi me gërma 4 cm (fig. 15) «SERG» (I njëri nga fiset e njohura të Romës. 3) Në një katë këndësh 0,14 x 0,08 m mbishkrimi me gërma 3 c EXUPER (O). 4) Mbishkrimi dy rreshtësh me germ 3,2 cm (fig. 21): C.MN . ./A.V. që mund të trans kriptohet C (orpus) M (ensorum) / (ve) V (ale). 5) Mbi shkrimi 4 rreshtësh mbi një fushë 0,40 x 0,35 me gër

ma 5 cm (fig. 22) BELL (AX) ΑΛΤSV /D . . . NES /ALEX. . . fig. 21 b. Nga fjala e parë kuptojmë se është një listë luftëtarësh. 6) Në një kornizë katërkëndëshe (0.04 x 0.05 m) mbishkrimi 5 rreshtash me germa 0,8 cm (fig. nr. 23): **An (no)D(omini)M /LXXXXVI/EN Mre / . . . vale / Hic . . . o / 1 december.** Data e mbishkrimit është 1 Ddhjetor 1096. fig. 23. Pas fjalës hic është skalitur shenja e një kryqi, kurse në fund të mbishkri-



Fig. 23

DO NOT COPY



Fig. 24

mit janë bërë tri vrima simetrike. 7) Në një sipërfaqe 0,16 x 0,18 m mbishkrimi tri rreshtësh me gërma 3,5 cm: **Pater v(ivius) v(ivae) f(ecit)... /Vernu .../... tus hic ... fueru(nt) ...**

Të 37 mbishkrimet greqisht e 7 latinisht që paraqitëm më sipër janë një pjesë e vogël e fondit të madh epigrafik të Gramatës e të pikave të tjera të Karaburunit e Rrëzës së Kanalit.

Mbishkrimet janë realizuar në shumicën e rasteve me inçizim duke përdorur daltë me majë. Përpara kësaj gdhendjeje tabela 5-8 cm e thellë rrafshohej deri në lëmim. Shpesh mbi inçizimin e mbi gërmat vihej bojë e kuqe dhe e zezë, kurse një pjesë më e vogël e mbishkrimeve janë bërë vetëm me anë të shkrimit me bojë. Bojërat duhet të jenë okside minerale, të cilat i kanë bërë ballë, deri në ditët tona, veprimit shkatërrues të agjentëve atmosferikë. Në një rast kemi të shënuar qartë dhe emrin e gdhëndësit (Opus Fecit -Mefeoflus) (CIL III, 1, 582). Në mbishkrimet greqisht shënohet emri **grafos,** dmth me shkrue. Në mbishkrimet greqisht përdoren formula të shekujve të ndryshëm. Shumë mbishkrime janë **continua,** janë përdorur disa forma kalendarësh. Në mbishkrimet greqisht dhe ato latinisht përdoren edhe gërmat e dyfishta, monogramet, inicialet, shkurtimet. Përveç gërmave kapitale janë përdorur dhe gërmat e dorës, ose të dyja, janë gërshetuar me njëra-tjetrën. Po kështu në të njëjtin mbishkrim hasen fjalë latine dhe greke, ose janë përdorur gërma të alfabetit grek në mbishkrimet latine. Në mbishkrimet hasen shenjat e pikësimit. Në to shpesh ka gabime, çka tregon për bërjen e tyre nga persona jo shumë të shkolluar, përgjithësisht detarë e udhëtarë të ndryshëm.

Mbishkrimet mund të grupohen në disa periudha. Periudha e parë i përket shekujve III-II p.e.sonë. Karakterizohet nga kushtimet drejtuar Dioskurëve. Periudha e dytë i takon shekullit I-rë p.e.sonë – shek. IV të e.sonë. Këtu futen mbishkrimet me emrat e Tit Statil Taurit, Mark Antonit, Sulës etj.[15]. Periudha e tretë përfshin shekujt V-XI të erës sonë, ku kemi shumë mbishkrime me formulën ΚΕΒΟΙΘΗ, të njëllojtë me atë të mozaikut të kapelës së amfiteatrit të Durrësit. Periudha e katërt përmbledh mbishkrimet në shekujt XI-XIX.

Mbishkrimet janë bërë gjatë shekujve, shpesh njëri mbi tjetrin, pa rregull e disa herë duke prishur mbishkrime më të lashta. Gjatë shekujve mbishkrimet janë dëmtuar duke zënë çmërs, janë ciflosur etj. Dendësia e mbishkrimeve është më e madhe në anën jugore të Gjirit të Gramatës, që është më e mbroitur nga erërat e stuhitë detare. Mbishkrimet janë të vendosura në korniza të formave të ndryshme, kryesisht të përmasave të vogla: katrore, katërkëndëshe, ovale, të rrumbullakta, gjysmë rrumbullake, në formën e tabulae ansata, ose në forma të tjera (Tabela

15) M. Korkuti – N. Ceka, **vep. cit,**

DO NOT COPY

III). Format më të përhapura janë katërkëndëshat që kanë sipër një fronton trekëndësh.

Ngjashmëri këto mbishkrime kanë me mbishkrimet e kornizat në Roka të Leukës. Këtu kemi një pikë korresponduese të Gramatës, me përmasa më të vogla. Në Roka, në shpellën e quajtur Grota Porcinaria, është zbuluar dhe një mbishkrim latin me emrat e tri anijeve, nga të cilat dy kishin emra hyjnish ilire: Medaur dhe Redon[16].

RELIEVE E VIZATIME NË GUR

Në Karaburun e në Rrëzën e Kanalit janë gjetur edhe relieve e vizatime të shoqëruara ose jo me mbishkrime.

1) Në gjirin e Pilit, Paçi gjeti në fillim të shekullit një reliev të shek. të I-rë të erës sonë[17] (fig. 24).

Në shpellën e gjirit, 3 km në veri të Gramatës, ishte skalitur në një sipërfaqe ovale (0,57 x 0,98 m) një reliev, sot është i dëmtuar (fig. 25). Relievi para-



Fig. 27



Fig. 28



Fig. 26

një reliev, sot është i dëmtuar. Relievi paraqet në mes një figurë, me sa duket femre, në pozicion ballor. Në krahun e majtë e të djathtë janë dy meshkujt me këmbë të përkulura. Figurat janë në mes të një dekoracioni të dëndur bimor, me gjethe e vila hardhie. Ky reliev për mendimin tonë, paraqet një skemë dioniziake, por figura e palloit në to flet për një element të ri, paleokristian. Datimi i relievit, duke

16) Pagliara, **Leuca,** Gallatica, 1948, fq. 179.

17) Relievi ndodhej në një kamare (0,32 x 0,30 m) të skalitur në mënyrë jo uniforme. Paraqiste Afërditën në pozicion ballor. Afërdita me dorën ka zënë një legen të vendosur në shkëmb. Atë e shoqëron një shërbëtore e cila hedh nga një poç ujë mbi legen. Në të djathtë të legenit, në një thellim 0,19 x 0,17 m gjendej busti i një gruaje, që sipas mbishkrimit quhej Primigenia, në pozicion gjithashtu ballor.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 29

gjykuar dhe nga mbishkrimi shoqërues i takon shekujve III e IV të erës sonë.

2) Në Gramatë në një sipërfaqe 0,30 x 0,24 m është gdhendur figura e një kafshe, ndoshta e një derri dhe sipër tij një gjethe gjatuke (fig. 26).

3) Në një reliev, me thellësi 2 – 3 cm dallohet figura e një tempulli, me fronton e katër kolona përballë (tetrastil) (fig. 27). Veç tyre hasen stela me fronton e edikul, disa me kolona me kapitele.

Vizatimet në gur janë bërë me teknikën e inçizimit.

Disa vizatime paraqesin figurën e anijeve të lashta (tab. IV, 30 – 34). Këto janë anije me basha të larta, ose me kiçe të ngritura përpjetë. Përveç një rasti, ato nuk i kanë të ravizuara velat. Disa nga përmasat e vizatimeve të anijeve janë 15 x 2,5, 11 x 12, 17 x 9, 22 x 3,5, 42 x 13 cm. Në faqen përballë detit të Gjirit të Gramatës, në një sipërfaqe vertikale, është skalitur dhe një anije me përmasat 53 x 15 cm (fig. 28). Në këtë figurë pa mbishkrim, si figurat e tjera analoge, kemi mendimin se duhet të shohim një simbol. Shembulli i skalitjes së një anije në këllçijtë prej bronxi të një iliri, gjetur në Glasinac, të datuar në shekujt VIII-VI p.e.sonë, flet për një kult të anijes te ilirët.[18] Pulenat e bashit të ngritura sipër, sipas figurave të anijeve ilire në monedhat e Shkodrës, labeatëve, daorsëve, lidhen me figurën e një gjarpëri që lidhet me botën e kultin e detit.[19] Gramata është vendi i përshtatshëm i një kulti të tillë. Formula e mbishkrimeve, ku përmenden zotërit Dioskurë, e përforcon këtë gjë. Ky kult i Dioskurëve është i përhapur në brigjet ilire, ku, tradita antike përmend kalimin e argonautëve mitikë.[20] Dioskurët, si hyjni lakemadomese, u përhapën gjatë kolonizonit në shekujt XIII-V p.e.sonë, në Adriatik e në Italinë e Jugut.[21] Barleti shënon se kulti i Dioskurëve ka mbijetuar gjatë te detarët e Mesdheut. Në Baldushk të Tiranës u zbuluan kohët e fundit figurat e Dioskurëve



Fig. 30

18) A. Stipçeviç, **Kultet te ilirët,** Prishtinë, 1981.

19) Ky gjarpër del dhe në pafkën prej argjendi të gjetur në Selcë, të shekullit të III p.e.sonë. N. Ceka, **Qyteti ilir në Selcën e Poshtme,** Tiranë, 1986.

20) Apollodori, Bib. 1, 27.

21) C. Pagliora, **Leuca,** flet për Kepin e Dioskurëve në Leuka. Për kultin e Dioskurëve shih Hammond **Epirus,** London, 1967 fq. 125, 639, 712, ku ve në dukje përhapjen e kultit në Kaoni.

si kalorës, në mermer, vepër e shek. të II, të bërë ndoshta në ndonjë atelie të Durrësit.[22] Vemë në dukje se vula sekrete e Skënderbeut tregonte Ledën, nënën e Dioskurëve[23] (fig. 29).

Në një kornizë ovale 9 : 6 cm kemi të rafiguruar dhe figurën e një anije, me rrema, direkun dhe vijat e litarëve që kulmohen në majë të tij. Pranë anijes është vizatuar në mënyrë skematike një figurë njerëzore, përballë, me duart e hapura (fig. 30). Figurat e anijeve të skalitura në gur, të gjetura në Leuka[24], lidhen me anijet në Gramata. Detarët ilirë, të përdorur në masë në marinën romake, sidomos në shekujt e parë të erës sonë, kanë lënë disa mbishkrime.[25]

Një pjesë e vizatimeve në shkëmb në Gramata paraqet simbole kulti. Kryqet janë të formave të tipave të ndryshme të shek. V-VI (tab. IV, 14, 13, – 19)[26] kurse ato me mbishkrimin NHKA janë të shek. XI (tab. IV, 25)[27], si dhe kryqet e Maltës (tab. IV, 7, 8, 23 e 24)[28], kryqet latine (tab. IV, 14, 15) dhe greke (tab. IV, 16, 20, 21). Në një vizatim tjetër tregohet një kupolë me kryq sipër, që poshtë i varet diçka si thekë, mesa duket paraqitja e një vendi të kultit të krishterë (fig. 31).



Fig. 31



Fig. 32

Një vend me rëndësi zenë dhe vizatimet që tregojnë figura arkitektonike, kryesisht tempuj me akrotere anash frontonit, kështjella, kulla etj. Në një ka-

22) Për Dioskurët kalorës të shek. II, V. Sokolovska, **Un sanctuaire des Dioscures a Denir – Kapije,** «Ziva antika» 1974, 1-2, fq. 277-278, foto 1.

23) Dh. Pilika, **Duke kërkuar albanica në arkivat e huaja,** Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Tiranë 1965, fq. 721 foto 5.

24) C. Pagliara, Kumtesë e mbajtur në Kuvendin e II të Studimeve Ilire.

25) Në një dipllomë, në një pllakë bronxi, lëshuar një detari dalmat më 11 dhjetor të vitit 52, nënshkruan gjashtë dëshmitarë me origjinë nga qyteti i Durrësit. I. Calabi **Epigraphia latina,** Roma 1968, fq. 139.

26) **Dictionarie des simboles,** Paris, 1969, fq. 262.

27) **Po aty,** fq. 262.

28) **Po aty,** fq. 262.

POOR COPY

DO NOT COPY



Fig. 33

mare katërkëndëshe, me brinjën e sipërme në formë gjysmë rrethi (16x10 cm) është inçizuar figura e një kulle që ka në majë të çatisë dyujëse një kryq (fig. 32). Në trupin e kullës duken vijat e gurëve të vënë mbi njëri-tjetrin, kurse baza e kullës është e rrumbullakët dhe e zgjeruar, më e madhe se pjesa tjetër që lartësohet. Tipi i kullës është ai i paraqitur shpesh në gravurat e shekujve XIV e XV në Evropë. P.sh. në gravurën e Durrësit më 1572 të bërë nga Kamocio. Përreth trupit të kësaj kulle qarkohet një gjarpër, si-



Fig. 34



Fig. 35

mbol i një rreziku dhe një figurë njerëzore, disa centimetra më poshtë. Figura e paraqitur ka sy të mëdhenj, hundë të gjatë gojë të vogël, mjekra vjen duke u kulmuar. Mbi kokë mban një kurorë perandorake, ku ngrihen tri maja. Koka lidhet me trupin me një qafë të hollë e të gjatë. Trupi është në pozicion përballë e aty dallohet dora e djathtë. Për fat të keq pjesa tjetër e trupit është e dëmtuar. Mungesa e mjekrës, ndoshta tregon se kemi të bëjmë me figurën e një princeshe (fig. 33).



Fig. 36

DO NOT COPY



Fig. 37



Fig. 38



Fig. 39

Kjo figurë njerëzore (krahas asaj më skematike të njeriut pranë anijes që përmendëm më sipër), nuk është e vetme. Pikerisht në njërën faqe të punuar të gurores së Mermerit në Karaburun kemi gjetur dy tytyra skematike njerëzore (fig. 34). Fytyrat janë të tipit maskë pa ravizimin e flokëve, veshëve. Këto figura duhet të jenë skalitur, mbas mbarimit të prerjes së faqes së shkëmbit, në periudhën e përdorimit intensiv të gurores, që i takon si kohë shekujve III-II p.e. sonë.

Një grup me interes historik paraqesin stemat mesjetare. Disa nga këto stema janë italiane (tab. IV, 1,3,5,6,8,9,10,11,23,26).

Veç të tjerave në vizatimet e Gramatës shihen dy figura amforash. Njëra amforë me lartësi 35 cm, me trup konik që përfundon me majë poshtë, është skalitur mbi sipërfaqen jugore të gurores (fig. 36). Në një faqe tjetër është skalitur një amforë tjetër me fund të sheshtë (fig. 37). Lartësia e amforës është 82 cm, së bashku me kapakun, ndërsa gjerësia 34 cm. Amfora ka dy vegje simetrike. Vija e skalitjes është gati 1 cm e gjerë, e njëjtë me atë të anijes më të madhe të skalitur, jo shumë larg kësaj amfore. Pra duhet të jenë bërë në të njëjtën kohë e ndoshta nga e njëjta dorë. Figura e kësaj amfore është gjithashtu e dukshme, sapo zbret njeriu nga anija ne bregun e gjirit. Ajo, jo rastësisht, është vendosur në një sipërfaqe vertikale punuar me lëmim. Figura e amforës mendojmë se lidhet me ujin e pijshëm, që figurativisht paraqitet me figurën e amforës. Në të vërtetë shpella me reliev jo shumë larg Gramatës ka burime të ujit të pijshëm.

Një figurë më vete përbën një trekëndësh barabrinjës i vizuar nga vija paralele (fig. 38), ndoshta një simbol kulti që shpreh trinitetin e shenjtë.[29].

GJETJE ARKEOLOGJIKE NËN DET

Zhytjet me akualang janë bërë në shumë pika të bregut të Karaburunit e të Rrëzës së Kanalit. Disa nga gjetjet po i rendisim sipas pikave të kërkimeve.

1) Në fundin e Gjirit të Raguzës së Parë kemi gjetur tri qafa amforash italike të shek. të II p.e.sonë dhe një broke mesjetare të shek. VII. 2) Në hyrjen e shpellës së Haxhi Aliut (fig. 39), në thellësinë 20 m, kemi gjetur një amforë të fragmentuar të Rodit të shek. IV p.e.sonë. 3) Në Gjirin e Ariut në thellësi 6-

29) A. Stipçeviç, **Simbolet e kultit te ilirët,** Prishtinë, 1981, fq. 94.



Fig. 40



Fig. 41



Fig. 42

-25 m kishte shumë fragmente amforash e amfora të plota (fig. 40). Prej tyre tri amfora korintike të tipit B (shek. V para erës sonë), katër amfora gjatoshe të shek. III-IV të erës sonë) dhe një amforë me trup konik, me vija paralele në trup e shek. XII e XIII. Veç qeramikës gjetëm dhe pjesën e sipërme të një ene qelqi të shek. III të erës sonë, (fig. 41) si dhe një shtypës rrushi, në formën e një legeni, të shek. V para erës sonë. Në thellësinë 15 metra dalluam karkasën e drunjtë të një anije të mbyltur, të cilën e kemi të vështirë për ta datuar. Jo shumë larg anijes ndodhej dhe një spirancë antike prej bronxi. Enët e tjera janë në një numër shumë të madh.

4) U gjetën fragmente amforash italike të shek. II p.e.sonë, në thellësinë 7-12 m në Gjirin e Dafinës. 5) Në Gjirin e Pirgut u gjetën në thellësinë 5-6 metra dy gryka amforash të shek. I-II të erës sonë. 6) Në thellësinë 3-10 metra në gjirin e Gramatës gjetëm vetëm pak fragmente amforash italike të periudhës perandorake të shekujve të parë të erës sonë (fig. 42). Varfëria e materialit arkeologjik nën ujë në një gji kaq të frekuentuar nga anijet spjegohet me prurjet e përroit, që padyshim, ka mbuluar amforat e hedhura nga anijet dhe sendet e tjera të lashta.

Nga vëzhgimet nën ujë u bë e mundur të vihen re shumë blloqe katërkëndëshe apo kolona të rëna në ujë.

PËRFUNDIME

Bregdeti i Karaburunit e i Rrëzës së Kanalit ka shumë shpella karstike, por shumica e tyre nuk kishin gjurmë të jetës njerëzore. Gjetëm objekte arkeologjike vetëm në shpellën e Haxhi Aliut, të Dukë Gjonit, në Gjirin e Ariut, në shpellën me reliev, si dhe në dy shpellat e vogla sipër Gjirit të Gramatës.

Lidhjet e lashta të Karaburunit me brigjet e Leukës janë edhe në toponime, siç e ka vërejtur C. Pagliara[30]. Kështu në bregdetin tonë kemi: Gjirin e Ariut, gjirin e Shën Andreas, dhe në Leuka «Torre del Orso», «Sant Andrea» etj. Për Gjirin e Ariut, ruhet dhe një gojëdhënë popullore, ku flitet për ngordhjen e kësaj kafshe të plagosur rëndë në buzë të detit. Roli i Gramatës është i trefishtë, së pari si gurore, së dyti si vendqëndrimi e shpëtimi i anijeve në shekujt, për t'u mbrojtur nga erërat, dhe së treti, si vend kulti i detarëve.

30) C. Pagliara, Kumtesë e mbajtur në Kuvendin e II të Studimeve Ilire.

DO NOT COPY

TAB. I



DO NOT COPY

TAB. II



DO NOT COPY


1
2
3
4
9
5
6
7
8
10
12
13
14
15
11
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30
31
32

DO NOT COPY

TAB. IV



DO NOT COPY

Moikom ZEQO

DO NOT COPY

RESULTATS OBTENUS PAR LES RECHERCHES EFFECTUEES DANS LA PENINSULE DE KARABURUN ET DANS RRËZA E KANALIT

RÉSUMÉ

La côte et le fond de la mer à la péninsule de Karaburun et à Rrëza e Kanalit, furent ces dernières années l'objet des recherches archéologiques. Ces recherches se concentrèrent en trois directions: 1) aux anciennes carrières 2) aux inscriptions, dessins et reliefs sculptés sur rocher, 3) aux trouvailles archéologiques sous-marines.

Les carrières

Les grandes carrières à l'Est de la péninsule de Karaburun jouèrent un rôle particulier au processus de construction dans cette zone et fournirent de matériaux les villes d'Orikum, Bylis, Amantia, Apollonia, Durrës etj. Les traces de ces carrières apparaîssent clairement depuis la baie de Dukat jusqu'au nord de la péninsule, dans la Grotte de Haxhi Ali, et surtout à Raguza e Parë, à Raguza e Dytë, à Ravenë à Saint Vasile etc. La carrière de Mermer (Marbre) fut exploitée plus que les autres. Les carrières ont des flancs coupés verticalement à une longueur de 100 m et une largeur de 80 m. A Mermer cette hauteur atteint les 130 m. Au-dessus d'elle se situe une deuxième carrière plus récente. Afin d'extraire les blocs quadrangulaires, des trois côtés, on creusait des canaux de 12 à 25 cm au moyen des leviers en fer pour détacher les blocs d'en bas. Pour créer les plateformes on à utilisé les échafaudages en bois dont les trous quadrangulaire en sont témoins. Les blocs détachés étaient rassemblés au môle de Mermer d'où ils étaient transportés en bateau. Même à Uji i Ftohtë à l'endroit dénomé Kalaja, on a rencontré des traces de la matière extraite dans les carrières. Il paraît que le complexe des carrières de la côte orientale de Karaburun était sous la juridiction d'Orikum, qui était favorisé par sa position et les plus grands moyens qu'il disposait pour l'exploitation et le transport de leur matériel. L'une des plus grandes carrières fut celle de Gjiri i Gramatës sur la côte occidentale de Rrëza e Kanait au sud de Karaburun. Dans cette carrière, on exploitait au début les rochers au bord de l'eau, côté méridional. C'est là que l'on trouve les superficies verticales exploitées depuis longtemps, d'une longueur de 50 m à 100 m et d'une hauteur de 20-30 m. Presque 150 m plus loin, se trouve une deuxième carrière à deux flancs verticaux qui forment un angle presque droit, d'une longueur de 15-20 m et d'une hauteur de 50 m. D'après quelques calculs aproximatifs de cette carrière on a extrait presque 3 milions de m³ de pierres.

Ces carrières utilisées depuis longtemps, dès le VIe sc jouèrent leur rôle dans le processus de l'urbanisation de l'Illyrie en connaissant au cours du IVè et IIIe sc. le comble de leu exploitation.

Les inscriptions

Les rochers de Karaburun et de Rrëza e Kanalit conserven de nombreuses inscriptions antiques et médiévales en langue grecque et latine.

Inscriptions en grec. Nous allons rappeler les inscriptions données dans le tableaux II-1-37. Ces inscriptions sont découvertes à l'intérieur de la grande grotte de Dukë Gjoni, au sud de Gjiri i Ariut (Golfe de l'ours) ainsi que sur une petite baie, 3 km au nord de Gramata, où il y a deux grottes carstiques. Dans l'une de ces grottes (ph. 10) avec des sources d'eau douce de la mer, est gravé un ancien relief. Tout près, sur une surface plate, on distingue deux inscriptions qui, parait-il se rapportent au relief (tab II, 2-3) et ph. 11). Comme signe de ponctuation on a utilisé une feuille gravée. On y lit le nom ΗΡΑΚΛΕΙΑ *tandis, que* ΝΑΥΚΛΗΡΟ(C) *veut dire «propriétaire du navire», donc fait allusion à l'accostage près de cette grotte, d'un navire qui se rattache à l'inscription.*

Sur le même flanc de la grotte on remarque une inscription en encre rouge (tab. II, 4 et 5). A l'intérieur de la grotte, à droite, à une hauteur de 3,5 m, on distingue un dessin architectonique portant les traces d'une inscription illisible (ph. 12).

A la baie de Gramata; les inscriptions en grec sont assez nombreuses. A cette occasion nous allons publier les photos de l'inscription de l'empereur de Byzance Joan V Palécologue (l'an 1369) et de l'ancien marin Heracle de Pont (Mer Noire)

DO NOT COPY

copiées pour la première fois par Patch. (ph. 14, 15).

On y trouva 37 inscriptions de l'Antiquité, de la Basse Antiquité et du Moyen Age (tab. II) ainsi qu'un grand nombre d'inscriptions du XVIIe sc. et du début du XXe sc. Dans quelques-unes des inscriptions de la basse Antiquité et du Moyen Age on distingue des croix, dans l'une on lit la formule;

ΚΕΒΟΙΘΗ tandis que dans une autre les initiales du christ (IC/xC) et NHKA.

Au-dessus de la première carrière de Gramata, se situent deux petites grottes en inscriptions.

Inscriptions en latin. Parmis les inscriptions en latin on trouve le nom d'un navire (ph. 21) Anteros, Serg(ia), le nom d'un des tribus connus de Rome Exuper (o), C(orpus)/,M (ensorum)/A (ve) V(ale), une liste de noms de combattant BELL (AX. / ΑΛΤΑSV

/Δ ... NES,/ALEX..., An(no),/D(ocini) M/LXXXXVI/EN/Mre/.. vale,/Hic... 0/I december et Pater ((ivius) v(ivae) f(ecit)... /vernu/tus hic fueru(nt).

Ces inscriptions ne représentent qu'une petite partie du grand fond épigraphique de Gramata et d'autres endroits de Karaburun et de Rrëza e Kanalit.

Dans la plupart des cas, les inscriptions sont incisées au ciseau pointu. Tout d'abord on gravait, à une profondeur de 5 à 8 cm, la table dont la surface devait être plate et polie. Souvent les caractères étaient enduits en encre rouge et noire. Quelques-unes de ces inscriptions sont réalisées simplement par une écriture en encre. Il parait que ce sont des oxides minéraux qui souvent ont pu résister aux agents atmosphériques. Dans l'une des inscriptions nous pouvons distinguer le nom du graveur en CIL, III, 1-582 (Opus Fecit-Meleoflus). Même dans les inscriptions en grec se trouve le verbe grafos c.à.d. écrire. Dans ces inscriptions sont utilisées des formules déterminées appartenant à de différents siècles. Dans les deux sortes d'inscriptions on trouve de doubles lettres, des monogrammes, des initiales, des abréviations. A part les lettres capitales il y a des lettres minuscules ou un mélange des deux sortes. Dans la même inscription se distinguent des mots latins et des mots grecs, ou des lettres de l'alphabet grec apparaissent dans des inscriptions en latin etc. Il y a aussi des signes de ponctuation. Parfois on y observe des erreurs de grammaire ce qui montre qu'elles sont écrites par des marins ou des voyageurs.

Ces inscriptions sont groupées en quelques périodes. La première période. IIIe-IIe sc. av.n.è, comprend des dédicaces aux Dioskur. Dans la deuxième période, du I sc. av.n.è jusqu'au IVe sc. de n.è, sont groupées les inscriptions qui mentionnent les noms Tit, Statil Taur, Pubël Dollabella, Mark Antoni, Sula etc. La troisième période. V^e sc-XIe sc, comprend les inscriptions qui portent la formule ΚΕΒΟΙΘΗ, pareille à celle de la mosaïque de la chapelle de l'amphithéâtre de Durrës. Dans la quatrième période sont groupées les inscriptions de XIe-XIX sc. Les inscriptions des IIIe-IIe sc. av.n.è ainsi que celles des Ve-XIXe sc. correspondent à deux périodes importantes de l'histoire illyrienne-albanaise.

Les inscription sont encadrées de petites corniches de diverses formes, carrées, ovales, rondes, quadrangulaires, en forme de tabula ansuate (tab. III).

Les inscriptions et les corniches ressemblent à celles de la côte italienne à Leuca, à la grotte dénomée «Grota Porchinaria» etc.

Reliefs et dessins sur pierre

A Karaburun et à Rrëza e Kanalit furent trouvés des reliefs et des dessins se rattachant à des cultes précis, accompagnés ou non d'inscriptions.

1) Dans la grotte du golfe, 3 km au nord de Gramata, près de quelques inscriptions, on trouva sur une surface ovale irrégulière 0,57 x 0,98 m un relief assez endommagé (ph. 25). Le relief est gravé à une profondeur de 1,5 cm – 4 cm.

Au milieu de relief on distingue à paine l'image d'une femme en face. L'immage se présente assez endommagée, presque illisible. A sa gauche apparait l'image d'un homme dont la jambe droite est pliée. Les images sont entourées d'une dense décoration florale composée de branches, des feuilles et de grouppes d'une vigne. D'après notre avis, ce relief, représente une scène du culte de Dionysos, mais l'image du paon fait preuve d'un nouvel élément paléochrétien. La datation du relief, prenant en considération aussi l'inscription qui l'accompagne, remonte aux IIIe-IVe sc.

2) A Gramatë, une superficie gravée de 0,30 x 0,24 m, représente l'image d'un animal, peut-être d'un sanglier, surmonté d'une feuille allongée. Les figures sont à peine lisibles (ph. 26).

3) Quelques figures architectoniques apparaissent sous forme de relief, gravées à une profondeur de 2-3 cm. On y distingue un temple tetrastyle (ph. 27), des stèles à fronton et l'édicule avec quelques colonnes avec les formes des chapiteaux en dessus.

Les dessins sur pierre se présentent intéressants et en grand nombre. Il sont réalisés par la technique de l'incision. Plus de douze dessins donnent l'image des anciens navires (tab. IV). Ce sont des navires à hautes proues ou à des poupes bien élevées. Dans la plupart des dessins on ne distingue pas les voiles (à part un cas) (ph. 30).

Entre autres, il y a des dessins qui représentent des objets architectoniques, essentiellement avec des acrotères aux extrémités du fronton, des forteresses etc. A la partie semicirculaire qui surmonte une niche quadrangulaire aux dimensions 16 x x 10 cm, il y a un dessin incisé qui représente une tour dont le toit à deux pentes est surmonté d'une croix (ph. 32). C'est le type qu'on trouve souvent dans les gravures des XIVe-XVe sc. en Europe comme p.ex. celui de la gravure de Durrës faite par Camocio en 1572.

DO NOT COPY

La tour est entourée d'un serpent qui symboliquement représente un danger et nous devons y voir une ancienne scène iconografique.

Parmis les dessins de Gramata on trouve deux qui représentent des amphores. L'une, d'une hauteur de 35 cm, a la forme d'un cône renversé, gravé sur la surface méridionale de la carrière (ph. 36).

A un autre endroit on distingue le dessin d'une autre amphore à fond plat (ph. 37). La hauteur de l'amphore avec le couvercle en dessus atteint 82 cm (sans couvercle 67 cm), alors que l'épaisseur maximale de son corps oval est de 34 cm. Elle est munie de deux enses. Le creux de la ligne du dessin est d'une largeur de 1 cm, pareil à celui du plus grand navire gravé qui se trouve près de cette amphore. Donc, ils ont dû être faits à la même époque et par la même main. Nous pensons que dans les deux cas on a à faire à des cultes. Un autre dessin à part représente un triangle dont les côtes sont presque égales et la superficie est dessinée en lignes parallèles (ph. 38). Peut-être il s'agit d'un symbole de culte qui représente la Sainte trinité.

Nous trouvons particulier l'image d'un homme gravé (8 cm de haut), près de la tour avec serpent (ph. 33). D'après notre avis, les deux dessins se rattachent non seulement par le style mais aussi par la même scène iconographique. Le visage est dessiné de face, avec de grands yeux, un nez allongé, une petite bouche, un menton presque pointu. Il porte sur sa tête une couronne de l'empire. La tête est liée au corps par un long cou mince. C'est un dessin selon le style médiéval byzantin. Peut-être il faut y chercher la scène iconographique connue de XIVe-XVIe sc. représentant l'enlèvement de la princesse pour la protéger de Saint Georges.

Sur l'un des flanc exploité de la carrière de Mermer à Karaburun, nous avons découvert en 1981, deux visages schématiques humains (ph. 34). Ce sont deux visages du type masque, où l'on ne distingue pas la ligne des cheveux, des oreilles. Le plus grand dessin est mieux lisible tandis que l'autre est plus endommagé. Ces figures ont dû être gravées après la coupure du flanc du rocher, pendant l'exploitation intensive de la carrière qui remonte aux III-II sc. av.n.è.

Trouvailles archéologiques sous mer

1) Au fond de la mer du golfe de Raguza e Paré furent découverts trois cols d'amphores italiques du IIe sc. av.n.è. ainsi qu'une cruche médiévale du VIIe sc.

2) A l'éntrée de la grotte de Haxhi Ali à 20 m de profondeur on trouva une amphore fragmentée de Rhodes du IVe sc.av.n.è.

3) Le golfe d'Ari (d'ours) fut le plus riche en objets archéologiques sous-marins On y trouva à une profondeur de 6 à 25 m de nombreux tessons d'amphores et des amphor complètes. (ph. 40).

On emporta trois amphores corinthiennes du type B (V sc.av.n.è) les fragments de quatre longues amphores des III IVe sc. et une amphore conique en col cassé et décorées en ligne parallèles, du XII-XIIIe sc. Outre la céramique on emporta l partie supérieure d'un récipient romain en verre du IIIe sc. (pl 41) ainsi qu'un pressoir de raisin du Ve sc.av.n.è. A 15 m d profondeur nous distingâmes la carcasse en bois d'un navir noyé, que pour le moment il est difficile de dater. Près du navir se trouvait une ancre en bronze. Les tessons des récipient étaient assez nombreux. il y avait aussi un fragment d'une as siette du XIV sc.

4) A une profondeur de 7-12 m au golfe de Dafina il avait de nombreux fragments italiques du IIe sc. av.n.è,

5) Au golfe de Pirg, à une profondeur de 5-6 m, il y avai deux cols d'amphores de Ie-IIe sc.

6) A une profondeur de 3 à 30 m, au golfe de Gramata nous n'avons trouvé qu'un petit nombre d'amphores de l'empire des premiers sc. de n.è. La pauvreté du matériel archéologique sous-marin dans un golfe assez fréquenté par les navires, apparait presque paradoxale. Mais cela s'explique par le fait que les alluvions du torrent ont dû couvrir les amphores et les autres objets jetés par les navires.

Conclusion

Les environs de Karaburun et de Rrëza e Kanalit sont riches en monuments et en objets archéologiques, tant sur terre que sous l'eau.

Karaburun et Rrëza e Kanalit représentent une ancienne zone de l'Illyrie qui au cours des siècles connut des relations d'échange avec les voisins et les autres cultures anciennes et médiévales. L'existence des plus importantes et plus grandes carrières du pays, à cet endroit depuis l'Antiquité, fait preuve de l'intense travail constructif qui s'y exerçait.

Les anciennes relations avec les côtes de Leuca se reflètent même par les toponymes, comme l'a déjà remarqué C. Pagliara. Ainsi nous avons sur notre côte Gjiri i Ariut le golfe de Shën Andreas et à Leuca «Torre de l'Orso», «Sant Andrea» etc. D'après notre avis, ce sont des témoignages qui montrent que les toponymes de la côte italienne sont apportés de la côte albanaise. Sur Gjiri i Ariut, il y a un conte orale.

Les inscriptions et les dessins à Rroca de Leuca reflètent les relations avec Gramata qui est si l'on peut dire «le métropole». Le rôle de Gramata est triple, il a servi de carrière de lieu de repos et d'abri pour les navires au cours des siècles, de lieu de culte pour les marins. La sauvegarde de ces monuments en plein air, exposés à l'activité des agents atmosphériques, pose un problème à part assez urgent.

NR. 2 1987

monumentet

DO NOT COPY

Ferid HUDHRI

MONUMENTE TË KULTURËS NË VEPRA TË AUTORËVE TË HUAJ

Si vizatime më të hershme të botuara nëpër libra, për Shqipërinë, janë disa harta të Durrësit, Vlorës, Kaninës, Shkodrës, Sazanit, Butrintit etj, ku janë skicuar kështjellat dhe muret rrethuese të qyteteve. Në gravurat më të njohura, në librat me autorë Françesko Kamoçio, Xhuzepe Rosaçio, Vinçenso Koroneli, që i përkasin fundit të shek. XVII, jepet edhe imazhi i arkitekturës dhe urbanistikës së qyteteve më të hershme shqiptare. Përgjithësisht, aty paraqiten kështjella me mure të larta, brenda të cilave janë skicuar ndërtesa të tjera banimi, shoqërore, godina të veçanta jashtë mureve si: kisha, tregje, shtëpi banimi etj. (fig. 1). Disa nga gravurat e të tre botimeve ngjajnë me njëra – tjetrën, por kanë ndryshime përsa i përket godinave dhe kalave më të vogla jashtë qyteteve, për të cilat sot thuajse nuk gjejmë asnjë gjurmë.

Gravurat e librit të Kamoçios me pamjen e qyteteve Durrës e Vlorë mbajnë datën 1571, ndërsa ato të Rosacios[1], ku jepen kalaja e Shkodrës, Durrësit, Vlorës, si dhe ato të dy librave të Koronelit[2], ku paraqiten pamje të Vlorës, Durrësit, Kaninës, Sazanit, Grykës së Drinit, Shkodrës etj, studiuesit i kanë vendosur në data të ndryshme. Sidoqoftë ato i përkasin viteve 1574-1696. Pra, paraqitja e kështjellave, monumenteve të tjera të kulturës, përbën motivin më të hershëm shqiptar në vizatimet e botuara nëpër libra.

Numri i vizatimeve, gravurave, tablove me pamje të tilla, erdhi gjithnjë duke u shtuar. Objekte të ndryshme të kulturës materiale janë vizatuar apo pikturuar, gjithashtu, në shumë vepra, që pasqyrojnë aspekte të tjera të jetës shqiptare. Më të shpeshta gjenden në krijimet me motive të qëndresës, ku kështjellat, muret rrethuese, urat, rrugët e gurta e objekte të tjera përbëjnë mjedisin kryesor, apo pasqyrohen në sfond, në peisazhe të natyrës, ku vizatimi i tyre është si një simbol i qëndresës për liri.



Fig. 1 – Një nga vizatimet e hershme për Durrësin.

1) G. Rossaccio, **Viaggio da Venetia, a Costantinopoli per Mare e per Terra,** Venetia, 1574.

2) V.M. Coronelli, **Citta, Fortezze ed altri Luogi principali Dell'Albania, Epiro e Livadia,** Venetia 1689, **Isolano, descrittione geone geografico – istorica,** Venetia 1696.

DO NOT COPY



Fig. 2 – Gjirokastra (botues Holand)



Fig. 3 – Tepelena (botues Holand)

Autorët e vizatimeve më të hershme ishin gjeografë. Ndërsa gravurat e tjera të mëvonshme në Shqipëri, ashtu si në vende të tjera të Evropës Juglindore u bënë nga shtegtarët rilindës, që erdhën për të nxjerrë nga shtresat e tokës statuja e monumente prej mermeri, dëshmi të qytetërimit të lashtë. Në këtë shkrim do të kufizohemi me krijime të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX.

Nga fundi i shek. XVIII, fillimi i shek. XIX drejt vendit tonë morën rrugën udhëtarë të ndryshëm që, ose shoqëroheshin nga piktorë e arkitektë, ose skicionin vetë objekte e monumente të kulturës, për t'i botuar si ilustrime në librat me shënime udhëtimi. Të kësaj periudhe njihen disa vizatime, litografi dhe gravura ku u fiksuan pamje që vitet e mëvonshme nuk i «ruajtën» dot nga shkaku i luftrave ose fatkeqësive natyrore.

Tri gravurat «Kështjella në Gjirokastër», «Sarajet në Tepelenë», «Shtyllë dorike në Apoloni», të botuara në librin e Holandit, japin tri pamje, që sot i gjejmë krejtësisht të ndryshuara (fig. 2,3). Të skicuara në fillim të shek. XIX, në vitin 1812, ato kanë të fiksuara disa monumente të kulturës shqiptare të sapondërtuara. Holand i ka vizatuar ato direkt nga natyra, ndërsa në libër janë botuar të gravuara prej Elisabet Byrne dhe R. Sands[3].

Një vit më vonë, më 1813, udhëtari tjetër anglez Th. Hjuz erdhi bashkë me arkitektin e njohur Çarl Kokrell. Hjuzi qe i bindur se në Shqipëri do të gjenin monumente të arkitekturës, Dhe vërtetë, në vendin tonë ata vizituan dhe vizatuan shumë objekte dhe monumente të bukura. Befasimin e parë e patën në Berat. Hjuzi shkruan: «Duke iu afruar Beratit ne gjetëm një vend të kultivuar dhe banorë shumë të qytetëruar. Një urë e bukur me nëntë harqe mbi lumin Osum të çonte në Varrezat piktoreske, që formonin periferinë e qytetit. Nga e djathta ndrihej një mal i lartë mbi të cilin shtrihej kështjella.»[4] Ndërsa



Fig.4 – Ç. Kokrell «Berati» 1813

3) H. Holand, **Travels in the Ionian Island, Albania Thessaly Macedonia during the years 1812 and 1813,** London, 1815, f. 488, 496.

4) Th. S. Hughes **Voyage a Janina en Albanie, per la Sicile et la Grece,** Paris, 1821,

«përshkrimin» më të plotë për qytetin na e jep Kokrelli (fig. 4). Në gjithë kuadrin ai ka vizatuar ndërtesa të shumta e të larmishme. Në plan të parë, të ndriçuar me shumë se çdo pjesë tjetër, paraqet një shtëpi dykatëshe, që të tërheq me pasurinë e ornamenteve dhe mjeshtërinë e të ndërtuarit. Aty çdo gjë duket si në relievi, oxhaku, çatia, dritaret, ballkonet, dyert, shkallët dhe elemente të tjera. Nëpërmjet një «paraqitjeje» të tillë arkitekti dhe piktori anglez shpreh entusiazmin e tij ndaj ornamentikës së pasur popullore. I njëjti entusiazëm vihet re edhe në pikturimin e urës së bukur mbi lumin Osum, të ndërtesave karakteristike në lagjen përballë, si dhe në kështjellën që ngrihet në mal. Tabloja ka një pasaktësi: mali me kështjellën nuk mund të shihen nga ai këndvështrim që e ka ndërtuar kuadrin piktori. Ato janë në anën e kundërt të pamjes së vizatuar aty. Të jetë lajthitje, apo ngatërresë gjatë përpunimit në studion e tij në Londër, larg pamjes reale?

Duke gjykuar thellë, mbështetur edhe në krijime të tjera të këtij autori, mendojmë se nuk kemi të bëjmë me ndonjë pakujdesi gjatë përpunimit në studio, por një trajtim i tillë është bërë qëllimisht, për të dhënë në një kuadër të vetëm gjithë pjesët më të bukura dhe më karakteristike të qytetit, urën, shtëpinë karakteristike, lagjen me shtëpitë njëra mbi tjetrën, malin e lartë me kështjellën në majë, si edhe kishën në faqen që bie pingul mbi rrugën e qytetit. Në një nga punimet më të bukura të këtij piktori, e cila ruhet në Akademinë Mbretërore të Arteve në Londër, janë kompozuar dhjetra monumente kulturore të lashtësisë në një tablo të vetme. Ajo është më karakteristike për autorin dhe nga më të bukurat e artit britanik. Riprodhimi i saj është vendosur në një album më 116 krijime të zgjedhura[5]. Në rastin tonë, tabloja e mësipërme që titullohet «Monumente të lashtësisë», dëshmon se vendosja në një kuadër të vetëm të dy a më shumë pamjeve, që në realitet nuk janë pranë njëra-tjetrës, ka qenë një prirje e përgjithshme e tij dhe jo pasaktësi, siç është menduar deri tani për tablonë «Pamje nga Berati».

Në fillim të shek. XIX erdhi nga Anglia edhe piktori U. Uiliams për të vizatuar monumente të lashtësisë në Greqi, por nuk u fut në brendësi të tokës shqiptare. Gjatë bregdetit pikturoi vetëm disa pamje nga brigjet e Vlorës dhe Malet Akrokeraune pranë Himarës, të cilat i ekspozoi më 1822 në Edimburg bashkë me disa pamje të monumenteve të antikitetit



Fig. 5 – Gjirokastra (Gravurë e shek. XIX)

grek.[6] Në gravurat dhe akuarelet nga Shqipëria paraqiten male të larta dhe bregdeti i thepisur i jugut me pamje monumentale.

Në këtë këndvështrim është edhe një nga gravurat më të bukura për Gjirokastrën, gdhendur në metal nga një autor anonim anglez (fig. 5). Ndihet e njëjta prirje romantike si te peizazhet e Uiliamsit. Kalaja dhe ujësjellësi në vizatim përbëjnë pikën më të lartë të qytetit duke ngritur më tej vijën e horizontit me madhështinë e tyre. Pamja bëhet edhe më monumentale nga ndriçimi i rrezeve në perëndim, që lëshojnë dritë vetëm në majat më të larta, në kalanë mbi shkëmb dhe te harqet e ujësjellësit, duke i evidentuar ato në gjithë peizazhin e mbuluar nga tonet e errëta të muzgut. Por vlera më e madhe e kësaj grafike qëndron në vizatimin e qartë të dy monumenteve më të bukura të Gjirokastrës, që sot mbeten si dëshmi figurative të pamjes së plotë të tyre. Një litografi e Lirit, që paraqet gjithashtu të njëjtën pamje, nuk e ka aq të detajuar ujësjellësin dhe kalanë. Ndërsa në gravura të autorëve të tjerë ujësjellësi nuk paraqitet më, pasi u rrënua. Kalaja jepet e dëmtuar duke na fiksuar kështu gjurmët shkatërrimtare të kohëve.

Në katër litografitë me temë shqiptare që botoi në albumin e tij, arkitekti Henri Kuk ka vizatuar pamje të shtëpive karakteristike në Shkodër, të kështjellës në Butrint dhe dy monumente gjysmë të rrënuara

5) **British Painting,** London 1976.
6) **Views in Greece, Italye Sicily and the Ionion island. Painted in Watercolours by H.W. Williams,** (Katalogu i ekspozitës. Edimburg 1822).

PO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6 – H. Kuk. «Rënime të ndërtimeve të hershme»



Fig. 7 – H. Kuk. Ndërtime në Butrint

gjatë bregdetit të Jugut (fig. 6). Rreth monumenteve është paraqitur edhe mjedisi natyror me liqenet dhe malet, me pemë dhe kopshte, për të krijuar pamje piktoreske, por H. Kuk, si arkitekt që ishte, kujdesin e veçantë e ka treguar në vizatimin e ndërtimeve. Pamjet e tij janë edhe me vlerë historike pasi për kështjellën në Butrint p.sh. na jep të vetmet punime figurative që e ka të fiksuar në pamjen e plotë (fi. 7), ndërsa litografitë për Shkodrën paraqesin lagjen karakteristike me shtëpi prej druri nga e cila sot nuk ka mbetur asnjë gjurmë, por as dhe një dëshmi tjetër figurative pasi, siç dëshmojnë historianët ajo është djegur e gjitha gjatë luftrave. Litografitë nga Shqipëria janë shoqëruar edhe me shënime të vetë autorit që botohen në faqet e para të albumit.[7]

Me të njëjtën pikë vështrimi, si te libri i A. Ho-



Fig. 8 – G.F. Sarzhen «Gjirokastra»



Fig. 9 – G.F. Sarzhen «Shtyllë dorike në Apoloni»

7) H. Cook, **Ionian islands, Greece and Costandinopole,** London 1853.



Fig. 10 – Kirshner. Fragment nga grafiku për Shkodrën

landit, që përmendëm në fillim, pamjet «Kështjella në Gjirokastër» (fig. 8), «Saraja në Tepelenë» dhe «Shtyllë dorike në Apoloni» (fig. 9) janë gravuruar rreth 30 vjet më vonë nga G.F. Sarzhen. Këndvështrimi dhe kompozimi i grafikave është aq i përafërt me ato të Holandit sa të krijohet përshtypja se janë kopje të tyre. Por, po t'i shohim me vëmendje, ato ndryshojnë nga trajtimi artistik, si edhe nga objekte dhe elemente të tjera. Ngjashmëria ndikon për të na krijuar bindjen se gravurat e Holandit me siguri kanë qenë të njohura e ndoshta janë përdorur si bazë për të gjetur të njëjtin këndvështrim, jo për të kopjuar të parat, por për të pasqyruar ndryshimet e 30 vjetëve pasi, siç dihet duke vizatuar në të njëjtën këndvështrim bëhet më lehtë krahasimi i ndryshimeve. Nga kjo pikëpamje gravurat e Sarzhenit marrin edhe një vlerë tjetër, janë të vetmet krijime grafike, nga sa njohim deri tani, të cilat na pasqyrojnë pamje nga këndvështrime të njëjta të vizatuara edhe shumë vite më vonë, për të dhënë ndërtime të tjera që janë bërë, mirëmbajtjen e monumenteve, si dhe ndryshimet në relievin natyror.

Nga krahasimi i gravurave të Gjirokastrës shihen më qartë ndryshimet. Në të dytën pasqyrohen shtëpi të reja banimi, ndërsa te «Apolonia», veç mjedisit natyror, në kodrën pas shtyllës, paraqiten ndërtime që nuk shihen në gravurën e parë. Pamjet e mësipërme të realizuara nga S.F. Sarzhen janë riprodhuar në një botim të ilustruar me 366 gravura të gdhendura në dru, realizuar nga një grup autorësh, të cilët, siç shkruhet që në faqen e parë, janë nga artistët më të njohur të Parisit dhe të Londrës. Libri me këto gravura u botua në Paris edhe në Londër njëkohësisht, madje pati edhe ribotime.[8]

Kalaja e Shkodrës është vizatuar nga disa autorë si: Kirshner (fig. 10), që pasqyron dhe urën mbi Bunë bashkë me lagjen në anën jugore të kalasë, nga E. Knajt që vizaton edhe dajlanin poshtë, kështjellën etj. Pamjen më të plotë, me vizatime të detajuara të gjithë ndërtimeve, si dhe të lagjes së banuar midis



Fig. 11 – A. Bonamore «Kështjella e Shkodrës»

8) **La Greece pittoresque et historique ancienne et moderne.** Paris 1841: Greece: **Pictoral, desciptive and histori,** London MDCCCXLIV.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12 – K. Udvil «Pranë vendvarrimit të Skënderbeut në Lezhë»

gjelbërimit, e ka paraqitur autori italian A. Bonamore (fig. 11). Në plan të parë është vizatuar një karvan me kuaj e luftëtarë shqiptarë me veshje kombëtare. Vështrimi drejtohet nga kështjella ku po ngjitet edhe kreu i karvanit. Gravura është botuar në revistën «La guerra d'oriente» rreth viteve 1880, pra pasqyron njëkohësisht një skenë nga vitet e luftrave për liri. Të këtyre viteve janë edhe disa krijime të piktorit Ketën Udvil. Në gravurat e tij pasqyrohet kryesisht qëndresa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Si piktor realist ai ka vizatuar figurat e shqiptarëve me veshje kombëtare në mjedise të ndryshme, duke pasqyruar dhe ndërtime, brendi shtëpish dhe objekte të kulturës sonë materiale. Interes për vlerat historike dhe arkitekturore paraqet gravura e titulluar, «Pranë vendvarrimit të Skënderbeut në Lezhë» (fig. 12). Me qartësi e me syrin e një arkitekti janë vizatuar ndërtimet prej guri dhe druri, «Hyrja në një fshat shqiptar», «Pushim në han», «Në pazarin e Shkodrës dhe zonave të tjera të Veriut, me interiere të pasura në ornamente dhe gdhendje të bukura artistike. Ashtu si në pasqyrimin e veshjeve kombëtare edhe në vizatimin e objekteve të arkitekturës, Udvil është shumë realist, aq sa nëpërmjet gravurave dhe tablove të tij krijon përfytyrim të plotë dhe të saktë për mjeshtërinë e të ndërtuarit në Shqipëri.

Peizazhet e piktorit Eduard Lir krijojnë imazhe të plota të shumë objekteve dhe monumenteve të kulturës sonë kombëtare. Disa litografi që paraqesin qytetet Shkodër, Durrës (fig. 14), Krujë, Gjirokastër, Berat, Butrint, kanë në qendër kështjella, ndërsa në tri të tjerat me pamje nga Vlora, Tirana (fig. 15) dhe Berati (fig. 16) vizatohen shtëpi karakteristike, rrugë, ura etj. Kështjella e Krujës (fig. 17) ka pamjen më monumentale nga gjithë ndërtimet që ka pasqyruar Liri. Në prerjen vertikale të kuadratit të tablosë, autori e ka vizatuar kështjellën pas një shkallëzimi lartësues, që fillon nga figura e një burri me veshje kombëtare në plan të parë, ngrihet me shtëpinë, pemën e lartë, lagjen karakteristike dhe shkëmbin mbi të cilin vizatohet kështjella në kullën e vrojtimit, që siluetohet qartë në sfondin e ndriçuar të qiellit. Kështjella e Krujës «bashkë me Himarën» janë dy litografi të



Fig. 13 – K. Udvil «Shqiptarët duke u argëtuar»



Fig. 14 – E Lir «Kalaja e Durrësit»



Fig. 15 – E. Lir «Tirana»

krijuara më me frymëzim e riprodhohen në librin e tij me ditare nga udhëtimi në Shqipëri.[9] Por në gjithë krijimtarinë e tij, dy punime përbëjnë interes të posaçëm për historinë e arkitekturës shqiptare: akuareli «Ura e Baçallëkut» dhe litografia «Gjirokastra». Në të parën (fig. 10) kemi të vetmen dëshmi figurative për urën e gurtë mbi Drin, pranë Shkodrës. Siç shihet në punimin e Lirit ajo është një monument i bukur me vlera arkitektonike dhe artistike. Në punim vërehet dhe ngjashmëria e saj me Urën e Mesit, një nga monumentet më të bukura shqiptare. Vlera e akuarelit të Lirit qëndron gjithashtu në paraqitjen e plotë të urës, pasi sot thuajse nuk gjendet asnjë gjurmë. Të rralla janë edhe përshkrimet mbi të veç ça përmend Marin Barleti në veprën e tij «Rrethimi i Shkodrës». Duke e pikturuar qindra vjet më vonë Liri jep këtë përshkrim në ditarin e tij, më 2 tetor 1848, data është shënuar edhe në akuarel. «Vizatova pa pushim, gjatë gjithë ditës, nga pika të ndryshme, poshtë anës jugore të kështjellës, prej nga pamja është tepër impozante, si dhe urën më të vjetër mbi lumë e ndërtuar nga harqe me masë e gjerësi të ndryshme. Ndofta pamja më madhështore e Shkodrës,



Fig. 16 – E. Lir «Berati»



Fig. 17 – E. Lir «Kruja»

9) E. Lear, *Journals of a landscape of painter in Albania»* London 1851.

DO NOT COPY



Fig. 18 – E Lir «Ura e Bahçallëkut» (Akuarel) 1848

është nga shkëmbi në anën lindore të pazarit. Kështjella dhe malet sipër, qyteti i rrënuar poshtë, lumi që gjarpëron nën urë dhe shikon tutje, të gjitha këto të krijojnë një pikturë të mrekullueshme».[10] Pikërisht nga pika më madhështore e ka pikturuar Liri Shkodrën në litografinë e riprodhuar në libër. Aty pasqyrohet gjithë peizazhi i përshkruar në ditar. Madje, duke u nisur nga ky përshkrim si dhe të ndihmuar nga akuareli që përmendëm më sipër i cili është botuar në një libër të ri kushtuar Lirit.[11], vemë re se ura me harqe duket pjesërisht edhe në litografinë «Shkodra», diku në thellësi, midis gjelbërimit. Pra na dalin dy punime të Lirit që pasqyrojnë këtë monument me rëndësi, nga i cili nuk kemi thuajse asnjë të dhënë tjetër.

Te litografia «Gjirokastra» (fig. 19) paraqitet kalaja me bedenat dhe dritaret për vendosjen e topave, ashtu si në gravurën e autorit tjetër anglez që përmendëm. Aty pasqyrohet gjithashtu ujësjellësi i famshëm prej të cilit sot ruhen vetëm disa gjurmë. Vizatimi dhe trajtimi i Lirit është më realist se gravura, ku vihet re ndonjë ekzagjerim i përmasave, apo edhe ndryshim i relievit natyror. Kështu litografia e Lirit mbetet më besnike, merr më shumë vlerë në krijimin e saktë të përfytyrimit mbi dy monumentet më të rëndësishme të Gjirokastrës, e sidomos për ujësjellësin që nuk ekziston më. Me interes të tillë janë disa punime të tjera, pamje nga Vlora, akuarelet dhe litografitë për qytetin e Beratit, që siç pohon edhe vetë Liri, i ka lënë mbresa të veçanta. Më 14 tetor 1848 ai shkruan: «Më në fund arritëm në Berat, një qytet shumë piktoresk që i kaloi parashikimet e mia». Për Beratin, ashtu si për gjithë Shqipërinë ai kishte lexuar para se të nisej në udhëtim. Para se të vizitonte një vend Liri studionte çdo libër që mund ti kishte rënë në dorë për të marrë informacion më të plotë mbi natyrën fizike dhe historinë.[12] Për Shqipërinë ai kishte lexuar Likun,[13] Hjuzin[14] dhe udhëtarë të tjerë, ndërsa për Beratin kishte parë peizazhin e Çarl Kokrellit të vizatuar 25 vjet më përpara, një nga krijimet më të bukura të autorëve të huaj për këtë qytet. Megjithatë pamja reale e Beratit e entuziazmoi më shumë», «i kaloi parashikimet» e tij. Fillova të vizatoj menjëherë – shkruan Liri në ditarin e tij, pasi nuk ka kohë për të humbur në këtë vend kaq interesant. Gjatë katër ditëve që qëndroi në këtë qytet ai bëri dhjetra viza-

10) E. Lear, *Vep.cit,*
11) **Edward Lear 1812 – 1888,** London 1985.
12) **A leat from the Journals of a Landscape Painter,** Macmillan's Magasine, London Aprill 1897.
13) W.M. Leake, **Travels in Northern Greece,** London 1835.
14) Th.S. Hughes, **Voyage a Janina en Albanie,** Paris 1821.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 19 – E. Lir «Gjirokastra»

time, ndërsa kur u largua shkroi: «Po largohem nga Berati dhe nuk mund ta fsheh keqardhjen që po le mbrapa një pamje kaq madhështore». Një artist mund të shkojë lehtë në çdo kohë të jetës së tij për të parë Romën, Konstandinopojën, Jerusalemin por Beratin dhe Ilirinë nuk mund t'i rivizitojë lehtë».[15] Krahasimi me qytete të njohura të botës është njëkohësisht edhe një shprehje tjetër e admirimit të tij ndaj arkitekturës së veçantë të Beratit. Sot gjithë krijimet e këtij piktori vlerësohen si një fiksim i bukur i gjendjes së banesave karakteristike dhe monumenteve të tjera të arkitekturës në mesin e shekullit të kaluar.

Dhjetra vizatime dhe akuarele të Edit Durhamit paraqesin pamje të shtëpive, rrugëve, kështjellave e brendive, kryesisht të zonave veriore. Në dy vizatime që ka botuar në një nga librat e saj.[16] shihet interesi për të paraqitur banesat më karakteristike. «Kulla në Nikaj» është si një përmendore mbi shkëmb, po ashtu dhe dy kullat në «Katundin e vjetër», «Lurë», të lidhura midis tyre nëpërmjet katit të parë, ngjajnë tepër të veçanta dhe madhështore me ngritjen vertikale (fig. 20, 21). Vizatime të tilla Durhami botoi edhe në libra të tjerë të saj, si te: «Lufta për Shkodrën» (1914) dhe «Mbi origjinën e disa fiseve, kanune dhe zakone të vendeve të Ballkanit» (1928), ndërsa në akuarelet dhe vizatimet e tjera, që mori në Londër, janë ende të papopullarizuara. Pas hulumtimeve të zellshme të studiuesit anglez Uiliem Blend na u bënë të njohura shumë krijime të Durhamit, që paraqesin interes të veçantë për historinë e arkitekturës sonë si dhe për etnografinë, pasi në to janë pasqyruar veshje të ndryshme kombëtare, ornamente e gdhendje artistike.

Në akuarelet me pamje nga Shkodra, ajo ka pik-



Fig. 20 – E. Durham. Kull në Nikaj



Fig. 21 – E Durham, Katund i vjetër, Lurë

15) E. Lear, **Vep.cit,**
16) E. Durham, **High Albania,** London 1985.



Fig. 22 – E. Grand. Xhamia e Tiranës

turuar dyqane të zanatçinjve dhe argjendarëve me punime druri, si dhe lagje banimi me banesa karakteristike. Në arkivin e Institutin Mbretëror Antropologjik dhe Muzeun Halifaks të Londrës, ku ruhen akuarelet dhe vizatimet e Durhamit, gjenden gjithashtu dokumente, dorëshkrime, fotografi që kanë lidhje me vendin tonë. Aty ruhen foto të Durhamit me veshje kombëtare, shqiptare, fotografuar në Shkodër nga Marubi.

Etnografë, arkeologë e albanologë të tjerë që nuk vizatonin si Durhami, e cila ka qenë piktore profesioniste, shpesh merrnin me vete piktorë për të ilustruar studimet apo shënimet e tyre të udhëtimeve. Bashkë me Karl Paçin p.sh. erdhi piktori Gremi, i cili vizatoi disa objekte me rëndësi në vendin tonë. Me grupin e arkeologëve francezë në vitet 20 erdhi piktori E. Grand. Ai pikturoi peizazhe nga natyra e vendit tonë si akuarelin «Kodrat e gjelbëruara në Pojan» etj, por në krijimet e tij paraqiti kryesisht monumente të arkitekturës në Apoloni, Tiranë etj. Në një revistë arkeologjike që dilte në Paris[17] ka botuar tre vizatime me përmasa të mëdha, ku jep pamje të ndryshme të xhamisë së Tiranë, me interesin e një arkitekti, duke paraqitur deri në detaje pjesë të veçanta të godinës (fig. 22).

Pavioni me piktura për Shqipërinë, që u hap në Vienë, pranë ekspozitës etnografike e arkeologjike të vendeve të ballkanit, u përgatit nga piktorët Farnih, L. Forstner etj. pjesëtarë në ekspeditat arkeologjike dhe etnografike.[18]. Edhe ekspozita që u organizua në Shkodër më 1918 nga piktorët austrohungarezë përmbante shumë vizatime apo peizazhe me monumente të Apolonisë, me pamje të shtëpive karakteristike në Berat, si dhe zonat veriore të vendit.[19] Krijime të veçanta u realizuan gjithashtu nga autorë të tjerë që vinin në Shqipëri për të bërë peizazhe ku fiksonin ndërtime të banesave, kështjellave apo objekteve të tjera të arkitekturës (fig. 23).

Shpesh krijimet artistike janë shoqëruar me përshkrime mbi bukuritë e ndërtimeve tona, ose kanë ilustruar shënimet e udhëtimit ku flitet për to. Çifti anglez Kora e Xhon Gordon, kur arritën në Gjirokastër u shprehen në këtë mënyrë: «Mbasi pamë Tiranën, Elbasanin, Pogradecin, Korçën dhe Shkodrën, mbasi kishin parë shumë qytete të Jugosllavisë, gjetën në Gjirokastër një madhëri të shkëlqyer dhe një individualitet të theksuar. Nuk besojmë se do të ketë në botë një qytet tjetër si Gjirokastra. Ka pjesë përrallore. Në pjesën e banuar qëndron pika më magjike e qytetit. Mbi kodra të larta gjenden shtëpi trekatëshe me dhjetë dritare të gjera në fasadën kryesore, me ballkon të thellë që del jashtë mureve. . .»[20] Por këtë mrekulli të përshkruar me fjalë nuk mundën ta pasqyrojnë po kaq bukur me vizatimet dhe akuarelet e tyre. Megjithatë pamjet e

17) **Albania Revue d'archéologie, d'histoire d'art et des sciences appliquées** en **Albanie et dans les Balkans,** Paris 1924.
18) **Ekspozicion balkanik Universitet të Vienës,** «Posta e Shqipnies» Nr. 11, Shkodër 1918.
19) **Ekspozicion pikturash në Shkodër,** «Posta e Shqipnies» Nr. 40, Shkodër 1918.
20) J. Gordon and C. Gordon, **Two vagabonds in Albania,** London 1927.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 23 – K. Gordon «Rënime në Këlcyrë»



Fig. 24 – L. Heshaimes. Monument kulture në Tiranë



Fig. 25 – K Gordon «Pamje nga Elbasanit».

shumta që krijuan në vendin tonë, një pjesë të madhe prej të cilave (rreth 100) i botuan në librin «Dy udhëtarë në Shqipëri», paraqesin shumë interes. Veç ndërtimeve në Gjirokastër ato kanë realizuar dhjetra punime me ndërtime nga Tirana, Elbasani, akuarele me kulla të veriut si dhe shumë lloj ndërtimesh të tjera (fig. 24, 25). Në një tablo me ngjyra ato kanë pikturuar brendinë e një kishe në Përmet, ku vihet re një mjedis i pasur me piktura. Veç krijimeve të botuara në libër, çifti anglez me siguri ka realizuar akuarele e vizatime të tjera, ndoshta edhe tablo me ngjyra vaji të cilat mund të ruhen në ndonjë koleksion në Angli.

Gjithë veprat që përmendëm, patën rëndësi të madhe në kohën kur u krijuan se bënin të njohur në botë monumente të arkitekturës shqiptare, ku shpesh, siç janë shprehur edhe vetë autorët e këtyre punimeve, vihen re ndërtime madhështore dhe veçori të theksuara kombëtare. Ndërsa tani ato shërbejnë si dëshmi figurative për gjendjen e mëparshme të shumë objekteve, për ndryshimet që kanë pësuar kohë pas kohe. Ato shërbejnë, gjithashtu, si një ndihmesë konkrete për restauruesit, si bazë e rëndësishme dhe madje e pazëvendësueshme për të pasur parasysh origjinalitetin e monumenteve që kanë nevojë për ndërhyrje restaurimi.

Ferid HUDHRI.

DO NOT COPY

LES MONUMENTS CULTURELS DANS DES OEUVRES D'AUTEURS ETRANGERS

RESUME

Vers la fin du XVIIIe sc et le début du XIXe sc, beaucoup de voyageurs qui visitèrent l'Albanie, dessinèrent des objets et des monuments culturels afin d'illustrer leurs notes de voyage. C'est à cette période que remontent quelques dessins, liitographies et gravures intéressantes, représentant des objets qui n'ont pas pu résister jusqu'à nos jours. Parmi les meilleures raélisations on peut mentionner les gravures et les aquarelles de l'architecte anglais C. Cockerell. Le cadre «Vue de Berat» représente de nombreuses habitations variées. Au primier plan se dresse une habitation à un étage qui attire l'attention par la richesse de l'ornementation et la maestria de son exécution. Une telle représentation exprime l'enthousiasme de l'auteur pour la riche ornementation populaire. On remarque le même enthousiasme sur la peinture du joli pont sur le fleuve Osum, des habitations caractéristiques du quartier en face et de la forteresse qui s'élève sur la montagne.

Au cours du XIXe sc des dizaines de peintres étrangers visitèrent l'Albanie afin de reproduire des monuments anciens et d'autres objets caractéristiques contemporains. Une publication particulière de tous ces dessins éveille un grand intérêt puisqu'à travers les différents styles des auteurs elle représente la richesse de la culture albanaise. Parmi ces dessins nous pouvons rappeler ceux de H. Cook, G.F. Sargent, J. Kirchner, A. Bonamore, K. Woodwille etc. Les descriptions faites par des voyageurs inspirèrent quelques auteurs, qui réalisèrent des gravures sur l'Albanie, sans la connaître. D'autres dessins furent réalisés par des auteurs à des tendences romantiques qui souvent exagéraient les dimensions ou déformaient le relief naturel. Les auteurs déjà mentionnés sont plus rigoureux dans la reproduction des monuments culturels.

Même les paysages du peintre Edward Lear évoquent l'image de plusieurs objets et monuments culturels de notre pays. Au centre de quelques lithographies des villes de Shkodra, Durrës, Krujë, Gjirokastër, Berat, Butrint, se trouve la forteresse, alors que les lithographies des villes de Vlora, Tirana, Berat, reproduisent des maisons caractéristiques, des ponts etc. La forteresse de Kruja constitue la construction la plus monumentale reproduite par Lear. Mais, dans toute sa création, y compris les aquarelles et les tableaux plus récents, il n'y a que deux reproductions qui suscitent un intérêt particulier pour l'histoire de l'architecture albanaise; l'aquerelle «Le pont de Baçallëk» et la lithographie «Gjirokastra». La première fournit le seul témoignage figuratif du pont de pierre sur le fleuve Drin, près de Shkodra, alors que la deuxième trace la forteresse de Gjirokastra avec ces crénaux et ces meurtières, ainsi que le fameux acqueduc de cette ville dont on ne conserve que quelques traces.

Des dizaines de dessins et graphiques d'Edith Durhan donnent des vues de maisons, de routes de forteresses, essentiellement du Nord d'Albanie. Dans les deux dessins qu'elle a publiés dans un livre, on remarque la tendence à reproduire les habitations les plus caractéristiques. Les aquarelles avec des vues de Shkodra, peignent des ateliers-magasins, construits en bois, appartenant aux artisans et aux bijoutiers ainsi que des quartiers avec des habitations caractéristiques.

D'autres ethnographes, archéologues et albanologues, qui n'avaient pas le don de la peinture, amenaient souvent des peintres qui illustraient leurs études ou leurs notes de voyage. Ainsi, Patch vint en compagnie du peintre Grem qui dessina quelques objets importants de notre pays, tandis que le peintre E. Gronol accompagne dans les années 20 le groupe des archéologues français. Le pavillon des peintures sur l'Albanie, ouvert à Vienne auprès de l'exposition ethnographique et archéologique des pays balkaniques, fut préparé par les peintres Ferbich et L. Forstner qui accompagnaient les expéditions archéologiques et ethnographiques. Même l'exposition organisée par les peintres austro-hongrois en 1918 à Shkodra, comprenait plusieurs dessins et paysages des monuments d'Apollonie, des vue des maisons caractéristiques à Berat et aux régions septentrionales du pays.

Toutes ces peintures reproduisant des constructions importantes et des particularités nationales à l'époque de leur création contribuèrent à faire connaître dans le monde les monuments de l'architecture albanaise.

NR. 2

monumentet

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

NDËRTIME TË FORTIFIKUARA GJATË RRUGËVE MESJETARE NË SHQIPËRI (shek. XVIII-XIX)

Veç fortifikimeve që kontrollonin e ruanin shtigjet rrugore gjatë operacioneve e ekspeditave ushtarake, në mesjetë, gjatë rrugëve të karvaneve, kanë ekzistuar lloje të ndryshme ndërtimesh me karakter mbrojtës, me përmasa mjaft më të vogla, siç kanë qenë karakollet (kullat) rrugore, hanet dhe urat e fortifikuara. Mbështetur në gjurmët materiale dhe në burimet historike, në këtë artikull do të prekim këto lloje ndërtimesh rrugore, të ndërtuara kryesisht në kohën e pashallëqeve të mëdha shqiptare, të Ali Pashë Tepelenës, Bushatllinjve të Shkodrës e të Ahmet Kurd Pashës së Beratit, pra gjatë gjysmës së dytë të shek. të XVIII e fillimit të shek. XIX. Këta prijës kryen investime për ndërtime e mirëmbajtje rrugësh e urash. Ali Pasha e Ahmet Kurd Pasha i Beratit në fillim të karierës së tyre kanë ushtruar detyrën e «Derven Pashajt», ruajtësit e mirëmbajtësit të rrugëve të karvaneve tregtare. Në këtë kohë, sidomos nga Ali Pasha, gjatë rrugëve u ngritën kulla-roje, karakolle, që vilnin tatimin e kalimit nëpër këto rrugë të fshatarëve, apo karvaneve tregtare.[1] Karakollet ndërtoheshin në grykat e ngushticat ose në qafat malore, duke pasur veç funksionit të vjeljes së taksës rrugore dhe atë të ruajtjes së karvaneve nga grabitësit e ndryshëm.

Burimet historike bëjnë fjalë për mjaft karakolle rrugore si në veri, ashtu dhe në qendër e jug të vendit. Deri më sot, kemi mundur të gjurmojmë vetëm një karakoll të ruajtur në këmbë, i cili ruhet në Qafën e Çajupit, në rrethin e Gjirokastrës Karakolli i Çajupit, i cili në popull njihet me emrin «Tabor», njihet nga vendësit si ndërtim i Ali Pashë Tepelenës. Ai ndodhet në një zonë, e cila në atë kohë njihej si «Derven»[2], Krahina e Lunxhërisë, që nga ura e Subashit, ishte «Derven», pra ruante e mirëmbante rrugët e ngushticat malore nga kalonin karvanet tregtare. Karakolli i Çajupit është një ndërtim i ulët, cilindrik, me mure me rrasa guri të palidhura me llaç (fig. 1), Muret me trashësi 1,60 m, mbyllin një ambient me trajtë rrethore, me diametër e lartësi të njëjtë, 3,25 m. Ambienti, që ka vetëm tri kamare dhe një oxhak, mbulohet me një kupol të gurtë sferike. Hyrja e karakollit që ndodhet nga lindja, kontrollohet nga dy frëngji të pjerrëta, në të dy anët e saj. Karakolli i Çajupit ndodhet në zbritje të Qafës, rrëzë fushës piktoreske të Çajupit, pranë fshatit Zhej të Zagorisë. Veç tij, në krahinën e Lunxhërisë, ka pasur dhe një karakoll tjetër, në fshatin Qestorat, ku rruga e karvaneve dilte nga Lunxhëria e merrte për në Grykën e Selcës (fig. 2). Karakolli ndodhej mbi një breg në hyrje të fshatit. Sot prej tij ruhen vetëm mure të rrënuara. Gjurmë karakolli ruhen dhe në Grykën e Selces, poshtë fshatit, buzë lumit. Ky karakoll, me planimetri katërkëndëshe, që ruhet në gjendje rrënoje, kontrollonte rrugën Lunxhëri-Pogon-Greqi (fig. 3).

Përveç krahinës së Gjirokastrës, karakolle gjenden në rrugën Berat-Korçë, në Qafën e Gurit të Prerë pas Dusharit[3]) dhe në rrugën Durrës-Fushë e Tiranës – Dibër. Këtu, në Qafë Murrizë (fig. 4) në hyrje të fshatit Gur i Bardhë dhe në dalje të fshatit Klos, ka pasur karakolle që kontrollonin rrugën e mësipërme. Karakolle ka pasur dhe në rrugën e rëndësishme Shkodër-Prizren[4], siç ka qenë karakolli në Qafën e Aliut, pasi kalon Pukën dhe Hanin e Rapsit[5].

1) L. Mile, **Çështje të historisë agrare shqiptare,** Tiranë 1984, f. 333.
2) F. Pouqueville, **Vouage de la Greece,** T, II, Paris, 1826, f. 20.
3) A. Baldacci, **Itinerari Albanesi,** Roma, 1917, f. 492.
4) A. Boue, **Recueil d'itineraires dans la Turquie d'Europe,** T, I, Vienne, 1854, 322.
5) A. Baldacci, **vep. cit,** 467.

DO NOT COPY





Fig. 2 – Karakolli Qestorat



Fig. 1 – Karakolli i Çajupit



Fig. 3 – Karakolli Selcë

Edhe në rrugën Shkodër-Gucijë, gjatë luginës së Cemit, në Selcë, ka pasur disa karakolle që dominonin grykën e Cemit[6]. Karakolli tek Qafa e Gjakorit, në Rugovë të Kosovës, kontrollonte rrugën Shkodër-Përroi i Thatë – Gucijë-Pejë[7]. Veç karakolleve në qafat e ngushticat malore të rrugëve të njohura të karvaneve, ka pasur një sërë kullash, që kontrollonin hyrjet e daljet e rrugëve në fshatra (Kalasë të Delvinës, në Vithkuq të Korçës, etj).

Shpesh, në mungesë të karakolleve, gjatë grykave të ngushta malore për mbrojtjen dhe kontrollin e rrugëve, përshtateshin shpella natyrore shkëmbore, siç qenë shpella me mur e frëngji e Kllukëve në Shkallën e Zezës (Barkanesh – Krujë, (fig. 5), që vrojtonte rrugën Shkodër-Krujë-Dibër, shpella në Qafën e Lajthizës në fshatin Zall-Dajt, që kontrollonte rru-

6) Po aty, 462.
7) Po aty, 457.

DO NOT COPY



Fig. 4 – Qafa e Murizës



Fig. 5 – Shpella në Shkallën e Zezës – Krujë



Fig. 6 – Shpella e Lajthizës Zall-Dajt

gën Tiranë – Guri Bardhë – Dibër (fig. 6). etj. Këto shpella, mbronin karvanet në zonat e thella malore, ndaj një takse apo detyrimi që qiraxhinjtë e karvaneve i paguanin prijësit të zonës ku kalonte karvani.

Gjatë shek. XVIII-XIX, pranë rrugëve të karvaneve ekzistonin mjaft hane. Sipas burimeve dokumentare, qenë ndërtuar dhe hane të fortifikuara, ku kalonin natën qiraxhinjtë me karvanet tregtare. Një han i fortifikuar ka qenë tek ura e Madhe e Vezirit, buzë Drinit të Bardhë, ndërtim i Bushatllinjve i gjysmës së dytë të shek. XVIII, i cili i shërbente rrugës Shkodër--Prizren. Një tjetër han i fortifikuar ka qenë në rrugën Elbasan – Ohër. Ai ndodhej në bregun e djathtë të Shkumbinit, ndërmjet urës së Haxhi Beqarit dhe fshatit Labinot – Fushë. Në mesin e shekullit të kaluar A. Bueja e përmend këtë han në vendin e quajtur Strembe.[8] Një han i fortifikuar, që i shërbente Ahmed Kurd Pashës[9], ndodhej dhe në rrugën e Devollit nga Elbasani në Berat, diku pranë Gostimës. Ali Pashë Tepelena pat ndërtuar një han të fortifikuar në rrugën Janinë – Artë[10]. Hane të fortifikuara, gjatë shek. XVIII[11] pati dhe rruga Shkodër – Prizren.

Urat e fortifikuara janë mjaft të rralla në krahasim me numurin e madh të urave të tjera. Nga kronikat mësojmë se në vitin 1478, mbi lumin e Bunës ndodhej një urë e gjatë prej druri, e cila nga të dy brigjet mbrohej me nga një kullë të pajisur me municionet e nevojshme për ruajtjen dhe kontrollin e saj.[12] Ura e sipërme e Vezirit, mbi lumin Drin i

8) A. Boue, **vep. cit,** 268.
9) Pouqueville, **vep. cit,** T, III, 65.
10) Pouqueville, **vep. cit,** T, II, 264.
11) Pouqueville, **vep. cit,** T, III, 254.
12) M. Barleti, **Rrethimi i Shkodrës,** Tiranë 1982, 113.

Bardhë në Kukës, ishte urë e rëndësishme e rrugës së karvaneve Shkodër-Prizren. Kjo urë mbrohej në të dy anët e saj. Në njërën anë ndodhej një han me mure të larta me frëngji, ndërsa anën tjetër e mbronte një kullë e lartë e pajisur gjithashtu me frëngji.[13]

Në 20 vjetorin e parë të shek. XIX, kalaja e Gjirokastrës furnizohej me ujë nga Lazarati nëpërmjet një ujësjellësi, i cili afër kalasë kalonte mbi «Urat e Mëdha», një urë kanal me dy palë harqe. «Urat e Mëdha» mbroheshin prej një kulle – banese me tre kate pranë saj, në katin e parë të së cilës ishte një ambient i paisur me frëngji që shihnin nga qyteti si dhe një pus kontrolli për tubacionin e ujësjellësit të Kalasë.

DO NOT COPY

13) A. Boue, vep. cit, 322.

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

CONSTRUCTIONS FORTIFIEES LE LONG DES ROUTES MEDIEVALES EN ALBANIE (XVIIIe-XIXe SC).

RESUME

A part les fortifications qui contrôlaient les sentiers pendant les opérations ou les expéditions militaires, au Moyen Age, le long des routes des caravanes se situaient de différentes constructions de petites dimensions à caractère défenliés. Les traces matérielles et les sources historiques nous aident à traiter dans cet article ces types de construction routières réalisées essentiellement au temps des grands pachaliks albanais d'Ali Pacha de Tepelena, des Bushatllinj de Shkodra et d'Ahmed Kurd Pacha de Berat, donc au cours de la deuxième moitié du XVIIIe sc et du début du XIXe sc.

Les sources historiques font mention de plusieurs caracoles routières situées tant au nord qu'au centre et au sud de l'Albanie. Jusqu'à l'heure actuelle, nous n'avons pu étudier qu'une seule caracole conservée sur pied, celle du col de Çajup. Les gens du pays l'appellent «Tabor» et la considèrent une construction d'Ali Pacha de Tepelena. La caracole de Çajup représente une basse construction cylindrique avec des murs en dalles de pierres sèches. Il y a eu une autre caracole dans la région de Lunxhëri, au village Qestorat, là où la route des caravanes qui venait de Lunxhëri suivait le Col de Selca. Les traces d'une caracole en état de ruine se distinguent au Col de Selca.

On rencontre des traces de caracoles le long de la route Berat-Korçë, au Col de Guri i Prerë après Dushar, et le long de la route Durrës-Plaine de Tirana-Dibër. Ici, au Col de Murrizë, à l'entrée du village Guri i Bardhë, et près du village Klos, il y a eu des caracoles qui surveillaient cette route. D'autres caracoles se trouvaient le long de l'importante route Shkodër-Prizren, comme p.ex. celle du Col d'Ali à la sortie de Pukë et de l'Auberge de Raps. Même le long de la route Shkodër-Gucijë, dans la valée de Cemi, à Selcë, il y a eu quelques caracoles qui dominaient la bouche de Cemi. La caracole du Col de Gjakovë à Rugovë de Kosove, contrôlait la route Shkodër-Prroi i Thatë-Gucijë-Pejë. Les cols montagneux des importantes routes de caravanes étaient flanqués de tours qui surveillaient les entrées et les sorties des routes dans les villages (à Kalasë de Delvina, à Vithkuq de Korça etc).

Souvent au lieu des caracoles, dans les étroites gorges montagneuses, on adaptait les grottes rocheuses pour défendre et surveiller les routes comme p.ex. la grotte avec des murs et des meurtières des Kiluk à Shkalla e Zezë (Barkanesh-Krujë) qui surveillait la route Shkodër-Krujë-Dibër, la grotte au Col de Lajthizë au village Zall-Dajt, qui contrôlait la route Tiranë-Guri i Bardhë-Dibër etc.

Au cours des XVIIIe-XIXe sc, au bord des routes de caravanes furent installés plusieurs auberges. D'après les sources documentaires, il y a eu des auberges fortifiées où les caravaniers passaient la nuit. Au grand pont de Vezir, à la rive de Drini, se trouvait une auberge fortifiée (construction des Bushatllinj de la deuxième moitié du XVIIIe sc) qui servait à la route Elbasan-Ohrid. Il se situait sur la côté droite de Shkumbin, entre le pont de Haxhi Beqar et le village Labinot-Fushë. Une autre auberge fortifiée qui servait à Ahmed Kurd Pacha, se trouvait sur la route de Devoll de Elbasan à Berat, près de Gostime. Ali Pacha de Tepelena a fait construire une auberge fortifiée sur la route Janine-Arte. Au cours du XVIIIe sc des auberges fortifiées furent construites aussi sur la route Shkodër-Prizren.

Les ponts fortifiés ne sont pas nombreux en comparaison avec les ponts construits chez nous au cours du Moyen-Age et au temps des Pachaliks. Les chroniques mentionnent qu'en 1478 lors du deuxième siège de Shkodra par les turcs à travers le fleuve Buna passait un long pont en bois qui des deux côtés était flanqué d'une tour pleine de munition, pour protéger et contrôler ce pont.

Lors des 20 premières années du XIXe sc la forteresse de Gjirokastra s'approvisionait de l'eau venant de Lazarat au moyen d'un aqueduc. La construction la plus monumentale de cet aqueduc, faite construire par Ali Pasha de Tepelena, était «le grand viaduc» qui reposait sur deux rangées d'arcs. Ce viaduc était surveillé par une construction à plusieurs meurtières qui donnaient sur la ville.

DO NOT COPY

NR. 2 1987

monumente

DO NOT COPY

Kristofor NASLAZI

MËSUES KOSTANDINI DHE DISA NGA IKONAT E TIJ

Në këtë shkrim do të bëjmë fjalë për Mësues Kostandinin, ose si e shkruan ai në mbishkrimin e tij «Dhaskal Kostandini» dhe për disa nga ikonat e tij më të mira. Krijimi i tyre lidhet afërsisht në kohë me ndërtimin e kishës së Shën Mëhillit, e cila më vonë ka shërbyer si Mitropolia e Vithkuqit. Nga kjo kishë kemi mundur të identifikojmë 11 ikona të vogla të tij, ndërsa nga kishat e Vangjelizmoit dhe e Shën Gjergjit 6 ikona të mëdha dhe 2 fragmente ikonostasi. Duke i analizuar këto ikona, mendojmë të japim konsideratat tona historiko-artistike dhe, individualitetin artistik të këtij piktori për të plotësuar sado pak kuadrin e pikturës dhe të mjeshtërve mesjetarë që kanë punuar për Vithkuqin.

Katër ikonat e mëdha paraqitin «Shën Mërinë» (fig. 1), «Krishtin Kryehierark» (fig. 2), «Joan Pagëzorin» (fig. 3) dhe «Lindjen e Krishtit» (fig. 4). Fragmentet e ikonostasit paraqitin: e para -5 apostuj dhe e dyta – 8 apostuj. Ndërsa ikona tjetër «Pagëzori në këmbë» (fig. 5) vjen nga kisha e Shën Gjergjit. E vetmja ikonë në të cilën autori vendos emrin e tij është ajo e «Pagëzorit» (fig. 3), për të cilën jemi të mendimit se është më e bukura, më e arritura dhe më tipikja për karakterin e tij krijues.

Katër ikonat e para janë të pikturuara mbi grunt gipsi të shtrirë mbi panele druri me origjinë halore, të thelluara pak në të gjithë sipërfaqen, duke lënë anash një kornizë të ngushtë, të pikturuar me motiv të njëjtë floreal me ngjyrë ari.

«Pagëzori» (fig. 3) është kompozuar me pamje përballë, deri poshtë belit. Ai ka vështrim të përqendruar dhe zhbirues. Me dorën e djathtë bekon, ndërsa me të majtën mban të mbështetur në gjoks kanistrën me kokën e prerë dhe një pergamen të shpalosur, të shkruar me gërma kapitale greke. Pagëzori paraqitet me veshjen e tij karakteristike, lëkurën me krela dhe pelerinën që hidhet sipër saj. Me mjeshtëri janë punuar flokët dhe mjekra. Portreti, sytë i ka shumë shprehës. Karakteristikë e veçantë e tyre është vizatimi i kapakëve të sipërm me dy vijëza gati paralele që shoqërojnë harkun e tyre dhe stërgjaten horizontalisht jashtë mase. Mbi supet lartësohen gati në mënyrë simetrike dy krahët e shpendit, të cilat thyhen e zbresin thuajse vertikalisht në kufirin e kor-



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

nizës. Një vend të dukshëm zë brerorja e madhe me motive floreale të ngritura në reliev dhe me participin e shkruar në ngjyrë të kuqe. Ndërsa poshtë, përfund kornizës, në vend të zbukurimit me motive floreale, është shkruar me gërma kapitale greke, në ngjyrë të zezë, autorësia e veprës. «Me dorën e Më-

ΔνΘΧVΡΟ... ΔΑCΚΑΛΟC KONSΔNTVNOV

sues Kostandinit».

Megjithëse në këtë ikonë mungon data e piktu-rimit, mendojmë se ajo është e së njëjtës kohë me ikonat që do të trajtojmë më poshtë.

Ikona e dytë «Shën Mëria me Krishtin» (fig. 1) është e tipit përkëdhelës. Ajo është pikturuar vertikalisht, gjysmëpërballë, me Krishtin në prehër dhe me kokën e mbështetur në faqen e të birit. E gjithë figura kap 2/3 e sipërfaqes së pikturuar, pjesën tjetër e zë brerorja e artë e zbukuruar me motive floreale të ngritura në reliev dhe sfondi i artë e jeshil. Shën Mëria dhe Krishti kanë veshjen e tyre karakteristike: Shën Mëria me mafore dhe hiton, ndërsa Krishti me hiton e himation. Kjo ikonë, ashtu si edhe «Pagëzori», është pikturuar me ngjyra mjaft të kursyera. Të bën përshtypje psikologjia e portreteve dhe harmonizimi shpirtëror i tyre, që shprehet mjaft bukur me qëndrimin dhe gjestet e duarve. Theksohet mirë aty dashuria amësore dhe shqetësimi i mëmës për fatin e ardhshëm të të birit.

Fytyra dhe duart dallohen për volumet e plastikën e tyre, ndërsa palëzimet e veshjeve në përgjithësi kanë karakter grafik e dekorativ. Ato janë të sheshta, të ngurta, të mprehta dhe herë-herë e humbasin disi qartësinë e volumeve të trupit.

Në të dy anët, mbi supet, në sfondin jeshil dallohet një shkrim me gërma kapitale greke si

dhe data e pikturimit të ikonës. Nga viti i para-



qitjes së mishëruar të Jesu Krishtit 1685. Ikona tjetër e këtij autori «Krishti Kryehierark» (fig. 2) është pikturuar përballë deri poshtë belit me veshje hierarku dhe mitrën mbi kokë. Me dorën e djathtë ai bekon, ndërsa me të majtën mban një libër të hapur. Ndryshe nga Shën Mëria, gjymtyrët e sipërme të tij janë anemike e të vogla në krahasim me kokën. Sfondi, deri në lartësinë e supeve, ashtu si te Shën Mëria, është ngjyrë jeshile, ndërsa pjesa e sipërme, së bashku me brerorën është e artë. Në përgjithësi edhe këtu palëzimet e veshjeve janë të stilizuara, gati të drejta e të mprehta e që pothuajse e humbin plasticitetin e vërtetësinë. Portreti i Krishtit ka afërsi karakteri me Pagëzorin e Shën Mërisë dhe trajtohet me të njëjtën ngjyrë e teknikë. Vlen të theksojmë piktu-rimin e syve, të cilat i bën gati njëlloj te të tri figurat.



Fig. 6

Në sfondin e artë dallohet partecipi i Krishtit me ngjyrë të kuqe në kafe, ndërsa në të dy anët, paksa mbi supet, në sfondin jeshil, është shkruar me gërma kapitale greke: «O mbret i mbretërve dhe i zaptuesve





Fig. 4



Fig. 5



Fig. 7

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 8

të të zaptuarve dhe kryehierarku i madh».

Në bërrylin e krahut të djathtë është shkruar data e pikturimit të ikonës: «Në vitin 1685». Në brinjën e poshtme të kornizës, në vend të motivit floreal, piktori, shkruan formulën e zakonshme të lutjes:

ΔΕΗCV ΤΟΝΔΟΛΟΝ ΓΔΘΕΧ..... ЄΘ

«Mëshiro shërbëtorin e perëndisë»... Lutja nuk është e plotë, sepse ka rënë grunti dhe shtrati i pikturës.

Ikona e katërt, «Pagëzori në këmbë» (fig. 5), trajtohet më thjeshtë se tri të parat. Është pikturuar mbi një panel druri halor, i thelluar pak në pjesën ku pikturohet, duke lënë anash një kornizë me brinjën e sipërme në formë gjysmë harku. Pagëzori paraqitet në këmbë, në një nga pozat e tij tradicionale, përballë, me dorën e djathtë ai bekon dhe me të majtën mban kanistrën me kokën e prerë dhe një pergamen të shpalosur. Mbi supet ka krahët e shpendit me flatra të gjata. Dallohet veshja e tij nga lëkura me krela dhe pelerina. Në të gjithë ikonën mbizotëron ngjyra e gjelbër me nuanca të ndryshme. Bëjnë përjashtim sfondi, pjesët e mishta dhe kanistra me kokën e prerë. Palëzimet edhe te kjo ikonë janë shumë të stilizuara. Përjashtim në këtë figurë bën brerorja e artë, pa asnjë element zbukurimi. Në të dy anët e brerores janë shkruar participi i Pagëzorit i stilizuar si ornament, siç bëjnë shumë piktorë mesjetarë, p.sh. O-ja dhe S-ja janë stilizuar, ndërsa mbiemrin. Prodromos, autori e ka kompozuar në mënyrë të tillë që të lexohet në fillim: Pro, pastaj të rikthehemi te gërma «D» e vendosur mbi «P» e të vazhdojë përsëri «Dromos» si duket për arsye vendi. Sfondi në këtë ikonë trajtohet me dy ngjyra: i kuq sipër dhe jeshil poshtë. Mbi këtë sfond afër kërcirit të djathtë të këmbës është një shkrim me ngjyrë të bardhë me gërma greke:

«E shërbëtorit të perëndisë Marko Tele 1685».

Ndryshe nga ikonat një figurëshe, ikona e pestë (fig. 4) është me shumë figura dhe paraqet «Lindjen



Fig. 9



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY

e Krishtit». Megjithëse, kjo ikonë, është shumë e dëmtuar nuk do të na pengojë të gjykojmë për kompozimin dhe vlerat artistike të saj. Në qendër të kompozimit është vendosur Shën Mëria me Shën Josifin të gjunjëzuar përpara Krishtit foshnjë në sfondin e errët të një shpelle. Prapa figurës së Shën Mërisë janë vendosur dy figura barinjsh shumë të gjata, që shtjellohen vertikalisht. Ndërsa prapa Shën Josifit janë vendosur bariu dhe engjëlli lajmëtar. Poshtë Shën Mërisë e Josifit janë dadilat që lajnë foshnjën, ndërsa lart tre ëngjëjt dhe segmentet qiellore. I gjithë sfondi ku zhvillohen ngjarjet është shprehur me një stilizim të përgjithshëm të tokës, malit, bimëve e deri te veshjet e figurave. Relievin malor piktori e trajton grafikisht me disa njolla ngjyrë qielli, ndërsa tokën poshtë në formën e disa gjysmë harqeve në ngjyrën jeshile, për të dhënë idenë e kodrave. Mbi secilën kodër ai vendos nga një bimë me tre-katër kërcej e që kanë në majë të tyre nga një gjethe në ngjyrë të zezë. Trajtimi i bimëve në këtë mënyrë është një dukuri që vihet re në disa afreske të shek. XVII, te afreskat e kishës së Shën Mitrit në lagjen Kala Berat, te afresku i ekzonarteksit të kishës së Ristozit Mborje, si edhe te skena «Kurbani i Abrahamit» në krahun e majtë të absidës, te kisha e Shën Prodhomit Voskopojë. Gjithashtu, këto elemente i gjejmë në disa ikona të shek. XVII, që ndodhen në viset e tjera të Ballkanit[1].

Në këtë ikonë mungon kompozimi tradicional. Mavët janë hequr fare, ndërsa skena e cytjes së Shën Josifit nga djalli i shfaqur si bari ndryshon. Shën Mëria në këtë ikonë nuk paraqitet në shtratin e lehonërisë, por e gjunjëzuar para Krishtit. Kompozimi i skenës së lindjes së Krishtit në këtë mënyrë,

1) K. Weitzmann, M. Chatzudakis, K. Miatev, S. Rajdojçiç: **Ikone sa Balkana,** Beograd — Sofje 1972, f. 142, 145, 146, 148.

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

është një dukuri trajtimi në ikonat e shek. XVIII e XIX. Në veshjet për të gjitha figurat autori përdor tri ngjyra bazë: blunë, të kuqen dhe jeshilen me nuancat e tyre të errëta e të çelura. Këto ngjyra ai i vendos në mënyrë harmonike duke i këmbyer sipas veshjeve.

Pavarësisht se ikonat janë gjetur në tri kisha të ndryshme dhe që nuk e kanë të gjitha emrin e autorit, apo vitin e pikturimit, duke gjykuar nga stili i tij i veçantë, ngjyrat, tipat, karakteret dhe analiza e grundit, mendojmë se janë të një autori të vetëm, Mësues Kostandinit. Për t'u bindur në vërtetësinë e këtij mendimi do të mundohemi të japim disa argumente.

I. Të gjitha ikonat, si dhe dy fragmentet e ikonostasit janë punuar në panele druri me origjinë halore, me grunt gipsi.

II. Katër ikonat e para «Pagëzori», «Krishti Kryehierark», «Shën Mëria» dhe «Lindja e Krishtit» janë të thelluara në sipërfaqen e pikturës dhe kanë të njëjtën kornizë, të pikturuar me të njëjtin motiv, floreal në ngjyrë ari.

III. Pjesa e poshtme e sfondeve tek të gjitha ikonat e tij pikturohet me të njëjtën ngjyrë jeshile, ndërsa pjesa e sipërme e sfondit pikturohet me ar, me përjashtim të ikonës. «Lindja e Krishtit», që vetëm një pjesë të vogël të sfondit e ka të artë, si dhe ikonës «Pagëzori më këmbë», ku pjesa e sipërme e sfondit është e kuqe. Brerorët te tre portretet e parë janë të njëjta si motiv, të ngritur në reliev grundi dhe të lyer me ar, ashtu si edhe sfondi. Brerorët te ikonat me figura të plota, apo te portretet e apostujve në dy-

fragmentet e ikonostasit, piktori i mban të thjeshta, të arta dhe pa zbukurime.

IV. Karakteret dhe tiparet e portreteve janë gati të njejta; syte, vetullat, hunda, goja, mjekra, balli dhe flokët janë, pothuajse të njëllojta dhe përsëritin njëra-tjetrën te të gjitha portretet, si në vizatim, ashtu edhe në ngjyrat.

V. Draperitë, palëzimet e veshjeve dhe mënyra e stilizimit janë një tregues tjetër, që plotëson mendimin, se të gjitha ikonat janë pikturuar nga Mësues Kostandini. Ato kanë karakter të theksuar grafik, me viza të mprehta, të thyera dhe të lakuara sipas formave.

VI. Tek të gjitha ikonat janë përdorur katër ngjyra bazë, me nuancat e tyre të çelura e të errëta, ngjyra e kuqe, jeshile, blu dhe kafe. Ndërsa, pjesët mishtore për të gjitha portretet e ikonave, janë pikturuar njëlloj, me të njëjtën ngjyrë bazë-kafe, që kalon në drite me nuanca rozë dhe të bardhë.

VII. Së fundi, një tipar i përbashkët për të gjitha ikonat janë shkrimet, duke filluar që nga shkrimi ku jepet autorësia në ikonën «Pagëzori», deri te participet e apostujve, në dy fragmentet e ikonostasit. Autori në të gjitha shkrimet përdor një stil shkronjash, pavarësisht nga ngjyra apo madhësia. Shkronjat «G», «S», «E», janë shumë të veçanta dhe dalluese për këtë autor, nga një farë stilizimi apo zbukurimi shtesë që iu bën. Këto gërma të veçanta i gjejmë si në shkrimet e lutjeve, të kushtimit, përgamenat e pagëzorëve, në librin e hapur të Krishtit deri te participet e apostujve në dy fragmentet e ikonostasit.

Duke u mbështetur në këto dukuri të përbashkëta për të gjitha ikonat që trajtuam më sipër mendojmë se ato janë të një autori të vetëm, Mësues Kostandinit.

Nga sa kemi mundur të hetojmë na del se veprimtaria krijuese e këtij piktori është e kufizuar vetëm në ikonat e Vithkuqit, Mbase ky aktivitet i kufizuar i tij duhet spjeguar me faktin se në Vithkuq nga 14 kisha që ka patur, sot kanë mbetur vetëm katër. Rrjedhimisht mendojmë se ky autor mund të ketë pikturuar ndonjë prej kishave që nuk janë më. Tjetër fakt që mund të përforcojë këtë mendim është lidhur edhe me profesionin tjetër të këtij autori, atë të mësuesit, të cilin e thekson në mbishkrimet e tij. Për vendosjen e datës ai përdor të dy mënyrat, me numra dhe shkronja.

Duke patur parasysh sasinë e madhe të ikonave të gjetura në tri kishat e Vithkuqit dhe mungesën e gjurmëve të krijimtarisë së tij jashtë pellgut të Korçës, mund të mendojmë se ky piktor e ka ushtruar aktivitetin e tij brenda këtij pellgu dhe një pjesë e krijimtarisë së tij mund të jetë zhdukur me shkatërrimin e qyteteve të Vithkuqit e Voskopojës.

Piktura e Mësues Kostandinit lidhet me pikturën e shek. XVIII. Me aq sa kemi mundur të hetojmë në zonën e Shqipërisë Juglindore, atë nuk mund ta ndajmë nga ikonat e Postenanit, Llëngës, Ardenicës, si dhe nga afreskat e kishës së Shën Prodhomit në Voskopojë, të kishës «Shën Mitri», Berat dhe afreskut të ekzonarteksit në kishën e «Ristozit» Mborje. Ai vazhdon traditën e piktorit Andon Jeromonahut»[2] i cili ka qenë ktitor dhe piktor i afreskut të kishës së «Shën Prodhomit» Voskopojë, që për nga cilësia dhe niveli artistik është shumë i lartë. Vlen të përmendim midis të tjerash Shën Prodhomin dhe figurat në këmbë të Krishtit, Shën Mërisë, Joanit (fig. 12). Shën e Premtes (fig. 13), Shën Thanasit, e më interesantin, figurën ekspresive të Shën Ilias (fig. 14) që ndodhen në ekzonarteksin e kësaj kishe.

Piktura e Mësues Kostandinit qëndron brenda kuadrit te pikturës se këtij pellgu. Ky piktor së bashku me Kostandin Jeromonahun paraqesin një interes te veçantë si një moment kalimtar nga piktura e pasuesve të Onufrit te ajo e Davidit[3]. Por, veç këtyre, nuk mund të lemë mënjanë Semionin e Ardenices, apo Kostandin Nikollën, Andon Shipskiotin dhe piktorët e tjerë anonimë të ikonave të Vithkuqit, Nikolices etj. Kostandin Nikolla së bashku me Jeromonahun, janë paraardhës të Kostandin Shpatarakut, sepse piktura e këtij të fundit ka shumë afërsi me ta përsa i përket tipave dhe mënyrës së trajtimit, ashtu si mund të themi për lidhje më të afërta të pikturës së Andon Shipskës me atë të ikonave të Postenanit. Pra, mund të themi se piktura e Mësues Kostandinit ka disa elemente që e dallojnë nga piktorë të tjerë. Piktura e tij është disi e veçantë përsa i përket tipizimit të portreteve dhe skenave që trajton. Portreti i Pagëzorit është i rrallë dhe qëndron i papërsëritshëm krahas «Pagëzorit» të Postenanit. Ky piktor shquhet për një stil të veçantë të trajtimit dhe materializimit të palëzimeve dhe natyrës në përgjithësi. Stilizimi i tij nganjëherë në vende të veçanta e kalon kufirin e mundshëm të skematizmit duke kaluar në çmateria-

2) I.M. Qafëzezi: Dorëshkrim në arkivin e Muzeut Historik, Korçë. «Faltoret e vjetra të Voskopojës» (sipas kodikut të arkivës të manastirit të Shën Prodhomit).

3) Dh. Dhamo, **Piktorët shqiptarë të shek. 16-18-të dhe vepra e tyre në Shqipëri,** Studime Historike, ... f. 170.

DOKUMENT

lizimin e objekteve. Portretet e tij si dhe palat e veshjeve ndërtohen sipas një rregulli dekorativ të caktuar. Në disa raste ato shoqërojnë mjaft mirë volumet e trupit duke krijuar thyerje dhe palëzime në vendet e duhura. Pavarësisht nga stilizimi ato qëndrojnë më afër natyrës sidomos te portretet e apostujve në të dy fragmentet e ikonostasit (fig. 6, 7, 8, 9, 10, 11). Ndërsa tek ikonat e vogla dhe në 5 ikonat e mëdha (fig. 1, 2, 3, 4, 5) janë shumë të ngarkuara e të lenë përshtypjen e një ndërthurjeje linjash grafike të holla e të trasha, të konturuara këto me linja të tjera. Po me një rregullsi gati simetrike vetjake trajtohen flokët, krelat e veshjes së Pagëzorit, deri te valët e lumit. Në këto tri materie të ndryshme, piktori mban një qëndrim dhe trajtim të njëjtë. Këto dukuri vërehen sidomos tek ikona «Lindja e Krishtit». Por aty, meqenëse kemi të bëjmë me natyrën, piktori e stilizon atë. Kodrat dhe bimët janë dhënë tepër të stilizuara, po ashtu edhe shkëmbinjtë. Mënyra e dhënies së kodrave në formë gjysmë harku, që përsëritin njëra-tjetrën piktori i përdor edhe në 6 ikonat e vogla të kishës së «Shën Mëhillit».

Në të dy pjesët e ikonostasit, në portretet e apostujve, dallohet individualiteti i tij, sidomos theksohet kjo te fytyrat, flokët, mjekrat etj. Ato piktori i mban me shumë kontrast, me ngjyra të kursyera dekorative që dallohen qartë. Portretet janë vizatuar dhe piktuar, me ngjyra të ngrohta që kalojnë nga kafja në rozë e me sytë dhe flokët e theksuara grafikisht. Flokët dhe mjekrat janë konceptuar me nga dy vija paralele që përsëriten vazhdimisht në të gjithë sipërfaqen e tyre me një rregullsi të madhe sipas formës së kokës dhe mjekrës. Flokët jepen me ngjyra të çelura në kontrast me pjesët e errëta të fytyrave, kur është fjala për apostujt apo shënjtorët pleq, ndërsa flokët dhe mjekrat te apostujt e rinj ai i pikturon me ngjyra të errëta. Portretet e apostujve dallohen për një vizatim të saktë me propocione harmonike në raport me gjymtyrët dhe torsin, gjë që nuk vihet re te ikonat e mëdha që kanë më tepër pretendime, sidomos te ikona e «Pagëzorit», «Krishtit», dhe «Lindjes së Krishtit». Piktori edhe për veshjet e apostujve përdor katër ngjyra bazë, të kuqe, blunë, kafen dhe jeshilen, të harmonizuara këto sipas vendeve që zenë. Të gjithë pikturën e Mësues Kostandinit e përshkon në përgjithësi një konceptim grafik, ashtu si edhe te piktura e afreskeve të Ristozit, Shën Mitrit Berat.

Megjithëse ky piktor qëndron brenda traditës së artit pasbizantin mund të themi se tek ai dallohet edhe ndonjë dukuri e veçantë që përcakton individualitetin e tij krijues e që e dallon disi nga piktorët e tjerë para dhe pasardhës. Duke gjykuar në tërësi pikturën e tij mund të themi se ajo qëndron në radhën e pikturave më të mira të shekullit XVII në pellgun e Korçës.

POWER COPY

Kristofor NASLAZI

DO NOT COPY

MAITRE COSTANTIN ET QUELQUES-UNES DE SES ICONES

RESUME

Dans le fond du Musée de l'Art Médiéval Albanais on conserve également un grand nombre d'icônes apportées de Vithkuq. De l'église de Saint Michel on a pu identifier 11 de ses petites icônes, tandis que de l'église de l'Annonciation et de celle de Saint Georges six grandes icônes et deux fragments d'iconostase avec des apôtres. Quatre grandes icônes, deux fragments d'iconostase de l'église de l'Annonciation ainsi qu'une icône de l'église de Saint Georges, feront l'objet de notre étude.

Les qautre icônes représentent la Sainte Vierge (fig. 1) le christ Pantocrator (fig. 2) Jean Baptiste (fig. 3) et la Nativité (fig. 4). Le premier fragment de l'iconostase représente cinq apôtres et le deuxième huit apôtres de l'église de l'Annonciation tandis que l'icône «Jean Baptiste debout» (fig. 5) est apporté de l'église de Saint Georges. Les icônes la «Sainte Vierge», le «Christ Pantecrator», «Jean Baptiste» et la «Nativité» sont peintes sur des panneaux en bois d'origine conifère. Les quatre panneaux sont approfondis vers l'intérieur, laissant une mince corniche peinte du même motif floral en couleur d'or. Les deux fragments de l'iconostase, eux aussi réalisés en bois d'origine conifère, représentent des apôtres séparés l'un de l'autre par des colonnes surmontées d'arcs. L'icône «Jean Baptiste debout» apporteé de l'église de Saint Georges, est peinte sur un panneau en bois, approfondi au milieu et surmonté d'un arc.

Jean Baptiste (fig. 3) est peint de face vêtu de son habit caractéristique et avec des ailes éployées. Avec sa main droite il bénit alors que dans la main gauche il tient le disque avec la tête coupée ainsi qu'un parchemin déplié. Sa tête entourée d'une auréole avec des motifs floraux, est mise en relief.

La Sainte Vierge, représente la Sainte Vierge caressante composée presque de face, avec l'enfant Jésus sur les genoux, vêtue d'un maphore rouge et d'un chiton vert, tandis que l'enfant porte le chiton vert et le manteau rouge claire. Leurs deux têtes sont entourées d'une seule auréole avec des mofifs floraux en relief.

Le «Pantecrator» peint de face, dans un habit de hiérarque, porte sur sa tête un mitre surmonté d'une auréole en relief, avec des motifs floraux. Avec la main droite il bénit, alors que dans celle gauche, il tient un livre ouvert. «Jean Baptiste debout» est composé debout de face, flanqué de deux ailes à moitié déployées, bénissant avec la main droite et tenant dans sa main gauche le disque avec la tête coupée et un parchemin déplié.

Le visage de Jean Baptiste est assez allongé, et il porte son habit caractéristique. La tête est entourée d'une simple auréole. L'icône «La Nativité» diffère des autres icônes à une seule image, elle représente plusieurs images. Au centre de la composition se trouve la Sainte Vierge avec Saint Joséphe agenouillés devant l'enfant Jésus, sur un fond de grotte. A leur gauche on distingue deux bergers tandis qu'à leur droite sont peints l'ange annonciateur et le troisième berger. Tout au-dessus figurent les anges et les segments célestes, en bas c'est l'ablution de l'enfant Jésus. Il manque les Mages et la scène de la tentation de Josèphe par le diable. La Vierge ne se trouve pas sur son lit d'accouchée. L'icône de Jean Baptiste est la seule qui porte le nom de l'auteur. Dans la corniche inférieure, au lieu du motif floral on trouve l'inscription «Par la main du maître Costantin». Sur le fond vert de l'icône de la Sainte Vierge, au-dessus des épaules, on remarque en lettres capitales grecques la date de l'offre et celle de la réalisation de la peinture – «De l'année de la présentation déplorable du Jésus Christ 1685» –. De même, sur le fond vert de l'icône de Pantecrator, au-dessus des épaules, on distingue cette inscription: «Oh, le roi des rois et des conquérants des conquis et le grand Archihérarque» et au-dessous du coude de la main droite, on remarque en lettre et en chiffres l'année de l'exécution de la peinture.

Sur l'icône «Jean Baptiste debout» on distingue tout près de la jambe droite, une prière et l'année de l'exécution de la peinture. «Au serviteur de Dieu, Marko Tele, 1685». Malgré le fait que ces icônes sont trouvées dans trois églises différentes et ne portent pas toutes le signe de l'auteur et l'année de l'exécution l'application du même style, des mêmes couleurs, des mêmes motifs décoratifs, des mêmes enduits, nous oblige à les attribuer à un seul auteur – maître Costantin.

L'auteur n'utilise que quatre couleurs principales qui se marient bien. Le visage de «Jean Baptiste» (fig. 3) exprime un air suggestif, d'un regard concentré et scrutateur. Chez la Sainte Vierge et l'enfant Jésus on remarque leur accord spirituel, C'est avec maestria aussi que l'auteur a réalisé les cheveud, l'amour et l'inquiétude de la mère pour l'avenir de son fils. les barbes, les différents habits, etc.

D'après ce que nous avons pu constater, il ressort que l'activité principale de ce peintre est limitée seulement aux icônes de Vithkuq. Cela doit s'expliquer par le fait que des 14 églises de Vithkuq, il ne reste que 4. Donc, nous pouvons

admettre qu'il a peint l'une des églises, qui à l'heure actuelle n'existent plus non seulement à Vithkuq, mais à Voskopojë aussi Un autre fait, c'est la profession de maître, laquelle est bien soulignée dans ses icônes. Ayant en vue le grand nombre des icônes trouvées dans les églises de Vithkuq, ainsi que l'absence des traces de ses peintures en dehors de la région de Korça, on pense que ce peintre a travaillé seulement dans cette région et une partie de son travail a dû disparaître avec la déstruction des villes de Vithkuq et de Voskopoje. La peinture du maître Costantin demeure dans le cadre de la peinture du XVIIe sc., du sud-est de l'Albanie. On ne peut pas la séparer des icônes de Postenan, de Llëngë, d'Ardenicë, des fresques de l'église de Saint Prodhrome à Voskopojë, des fresques des exonarthex de l'église de Ristoz à Mborje et de Saint Dèmetre à Berat. Il poursuit la tradition du peintre Andon Jeromonaku en tant que peintre des fresques de Saint Prodhrome. Le maître Costantin et Costantin Jeromonaku représentent un intérêt particulier, un moment de passage de la peinture des successeurs d'Onufre à celle de David. De même, on ne peut pas laisser à l'écart Costantin Nikolla, Semion d'Ardenicë, Anton Shipskioti et d'autres peintres anonymes.

Castantin Nikolla et Costantin Jeromonaku sont les dévanciers de Shpataraku, parce la peinture de celui-ci ressemble beaucoup à la leur quant aux types réalisés, à la finesse et le mode de son traitement. Malgré le fait que la peinture du maître Constantin est caractérisée, en général, d'une conception graphique, nous pensons que ce peintre poursuit la tradition de l'art postbyzantin en apportant son individualité créatrice, ce qui le distingue d'une certaine manière des autres peintres prédécesseurs et successeurs. Nous pensons que sa peinture se range parmi les meilleures du XVIIe sc. dans la région de Korça.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë